



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në
gjuhën shqipe të romanit “*Plaku dhe deti*” të shkrimtarit amerikan
Ernest Heminguei**

**Punim për gradën Doktor
në Shkenca Gjuhësore/Përkthimore**

Kandidati

MA. Anejda Rragami

Udhëheqës shkencor

Prof. Dr. Viktor Ristani

Tiranë 2020



**Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Departamenti i Gjuhës Angleze**

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në
gjuhën shqipe të romanit “*Plaku dhe deti*” të shkrimtarit amerikan
Ernest Heminguei**

**Punim për gradën Doktor
në Shkenca Gjuhësore/Përkthimore**

Komisioni

- 1. Prof. Dr. Brikena Kadzadej (Kryetare)**
- 2. Prof. Dr. Shpresa Rira (Oponente)**
- 3. Prof. Asoc. Dr. Mirela Papa (Oponente)**
- 4. Prof. Asoc. Dr. Leonard Danglli (Anëtar)**
- 5. Prof. Asoc. Dr. Eda Shehu (Anëtare)**

Tiranë 2020

Deklaratë

Me anë të së cilës e nënshkruara deklaron me përgjegjësi të plotë se punimi është origjinal dhe paraqet pikëpamjet dhe studimin e saj mbi çështjen në fjalë.

Shembujt dhe referencat e përfshira në këtë hulumtim nuk bazohen në arsye subjektive, por janë të zgjedhura në mënyrë të tillë që t'i shërbejnë këtij rasti studimor.

Anejda Rragami

Mirënjohje

Në rradhë të parë, falenderimet më të sinqerta shkojnë për udhëheqësin tim shkencor, Prof. Dr. Viktor Ristanit, i cili me durim e përkushtim, si dhe falë udhëheqjes, sugjerimeve dhe profesionalizmit të tij bëri të mundur realizimin e këtij studimi. Profesorit tim të nderuar i jam jashtëmase mirënjohëse pasi më besoi një tematike, analizën përkthimore, e cila është mjaftueshmërisht e ndërlikuar, jo shumë e trajtuar dhe me rëndësi të vecantë për studimet aktuale përkthimore dhe ato që do të pasojnë. Shpresoj që t’ia kem shpërblyer deri diku të gjithë mbështetjen dhe përkushtimin e tij!

Së dyti, dua t’i shpreh mirënjohjen time Departamentit të Gjuhës Angleze dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës që më dhanë mundësinë të realizoj këtë hulumtim.

Gjithashtu, falenderime për koleget e Universitetit të Shkodrës, Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për mbështetjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm!

Së fundmi, nuk mund të lë pa përmendur dhe pa falenderuar familjen time të mrekullueshme. I jam thellësisht mirënjohëse prindërve të mi Fehmi dhe Rudina, vëllait tim Endrit si dhe te fejuarit tim Oltit, së bashku me familjen e tij për mbështetjen e tyre të vazhdueshme dhe çdo arritje e imja është falë dashurisë dhe përkushtimit të tyre ndaj meje.

Ky studim i kushtohet të gjithë personave të lartpërmendur, por edhe shpresoj që të merret si pikë referimi për studimet pasardhëse në këtë fushë studimi.

Pasqyra e lëndës

Hyrje	0
0.1 Përligjja e studimit	1
0.2 Objekti i studimit rezultatet e pritshme	1
0.3 Metodologjia e kërkimit dhe korpusi gjuhësor.....	2
0.4 Struktura e studimit	2
<u>Kreu I</u> Përkthimi si proces dhe ecuria e tij ndër vite	
I.1 Procesi i përkthimit dhe rëndësia e tij.....	4
I.1.1 Një përmbledhje e shkurtër e fillimit dhe ecurisë së procesit të përkthimit deri në ditët e sotme.....	4
I.1.2 Studimet mbi teorinë e përkthimit dhe llojet e tij.....	25
I.1.3. Metodatat e përkthimit.....	30
I.1.4 Qëndrimi i përkthyesit ndaj tekstit origjinal.....	33
I.2 Zhvillimet kryesore në fushën e përkthimit para viteve '90.....	35
I.2.1 Llojet dhe metodatat kryesore të përkthimit para viteve '90.....	36
I.3 Porcesi i përkthimit pas viteve '90.....	40
I.3.1 Llojet dhe metodatat kryesore të përkthimit pas viteve '90.....	41
I.4 Ndryshimet në metodikën e procesit të përkthimit në periudhën para dhe pas viteve '90.....	43
<u>Kreu II</u> <i>Plaku dhe Deti</i> i Ernest Heminguei nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona	
II.1 Pak mbi jetën dhe veprat e Ernest Heminguei.....	45
II.1.1 Plaku dhe Deti nga Heminguei.....	48
II.1.1.1 Një përmbledhje e shkurtër e veprës.....	49
II.1.2 Analizë e personazheve kryesorë të veprës.....	51
II.1.3 Tematikat dhe simbolet e trajtuara në vepër.....	52

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

II.2 Jeta dhe veprat e Ismail Kadaresë.....	55
II.2.1 Kadareja si përkthyes.....	57
II.2.1.1 <i>Plaku dhe deti</i> sipas Ismail Kadaresë.....	57
II.3 Kush është Vedat Kokona?.....	60
II.3.1 Kokona si përkthyes.....	61
II.3.1 <i>Plaku dhe deti</i> sipas Vedat Kokonës.....	61
<u>Kreu III</u> Vlerësimi dhe krahasimi i përkthimit në rrafsh të ndryshme	
A. III. Krahasim përkthimi i <i>Plaku dhe deti</i> nga Ismail Kadare dhe	
<i>Plaku dhe deti</i> nga Vedat Kokona në rrafshin gramatikor.....	63
A. III.1 Analizë krahasuese e strukturës së fjalisë.....	63
III.1.1 Rendi i fjalëve në fjali.....	63
III.1.2 Fjali me bashkrënditje apo nënrënditje?.....	66
III.1.3 Përkthimi i formës së ngurtësuar (ing-form).....	71
A. III.2 Analizë krahasuese e përdorimit të kohëve të foljeve.....	73
A. III.3 Analizë krahasuese e përkthimit apo jo të vetës së parë njëjës dhe shumës...76	
A. III.4 Analizë krahasuese mbi përdorimin e shenjave të pikësimit.....	78
B. III. Krahasim përkthimi i <i>Plaku dhe deti</i> nga Ismail Kadare dhe	
<i>Plaku dhe deti</i> nga Vedat Kokona në rrafshin leksikologjik.....	82
B. III. 1 Analizë mbi përzgjedhjen e fjalëve.....	83
B. III. 2 Përkthimi i emrave të përvetshëm.....	87
B. III. 3 Anglicizmat.....	92
C. III. Krahasim përkthimi i <i>Plaku dhe deti</i> nga Ismail Kadare	
dhe <i>Plaku dhe deti</i> nga Vedat Kokona në rrafshin stilistikor.....	97
C. III. 1 Krahasim i stilit përkthimor të Kadaresë me atë të Kokonës.....	101
C. III. 2 Analizë krahasuese e mjeteve stilistike.....	102
III.2.1 Përshtatja.....	107
III.2.2 Ekuivalenca.....	110

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

III.2.3 Transpozimi.....	118
D.III. Krahasim përkthimi i <i>Plaku dhe deti</i> nga Ismail Kadare dhe <i>Plaku dhe deti</i> nga Vedat Kokona në rrafshin pragmatik.....	122
D. III. 1 Rëndësia e kontekstit kulturor dhe historik si dhe ndikimi i tij në dy versionet e përkthyer të veprës.....	124
D. III. 2 Krahasim në përkthimin e idiomave dhe shprehjeve frazeologjike.....	127
<u>Kreu IV</u> Krahasim analitik mbi llojet e përkthimit të përdorura nga Kadareja dhe Kokona në dy versionet përkatëse të përkthimit të veprës <i>Plaku dhe deti</i>	
IV.1 Përkthim fjalë për fjalë.....	135
IV.2 Përkthim stukturor.....	138
IV.3 Përkthim besnik.....	140
IV.4 Përkthim semantik.....	142
IV.5 Përkthim me përshtatje.....	145
IV.6 Përkthim i lire.....	148
IV.7 Përkthim idiomatik.....	151
IV.8 Përkthim komunikues.....	156
<u>Kreu V</u> Përfundime	
V.1 Përfundime	160
V.2 Bibliografia.....	172

HYRJE

Përkthimi, apo më saktë studimet përkthimore, përbëjnë një tematike shumë të rëndësishme në ditët e sotme dhe mbi të cilat vazhdohet të hidhen teori të ndryshme në varësi të mënyrës së trajtimit dhe rëndësisë që u kushtohet aspekteve të vecanta në lidhje me procesin e përkthimit. Pavarësisht diskutimeve të vazhdueshme rëndësi i kushtohet faktit që përkthimi duhet të krijojë tek lexuesit e tekstit të përkthyer efekt sa më të afërt me atë të lexuesve të tekstit të burimit.

0.1 Perligjja e studimit

Përkthimi është shumë i hershëm. Fillesat e tij janë që në përdorimin e tij në trajtë gojore për nevoja të përditshme, për të kaluar pastaj në trajtë shkrimi me kthimin e Biblës nga hebraishtja e lashtë në greqishten e vjetër.

Ky studim përqëndrohet në një periudhë shumë më të freskët kohore së fillesat e përkthimit, pasi përqëndrohet në procesin e përkthimit para viteve '90 dhe pas viteve 90. Si pikë reference është trajtuar romani Plaku dhe deti i Ernest Hemingueit dhe dy versionet e tij të përkthyer në shqip nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona.

0.2 Qëllimi i studimit dhe rezultatet e pritshme

Ky studim synon të përmbush pikë së pari qëllimin e realizimit të një analize të detajuar të bazuar në dy versionet e përkthyer në shqip të veprës Plaku dhe deti të Heminguei, përkatësisht nga Ismail Kadare në vitin 1963 dhe nga Vedat Kokona në vitin 1997. Ky studim bëhet me synimin e analizimit të tipareve dhe vecorive të aspekteve të vecanta tek dy versionet e përkthyer të veprës origjinale, duke theksuar ngjashmëritë ashtu si dhe ndryshimet që ka pësuar metodika e përkthimit me kalimin e viteve. Duke krahasuar dy përkthime të dy periudhave të ndryshme, ky studim synon gjithashtu të nxjerri në dritë transformimet e mundshme që mund të kenë ndodhur në procesin e përkthimit si dhe në këtë mënyrë të përcaktoj rrjedhën që ka marrë përkthimi deri para disa vitesh duke na dhënë mundësinë të vërejmë nëse ato tipare vazhdojnë të jenë pjesë e procesit të përkthimit edhe në ditët e sotme.

Kjo temë është përzgjedhur pasi përbën një tematike shumë të rëndësishme, përkthimin dhe analizën përkthimore. Roli i përkthyesve në shoqërinë njerëzore vjen e bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Në gjithë historinë e njerëzimit, përkthimi do të luaj gjithmon një rol shumë të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm për zhvillimin e tij. Dhe të bësh analiz dhe krahasim të përkthimeve të dy përkthyesve shume të aftë siç janë Kadareja dhe Kokona të veprës së mirënjohur Plaku dhe deti e shkruajtur nga një prej shkrimtarëve me famë botërore Ernest Heminguei është sfidë dhe arritje më vete.

Ruzultatet e këtij hulumtimi do jenë shpërblyese dhe me rëndësi të vecantë pasi do të na mundësojnë të shikojmë qartë ecurinë e përkthimit gjatë këtyre viteve. Kështu do kemi

mundësi të konstatojmë ndryshime që mund t'i jenë ngjitur procesit të përkthimit rrugës deri në formën e tij aktuale, tipare të vecanta që më pare mund të mos kenë egzistuar, metoda apo ngjyrimë të ndryshme të cilat nuk i kemi vënë re më përpara. Megjithatë, përvec aspekteve dhe tipareve të mira dhe që mund të jenë në dobi të procesit përkthimor, ky studim na vë në dijeni të disa vecorive specifike të cilat mund të mos jenë në të mirë të përkthimit, si për shembull huazimi i tepërt i fjalëve të huaja.

Ky hulumtim mund të merret për bazë për studime të ndryshme akademike, të cilat kanë si qëllim analizën dhe krahasim e versioneve përkthimore të një vepre të mirënjohur për të dalluar tipare të vecanta dhe për të përcaktuar ecurinë e procesit të përkthimit për atë periudhë kohore.

0.3 Metodologjia e kërkimit dhe korpusi gjuhësor

Ky studim gërshëton aspektin teorik të procesit të përkthimit i cili në kreret tre, katër dhe pesë demonstron praktikisht me shembuj konkret për të ilustruar sa më qartë tiparet që duam të theksojmë. Pikërisht kjo ndërthurje përbën edhe metodologjinë e kërkimit të këtij hulumtimi, e cila mbështetet në vepra letrare shkencore të mirëfillta dhe bashkëkohore.

Ky hulumtim përbën dy korpusë gjuhësore (në anglisht dhe shqip) të cilat bëjnë të mundur realizimin e tij. Për vet natyrën e tij, analizë dhe krahasim përkthimi, duhet të ishin të përfshirë këto dy korpusë, ku në këtë rast korpusi në anglisht është vepra në gjuhën origjinale “The Old Man and the Sea” (Plaku dhe deti) nga Ernest Heminguej si dhe një gamë të përzgjedhur materialesh letrare shkencore për shfrytëzim të qëllimit dhe ilustrimit të studimit, si dhe korpusi gjuhësor shqip përbën dy versionet e përkthimit të veprës në gjuhën origjinale si dhe literature shkencore të pasur dhe bashkëkohore në shërbimin të shtjellimit të këtij dizertacioni.

0.4 Struktura e punimit

Ky dizertacion përbëhet nga pesë krere. Dy kreret e parë japin një pasqyrë teorike të studimit. Ndërsa kreu i dytë, i tretë dhe i katërt përbën thelbin e këtij studimi ku zhvillohet analiza dhe krahasimi përkthimor dhe kreu i fundit, apo kreu i peste, jep përfundimet, propozimet dhe ne fund bibliografinë e studimit.

Kreu i parë synon të paraqesë një panoramë në të cilën kërkon të përfshijë një përshkrim të shkurtër mbi përkthimin dhe procesin e përkthimit, si dhe ndalet më shumë në përkthimin, studimet përkthimore si dhe procesin e përkthimit për periudhën para dhe pas viteve '90.

Kreu i dytë jep një aspekt tjetër teorik, atë të prezantimit të tre autorëve, të cilat do jenë nën shqyrtim në këtë hulumtim. Vepra qëndrore e këtij dizertacioni është Plaku dhe deti nga shkrimtari i mirënjohur Ernest Heminguei, dhe dy shkrimtarët e tjerë jo më pak të rëndësishëm që janë pjesë e analizës së këtij dizertacioni janë Ismail Kadare dhe Vedat Kokona. Në këtë kre flitet për romanin në fjalë Plaku dhe deti si dhe për jetët dhe veprimtarit e këtyre tre autorëve.

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Kreu i tretë synon të filloj fazën e analizës së krahasim-përkthimit. Në këtë kre do gjejmë analizë në rrafshin: A. Gramatikor, B. Leksikologjik, C. Stilistikor, D. Pragmatik

A. Rrafshi gramatikor përqëndrohet tek ndryshimet gramatikore që mund të hasim në krahasimin që do t'i bëjmë dy përkthimeve.

B. Rrafshi leksikologjik synon gjithashtu të mbaj rritmin e kreut paraardhës, duke u përqëndruar në analizën leksikologjike. Në këtë kre dy përkthimet do të vlersohen bazuar në përzgjedhjen e fjalëve, përkthimin e emrave të përvetshëm si dhe një rëndësi e vecantë do t'i kushtohet edhe dendësisë së përdorimit të fjalëve të huaja në tekstin e përkthyer shqip.

C. Rrafshi stilistikor vazhdon me analizën e krahasim-përkthimit. Në këtë kre rëndësi e vecantë do t'i jepet stilit që përdorin përkthyesit tone për t'a transmetuar sa më qartë mesazhin e dhënë nga shkrimtari i veprës në gjuhën origjinale. Ky kre synon të theksoj mjetet stilistike si përshtatjen, ekuivalencën dhe transpozimin.

D. Rrafshi pragmatik i bën një mbyllje analizës krahasim-përkthimore. Në këtë kre theksohet rëndësia e kontekstit kulturor dhe historik si dhe ndikimi i tij në fushën e përkthimit, si dhe krahasimin në përkthimin e idiomave dhe shprehjeve frazeologjike.

Kreu i katërt synon të paraqesi metodat e ndryshme që kanë përdorur dy përkthyesit gjatë përkthimit të veprës nga gjuha origjinale në gjuhën mbrëritëse dhe **Kreu i pestë** e përbyll këtë punim me dhënien e përfundimeve , disa propozime dhe bibliografinë.

Kreu I

Përkthimi si proces dhe ecuria e tij ndër vite

I.1 Procesi Përkthimit dhe rëndësia e tij ndër vite

I.1.1 Një përmbledhje e shkurtër e fillimit dhe ecurisë së procesit të përkthimit deri në ditët e sotme

Kur flasim për historinë e përkthimit, na vjen të mendojmë për teoritë që kanë lindur në periudha të ndryshme kohore. Në fakt çdo periudhë është e karakterizuar nga ndryshime specifike në teoritë e përkthimit. Këto ndryshime sigurisht janë të ndryshme nga një vend në një vend tjetër. Për shkak me rradhë njerëzit besonin në lidhjen e përkthimit me historinë e kullës së Babelit në librin e Gjenezës.¹ Sipas bibles, pasardhësit e Noas, vendosën pas përmbajtjes së madhe të stabilizoheshin në tokën e Shinarit. Atje, ato bënë një mëkat të madhë. Në vend që të krijonin një shoqëri që i përshtatej vullnetit të Zotit, ata vendosën t’u sfidonin Atë dhe të ndërtonin një kullë që të arrinte Parajsën. Megjithatë ky plan nuk u përmbush pasi Zoti duke e ditur dëshirën e tyre, mori situatën nën kontroll përmes një strategjie linguistike. Ai bëri që ato të flisnin gjuhë të ndryshme në mënyrë që të mos kuptonin njëri-tjetrin. Pastaj, Ai i shpërndau ato në vende të ndryshme të botës.²

Pas kësaj ngjarjeje, numri i gjuhëve në botë u rrit dhe njerëzit filluan të kërkonin mënyra për të komunikuar dhe si rezultat lindi përkthimi. Me lindjen e shkencave përkthimore dhe rritjen e kërkimit në këtë fushë, njerëzit filluan të largoheshin nga historia e kullës së Babelit dhe filluan të kërkonin të dhëna specifike që shënonin periudhat e historisë së përkthimit. Kërkuesit pohojnë që shkrimet mbi përkthimin datojnë që në kohë të romakeve. Erik Xhakobson (Eric Jakobson) thotë që përkthimi është një shpikje romake. Ai thekson që Ciceroni dhe Horaci (shek I p.e.s) ishin teoricienët e parë të cilët bënë dallimin mes përkthimit fjalë për fjalë dhe përkthimit të mirëfilltë kuptimplotë.³ Një periudhë tjetër e cila shënon një pikë kthese në zhvillimin e përkthimit lidhet me Shën Xheromin (Saint Jeromy) për të cilin thuhet “Qasja e tij për të përkthyer biblen greke në latinisht do të ndikonte përkthimet e mëvonshme të shkrimeve të shenjta”.⁴

Në Mesjetë, Shkolla e Përkthyesve Toledo u bë pikë takimi e përkthyesve nga e gjithë Evropa në shekujt 12 dhe 13. Ata u vendosën në Toledo, në Gadishullin Iberian (që më vonë u bë Spanjë), për të përkthyer të gjitha veprat kryesore arabe dhe greke

¹ Dennis, Lane T, Justin, Taylor, Deckard, Grose, Sherah, *The Crossway ESV Study Bible*, R.R Donnelley & Sons, France, 2006, fq, 23

² Po aty, fq. 69-70

³ Lefevere, Andre, *Translatuon, History, Culture*, Routledge, London and New York, 2003, fq. 46

⁴Munday, J., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 87

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

filozofike, fetare, shkencore dhe mjekësore në Latinisht. Disa përkthime nuk bazoheshin në origjinalet e Greqisë, por në botimet e tyre arabe, që ishte e zakonshme në atë kohë. Të gjitha këto përkthime ndikuan në zhvillimin e filozofisë mesjetare evropiane, shkencës, mjekësisë astronomike dhe u përdorën për të prodhuar vepra të reja në gjuhët moderne.⁵

Roger Bacon, një studiues anglez i shekullit të 13-të, ishte i pari që vlerësoi se një përkthyes duhet të kishte një njohuri të plotë si të gjuhës origjinale ashtu edhe të gjuhës fundore për të prodhuar një përkthim të lezetshëm, dhe se ai gjithashtu duhet të jetë i përgatitur mirë në disiplinën e punës që ai ishte duke përkthyer.⁶

Në shekullin 15-të, pas themelimit të Akademisë Platonike rreth vitit 1440, studiuesi italian dhe përkthyesi Marsilio Ficino përktheu ose mbikëqyri përkthimin në Latinisht të të gjitha veprave të Platonit, "Enneads" të Plotinusit dhe veprave të tjera të Neoplatonistit. Puna e Ficino dhe botimi latin i Erasmus-it nga Testamenti i Ri çoi në një qëndrim të ri për përkthimin. Për herë të parë, lexuesit kërkuan rigorozitet në përzgjedhjen e fjalëve të sakta të Platonit dhe Jezusit (dhe Aristotelit dhe të tjerëve) si bazë për bindjet e tyre filozofike dhe fetare.⁷

Në shekullin e 16-të Martin Luther, një profesor gjerman i teologjisë dhe një figurë kryesore në Reformimin Protestant, përktheu Biblën në Gjermanisht në vitet e tij të mëvonshme (1522-34). Ai ishte studiuesi i parë evropian që vlerësoi se dikush përkthente në mënyrë të kënaqshme vetëm drejt gjuhës së tij, një thënie e guximshme që u bë normë dy shekuj më vonë. Botimi i "Biblës Luther" gjithashtu kontribuoi në zhvillimin e gjuhës moderne gjermane. Përkthimet e Biblës në gjuhë të tjera (Anglisht, Polonisht, Hollandisht, Frëngjisht, Spanjisht, Czechkisht Sllovene) ndihmuan zhvillimin e gjuhëve moderne në Evropë.⁸

Mbi përkthimin e bibles pati debate të ndryshme mes teoricienve për qindra vite. Konfliktet mbi përkthimin e bibles u përforcuan më shumë me ardhjen e reformimit në shek XVI, kur “përkthimi filloi të përdorej si një armë në konfliktet dogmatike dhe politike ndërsa shtetet filluan të krijoheshin dhe centralizimi i kishës filloi të dobësohej, gjë që vërtetohet në terma lingustik nga rënia e latinishtes si një gjuhë universale”.⁹

Për sa i përket Biblës, preokupimi i Kishës Katolike Romake ishte që kuptimi i saktë i vendosur i Biblës të mbrohej. Cdo përkthim që devijonte nga interpretimi i pranuar kishte të ngjarë të konsiderohej heretik dhe të censurohej ose ndalohej. Një fat edhe më i keq ishte i destinuar për disa prej përkthyesve. Shembujt më të famshëm janë ata të përkthyesit teolog anglez Uilliam Tajndejll (William Tyndale) dhe humanistit francez Etienne Dolet, të dy të djegur për këtë shkak. Tajndejll (Tyndale), një gjuhëtar shumë i zoti për të cilin thuhej se zotëronte dhjetë gjuhë, përfshirë hebraishten, Bibla e jashtëzakonshme në anglisht e të cilit u përdor më vonë si bazë për King James, u rrëmbye, u gjykua për herezi dhe u ekzekutua në Hollandë në 1536. Dolet u dënua nga

⁵ Po aty, fq. 25

⁶ Lebert, Marie, *History of Translation and Translators*, CC BY-NC-SA, 2019, fq. 43

⁷ Po aty, fq. 43-44

⁸ Po aty, fq. 45

⁹ McGuire. S, *Translation Studies*, London, Methuen, 1980, fq. 47-49

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

fakulteti teologjik i Sorbonne në 1546, pasi shtoj në përkthimin e tij të një prej dialogëve të Platonit frazën "rien du tout" ('asgjë fare') në një pasazh rreth asaj që ekzistonte pas vdekjes. Shtesa çoi në akuzën e blasfemisë, pohimi që Dolet nuk besonte në pavdekësi. Për një gabim të tillë të përkthimit ai u ekzekutua.¹⁰

Qasja më sistematike, dhe kryesisht e orientuar nga ana gjuhësore për studimin e përkthimit, filloi të shfaqej në vitet '50 dhe '60. Ka një numër shembujsh klasikë tani:

- Zhan-Paul Vinej dhe Zhan Dabernet (Jean-Paul Vinay dhe Jean Darbelnet) prodhuan prodhimet e tyre *Stilistikë krahasues të frëngjishtes dhe anglishtes: Një metodologji për përkthimin* (*Comparative Stylistics of French and English: A methodology for Translation*), (1958), një qasje kontrastive që kategorizonte ato që ata shikonin në praktikën e përkthimit midis frëngjisht dhe anglisht;

-Alfred Malblanc (1963) bëri të njëjtën gjë për përkthimin midis frëngjisht dhe gjermanisht;

-Georges Mounin *Problemet teorike te perkthimit* (*Les problèmes théoriques de la traduction*), (1963) shqyrtuan çështjet specifike të përkthimit;

-Eugjeni Nida (Eugene Nida) (1964) përfshiu elemente të gramatikës së atëhershme të modelit të Chomskit (Chomsky) si një themel teorik i librave të tij, të cilat fillimisht u hartuan për të qenë manuale praktike për përkthyesit e Biblës¹¹

Shekulli i 17-të njohu lindjen e shumë teoricienëve me influencë si: Sër Xhon Denhom (Sir John Denhom) (1615-68), Abraham Koulej (Abraham Kollei) (1618-67), Xhon Drajdën (John Dryden) (1631-1700), ky i fundit ishte i famshëm për dallimin e tij mes tre tipeve të përkthimit: metafrazim, perifrashim dhe imitim, si dhe Aleksandër Poup (Aleksander Pope) 1688-1744.¹²

Po në shekullin e 17-të, Migel de Servantes (Miguel de Cervantes), një shkrimtar spanjoll që shkroi romanin e famshëm "Don Kishoti" (1605-15), shprehu pikëpamjet e tij mbi procesin e përkthimit. Sipas Cervantes, përkthimet e kohës së tij, me përjashtim të atyre të bëra nga greqishtja në Latinisht, ndonjherë shikoheshin si një sixhade flamane nga ana e saj e kundërt. Ndërsa figurat kryesore të një sixhade flamane mund të dallohen, ato u errësuan nga temat e lirshme, dhe atyre u mungonte qartësia e anës së përparme.¹³

Nikolas Perrot D’Ablankort (Nicolas Perrot d’Ablancourt), anëtar i akademise se gjuhes frënge “Académie Française” dhe një përkthyes i Greqisë dhe klasikëve Latine, perdorte shprehje origjinale të modifikuara ose modernizuara rregullisht për arsye stili. Metoda e tij u bazua në praktikën e popullarizuar nga Valentin Conrart, themeluesi i “Académie

¹⁰ Munday, J, *Introducing Translation Studies*, London, New York, Routledge, 2001, fq, 23

¹¹ Po aty, fq, 9

¹² Po aty, fq 10

¹³ Lebert, Marie, *History of Translation and Translators*, CC BY-NC-SA, 2019, fq. 44

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Française”. Një vërejtje e autorit francez Gilles Ménage i dha lindje termit "the infidèle belle" (bukurosha e pabesë).¹⁴

Ménage shkroi se përkthimet e Perrot d'Ablancourt "më kujtojnë një grua që unë e doja shumë në Tours, e cila ishte e bukur, por jo besnike"¹⁵. Termi "belle infidèle" u popullarizua më vonë nga Voltaire.

Në shek. 18-të, përkthyesi krahasohej me një artist me detyrën morale ndaj punës së autorit origjinal dhe lexuesit. Për më tepër, me zhvillimin e teorive të reja dhe volumet e procesit të përkthimit, studimi i fushës së përkthimit filloi të ishte më sistematik. Vëllimi i Aleksander Frejzer Tajtler (Aleksander Fraser Tytler) “Parimet e Përkthimit” 1791 është një nga studimet më me influencë të publikuara në atë kohë.¹⁶

Në shekullin e 18-të pati një debat mbi "Besnikërinë" dhe "transparencën", të cilat u përkufizuan si ndërhyrje të ideve të dyfishta, ndërsa shpesh ishin në kundërshtim. "Besnikëria" është shkalla në të cilën një përkthim jep saktësisht kuptimin e tekstit origjinal, pa shtrembërim, duke marrë parasysh vetë tekstin (lëndën, llojin dhe përdorimin), cilësitë e tij letrare dhe kontekstin e tij shoqëror ose historik. "Transparenca" është shkalla në të cilën rezultati përfundimtar i një përkthimi qëndron si një tekst i vetvetes që mund të ishte shkruar fillimisht në gjuhën e lexuesit, dhe përputhet me gramatikën, sintaksën dhe idiomën e saj.¹⁷

Shek. 19-të u karakterizua nga dy konflikte. I pari e konsideronte përkthimin si kategori e mendimit dhe e shikonte përkthyesin si një gjeni krijues, i cili pasuronte letërsinë dhe gjuhën në të cilën ai po përkthente. Konflikti i dytë e shikonte përkthyesin përmes funksionit mekanik të të bërit të një teksti apo të berit të një autori të njohur në gjuhën që po përkthente. Sic pohon dhe Snell-Hornby “kjo periudhë njohu gjithashtu zhvillimin e romanticizmit i cili çoi në krijimin e shumë teorive dhe përkthimeve në fushën e letërsisë, veçanërisht në poezi.¹⁸

Po në këtë shekull, Fridrih Shlajermajer (Friedrich Schleiermacher), një teolog gjerman, filozof dhe studiues biblik, zhvilloi teorinë e përkthimit "jo transparent". Në ligjëratën e tij "Për metodat e ndryshme të përkthimit" (1813), Schleiermacher dalloi midis metodave të përkthimit që lëviznin shkrimtarin drejt lexuesit, d.m.th. transparencë, dhe ato që e shtynë lexuesin drejt autorit, d.m.th. një besim ekstrem ndaj huajësisë së tekstit burimor. Schleiermacher favorizoi qasjen e dytë. Dallimi i tij midis "zbutjes" (sjellja e autorit te lexuesi) dhe "huajizimi" (marrja e lexuesit te autori) frymëzoi teoricienët e shquar të shekullit të 20-të.¹⁹

¹⁴ Po aty

¹⁵ cituar në Amparo Hurtado Albir, *La notion de fidélité en traduction*, Didier Érudition, 1990

¹⁶ Lebert, Marie, *History of Translation and Translators*, CC BY-NC-SA, 2019, fq. 44

¹⁷ Po aty, fq. 45

¹⁸ Snell-Hornby, Mary, *The Turns of Translation Studies: New Paradigms or Shifting Viewpoints?*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam, Philadelphia, 2006, fq. 56

¹⁹ Lebert, Marie, *History of Translation and Translators*, CC BY-NC-SA, 2019, fq. 45

Në gjysmën e dytë të shek. 19-të, studimet në fushën e përkthimit u bënë një tematike e rëndësishme në mësimdhënien dhe studimin në shkolla. Ajo çka i shtoi vlerën, ishte krijimi i një shumëllojshmërie metodash dhe modelesh përkthimore.²⁰ Për shembull, metoda e përkthimit gramatik studionte rregullat gramatikore dhe strukturat e gjuhëve të huaja. Modeli i përkthimit kulturor ishte gjithashtu dëshmi e zhvillimit të studimeve përkthimore në atë periudhë. Përkthimi kulturor kishte rëndësi të veçantë sepse përveç përkthimit kishte të bënte edhe me analizen kulturore të shoqërive të ndryshme.

Një model tjetër që u shfaq në këtë periudhë është modeli i përkthimit të bazuar në mesazhin e tekstit i cili përqëndrohej në idenë e përgjithshme të tekstit dhe jo në fjalë apo fjali specifike. Pjesë të kësaj periudhe janë edhe qasjet pragmatike dhe sistematike të përkthimit. Ndër figurat kryesore të kësaj periudhe mund të përmendim Zhan-Pol Vinej dhe Darbelnet (Jean-Paul Vinay and Darbelnet) 1958, Xhon Ketford (John Catford) 1965 dhe Juxhin Najda (Eugene Nida) 1964.²¹

Ndër vite, përkthimi është përkufizuar në mënyra të ndryshme. Sipas Manfredpërkthimi mund të konsiderohet “edhe proces edhe produkt”.²² Në mbështetje të këtij përkthimi Bell sugjeron që të bëhet një ndarje mes përkthimit si proces, përkthimit si produkt dhe përkthimit në përgjithësi, pra asaj që vjen si rezultat i bashkimit të këtyre dy të fundit. Sipas tij, “përkthimi përfshin disa lloje tekstesh duke filluar nga ato letraret deri tek tekniket”.²³ Shuttelworth dhe Kouï (Schuttleworth dhe Cowie) theksojnë se “sot përkthimi përfshin edhe forma të tjera si p.sh ai audiovisual”.²⁴

Nga, ana tjetër, sipas Haliday (Halliday) “përkthimi është një process i cili bën të mundur të krijohet një lidhje mes dy gjuhëve dhe lexuesve të këtyre dy gjuhëve”.²⁵ Ndërsa Hatim dhe Mandej (Hatim and Munday) theksojnë se “përkthimi mund të analizohet në dy këndvështrime: si proces i cili i referohet kalimit të një mesazhi nga një gjuhë në tjetërën dhe si produkt që i referohet tekstit të përkthyer”.²⁶

Në vitin 1963, teoristi francez, Mounin e përkufizonte përkthimin si “një seri veprimesh nga të cilat pika fillestare dhe produkti përfundimtar janë tregues të një kulture të caktuar”.²⁷ Ndërsa sipas Basnet (Bassnett) “në përkthim vihet gjithmonë theksi tek lexuesi dhe se përkthyesi duhet t’a sjellë tekstin origjinal në gjuhën e përkthimit në atë formë që të jetë një version sa më i ngjashëm me origjinalin”.²⁸ Si rezultat, theksohet ideja

²⁰ Po aty, fq. 58

²¹ Po aty, 67-68

²² Manfred, M, *Translating Text and Context: Translational Studies and Systematic Functional Linguistics*, vol. 1, Cagliari, CUEC, 2008, fq. 89

²³ Bell, R.T, *Transaltion Theory: Where are we going?* London, META, 1991, fq. 13

²⁴ Shuttlworth.M, Cowie. M, *Dictionary of Translation Studies*, St. Jerome, Manchester,1997, fq. 112

²⁵ Halliday, M.A.K., Hasan, R. *Language, Context and Text: Aspects of Language in a Social-semiotic Perspective*. Deakin University Press/Oxford University Press, Australia/Oxford, 1989, fq. 90-91

²⁶ Hatim, Basil dhe Munday, Jeremy. *Translation: An advanced resource book*. NewYork: Taylor&Francis e-Library, 2004, fq. 116-117

²⁷ Mounin,G. *Les problèmes théoriques de la traduction*, Paris: Gallimard, 1963, fq. 167

²⁸ Bassnett-McGuire, Susan, *Translation Studies*, London, Methuen, 1980, fq. 23

që përkthyesi rekomandohet të ketë parasysh se nuk mund të jetë “autori” i tekstit në gjuhën e përkthimit.

Mandey (Munday) thekson faktin se përkthyesi nuk mjafton të ketë vetëm zotësinë e përkthimit por edhe aftësinë e përthithjes së tekstit në gjuhën origjinale dhe mesazhit të synuar duke u shprehur kështu: “Kur merremi me përkthim, besojmë fort se kjo nevojë është edhe më e fortë. Shkathtësia në dy gjuhë, të origjinalit dhe të përkthimit, nuk është qartësisht e mjaftueshme për t'u bërë një përkthyes kompetent”²⁹ Me fjalën “nevojë” ata i referohen aftësisë që duhet të ketë përkthyesi për të hyrë në bredësi të tekstit, për t'a kuptuar dhe pse jo edhe ndjerë atë në mënyrë që rezultati përfundimtar, teskti i përkthyer, të jetë sa më i suksesshëm në transmetimin e mesazhin të synaur nga autori tek lexuesit.

Në ditët e sotme kërkimet mbi fushën e përkthimit kanë filluar të marrin një rrugë tjetër e cila është më automatike. Shpikja e internetit së bashku me zhvillimet e reja teknologjike në fushën e komunikimit kanë rritur shkëmbimet kulturore mes kombeve. Kjo i bëri përkthyesit që të kërkonin për mënyra se si të përballeshin me këto ndryshime dhe të perdornin teknika praktike që i mundësonin atyre që të përkthenin më shumë dhe të humbisnin më pak. Ato gjithashtu e kishin të nevojshme të hynin në botën e përkthimeve kinematografike, gjë që solli lindjen e përkthimit audio-viziv.³⁰

Për t'a mbyllur këtë pjesë hyrëse të këtij kapitulli kemi menduar të sjellim një shtrirje kohore të përkthimeve dhe përkthyesve në vite të hartuar nga Marie Lebert në punimin e saj *Historia e perkthimit dhe e perkthyesave*³¹ që vijon si më poshtë:

- Shekulli II pes > Terence, një dramaturg romak diskutoi rolin e përkthyesit si një urë lidhëse për vlerat "e tejkalimit" të betejës së kulturës.
- 55 pes > Cicero, një burrë shteti romak, orator, avokat dhe filozof, ishte një përkthyes nga Greqisht në Latinisht. Në dialogun e tij "On Orator" ("De Oratore", 55 pes), ai paralajmëroi duke përkthyer "fjalë për fjalë" ("verbum pro verbo"): "Unë nuk mendoja se duhej t'i numëroja [fjalët] lexuesit si monedha, por për t'i paguar ato sipas peshës, ashtu siç ishin."
- 405> Jerome, një teolog dhe historian romak i njohur gjithashtu si Shën Jeronim, përfundoi në 405 përkthimin e Biblës nga Hebraishtja origjinale në Latinisht, një përkthim i njohur si "Vulgate". Në "Letrën drejtuar Pammachius" -it (396), Jerome deklaroi se një përkthim nuk duhet të jetë "fjala për fjalë, por kuptim për kuptimin" ("non verbum e verbo sed sensum de sensu"). Pas trazimit të kundërshtimit, "Vulgata" e tij u miratua gjerësisht dhe u bë Bibla Latine më e përdorur në shekullin e 13-të. Këshilli i Trentit e quajti Biblën zyrtare të Kishës Katolike Romake në 1546.

²⁹ Hatim, Basil dhe Munday, Jeremy. *Translation: An advanced resource book*. NewYork: Taylor&Francis e-Library, 2004, fq. 134

³⁰Po aty, fq. 136

³¹ Lebert, Marie, *History of Translation and Translators*, CC BY-NC-SA, 2019, fq. 47-63

- 425> Përkthyesit e Shenjtë - një grup studiuesish armenë (Mesrop Mashtots, Isaku i Armenisë, Movses Khorenatsi, Yeghishe dhe të tjerët) - përfunduan në 425 përkthimin e Biblës nga Greqishtja dhe Sirishtja në Armenisht. Ata gjithashtu përkthyen letërsinë greke dhe siriane, për shembull vepra nga Athanasius of Alexandria, Cyril of Jeruzalem, Gregory of Nazianzus, Gregory of Nyssa, John Chrysostom dhe Ephrem Sirian. Bibla e Përkthyesve të Shenjtë përdoret akoma sot në liturgji të Kishës Armene dhe një Festë e Përkthyesve të Shenjtë festohet çdo vit në Tetor.
- 735> Bede, një murg, shkrimtar dhe studiues anglez, përktheu Ungjillin e Shën Gjonit në anglisht të vjetër gjatë dyzet ditëve të fundit të jetës së tij në 735, pasi prodhoi shumë përkthime nga Greqisht në Latinisht. Latinishtja ishte akoma gjuha kryesore në Angli. Besohet se Bede ka thënë: "Gjithë ka mbaruar" para se të vdiste. Ai i bëri veprat Greke nga Etërit e Kishës së hershme më të arritshme për bashkëkombasit e tij Anglo-Saksone, duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin e Anglezisë Kristiane.
- 840-873> Hunayn ibn Ishaq, një mjek dhe shkencëtar Nestorian (i krishterë), ishte përkthyesi kryesor i Lëvizjes për Përkthim Greqisht-Arabisht në Shtëpinë e Urtësisë, një qendër kryesore intelektuale në Bagdad, nga 840 në 873. Veprat Greke të filozofisë, matematika, shkenca natyrore dhe mjekësia u përkthyen në arabisht, që ato të ishin në dispozicion të studiuesve në të gjithë botën islamike. Hunayn ibn Ishaq përktheu 116 vepra vetë (Testamenti i Vjetër dhe shumë vepra nga Platoni, Aristoteli, Galeni i Pergamonit dhe të tjerët) duke mbikëqyrur ndërkohë edhe punën e përkthyesve të tjerë. Një tjetër përkthyes kryesor ishte Qusta ibn Luqa për vepra të astronomisë dhe mekanikës. Një përkthyes i tretë kryesor ishte Thābit ibn Kurra për vepra nga Ptolemeu, Arkimedi dhe Euklidi. Të gjitha këto përkthime sollën njohuri greke në civilizimin arab.
- 880? > Alfredi i Madh, Mbreti i Wessex në Angli, filloi një program ambicioz rreth vitit 880 për të përkthyer nga latinishtja në anglisht librat që ai konsideronte "më të domosdoshëm për të gjithë njerëzit që të kenë dije", ndërsa promovuan arsimin fillor në anglisht në një kohë kur Latinishtja ishte akoma gjuha standarde. Alfredi i Madh përktheu disa vepra në anglisht, duke përfshirë "Pastor Care" Papa Gregori I, "Ngushëllimi i Filozofisë" të filozofit Boethius, "Soliloquies" të teologut Augustine, te pesëdhjetë psalmet e para të Psalterit dhe "Libri i Eksodit" të Vulgate. Të gjitha këto përkthime kontribuan në përmirësimin e prozës angleze.
- 1040-90> Tangutët, të cilët ishin një bashkim fisnor Tibeto-Burman që banonte në Kinën Veri-perëndimore diku para shekullit të 10-të dhe që flisnin gjuhën Tangut, përkthyen të gjitha veprat budiste nga gjuha kineze

në gjuhën Tangut dhe prodhuan 3.700 fashikuj në një përpjekje kolektive gjatë një periudhe kohore prej pesëdhjetë vjetësh (1040-90). Burimet bashkëkohore përshkruan perandorin e perandorisë Tangut dhe nënën e tij duke kontribuar personalisht në përkthim, përkrah sherebave të kombësive të ndryshme.

- 1125-1284? > Shkolla e Përkthyesve Toledo u themelua rreth vitit 1125 si një pikë takimi për studiues nga e gjithë Evropa. Shumë studiues u vendosën në Toledo për të përkthyer të gjitha veprat madhështore dhe mjekësore nga arabishtja dhe greqishtja në latinisht (në shek. XII) dhe Kastiliane (në shek. XIII) dhe i vunë njohuritë arabe dhe greke në dispozicion të grupeve të tyre në Evropë. Disa përkthime nuk bazoheshin në origjinalet greke, por në botimet e tyre arabe, që ishte e zakonshme në atë kohë. Të gjitha këto përkthime ndikuan në zhvillimin e shkencës mesjetare, astronomisë dhe mjekësisë në Evropë dhe u përdorën për të prodhuar vepra të reja në gjuhët moderne.
- 1136-38> Platoni i Tivolit (i njohur edhe si Platoni Tiburtinus), një matematikan dhe astronom italian, prodhoi dy përkthime kryesore nga arabishtja në Latinisht: "Libri i Lindjes" i astrologut arab Albohali "1136" dhe (nga versioni i tij arabisht) astronom Grek dhe "Tetrabiblos" (1138) e astrologut Ptolemeu, një vepër autoritare mbi filozofinë dhe praktikën e astrologjisë.
- 1138> Abraham bar Hiyya, një shkencëtar dhe filozof hebre, përktheu "Tetrabiblos" të Ptolemeut nga arabishtja në Hebraisht në 1138.
- 1138-43> Hermani i Carinthia, një filozof dhe shkencëtar i Evropës Lindore, përktheu veprat astronomike Greke Arabiane në Latinisht, për shembull "Libri sextusastronomie" i Sahl ibn Bishr-it (1138), "Introducori i astronomisë" i Abu Ma'shar-it. "Elementet" e Euklidit (1140) dhe "Planisphaerium" të Ptolemeut dhe "Canon of Kings" (1143). Përkthimet e tij popullarizuan njohuritë arabe dhe greke në Evropë dhe ndikuan në zhvillimin e astronomisë mesjetare evropiane. Herman nga Carinthia gjithashtu përktheu tekste fetare mbi Islamin nga arabisht në Latinisht, duke përfshirë "De genere Muhametet nutritura eius" dhe "Doctrina Muhamet", me ndihmën e përkthyesve të tjerë. Këto përkthime u prodhuan me kërkesën e Peter Venerable, abati i Abbey Benediktinit i Cluny, Francë, gjatë vizitës së tij në Gadishullin Iberik në 1142.
- 1140? > Filozofi anglez Adelard i Bath përktheu "Elementet" e matematikanit Grek Euklid - një traktat i përbërë nga 13 libra - nga arabisht në Latinisht rreth vitit 1140. Përkthimi i tij u përdor më vonë nga matematikani italian Campanus i Novara për të prodhuar një nga librat e parë matematikë të shtypur në 1482 , që u bë libri kryesor në shkollat matematikore evropiane në shekullin e 16-të.

- 1140? > John of Seville, një studiues i pagëzuar i Judenjve, iu bashkua Shkollës së Përkthyesve të Toledo-s gjatë ditëve të para të vitit 1140, me Dominicus Gundissalinus dhe studiues të tjerë, dhe përktheu veprat kryesore arabe të astrologjisë, astronomisë, filozofisë dhe mjekësisë nga Arabisht Latinisht, për shembull të filozofit arab Qusta ibn Luqa "De diffiaia Spiritus et animae", dhe disa vepra të astronomit Al-Farghani dhe nga astrologët Abu Ma'shar al-Balkhi dhe Albohali. Gjoni i Seviljes gjithashtu përktheu (nga versioni arabisht) "Secretum secretorum", një letër e shkruar nga filozofi grek Aristoteli për studentin e tij Aleksandrin e Madh.
- 1143> Robert i Ketton, një teolog dhe astronom anglez, përktheu "Lex Mahumet pseudoprophete", përkthimi i parë i njohur i Kuranit nga arabisht në Latinisht në 1143, me ndihmën e Hermanit të Karinthisë dhe përkthyesve të tjerë. Përkthimi u prodhua me kërkesën e Peter Venerable, abati i Abbey Benedikti i Cluny, Francë, gjatë vizitës së tij në Gadishullin Iberik në 1142, dhe mbeti botimi standard Latin i Kuranit deri në shekullin e 18-të.
- 1160? > Filozofi spanjoll Dominicus Gundissalinus përktheu filozofin persian Avicenna "Liber de filozofia prima" dhe "De anima" nga arabishtja në Latinisht rreth vitit 1160, duke kontribuar në përhapjen e doktrinaeve të Avicenna-s në shekullin XIII.
- 1175> Studiuesi italian Gerard i Kremones përktheu astronomin grek Ptolemeu "Almagest" - një traktat mbi lëvizjet e dukshme të yjeve dhe shtigjeve planetare - nga arabishtja në Latinin 1175, pasi udhëtoi në Toledo për të lexuar versionin arab. Pasi u anëtarësua në Shkollën e Përkthyesve Toledo, ai përktheu 87 vepra madhore nga arabishtja dhe greqishtja në latinisht gjatë gjithë jetës së tij - vepra të shkruara fillimisht në arabisht (nga al-Khwarizmi dhe Jabir ibn Aflah), botime greke të veprave arabe (nga Alfraganus) dhe vepra shkruar fillimisht në greqisht (nga Archimedes, Euclidand Aristotle).
- 1220? > Samuel ibn Tibbon, një filozof dhe mjek hebre, përktheu filozofin hebre Maimonides "Udhëzuesi për të hutuar" nga versioni i tij origjinal arabisht në rrethin hebraik1220. Vetë Maimonides dërgoi udhëzime për përkthimin dhe vlerësoi aftësinë dhe njohurinë e përkthyesit. Samuel ibn Tibbon gjithashtu përktheu vepra të tjera të Maimonides, si dhe vepra të filozofit musliman Averroes dhe të filozofit grek Aristotel.
- 1225? > Michael Scot, një matematikan dhe studiues skocez, mbikëqyri - së bashku me Hermannus Alemannus - përkthimin e veprave të filozofit grek Aristotelit nga arabisht në Latinisht me kërkesën e mbretit të Sicilisë Frederick II. Skot përktheu vetem tre vepra ("Historia animalium", "De anima" dhe "De coelo") rreth vitit 1125, si dhe komentet e filozofit musliman Averroes për këto vepra.

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

- 1267? > William of Moerbeke, një dominikane flamane, përktheu veprat e Aristotelit direkt nga dorëshkrimet Greke Bizantine (që u humbën më vonë) në Latinisht, me kërkesën e filozofit Thomas Aquinas. Deri atëherë, shumica e përkthimeve latine të veprave të Aristotelit ishin bazuar në botimet siriane ose arabe. William of Moerbeke përktheu "De anima", "Retoric" (përkthim i ri latin) dhe "Politika" (në dispozicion në gjuhën latine për herë të parë) rreth vitit 1267. Këto përkthime të mirëfillta ("De verbo en Verbo"), besnike ndaj shpirtit të Aristotelit, u bënë klasikët standardë dhe akoma respektohen nga studiuesit modernë.
- 1382-84> Gjon Uajklif (John Wycliffe), një filozof dhe teolog anglez, drejtoi në 1382-84 botimin e parë Anglez të Biblës të përkthyer nga latinishtja në anglisht, bazuar në Latinishten "Vulgate" dhe e quajti "Bibla e Wycliffe's". Wycliffe përktheu Ungjijtë e Mateut, Markut, Llukës dhe Gjonit dhe mund të jetë i gjithë Testamenti i Ri, ndërsa shoku i tij Nicholas i Hereford përktheu Testamentin e Vjetër. Përkthimi kontribuoi në përmirësimin e prozës angleze ende të pazhvilluar të asaj kohe. Pas vdekjes së Wycliffe, "Bibla e Wycliffe" u rishikua në 1388 nga ndihmësi i Wycliffe John Purvey. Një botim i dytë i rishikuar u arrit në 1395. Sot ka ende 150 dorëshkrime të plota ose të pjesshme të "Biblës së Wycliffe" në formën e saj të rishikuar.
- 1385? > Geoffrey Chaucer, një poetë dhe filozof anglez i njohur për historitë e tij të Canterbury, përktheu filozofin romak Boethius "Ngushëllimi i Filozofisë" nga latinishtja në anglisht, dhe poetin francez Guillaume de Lorris "Romanca e Rozës" ("Le Roman de la rose ") nga frëngjishtja në anglisht rreth vitit 1385. Chaucer gjithashtu prodhoi përkthime dhe adaptime të disa veprave, për shembull vepra të poetit italian Giovanni Boccaccio që u bënë baza të versioneve të përkthyer si "Përrallën e Knight "të Chaucer-it dhe" Troilus and Criseyde ". Si një përkthyes dhe përshtatës gjenial, Chaucer themeloi një traditë poetike angleze bazuar në përkthime dhe përshtatje të veprave letrare latine dhe frënge, dhe promovoi përdorimin letrar të anglishtes së mesme në një kohë kur gjuhët dominuese letrare në Angli ishin ende latinishtja dhe frëngjishtja.
- 1440? > Pas themelimit të Platonic Academic, studiuesi italian Marsilio Ficino përktheu ose mbikëqyri përkthimin nga Greqishtja ose Arabishtja në Latinisht të të gjitha veprave të Platonit, "Enneads" të Plotinusit dhe vepra të tjera Neoplatoniste rreth vitit 1440.
- 1471-85> William Caxton, një tregtar anglez, përktheu në anglisht "Recuyell of the Historyes of Troye", një romancë franceze me drejtësi franceze e shkruar në 1464 nga Raoul Lefèvre, dukë i Burgundy. Përkthimi i Caxton u përfundua në 1471 dhe u shtyp në Bruges, Belgjikë, në 1473. Botimi në anglisht pati një numër shume të madh shitjesh. Në

vazhdën e këtij sukcesi, Caxton ngriti një shtypshkronjë në 1476 në Westminster Abbey, për të shtypur "Taleset e Canterbury" të poetit anglez Geoffrey Chaucer dhe përkthimin e tij të "Recuyell of the Histores of Troye". Caxton përktheu vepra të tjera, për shembull "Legjenda e Artë" e kronistit italian Jacobus da Varagine (shtypur në 1483, 1487 dhe 1493), "Libri i Kullës së Knightin" (fab. 1484) fisniku francez Geoffroy IV de la Tour Landry. "Fabulat" e fabulistit Aesop (shtypur në 1484), "Metamorfozat" e poetit romak Ovid (shtypur në 1484) dhe "Le Morted'Arthur" i autorit anglez Thomas Malory (shtypur në 1485). Përkthimet e Caxton ndihmuan në standardizimin e dialekteve të rajoneve angleze në një "dialekt në Londër" që u bë gjuha standarde angleze.

- 1485> Autori anglez Thomas Malory prodhoi në 1485 "Le Morte d'Arthur", një përkthim falas dhe adaptim i romancave Arthurian, me Mbretin legjendar Arthur dhe shoqëruesit e tij letrarë Guinevere, Lancelot, Merlin dhe Kalorësit e Tabelës së rrumbullakët. Malory përshtati tregimet ekzistuese Franceze dhe Angleze ndërsa shtoi materiale origjinale, për shembull tregimin "Gareth" si një nga tregimet e Kalorësve të Tabelës së rrumbullakët. "Le Morte d'Arthur" ishte një moment historik në letërsinë angleze dhe prezantoi Epokën e Madhe të prozës angleze.
- 1516> Studiuesi dhe teologu Hollandez, Erasmus prodhoi një botim latin të Testamentit të Ri duke mbledhur disa dorëshkrime të latinishtes "Vulgate" dhe duke polimizuar tekstet latine për të krijuar një botim të ri kritik në 1516. Erasmus sinkronizoi, unifikoi dhe azhurnoi njëkohësisht latinishten dhe Botimet Greke - të dyja ishin pjesë e traditës kanunore - dhe i bënë të dy botimet "të pajtueshme", që do të thotë se ai redaktoi botimin Latin për të pasqyruar botimin Grek, dhe anasjelltas. Për shembull, pasi gjashtë vargjet e fundit të "Librit të Zbulesës" mungonin në dorëshkrimin Grek, Erasmus përktheu këto vargje përsëri në Greqisht nga "Vulgate". Botimet në latinisht dhe greqisht të Erasmus të Testamentit të Ri ishin me ndikim në Reformimin Protestant dhe në Kundërreformimin Katolik.
- 1522-34> Teologu gjerman Martin Luther, një figurë kryesore në Reformimin Protestant, përktheu Biblën nga hebraishtja dhe greqishtja në gjermanisht në vitet e tij të mëvonshme. Ai për herë të parë përktheu Testamentin e Ri (1522) para se të përkthente Testamentin e Vjetër dhe Apokrifën (1534). "Bibla e plotë" nuk ishte Bibla e parë në dispozicion në gjermanisht, por u vlerësua si më e mira. Përkthimet e mëparshme bazoheshin në Latinishten "Vulgate" dhe jo në tekstet origjinale, dhe teksti gjermanisht ishte shumë më i varfër. "Bibla Luther" kontribuoi në zhvillimin e gjuhës gjermane dhe krijimin e një identiteti kombëtar gjerman. Luther ishte gjithashtu studiuesi i parë evropian që vlerësoi se "dikush përkthehen në mënyrë të kënaqshme vetëm drejt gjuhës së tij", një thënie që u bë normë në shekullin e 18-të.

- 1525> Studiuesi anglez William Tyndale prodhoi një botim të ri të Biblës në anglisht, të përkthyer direkt nga tekstet hebraike dhe greke. "Testamenti i Ri Tyndale" (1525) u vlerësua si përkthimi i parë i saktë i Testamentit të Ri në anglisht. Pas përkthimit të “New Testament”, Tyndale filloi të përkthente Testamentin e Vjetër dhe përktheu gjysmën e tij. Ai u bë një figurë udhëheqëse në Reformimin Protestant para se të dënohej me vdekje për posedimin e palicencuar të shkrimit në anglisht. Pas vdekjes së tij, përkthimi i tij u krye nga një prej ndihmësve të tij. Me shpikjen e fundit të shtypshkronjës, "Bibla Tyndale" u bë bibla e parë angleze e prodhuar në masë. Ajo u zëvendësua nga "Bibla e Madhe" në 1539.
- 1539> Myles Coverdale, një reformator kishtar dhe predikues anglez, prodhoi botimin e parë të plotë të Biblës në anglisht, të quajtur "Bibla e Madhe" (1539) dhe bazuar në "Bibla Tyndale" (1525), me kërkesë të Thomas Lord Cromwell , gjeneral periferik dhe sekretar i Mbretit Henry VIII të Anglisë. Paragrafët kundërshtarë të "Biblës Tyndale" u rishikuan dhe pjesët që munguan (disa libra të Testamentit të Vjetër dhe Apokrifia) u shtuan. “Bibla e Madhe” u pasua më vonë nga “Bibla e Peshkopëve” (1558) dhe “Bibla e Mbretit James” (1604-11).
- 1559-65> Shkrimtari francez i Rilindjes Franceze Zhak Amyot përktheu biografën dhe eseistin grek "Jetët paralele" nga Greqishtja në Frengjisht. Përkthimi i tij, i quajtur "Vies des hommes illustres" (1559-65), i lexuar si një vepër origjinale, u bë shumë i njohur dhe ndikoi në shumë shkrimtarë francezë. Filozofi francez Montaigne shkroi: "Unë i shtrëngoja dorën Jacques Amyot nga të gjithë shkrimtarët tanë francezë, jo vetëm për thjeshtësinë dhe pastërtinë e gjuhës së tij në të cilën ai i tejkalon të gjithë të tjerët, jo për qëndrueshmërinë e tij për kaç gjatë një ndërmarrje, jo për mësimin e tij të thellë (...) por unë jam mirënjohës ndaj tij, veçanërisht për mençurinë e tij në zgjedhjen e një veprë kaç të vlefshme.” Botimi frëngjisht u përkthye në anglisht nga Thomas North në 1579.
- 1578> Margaret Tyler, e cila ndoshta ishte shërbëtore e familjes katolike Howard, përktheu romancën spanjolle të Diego Ortúñez de Calahorra "Espejo de príncipes y caballeros" në anglisht nën titullin "Mirrour of Princely Bates and Knighthood" në 1578. Përkthimi i saj i përafrohej tekstit origjinal, me qartësi të preferuar për elegancën rrjedhëse të origjinalit. Përkthimi i tij u bë bestseller, megjithë disa kritika sepse tema e saj mashkullore dhe laike konsiderohej e papërshtatshme për një grua. Përkthyeset e grave duhej të përkthenin vepra fetare, në përputhje me faktin se edukimi i grave duhet të promovojë devotshmërinë. Në "Letterto lexuesin" e saj, Margaret Tyler protestoi kundër këtyre kufizimeve, insistoi në seriozitetin dhe rëndësinë e veprës letrare nga gratë, dhe propozoi që si gratë ashtu edhe burrat duhet të trajtohen si qenie të barabarta.

- 1579-1603> Thomas North, një oficer gjyqësor dhe ushtarak anglez, përktheu biografin grek dhe eseistin Plutarch "Jetë paralele" nga përkthimi frëngjisht i Jacques Amyot, dhe prodhoi tre botime (1579, 1595 dhe 1603). Sipas “Enciklopedia Britannica” (1911), “është pothuajse e pamundur të mbivlerësohet ndikimi i anglishtes energjike të North mbi shkrimtarët bashkëkohorë, dhe disa kritikë e kanë quajtur atë mjeshtri i parë i prozës angleze.” Përkthimi i North nga “Jeta paralele” ishte një nga burimet e Romanit të Shekspirit "Julius Caesar", "Coriolanus" dhe "Antony and Cleopatra". Në "Antony and Cleopatra", Shekspiri kopjoi ose adaptoi shumë fjalime të përkthyer nga North, një praktikë e zakonshme në atë kohë sepse idetë moderne të pronësisë intelektuale nuk ekzistonin në ato ditë.
- 1593> Polaku Jesuit Jakub Wujek përktheu Biblën nga latinishtja "Vulgate" në polonisht pasi iu dha leja zyrtare për të ndërmarrë një punë të tillë nga Papa Gregori XIII dhe Rendi Jezuit. Botimi i parë i "Biblës Jakub Wujek" ("Biblia Jakuba Wujka") u përfundua në 1593. Edicioni i plotë i autorizuar u përfundua në 1599, dy vjet pas vdekjes së Wujek. “Bibla Jakub Wujek” zëvendësoi “Biblën e Leopolitës” (1561) si Biblën kryesore të përdorur nga Kisha Katolike Romake në Poloni. Përkthimi i Biblës nga Wujek u njoh si një përkthim i shkëlqyer dhe një vepër madhore letrare dhe kontribuoi në zhvillimin e gjuhës polake. Ajo u bë Bibla zyrtare polake për katër shekuj, para se të zëvendësohej nga "Bibla e Mijëvjeçarit" (1965).
- 1604-11> 47 përkthyes - të gjithë ata studiues dhe anëtarë të Kishës së Anglisë - prodhuan “King James Bible” (1604-11), një përkthim kryesor i Biblës në anglisht, me 39 libra për Testamentin e Vjetër (përkthyer nga greqishtja, 27 libra për Testamentin e Ri (përkthyer nga greqishtja dhe latinisht) dhe 14 libra për Apokrifën (përkthyer nga hebraishtja dhe aramenishtja). Përkthyesve iu dhanë udhëzime për të siguruar që përkthimi i ri të përputhej me eklezologjinë dhe të pasqyronte strukturën episkopale të Kishës së Anglisë dhe besimin e saj në klerikë të shuguruar. “Bibla e Mbretit James” ishte përkthimi i tretë në anglisht që u aprovua nga Kisha Angleze, pas “Biblës së Madhe” (1539) dhe “Biblës së Peshkopëve” (1568). Gjithashtu u vlerësua si një arritje letrare, me efekte të qëndrueshme në gjuhën dhe kulturën angleze.
- 1637-62> Nicolas Perrot d’Ablancourt, një anëtar i Académie Française në Paris dhe një përkthyes i klasikëve grekë dhe latine nga 1637 deri në 1662, i cili mkishte tipar të tijin modifikimin e shprehjeve origjinale për arsye stili. Metoda e tij u bazua në praktikën e popullarizuar nga Valentin Conrart, themeluesi i Académie Française.
- 1644> Anna Hume, një shkrimtare dhe poete skoceze, përktheu "Trionfi" të poetit italian Petrarch nën titullin “Triumfet e Dashurisë, Ndarjes dhe

Vdekjes”. Poemat e Petrarchit tregojnë për triumfin e dashurisë së poetit (Petrarch bie në dashuri me Lauren), të rrënuar nga triumfi i dëlirësisë mbi epshin (në atë që Laura nuk i nënshtrohet dashurisë së Petrarkut), e cila pasohet nga triumfi i vdekjes. Përkthimi i Anna Hume u botua nga Evan Tyler në Edinburgh në 1644. Një përkthim i botuar nga një grua që i përkiste një familjeje të shquar ishte shumë e pazakontë në atë kohë, por u prit mirë dhe puna e saj u vlerësua si besnike dhe shpirtërore.

- 1688-89> Aphra Behn, një dramaturge, poete dhe noveliste angleze, iu përkushtua zhanreve të prozës dhe përkthimeve pasi shkruajti një prolog dhe një epilog që i sollli telashe ligjore. Përkthimet e saj të fundit ishin përkthimi (nga frëngjishtja në anglisht) i astronomit francez Bernard le Bovier de Fontenelle “A Discovery of New Worlds” (“Entretiens sur la pluralité des mondes”) në 1688, dhe përkthimi (nga anglishtja në frëngjisht) i “Gjashtë Librat e Bimëve” të poetit anglez Abraham Cowley në 1689. E lodhur nga një shëndet i dobët, varfëri dhe borxhe, Aphra Behn vdiq në Prill 1689.
- 1693-97> John Dryden, një poet dhe dramaturg anglez që u bë laureat i parë i Poeteve në Angli në 1668, përktheu “Veprat e Virgjilit” gjatë katër viteve (1693-97). Botimi i tij në vitin 1697 ishte një ngjarje kombëtare. Më pas, Dryden përktheu vepra nga Ovid, Boccaccio dhe Chaucer, botuar në “Fables Ancient and Modern” (1700) me fabulat e tij. Dryden e përshkroi përkthimin si përzierje e arsyeshme e dy mënyrave të frazimit - metafaza (përkthimi fjalë për fjalë) dhe parafrazimi (rivendosja me fjalë të tjera) - kur zgjedh ekuivalentët për frazat e përdorura në gjuhën origjinale.
- 1699-1708> Redaktorja dhe përkthyesja franceze Anne Dacier prodhoi përkthime proze të Homerit “Iliada” (1699) dhe “Odyssey” (1708). Përkthimet e saja e prezantuan Homerin në botën letrare franceze. Ata u vlerësuan nga bashkëkohësit e saj, përfshirë poetin anglez Alexander Pope, i cili përktheu poezitë epike të Homerit në anglisht (1715-20 dhe 1726). Anne Dacier botoi një ese mbi përkthimin e Papës të “Odyssey”, që i dha asaj një famë edhe në Angli.
- 1704-17> Orientalisti dhe arkeologu francez Antoine Galland përktheu “Një mijë e një netë”, një përmbledhje me tregime popullore të Lindjes së Mesme të përpiluara në arabisht gjatë epokës IslamGolden. Përkthimi i tij me 12 vëllime frëngjisht “Les Mille et une nuits” (1704-17) u bë një bestseller dhe është ende përkthimi standard frëngjisht deri më sot. Ai popullarizoi përrallat orientale në letërsinë evropiane dhe romantizmin e ri. “Les Mille et une nuits” u përkthye nga frëngjisht në anglisht (1706), gjermanisht (1712), italisht (1722), holandezisht (1732), rusisht (1763) dhe polonisht (1768).
- 1713-26> Poeti anglez Alexander Pope, një lexues i zjarrtë i veprave të Homerit që nga fëmijëria e tij, filloi të përkthente “Iliadën” në 1713. Atij

iu paguan 200 guinea nga botuesi Bernard Linto, i cili lëshoi një vëllim në vit gjatë gjashtë viteve (1715-20). Pastaj Pope përktheu "Odyssey" me paga ekuivalente, dhe përkthimi i tij u botua në 1726.

- 1722> Giuseppa Barbapiccola, një filozofe dhe poete italiane, përktheu "Parimet e Filozofisë" të frëngjishtes René Descartes në italisht në 1722. Qëllimi i saj ishte jo vetëm të përcillte filozofinë e Descartes në një audiencë italiane, por edhe të frymëzonte gratë për të edukuar dhe fuqizuar vetveten. Ajo demonstroi se Descartes krijoi një filozofi që vlerësonte intelektin e femrës, dhe përkthimi i saj i dha asaj mundësinë për të shprehur idetë e saj. Në parathënie, ajo shkroi se "Gratë nuk duhet të përjashtohen nga studimi i shkencave, pasi shpirtrat e tyre janë më të ngritur dhe nuk janë inferiorë ndaj burrave për sa i përket virtyteve më të mëdha".
- 1735> Studiuesi anglez Samuel Johnson prodhoi në 1735 një botim në anglisht të misionarit portugez Jesuit Jernimo Lobo "Itinerário", një rrëfim gjatë udhëtimit të tij në Etiopi, nga botimi francez "Voyage historique d'Abyssinie" (1728) përkthyer nga Joachim Le Grand. Johnson mendoi se një botim i shkurtër i përkthyer nga frëngjishtja mund të ishte "i dobishëm dhe fitimprurës" për lexuesit anglezë.
- 1772-1803> Poeti polak, Ignacy Krasicki, i quajtur shpesh La Fontaine i Polonisë pas botimit të librit të tij "Përralla dhe shëmbëlltyra" (1779), ishte gjithashtu një përkthyes dhe teoricien i përkthimit. Eseja e parë e Krasicki "Mbi Përkthimin e Librave" ("O przekładaniu ksiąg") u botua në 1772, dhe eseja e tij të dytë "Për Librat e Përkthimit" ("O tłumaczeniu ksiąg") u botua pas vdekjes në 1803. Në esenë e tij të dytë, ai shkroi se "Përkthimi është në të vërtetë një art i vlerësueshëm dhe shumë i vështirë, dhe për këtë arsye nuk është puna dhe pjesa e mendjeve të zakonshme; duhet të praktikohet nga ata që janë të aftë të jenë aktorë, kur shohin përdorim më të madh në përkthimin e veprave e të tjerëve sesa në veprat e tyre, dhe mbajnë më lart se lavdinë e tyre shërbimin që i japin vendit të tyre. "
- 1772-1805> Johann Gottfried Herder, një kritik i letërsisë gjermane dhe teoricien i gjuhës, botoi "Traktat mbi origjinën e gjuhës" (1772), i cili vendosi themelet e filologjisë krahasuese. Sipas Herderit "një përkthyes duhet të përkthejë drejt gjuhës së tij", një thënie e shprehur tashmë dy shekuj më parë nga Martin Luther, i cili ishte studiuesi i parë evropian që vlerësoi se dikush përkthen në mënyrë të kënaqshme vetëm drejt gjuhës së tij. Herder u bë një përkthyes më vonë në jetë. Dy përkthimet e tij kryesore ishin "Terpsichore" (1795-96), një përkthim dhe adaptim i poezive të latinistit gjerman Jakob Balde dhe "The Cid" (1805).
- 1781-93> Johann Heinrich Voss, studiues dhe klasicist gjerman, prodhoi një përkthim të "Odyssey" së Homerit (1781) që prezantoi Homerin në botën letrare gjermane. Më pas ai përkthente "Bucolics" dhe "Georgics" të

poetit romak Virgil para se të përkthente "Iliadën" e Homerit (1793), botuar me një përkthim të rishikuar të "Odyssey". Pasi u tërhoq në vitin 1802, Voss pranoi të fillonte punën si profesor i letërsisë klasike në Universitetin e Heidelberg në 1805. Pagesa që merrte e lejoi atë të përkushtohet në përkthimin e klasikëve latine dhe grekë deri në vdekjen e tij.

- 1783> Onufry Andrzej Kopczyński, një poet dhe gramaticien polak, theksoi në 1783 që leximi i sigurt në një gjuhë të huaj dhe dëgjimi i gjuhës së folur ishte më i dobishëm se përdorimi i fjalorëve për të prodhuar përkthime të mira.
- 1791> Në "Ese mbi Parimet e Përkthimit" (1791), historiani skocez Alexander Tytler gjithashtu theksoi se leximi i besueshëm ishte më i dobishëm sesa përdorimi i fjalorëve. Ende nuk kishte shumë shqetësime për saktësinë, dhe fjala e shikimit ishte e lehtë për të lexuar. Fjalorët dhe thesaret nuk u vlerësuan si udhëzues të përshtatshëm për përkthimin në një gjuhë të huaj.
- 1797-1810> Poeti dhe kritiku gjerman August Schlegel përktheu shfaqjet e Shekspirit në Gjermani nga 1797 deri në 1810, dhe përkthimet e tij të lavdëruara shumë i shndërruan në "Germanclassics". Kompozitori i ri Felix Mendelssohn, në moshën 17 vjeç, mori frymëzimin e tij nga përkthimi i Schlegel "Një ëndërr e natës së mesme" për të shkruar koncertin e tij të parakohshëm. Përkthimi i Schlegel-it për shfaqjet e Shekspirit u redaktua nga shoku i poetit dhe përkthyesi Ludwig Tieck, dhe u përfundua nga Dorothea Tieck, vajza e Ludwig Tieck, dhe nga poeti dhe përkthyesi i shokëve të tij Wolf Heinrich Graf von Baudissin. Schlegel më pas u përkthye në vepra gjermane nga dramaturgu spanjoll Pedro Calderón de la Barca (1803-09), dhe nga poeti italian Dante dhe poeti portugez Luís de Camões (1804). Ai përktheu në Latinisht tekstet sanskrite "Bhagavad Gita" (1823) dhe "Ramayana" (1829).
- 1799-1804> Ludwig Tieck, një poet dhe kritik gjerman, përktheu romancierin spanjoll Cervantes "Don Kishoti" në gjermanisht me vajzën e tij Dorothea Tieck nga 1799 deri në 1804. Ai përktheu dramën Elizabetjane në dy vëllimet "Teatri Altenglisches" (1811). Ai redaktoi përkthimin e August Schlegel të shfaqjeve të Shekspirit.
- 1800-99> Vlen për t'u theksuar fakti që në këtë periudhë standarde të reja u zbatuan për saktësi dhe stil përgjatë shekullit të 19-të. Për saktësi, politika u bë "teksti, tërë teksti dhe asgjë tjetër përveçse teksti (përveç fragmenteve të besimit), me shtimin e shënimeve shpjeguese të gjera". Për stilin, qëllimi ishte të kujtonte vazhdimisht lexuesit se po lexonin një klasik të huaj.

- 1804-26> Friedrich Schleiermacher, një teolog dhe filozof gjerman, prodhoi një përkthim me 6 vëllime të veprave të Platonit (vëllimi 1-5 në 1804-10, vëllimi 6 në 1826) që po ndikonte në romantizmin gjerman. Në ligjëratën e tij seminale "Mbi metodat e ndryshme të përkthimit" (1813), Schleiermacher kundërshtoi metodat e përkthimit që lëviznin shkrimtarin drejt lexuesit, që për të do të thoshte transparenca, dhe favorizonte metodat e përkthimit që e shtynin lexuesin drejt autorit, qasje që ai tashmë ndiqte në përkthimet e tija.
- 1808-13> Përkthimet melodike të poetit rus Vasily Zhukovsky të baladave gjermane dhe angleze, veçanërisht baladat "Ludmila" (1808) dhe "Svetlana" (1813) u bënë shenjë dalluese në poezinë ruse. Të dy ishin përkthime falas të baladës "Lenore" të poetit gjerman Gottfried August Bürger. Zhukovsky më vonë përktheu "Leonore" një herë të tretë, si pjesë e përpjekjes së tij të përrjetshme për të zhvilluar një heksameter daktilik rus me tinguj natyral. Përkthimet e tij të poezive të Friedrich Schiller u bënë klasike ruse dhe konsideroheshin të ishin të një cilësie të barabartë, nëse jo më të lartë se origjinalet. Zhukovsky gjithashtu prodhoi një përkthim vargje të romanit të prozës së shkrimtarit gjerman Friedrich de la Motte Fouqué "Undine".
- 1818> Shkrimtarja franceze Louise Swanton Belloc përktheu poetin dhe romancierin irlandez Adelaide O’Keeffe “Patriarkalen Times” dhe Toka e Kanaanit: Një Histori Figurative”, një rrëfim i pesë librave të parë të Biblës të botuar në 1818. Ajo u miqësua me shumë figura letrare, përfshirë shkrimtarët francezë Victor Hugo, Emile Souvestre dhe Alphonse de Lamartine, shkrimtarin anglez Charles Dickens, shkrimtaren anglo-irlandeze Maria Edgeworth dhe shkrimtarin amerikan Harriet BeecherStowe. Ajo përktheu "Kabina e Xha Tomit" të Harriet Beecher Stowe, një libër që përshkruan kushtet e vështira të jetës për afrikano-amerikanët e skllavëruar. Ajo gjithashtu përktheu romanin e shkrimtares skoceze Elizabeth Gaskell "Cranford", romanin e shkrimtarit irlandez Oliver Goldsmith "The Vicar of Wakefield", "Meloditë Irlandeze" të poetit irlandez Thomas Moore, kujtimet e poetit anglez Lord Byron dhe veprat e Charles Dickens, Maria Edgeworth dhe shkrimtarit skocez Walter Scott.
- 1822-26> Therese Albertine Louise Robinson, një shkrimtare dhe gjuhëtare gjermano-amerikane, përktheu romanet e shkrimtarit skocez Walter Scott "Vdekshmëria e Vjetër" dhe "Xhuxhi i Zi" nga anglishtja në gjermanisht në 1822 nën pseudonimin Ernst Bertield. Ajo mësoi serbisht pasi lexoi përkthimet e filologut gjerman Jacob Grimm për këngët popullore serbe. Ajo përktheu vetë këngët popullore serbe me mbështetjen dhe inkurajimin e Goethe. Përkthimi i saj "Volkslieder der Serben" (Këngët Folklorike të Serbëve) u shfaq në 1826, dhe u vlerësua nga Goethe dhe bota letrare gjermane.

- 1833-67> Studiuesi dhe poeti amerikan Henry Wadsworth Longfellow përktheu vjershën e funeralit të poetit mesjetar kastilian Jorge Manrique "Vargje mbi vdekjen e të atit të tij" ("Coplas ala muerte de su padre") në anglisht në 1833. Ai redaktoi "Poetët dhe Poezia e Evropës" (1845), një përmbledhje me 800 faqe poezish të përkthyer, duke përfshirë poema të përkthyer nga kolegu dhe shoku i tij Cornelius Conway Felton. Antologjia kishte për qëllim "të sjellë së bashku, në një formë kompakte dhe të përshtatshme, sa më shumë që të jetë e mundur e atyre përkthimeve në anglisht, të shpërndara në shumë vëllime, dhe jo të arritshme për lexuesit e përgjithshëm." Longfellow kaloi disa vjet duke përkthyer poezinë italiane Dante "Komedi Hyjnore". Ai organizoi takime javore me një grup miqsh të quajtur Klubi Dante për ta ndihmuar atë të përsoste përkthimin dhe të rishikonte provat. Përkthimi 3-vëllim u botua në 1867, dhe kaloi katër shtypshkronja në vitin e tij të parë. Vitet e fundit Longfellow i shpenzoi në përkthimin e poezisë së artistit italian Michelangelo, me një botim pas vdekjes të botuar në 1883.
- 1834> Shkrimtarja angleze Sarah Austin përktheu nga frëngjishtja në anglisht në 1834 "Raportin mbi gjendjen e udhëzimeve publike në Prusia" që filozofi francez Victor Cousin shkroi për Count de Montalivet, asokohe Ministër Francez i Udhëzimeve Publike. Përkthimet e saj të tjera përfshinin vepra të filozofit gjerman Friedrich Wilhelm Carové, historianit gjerman Leopold von Ranke, princit gjerman Hermann dhe historianit francez François Guizot. Sarah Austin gjithmonë qëndronte për të drejtat e saj intelektuale si përkthyes, duke shkruar se "Ka qenë praktika ime e pandryshueshme, që pasi të jem angazhuar për të përkthyer një vepër, t'i shkruaj autorit duke e njoftuar për qëllimin tim, dhe duke shtuar se nëse ai ka ndonjë korrigjim, lëshim ose shtesë për të bërë, ai/ajo mund të mbeshtetet tek une dhe vëmendja ime i kushtohet sugjerimeve të tij. "
- 1838-45> Charlotte Guest, një studiuese angleze dhe arsimitare liberale, përktheu "Mabinogion" nga gjuha uellshe në anglisht nga transkriptimi i dorëshkrimit i bërë nga shkrimtari Uellsit Tegid kur ishte një studiues i ri në Universitetin e Oksfordit. "Mabinogion" ishte një seri tregimesh mesjetare të përpiluara nga traditat gojore të shekullit XII dhe të XIII, dhe proestoritë më të hershme në Britani. Përkthimi 7 vëllimesh i Charlotte Guest u botua në 1838-45. Një botim i ri me 3 vëllime u botua në 1849 nga Tonn Press në Uells dhe nga Longmans në Londër. Të dy botimet ishin dygjuhëshe.
- 1842-51> Matilda Hays, një gazetare dhe noveliste angleze, dhe shoqja e saj Elizabeth Ashurst, një aktiviste radikale angleze, u bashkuan për të përkthyer veprat e romancierit francez George Sand në anglisht nga 1842 në 1851. Dashuria e lirë dhe jeta e pavarur e George Sand ishte akoma e pazakontë në shekullin XIX, si dhe çështjet politike dhe sociale të trajtuara në librat e saj. Ata përkthyen "Spiridon" të George Sand ("Spiridon"),

"Letrat e një udhëtar" ("Lettres d'unvoyageur"), "Mjeshttrat e Mozaikut" ("Les maîtres mosaïstes") dhe "André" ("André") .Matilda Hays përktheu "La Dernière Aldini" përpara se të takohej me Elizabeth Ashurst, dhe përktheu "Fadette" vetëm pas vdekjes së Elizabeth Ashurst gjatë lindjes.

- 1842-63> Mary Howitt, një poete dhe shkrimtare angleze, përktheu romanet e shkrimtarit suedez Fredrika Bremer në anglisht. Përkthimi i saj me 18 vëllime (1842-63) ndihmoi futjen e Fredrika Bremer te lexuesit anglezë, përfshirë idetë e saj si një reformatore feministe. Mary Howitt gjithashtu përktheu përrallat e shkrimtarit danez Hans Christian Andersen, për shembull "Vetëm një Fiddler" (1845), "Improvisators" (1845), "Tregime të mrekullueshme për fëmijë" (1846) dhe "Histori e vërtetë e çdo jete" (1847) . Ajo përktheu "Historinë e Magicit" të mjekut gjerman Joseph Ennemoser (1854) në të njëjtën frymë, me qëllim që idetë e tij të arrinin edhe në një audiencë angleze.
- 1843-78> Shkrimtarja feministe angleze Anna Swanwick përktheu vepra nga poetë gjermanë Goethe dhe Schiller, dhe botoi përkthimet e saj si "Seleksione nga Drama e Goethe and Schiller" (1843), me Goethe "Torquato Tasso" dhe "Iphigenia in Tauris", dhe Schiller "Idupë e Orleans". Ajo prodhoi përkthime me vargje boshe të veprave të tjera të Goethe (1850, dhe volumin e dytë në 1878). Përkthimi i saj i "Faust"-it të Goethe u vlerësua shumë dhe u ribotua disa herë. Ajo gjithashtu përktheu shfaqjet e tragjedianit grek të Eskilit në 1873. Ajo ishte e interesuar për shumë çështje sociale të ditës së saj, veçanërisht edukimin e grave dhe klasave punëtore. Ajo ndihmoi në shtrirjen e leksioneve të Kolegjit King të grave. Ajo mbrojti studimin e letërsisë angleze në universitete dhe mbajti leksione private për burra dhe gra të rinj që punonin në atë kohë.
- 1847-51> Gjuhëtari suedez Carl August Hagberg përktheu shfaqjet e Shekspirit në suedisht, botuar në një botim me 12 vëllime (1847-51). Disa nga punimet e tij bazoheshin në një përkthim të mëparshëm të Johan Henrik Thomander të vitit 1825. Hagberg ishte anëtar i Akademisë Suedeze nga 1851 deri në vdekjen e tij.
- 1847-55> Feministja Amerikane Julia Evelina Smith prodhoi përkthimin e saj të Biblës në anglisht nga 1847 deri në 1855, pasi lexoi Biblën në gjuhët e saj origjinale, me theks të theksuar mbi leteralizmin. Përkthimi i saj u botua në 1876, para botimit të "Versionit të Revizionuar në anglisht të Biblës Mbretit James" (1881-94), i konsideruar si botimi zyrtar i autorizuar në anglisht i Biblës.
- 1852-65> Poeti francez Charles Baudelaire përktheu "Historitë e jashtëzakonshme" të poetit anglez Edgar Allan Poe ("Histoires extraordinaires", 1852), "Tregime të reja të jashtëzakonshme" ("Nouvelles histoires extraordinaires", 1857), "The narrative of Arthur Gordon Pym of Nantucket" (" Les aventures d'Arthur Gordon Pym ", 1865), "Eureka" ("

Eureka ", 1865) dhe " Tregime Groteske dhe Serioze "(" Histoires grotesques et sérieuses ", 1865). Baudelaire nuk ishte i pari që përkthen veprat e Poe në frëngjisht, por përkthimet e tij skrupuloze u vlerësuan shumë dhe u konsideruan më të mirat. Ai gjithashtu shkroi dy ese mbi poezinë e Poe-së. Në vitet e tij të mëvonshme, ai përktheu dhe adaptoi eseisten angleze Thomas De Quincey "Rrëfimet e një ngrënësi të opiumit anglez".

- 1861-65> Mary Louise Booth, një shkrimtare dhe redaktuese amerikane, përktheu veprat kryesore të kohës së saj nga frëngjishtja në anglisht. Kur filloi Lufta Civile Amerikane në 1861, ajo përktheu avokatin francez kundër skllavërisë "Kryengritja e një populli të madh" Agénor de Gasparin në një kohë shumë të shkurtër duke punuar njëzet orë në ditë për një javë. Edicioni në anglisht u botua brenda pasdites nga botuesi amerikan Scribner. Mary Louise Booth më pas përktheu libra të tjerë mbi skllavërizmin, përfshirë "Amerikën para Evropës" të Agénor de Gasparin në 1861, "Rezultatet e emancipimit" të Pierre-Suzanne-Augustin Cochin dhe "Rezultatet e skllavërisë" në 1862, dhe "Parisin" e Edouard René de Laboulaye në Amerikë në 1865. Ajo mori lavdërime dhe inkurajime nga presidenti Abraham Lincoln, senatori Charles Sumner dhe shtetarë të tjerë.
- 1862-73> Clémence Royer, një studiuese franceze përktheu punën seminarit të natyralistit anglez Charles Darwin "Mbi origjinën e specieve" (1859). Në edicionin e parë francez (1862), Clémence Royer shkoi përtej rolit të saj si përkthyes, me një parathënie prej 60 faqesh që shprehte pikëpamjet e veta dhe shënimet shpjeguese të hollësishme që e bënë Darwinin të pakënaqur. Edicioni i dytë i përkthimit (1866) përfshinte disa ndryshime të bëra me kërkesën e Darwinit për të korrigjuar disa gabime dhe pasaktësi. Botimi i tretë i përkthimit (1873) u prodhua pa pëlqimin e Darwinit, me një parathënie të dytë që gjithashtu e bëri Darwinin të pakënaqur, dhe pa përmendur shtesat në botimet e katërt dhe të pestë në anglisht. Përkthimi përfshinte vetëm një shtojcë që tregonte shtesat në botimin e gjashtë anglez të botuar në 1872. Sidoqoftë, përkthimi i saj i diskutueshëm i solli famë Clémence Royer, e cila ligjëroi gjerësisht për filozofinë, feminizmin, ekonominë dhe shkencën, përfshirë Darwinizmin.
- 1876> Aktivistja socialiste Eleanor Marx përktheu disa pjesë të "Kapitalit" të babait të saj Karl Marx nga gjermanishtja në anglisht, para se të përkthente "Historia e Komunës së Parisit të 1871", të socialistit revolucionar francez Prosper-Olivier Lissagaray ("L'histoire de la Commune de 1871") nga frëngjishtja në anglisht në vitin 1876. Ajo gjithashtu përktheu vepra letrare, si "Madame Bovary" të romancierit francez Gustave Flaubert dhe "Një armik i popullit" të dramaturges norvegjeze Henrik Ibsen në 1888 dhe "Zonja nga deti" në 1890.

- 1883-97> Katherine Prescott Wormeley, një infermiere amerikane që punonte në Komisionin Sanitar të Sh.B.A-së gjatë Luftës Civile Amerikane, ishte gjithashtu një shkrimtare dhe përkthyes. Ajo përktheu shumë klasikë letrare francezë në anglisht, për shembull të gjitha romanet e Honoré de Balzac me një përkthim 40 vëllim të botuar në 1883-97, shfaqjet e Moliere, me një përkthim 6-vëllim të botuar në 1892, si dhe kujtimet e Henri de Saint-Simon dhe romane nga Alexandre Dumas and Alphonse Daudet. Ajo gjithashtu shkroi një "Jetë të Balzaku" në 1892.
- 1883-1900> Francesca Alexander, një shkrimtare dhe ilustruese amerikane, mblodhi këngë popullore, tregime dhe zakone në Toskan, Itali dhe i përkthen ato në anglisht me vizatimet e saj. Më 1882, ajo u takua me kritikun e artit anglez John Ruskin, i cili u bë një mik dhe korrespondent i ngushtë deri në vdekjen e tij. Ruskin bleu dy dorëshkrimet e saj, dhe botoi "Histori e Ide" (1883) dhe "Këngët në rrugë të Toskanës" (1884-85), përpara se të botonte dorëshkrimin e saj të tretë "Këngët e Krishtit në Apenine" (1887-89). Pas vdekjes së Ruskin, Francesca Alexander publikoi veten "Këngët Toskane" (1897) dhe "Shërbëtorët e fshehur dhe tregimet e tjera shumë të vjetra" (1900).
- 1898> Studiuesi kinez Yan Fu, i cili përktheu shumë vepra në shkencat shoqërore nga anglishtja në gjuhën kineze, zhvilloi teorinë e tij të treanshme të përkthimit në 1898: 1. besnikërinë- që do të thonte të jetë e vërtetë me origjinalin në shpirt; 2. ekspresiviteti, që do të thonte të jetë i arritshëm për lexuesin e gjuhës së përkthimit; dhe 3. hijeshia, që do të thonte të jetë e shkruar në një gjuhë "të arsimuar". Nga tre aspektet, ai e konsideroi të dytin si më të rëndësishmit. Nëse kuptimi i tekstit të përkthyer nuk ishte i arritshëm për lexuesin, nuk do të kishte ndonjë dallim midis përkthimit të tekstit dhe mospërkthimit të tekstit fare. Për të lehtësuar kuptueshmërinë, fjala mënyrë mund të ndryshohet, shembujt kinezë mund të zëvendësojnë ato angleze, dhe emrat e njerëzve mund të jepen në gjuhën kineze. Teoria e tij pati shumë ndikim në të gjithë botën, por ndonjëherë u shtri gabimisht në përkthimin e veprave letrare.
- 1898-1904> Mjeku francez Joseph Charles Mardrus përktheu "Një mijë e një net" në frëngjisht me titullin "Le Livre des mille et une nuits". Përkthimi i tij me 12 vëllime (1898-1904) u botua nga Henri Piazza, përpara se të përkthehej nga frëngjisht në anglisht nga poeti anglez Edward Powys Mathers. Mardrus botoi një botim të dytë të përkthimit frëngjisht në vitet 1926-32. Përkthimi elegant i Mardrus u përmend nga romancieri francez Marcel Proust në "Kujtimi i gjërave të kaluara". Mardrus futi disa materiale të tija për të kënaqur shijet e kohës së tij, dhe përkthimet e tij jo plotësisht autentike tani janë më pak të lavdëruara se përkthimet e tjera.

1903-09> Poetit dhe romancieri rus Ivan Bunin iu dha çmimi Pushkin dy herë, së pari më 1903 për koleksionin e tij të poezisë "Gjethet që bien" (1901) dhe përkthimin e tij të "Kënga e Hiawatha" të poetit amerikan Henry Wadsworth Longfellow, dhe pastaj në 1909 për koleksionin e tij të poezisë "Poemat 1903-1906" dhe dy përkthimet e tij të "Legjendës së Artë" të Longfellow dhe "Cain" të poetit anglez Bajron. Bunin gjithashtu përktheu disa vepra të Laureatit anglez Alfred Tennyson dhe nga poetë francezë François Musset dhe François Coppée.

- 1922-30> Charles Kenneth Scott Moncrieff ishte një shkrimtar skocez që fitoi jetesën e tij si përkthyes i veprave letrare franceze. Përkthimi i tij kryesor ishte përkthimi i romanit me 7 vëllime të shkrimtarit francez Marcel Proust "Kujtim i gjërave të kaluara" nga 1922 deri në vitin 1930. Përkthimi i vëllimit të shtatë mbeti i papërfunduar për shkak të vdekjes së tij. Ai zgjodhi vargun e dytë të Sonetit 30 të Shekspirit si një përkthim joletrar të titullit të romanit, që më vonë u zëvendësua nga "Në kërkim të kohës së humbur" në përkthime të tjera. Përkthimi i Scott Moncrieff kontribuoi në famën e Proust në sferën letrare angleze.
- 1923-39> Përkthyesja polake Aniela Zagórska përktheu në polonisht nga 1923-1939 shumicen e punimeve të shkruara nga xhaxhai i saj Joseph Conrad, një romancier polako-britanik që shkroi në anglisht. Sipas mendimit të Conrad, përkthimi, si artet e tjera, është zgjedhje fjalësh dhe strukturash dhe për të zgjedhja nënkuptonte interpretim.
- 1939-45> Poeti rus Mikhail Lozinsky përktheu "Komedinë Hyjnore" të poetit italian Dante në rusisht. Përfundoi në shtatë vjet (1939-45) përkundër shëndetit të tij të dobët, përkthimi i tij i dha atij çmimin Stalin në 1946.
- 1942-51> Përkthimi kryesor i shkrimtarit rus Samuil Marshak ishte përkthimi i soneteve të Shekspirit në rusisht në 1948. Sonetet e përkthyerë frymëzuan disa muzikantë klasikë, pop dhe rock të Rusisë ndër vite. Marshak përktheu shumë poetë të tjerë (William Blake, William Wordsworth, Robert Burns, Lord Byron, Percy Bysshe Shelley, John Keats, Alfred Tennyson, Robert Browning, William Butler Yeats, Edward Lear dhe të tjerë). Përkthimet e tij poetike tani janë aq të ngulitura në kulturën ruse sa që përkthyesi i tyre vlerësohet më shumë si autorizues sesa një përkthyes. Gjatë karrierës së tij, Marshak fitoi katër çmime Stalin (1942, 1946, 1949 dhe 1951).
- 1943> Cesare Pavese, një poet, novelist dhe kritik letrar italian, përktheu shkrimtarë anglezë dhe amerikanë, të cilët atëherë ishin të rinj në sferën letrare italiane, duke përfshirë poetin amerikan Edgar Lee Masters "'Spoon River Anthology", një përmbledhje me poezi. Përkthimi i tij u botua nga Einaudi në 1943. Gjatë viteve të tij në Torino, Itali, Pavese ishte mentori i Fernanda Pivano, i cili më vonë u bë vetë shkrimtare dhe përkthyes. Ai i dha Fernandes Pivano të dy botimet (anglisht dhe italisht) të "Spoon River

Anthology" që ajo të kuptonte më mirë ndryshimin midis një vepre origjinale dhe një vepre të përkthyer.

- 1949> Fernanda Pivano, një shkrimtare, gazetare dhe kritike letrar italiane, përktheu romanin e Ernest Hemingway "Një Lamtumirë me Armët" në italisht në 1949. Ajo ishte takuar me Ernest Hemingway vitin e kaluar, duke rezultuar në një bashkëpunim dhe miqësi të fortë. Përkthimet e shumta të Fernanda Pivano prezantuan shkrimtarët amerikanë në një audiencë italiane, nga ikonat e shkëlqyera të Roaring Twenties (F. Scott Fitzgerald, Dorothy Parker dhe William Faulkner) përmes shkrimtarëve të viteve 1960 (Allen Ginsberg, Jack Kerouac, William S. Burroughs, etj.) Gregory Corso dhe Lawrence Ferlinghetti) për një gjeneratë të re shkrimtarësh të rinj (Jay McInerney, Bret Easton Ellis, David Foster Wallace, Chuck Palahniuk dhe Jonathan Safran Foer).
- 1956-60> Poeti dhe novelisti rus Boris Pasternak - autori i mirënjohur i "Doktor Zhivago" (1957) u desh të kthehej në përkthim nga 1956 deri në 1960 në mënyrë që të sigurote të ardhura për familjen e tij. Ai prodhoi përkthime të veprave nga poetë gjermanë Goethe, Rilke dhe Schiller, poeti francez Verlaine, dramaturgu spanjoll Calderón de la Barca dhe dramaturgu anglez Shakespeare. Përkthimet e tij të shfaqjeve të Shekspirit ishin të njohura për audiencën ruse për shkak të dialogut të tyre kolokual dhe të modernizuar. Pasternak gjithashtu përktheu vepra nga poeti hungarez Sándor Petőfi, poeti polak Juliusz Słowacki, poeti ukrainas Taras Shevchenko dhe gjeorgjiani Nikoloz Baratashvili.
- 1956-72> James S. Holmes, një poet amerikano-holandez, gjithashtu përktheu poezi nga Hollandishtja në anglisht. Ai mori në 1956 çmimin Martinus Nijhoff, të quajtur pas poetit dhe eseistit Holandez, Nijhoff. Kur revista letrare "Delta" u themelua në vitin 1958 për të raportuar mbi kulturën holandeze në Hollandë dhe Belgjikë, Holmes u bë redaktori i poezisë dhe përktheu poezinë bashkëkohore holandeze për revistën. Holmes ishte i pari që shënoi termin "Studime të Përkthimit" në punimin e tij "Emri dhe natyra e studimeve të përkthimit" (1972), që u bë deklarata themeluese e disiplinës së re. Ai dha studime të përkthimit në Universitetin e Amsterdemit dhe shkroi një numër artikujsh me ndikim të madh në lidhje me përkthimin.
- 1960-1980? > Jorge Luis Borges, një shkrimtar argjentinas me histori të shkurtër, eseist dhe poet, përktheu në spanjisht një numër veprash letrare nga anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, anglishtja e vjetër. Borges gjithashtu shkroi dhe ligjëroi gjerësisht mbi artin e përkthimit.
- 1961> Studiuesi dhe politikani shqiptar Fan Noli prodhoi një përkthim të Testamentit të Ri nga shqipja në anglisht, botuar në vitin 1961 me titullin "Testamenti i Ri i Zotit tonë dhe Shpëtimtarit Jezu Krisht nga teksti i aprovuar Grek i Kishës së Kostandinopojës dhe Kishës së Greqisë". Dy

ditë pas vdekjes së Nolit në 1965, udhëheqësi shqiptar Enver Hoxha shkroi në ditarin e tij: "Noli ishte një nga figurat e shquara politike dhe letrare të fillimit të këtij shekulli. Ai sot gëzon një popullaritet të madh në vendin tonë, i merituar si një përkthyes letrar dhe kritik muzikor. Ai ishte një promovues i shquar i gjuhës shqipe. Ai gjithashtu u respektua si një politikan realist dhe si një demokrat revolucionar në ideologji dhe politikë."
"

- 1961> Shkrimtari anglez Stanley Chapman përktheu poezinë franceze Raymond Queneau "Njëqind mijë Miliardë Poema" në 1961, një përkthim i vlerësuar shumë nga vetë Queneau. Chapman gjithashtu përktheu Queneau "Të gjithë e dinë" dhe "Darvin pa dyshim rëndësinë e krimbit të tokës", romanet e shkrimtarit francez Boris Vian "Froth on daydream", "Vjeshta në Pekin" dhe "Hajduti i zemrave", dhe vepra nga poetë të tjerë francezë.
- 1963-1964 - Alfred Malblanc (1963) prodhoi një qasje kontrastive që kategorizoi atë që ai pa duke ndodhur në praktikën e përkthimit midis frëngjishtes dhe gjermanishtes. Në përkthimin e "Les problimes thioriques de la tradztion" i Georges Mounin (1963) shqyrtoi çështjet gjuhësore të përkthimit.
- 1964- Eugene Nida përfshiu elemente të gramatikës gjenerative të asaj kohe të modës si Chomsky si një themel teorik i librave të tij, të cilat fillimisht u krijuan si manuale praktike për përkthyesit e Biblës.
- 1964-67> Romanisti ruso-amerikan Vladimir Nabokov shkroi nëntë romanet e tij të para në rusisht, dhe i përkthej ato në anglisht më vonë. Romani i tij "Lolita" (1955), shkruar në anglisht, i solli famë ndërkombëtare.
- 1932-2016 - Umberto Eco ishte një romanist italian, kritik letrar dhe profesor, dhe një përkthyes nga frëngjisht në italisht. Ai u ngrit në famë ndërkombëtare me romanin e tij "Il nome della rosa" në 1980, një mister historik që ndërthur trillimin me semiotikën, analizën biblike, studimet mesjetare dhe teorinë letrare. Eco shkroi romane të tjera, duke përfshirë "Il pendolo di Foucault", "Ishulli i ditës më parë" ("L'isola del giorno prima") dhe "Varreza e Pragës" ("Il cimitero di Praga"). Të gjitha janë përkthyer në shumë gjuhë. Eco gjithashtu shkroi letra akademike, ese dhe libra për fëmijë. Ai përktheu "Ushtrimet në stil" të shkrimtarit francez Raymond Queneau në 1983, dhe novela "Sylvie" e shkrimtarit francez Gérard de Nerval. Një nga esetë e tij kryesore ishte "Mouse apo Rat? ;Përkthimi si negociim" (2003), që ka të bëjë me temën e përkthimeve dhe problemet që mund të shkaktojnë ndryshimet midis kulturave.

I. 1. 2 Studimet mbi teorinë e përkthimit dhe llojet e tij

Për shkak të zhvillimeve të shpejta në fushën e studimeve të përkthimit, veçanërisht gjatë dekadës së fundit, është dashur të merren vendime të vështira në lidhje me zgjedhjen e materialit në të cilin duhet të mbështetemi për të marrë përkufizime për llojet e përkthimeve të përdorura në të gjithë botën.

Termi *përkthim* në vetvete ka disa kuptime: ai mund t'i referohet lëndës së përgjithshme, produktit (teksti që është përkthyer) ose procesit (akti i prodhimit të përkthimit, i njohur ndryshe si përkthim). Procesi i përkthimit midis dy gjuhëve të ndryshme të shkruara përfshin përkthyesin që ndryshon një tekst origjinal të shkruar (tekstin origjinal) në gjuhën origjinale në tekstin e shkruar të gjuhës së përkthimit (tekstin e përkthyer).³² Ky lloj përkthimi korrespondon me “përkthimin ndërgjuhësor” dhe është një nga tre kategoritë e përkthimit të përshkruar nga strukturalisti ruso-amerikan Roman Jakobson në vepren e tij *Mbi aspektet gjuhësore të përkthimit* ku jep këto kategori përkthimi:

(1) përkthim brëndagjuhësore, ose "rishkrim": "interpretim i shenjave gjuhësore të një gjuhë me anë të shenjave gjuhësore të së njëjtës gjuhë";

(2) përkthimi ndërgjuhësor, ose ‘përkthimi i duhur’: interpretim i shenjave gjuhësore me anë të shenjave gjuhësore të ndonjë gjuhe tjetër’;

(3) përkthim ndërsemiotik, ose ‘shndërrim’: ‘interpretim i shenjave gjuhësore me anë të shenjave të sistemeve të shenjave jogjuhësore’³³

Përkthimi brendagjuhësore do të ndodhte, kur riformulojmë një shprehje ose kur përmbledhim ose rishkruajmë një tekst në të njëjtën gjuhë. Përkthimi ndërsemiotik do të ndodhte nëse një tekst i shkruar përkthehej, në muzikë, film ose pikturë. Në çdo rast, përkthimi ndërgjuhësor që ndodh ndërmjet dy gjuhëve të ndryshme është ai tradicional.

Ashtu sic shprehet një nga studiesit e njohur të studimeve përkthimologjike profesor Gideon Toury (Gideon Tourny) në librin e tij *Në kërkim të teorisë së përkthimit*, “Përkthimi është ai lloj aktiviteti i cili, në mënyrë të pashmangshme përfshin të paktën dy gjuhë dhe dy kultura të ndryshme.”³⁴ Për rrjedhojë, Nida shton faktin se “përkthyesit përballen gjithmonë me probleme lidhur me faktin se si do të trajtohen aspektet kulturore dhe cilat janë metodat e teknikat më të mira për të sjellë një përkthim sa më afër origjinalit”³⁵ dhe shtron problemet të cilat hasen më shpesh nga përkthyesit.

Vet Toury thekson se “përkthimet para së gjithash zënë një pozicion në sistemet shoqërore dhe letrare të kulturës së tekstit të perkthyer, dhe ky pozicion përcakton strategjitë e përkthimit të përdorura.”³⁶ Ai propozon metodologjinë e mëposhtme të

³² Munday, Jeremy., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 4-5

³³ Jakobson, R. *On linguistic aspects of translation*, in L. Venuti (ed.) (2004), fq. 138–43

³⁴ Toury, Gideon, *In Search of a Theory of Translation*, Tel Aviv, 1980, fq. 35-46

³⁵ Nida, E., *Language Structure and Translation*. Stanford, California: Stanford University Press, 1975, fq.130

³⁶ Toury, Gideon, *In Search of a Theory of Translation*, Tel Aviv, 1980, fq. 13

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

përbërë nga tre faza për strategjitë sistematike përshkruese të përkthimit, duke përfshirë një përshkrim të produktit dhe rolin më të gjerë të sistemit sociokulturor:

1. vendoseni tekstin brenda sistemit të kulturës së përkthimit, duke parë rëndësinë ose pranueshmërinë e tij
2. krahasoni tekstin e origjinalit me tekstin e përkthimit për zhvendosje stilistikore, duke identifikuar marrëdhëniet midis 'çifteve' të segmenteve të tekstit të origjinalit me tekstin e përkthimit
3. zbuloni implikimet që do të shërbejnë për vendimmarrje në përkthimin e ardhshëm.³⁷

Qëllimi i studimeve të çështjeve të Toury është të dallojë tendencat e sjelljes së përkthimit, të bëjë përgjithësime në lidhje me proceset e vendimmarrjes së përkthyesit dhe më pas të "rindërtojë" normat që kanë qenë në funksion në përkthim dhe të bëjnë hipoteza që mund të testohen nga studime të ardhshme përshkruese. Përkufizimi i normave të përdorura nga Toury është:

“përkthimi i vlerave të përgjithshme ose ideve të ndara nga një komunitet për atë që është e drejtë ose e gabuar, e përshtatshme ose jo e përshtatshme në udhëzimet e performancës së duhur dhe të zbatueshme për situata të veçanta”³⁸

Këto norma janë kufizime sociokulturale specifike për një kulturë, shoqëri dhe kohë. Thuhet se një individ i përvetëson ata nga procesi i përgjithshëm i edukimit dhe shoqërizimit. Për sa i përket 'fuqisë' së tyre Toury vendos norma midis rregullave dhe sjelleve të veçanta të individit.³⁹

Puna e Toury vlerësohet shumë pasi ka patur një ndikim të rëndësishëm në studimet e përkthimit për tre arsye kryesore:

- braktisja e konceptit një-me-një në përkthim si dhe mundësia e ekuivalencës letrare/gjuhësore;
- përfshirja e tendencave letrare brenda sistemit kulturor të gjuhës së përkthimit në prodhimin e çdo teksti të përkthyer;
- integrimi i tekstit origjinal dhe i tekstit të përkthyer në rrjetin semiotik të ndërveprimit të sistemeve kulturore⁴⁰

Duke patur parasysh normat e vendosura nga Toury në kontekstin kulturor vështirësohet edhe më tepër detyra e përkthyesit.

³⁷ Po aty, 36-39

³⁸ Po aty, fq. 55

³⁹ Munday, Jeremy., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 113

⁴⁰ Gentzler, Edwin, *Contemporary Translation Theories*, London and New York Routledge, 1993, fq. 133-134

Në rrjedhën e studimeve mbi përkthimin gjenden të përmendura edhe llojet dhe metodat e përkthimit. Shpesh këto dy terma, lloje dhe metoda, duken sikur i referohen të njëjtës gjë, por është Newmark i cili përmend ndryshimin midis llojeve të përkthimit dhe metodave të përkthimit. Ai shkruan se, "ndërsa llojet e përkthimit kanë të bëjnë me tërë tekstet, metodat e përkthimit përdoren për fjali dhe njësitë më të vogla të gjuhës".⁴¹ Ai vazhdon t'u referohet llojeve të mëposhtme të përkthimit:

- Llojet kryesore të përkthimit vijojnë si më poshtë:

Përkthimi fjalë për fjalë është përkthimi në të cilin fjalët përkthehen duke u marrë si njësi të veçanta dhe jo si pjesë të një fjalie apo teksti duke humbur kështu elementët e përmbajtjes. Nga ana tjetër, forma është ajo që mbetet pothuajse e pandryshuar. Në këtë mënyrë konteksti nuk merret në konsideratë dhe për këtë arsye mesazhi mund të mos përcillet në mënyrën e duhur tek lexuesi. Ky është një lloj përkthimi automatik që shpeshherë sjell humbje nga teksti origjinal.

Përkthimi fjalë për fjalë mund të konsiderohet thjesht një kalim i tekstit nga një gjuhë në tjetrën duke u marrë me fjalët një nga një duke përcjellë ose jo mesazhin e tekstit origjinal. Ndonjëherë, kjo mund të jetë një praktikë jo e duhur për përkthimin e teksteve letrare pasi mund të kemi ruajtje të formës por humbje të përmbajtjes. Mund të përmendim dhe rastin e idiomave kur përkthimi fjalë për fjalë ndikon drejtpërdrejtë në cënimin e kuptimit të tekstit duke e bërë atë të padeshifrueshëm për lexuesin e tekstit të përkthyer. Siç komenton dhe linguisti Kolthard “për shkak të këtij përkthimi, idiomat mund të tingëllojnë qesharake dhe aspak profesionale”.⁴²

Në fjalët e Vinay dhe Dalbernet, është “transferimi i drejtpërdrejtë i një teksti origjinal në një tekst të përkthyer gramatikisht dhe idiomatikisht të përshtatshëm, në të cilin detyra e përkthyesve është e kufizuar në respektimin e rolit të servitutit gjuhësor të gjuhës së përkthimit”.⁴³

Përkthimi strukturor, ashtu siç na e tregon dhe emërtimi, është ai lloj përkthimi që fokusohet më tepër tek rendi i fjalëve, tek ruajtja e tij edhe në gjuhën e përkthimit. Pra, në këtë lloj përkthimi vëmendja e përkthyesit përqëndrohet tek struktura e fjalisë.

Në këtë lloj përkthimi, u jepet rëndësi edhe formave gramatikore duke u kujdesur të mos largohemi shumë nga teksti origjinal. Edhe këtu, ashtu si në rastin e përkthimit fjalë për fjalë, konteksti nuk merret shumë në konsideratë duke u bazuar më tepër tek rendi i fjalëve. Megjithatë, gjuhët e ndryshme kanë struktura të ndryshme dhe për rrjedhojë në shumë raste nuk mund të përdoret ky lloj përkthimi. Po të marrim në konsideratë gjuhën shqipe dhe angleze vërejmë se ato ndryshojnë nga njëra-tjetra sidomos për sa i përket rendit të fjalëve në fjali. Një fjali në gjuhën angleze zakonisht ruan rendin e gjymtyrëve

⁴¹ Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 81

⁴² Coulthard, M., *Linguistic Constraints on Translation. In Studies in Translation*. Universidada Federal de Santa Catarina, 1992, fq. 34

⁴³ Vinay, J. P, and J. Dalbernet. *Comparative Stylistics of French and English: A methodology for Translation*, translated by J.C Sager and M.J Hamel, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 1995, fq. 48

në fjali duke respektuar strukturën S-V-O⁴⁴ (Subject – Verb - Object = Kryefjale – Kallezues - Kundrinore) ndërsa një fjali në gjuhën shqipe luan më lirshëm me rendin e gjymtyrëve të saj në fjali.

Përkthimi besnik është lloji i përkthimit i cili “kujdeset” të sjellë në gjuhën e përkthimit si formën ashtu dhe përmbajtjen. Sipas Drajer (Dryer) “Konteksti është një element i cili merret shumë në konsideratë dhe si rrjedhojë teksti i përkthyer sjell të njëjtin efekt tek lexuesi.⁴⁵

Kur përkthyesi zgjedh të përdorë përkthimin besnik, ai/ajo synon të prodhojë mesazhin e saktë të tekstit origjinal duke marrë në konsideratë elementët si: konteksti, struktura e fjalive, anën gramatikore, etj. Me këtë lloj përkthimi, përkthyesi synon të trasmetojë më së miri mesazhin e autorit të tekstit origjinal në gjuhën e përkthimit.

Për më tepër, në përkthimin besnik ruhen si forma ashtu dhe përmbajtja me një fanatizëm tepër të madh. Përkthyesi përpiqet që çdo mesazh të përcillet tek lexuesi i gjuhës origjinale në mënyrën më të mirë të mundshme. Këtu fjalët apo fjalitë përkthehen duke u bazuar tek konteksti dhe jo si fjalë apo fjali të veçanta që nuk lidhen me pjesën tjetër të tekstit. Në këtë lloj përkthimi, përkthyesit mundohen të mos dalin jashtë kornizave të tekstit origjinal duke qenë se duan t’ a trasmetojnë atë me saktësi të lart.

Përkthimi semantik është një përkthim që fokusohet me tepër tek vlerat estetike të tekstit në gjuhën e përkthimit ndryshe nga përkthimi besnik. Halliday thekson “përkthyesi e përqëndron vëmendjen e tij tek stili i autorit dhe mënyra sesi ai e ka përdorur gjuhën dhe ndryshimet që duhen bërë për të sjellë këtë stil pa humbur origjinalitetin.”⁴⁶

Ky lloj përkthimi bazohet më tepër tek kuptimi që mbartin fjalët dhe veshja e tyre me po atë domethënie në një gjuhë tjetër. Qëllimi i tij është të përcjellë sa më mirë kuptimin e origjinalit, stilin e autorit si dhe emocionet që sjell teksti tek lexuesi.

Përkthimi semantik ka disa karakteristika dhe e para është fokusimi tek autori. Pra, përkthyesi kërkon të njohë sa më shumë autorin në mënyrë që te hyjë sa më në brendësi të veprës. Ai mund ta njohë autorin duke bërë kërkime për jetën e tij, aktivitetet, koha apo kushtet historike në të cilat ka jetuar.

Një tjetër karakteristikë është dhe tendenca që përkthimi semantik ka për të qenë më i ndërlikuar dhe i detajuar në krahasim me llojet e tjera të përkthimeve. Njumark (Newmark) shkruan “përkthimi semantik ndryshon nga përkthimi fjalë për fjalë në atë që ai respekton kontekstin, interpreton dhe madje shpjegon (si për shembull, metaforat). Përkthimi literal, nga ana tjetër, do të thotë fjalë për fjalë në versionin e tij ekstrem dhe,

⁴⁴ Wekker, Herman & Haegeman, Liliane, *A Modern Course in English Syntax*, London, New York, Routledge, 1985, fq. 43

⁴⁵ Dryer S. Mathew, *Language Typology and Syntactic Description*, Oxford University Press, 1998, fq. 41

⁴⁶ Halliday, M.A.K., Hasan, R. *Language, Context and Text: Aspects of Language in a Social-semiotic Perspective*. Deakin University Press/Oxford University Press, Australia/Oxford, 1989, fq.76

edhe në formën e tij më të dobët, i përmbahet shumë ngushtë leksikut dhe sintaksës së tekstit të origjinalit”.⁴⁷

Përkthimi me përshtatje është përkthimi përmes të cilit ruhen temat, personazhet si dhe përmbajtjet. Këtu kemi dhe përshtatje të kulturave duke përshatur çdo element në mënyrë që dhe lexuesi të jetë sa më i qartë. Mund të themi se në këtë mënyrë teksti rishkruhet duke ruajtur elementët më kryesorë edhe pse është bërë një lloj përshtatjeje e cila e bën tekstin më të kuptueshëm për lexuesin e gjuhës së përkthyer por duke u munduar të përcillet e njëjta atmosferë si në versionin origjinal.

Qëllimi kryesor përse përkthyesi zgjedh të përdorë këtë lloj përkthimi është përcjellja e efektit të njëjtë tek lexuesit e tekstit në gjuhën e përkthimit duke u kujdesur në veçanti për termat kulturorë, në mënyrë që ato të mos humbasin kuptimin e tyre. Përshtatja është një metodë që mund të emërtohet edhe si “ekuivalencë që vjen si rrjedhojë e situatës apo kontekstit” thekson Mandej.⁴⁸

Përkthimi i lirë është ai lloj përkthimi në të cilin përkthyesi ruan vetëm esencën e origjinalit por pa u kujdesur shumë për formën, strukturën e ndonjëherë, edhe përmbajtjen.

Përkthimi i lirë ka disa pika të dobëta dhe këtu mund të përmendim tre prej tyre. E para lidhet me rastin kur përkthyesi mund të japë shumë element nga vetja duke eklipsuar në këtë mënyrë punën e autorit. Një tjetër element është dhe fakti që, duke qenë një përkthim i lirë, mund të shkohet tepër larg me ndryshimet duke sjellë humbje të mëdha në tekstin në gjuhën e përkthimit.⁴⁹

Dhe e fundit lidhet me kufizimin e përdorimit të këtij lloj përkthimi. Ai mund të përdoret vetëm në tekstet letrare ku ndryshimet janë deri diku të pranueshme por nuk është ndër llojet e përkthimeve që sugjerohen të përdoren në tekste shkencore, teknike apo politike.

Përkthimi idiomatik ka si qëllim të riprodhojë të njëjtin mesazh që përcjell teksti origjinal edhe pse ka raste që është e vështirë të gjenden ekuivalentët në gjuhën e përkthimit. Kjo ndodh për faktin se idiomat janë shprehje fikse që mund t’i përkasin vetëm një kulture të caktuar dhe është shumë e vështirë të transmetosh të njëjtin efekt në një kulturë që nuk e njeh fenomenin/konceptin në fjalë. Ndonjëherë ndryshimet që duhen bërë tek ky lloj përkthimi janë të pashmangshme dhe të kushtëzuara nga kultura.

Kur kemi të bëjmë me një përkthim idiomatik përkthyesi duhet të ketë kujdes disa elementë. Së pari, faktin që efekti nga një gjuhë në tjetrën duhet të jetë i njëjtë. Së dyti, natyrshmërinë me të cilën duhet të përkthehet shprehja në mënyrë që të mos jetë e sforcurar dhe e pakuptimtë. Më pas ka dhe raste kur është më mirë të perifrashohet nëqoftëse nuk ka një shprehje fikse në gjuhën e përkthimit me të cilën duhet të jetë e

⁴⁷ Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 63

⁴⁸ Hatim, Basil dhe Munday, Jeremy. *Translation: An advanced resource book*. New York: Taylor&Francis e-Library, 2004, fq. 151

⁴⁹ Mounin, G. *Les problèmes théoriques de la traduction*, Paris: Gallimard, 1963, fq. 24

barazvlefshme.⁵⁰

Përkthimi komunikues synon të sjellë tekstin në gjuhën e përkthimit duke ruajtur si formën ashtu dhe përmbajtjen në mënyrë që të komunikojë dhe të përcjellë një mesazh sa më të kuptueshëm.

Sipas Newmark, ky lloj përkthimi synon që të arrijë të njëjtin efekt që arrin dhe autori me lexuesin e tekstit origjinal.⁵¹ Lexuesi është në qëndër të vëmendjes. Si pasojë, përkthyesi përkthen duke patur në mendje lexuesin, sesi mund të reagojë ai ndaj tekstit.

Ky lloj përkthimi përfshin elemente të të gjithë llojeve të përkthimeve pasi herë-herë ai është i lirë dhe herë të tjera besnik në të gjitha elementët.

Newmark ka propozuar që përkthimi komunikues duhet të përdoret në tekstet informative dhe në fjalime të ndryshme. Në përgjithësi, ky lloj përkthimi është i thjeshtë, i qartë, i drejtpërdrejtë, konvencional dhe i përshtatet regjistrin të gjuhës së përkthimit. Ka raste kur ai jep më pak detaje sesa versioni origjinal me qëllim që lexuesi ta ketë më të thjeshtë ta kuptojë atë pa u ndikuar nga detajë që mund të jenë të panevojshme.

Në kapitujt vijues do t'i trajtojmë më gjerësisht këto lloje përkthimesh duke i ilustruar dhe me shembujt përkatës.

1.1.3 Metodatat e përkthimit

Strategjitë e procedurave të bazuara në stilistikën krahasuese (Vinej dhe Darbelnet), të përdorura edhe nga studiues të tjerë (Njemark), ose teknikat e sugjeruara nga përkthyesit e Biblës (Nida), kanë për qëllim të propozojnë një “metagjuhë”⁵² dhe të katalogojnë zgjidhje të mundshme në detyrën e përkthimit. Procedura të tilla janë kritikuar shpeshherë, madje edhe për arsye të mungesës së konsensusit se çfarë emri duhet t'u jepet këtyre kategorive (procedurat, teknikat, strategjitë apo metodatat shpesh ndërliken dhe përdoren si sinonime).

Problemet e emërimit ndodhin sepse procedurat ndonjëherë mbivendosen, ato vetëm katalogojnë ndryshime në aspektin e gjuhës dhe jo të përdorimit, si dhe përqendrohen më shumë në rezultatet e përkthimit sesa në procesin e përkthimit. Sidoqoftë, ka pasur disa përpjekje për të dalluar shtrategjitë apo procedurat nga metodatat, të cilat lidhen më shumë me procesin e përkthimit. Megjithatë, është për t'u theksuar fakti se procedurat ose strategjitë që përmenden zakonisht në botimet akademike shërbejnë si për të analizuar ashtu edhe për katalogimin e ekuivalencës së përkthimit, si dhe për të

⁵⁰ Manfredi, M. *Translating Text and Context: Translational Studies and Systematic Functional Linguistics*, vol. 1. Cagliari, CUEC, 2008, fq. 34

⁵¹ Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 63

⁵² Shpjegimi i këtij termi është : “një formë e gjuhës ose një tërësi termash të përdorura për përshkrimin ose analizën e një gjuhe tjetër”

përmirësuar përvetësimin e kompetencës së përkthimit, pasi njohja dhe krahasimi i tyre është përfundimisht e nevojshme për të marrë një përkthim sa më të përshtatshëm në gjuhën e përkthimit.

Në librin “*Translation. An advanced resource book*” **përshtatja** përkufizohet kështu: “Përshtatja është kufiri i skajshëm i përkthimit: përdoret në ato raste kur lloji i situatës për të cilin referohet mesazhi i gjuhës origjinale nuk është i njohur në kulturën e gjuhës së përkthimit. Në raste të tilla, përkthyesit duhet të krijojnë një situatë të re që mund të konsiderohet si ekuivalente. Përshtatja, si rezultat, mund të përshkruhet si një lloj i veçantë ekuivalentimi, një ekuivalencë situative.”⁵³

Sipas këtij përkufizimi, përshtatja është një lloj i veçantë i ekuivalencës, një lloj ekuivalence që varet tek konteksti dhe situata. Ky mjet stilistik përdoret në rastet kur mesazhi nuk mund të përcillet në gjuhën e përkthimit pa bërë një lloj përshatjeje që e bën më të kuptueshëm këtë mesazh në gjuhën tjetër.

Për më tepër përshtatja përshkruhet si një teknikë ku një element kulturor zëvendësohet me një tjetër element që është tipar i kulturës së gjuhës së përkthimit, dhe si pasojë lexuesi e kupton atë pasi ai element vjen përmes një elementi që ai e njeh dhe si rezultat arrin dhe ta kuptojë. Kjo është një teknikë shumë e mirë kur kemi të bëjmë me përkthimin e sloganeve të ndryshme, reklamave, etj. Në këto raste i jepet rëndësi mesazhit më tepër sesa fjalëve të përdorura dhe kjo ndodh për shkak se mesazhi që përcillet është më i rëndësishëm se forma se si përcillet.

Qëllimi kryesor thekson Hatim përse përkthyesi zgjedh të përdorë këtë mjet stilistik “është përcjellja e efektit të njëjtë tek lexuesit e tekstit në gjuhën e përkthimit duke përshtatur termat kulturorë në një farë mënyre”.⁵⁴ Në mënyrë që të arrihet një përkthim sa më i mirë duhet të shkohet përtej kuptimit sipërfaqësor të fjalëve. Është shumë e rëndësishme që të përcillet kuptimi i fjalëve në një situatë të caktuar duke u bazuar tek konteksti kulturor. Fakti që merret parasysh elementi kulturor bën që të kuptohet se përkthyesi nuk është i vetmi person i përfshirë në përkthim.

Duke ndjekur Nida dhe duke zbatuar kulturën e konceptit në detyrën e përkthimit, Newmark shtron klasifikimin e tij të fjalëve kulturore të huaja, duke vendosur pesë kategori:

- a. Ekologjia (flora, fauna, erërat, klima, etj.);
- b. Kultura materiale (ushqim, rroba, shtëpi, qytete, transport);
- c. Kultura shoqërore (punë dhe kohë të lirë);
- d. Organizimet, zakonet, aktivitetet, procedurat ose konceptet (të cilat përfshijnë nënkategoritë artistike, fetare, politike dhe administrative);

⁵³ Hatim, Basil dhe Munday, Jeremy. *Translation: An advanced resource book*, New York: Taylor&Francis e-Library, 2004, fq. 151

⁵⁴ Hatim Basil and Ian Mason, *Discourse and the Translator*, London and New York. Longman, 1990, fq. 45

e.Gjestet dhe zakonet.⁵⁵

Metoda e quajtur **transpozim** përfshin zëvendësimin e një fjale që i përket një kategorie të caktuar gramatikore me një tjetër pa ndryshuar përmbajtjen e mesazhit.⁵⁶ Përveç faktit se kjo është një procedurë e veçantë përkthimore, transpozimi mund të përdoret edhe për ndryshimet që ndodhin brenda të njëjtës gjuhë. Po ta shohim nga pikëpamja stilistike, teksti original dhe ai i transpozuar nuk kanë të njëjtën vlerë. Përkthyesit rekomandohet që kur të përdorin këtë metodë të kujdesen edhe për faktin se nuanca stilistike nuk duhet të ndryshojë, ajo duhet të jetë e njëjtë pavarësisht ndryshimeve të bëra. Në të vërtetë versioni i transpozuar ngjan më tepër me një përkthim literal.⁵⁷

Ekuivalenca përdoret në rastet kur kemi të bejmë me dy tekste që kanë dy stile dhe metoda strukturore tërësisht të ndryshme. Produkt i përdorimit të ekuivalencës janë dy tekste ekuivalente. Ekuivalencat, në shumicën e rasteve, janë të “ngurta” dhe përdoren sidomos në rastet e përkthimit të shprehjeve frazeologjike, proverbave, grupeve emërore, etj. Sipas Vinej dhe Dalbernet (Vinay and Dalbernet), “ekuivalentimi i referohet një strategjie që përshkruan të njëjtën situatë duke përdorur metoda krejtsisht të ndryshme stilistike ose strukturore për prodhimin e teksteve ekuivalente”.⁵⁸ Kjo në thelb do të thotë që përkthyesi përdor një term ose shprehje të njohur si një ekuivalent të vendosur në gjuhën e përkthimit.

Në monografinë e prof. Dr. Ristanit, ekuivalenca përkufizohet si “përftesë përkthimore e emërtuar ekuivalencë ose ndryshe përkthim i barazvlefshëm, nëpërmejt së cilës vendosen marrëdhënie të barazvlefshmërisë kuptimore” e cila përdoret në rastet kur ka mospërputhje sintaksore dhe leksikore ndërmjet njësisive gjuhësore përkatëse në gjuhën e burimit dhe të përkthimit.⁵⁹

Ndërsa Nida është në favor të "dy orientimeve themelore" ose "llojeve të ekuivalencës": (1) ekuivalencës formale dhe (2) ekuivalencës dinamike. Këto përcaktohen nga Nida si më poshtë:

-Ekuivalenca formale: përqëndron vëmendjen në vetë mesazhin, si në formë ashtu edhe në përmbajtje ... shqetësohet që mesazhi në gjuhën e përkthimit duhet të përputhet sa më shumë që të jetë e mundur me elementët e ndryshëm në gjuhën e origjinalit.

Ekuivalenca dinamike: bazohet në atë që Nida e quan "parimi i efektit ekuivalent", ku "marrëdhënia midis receptorit (marrësit të mesazhit) dhe mesazhit

⁵⁵ Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 21

⁵⁶ Vinay, J. P, and J. Dalbernet. *Comparative Stylistics of French and English: A methodology for Translation*, translated by J.C Sager and M.J Hamel, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 1995, fq. 50

⁵⁷ Hatim, Basil dhe Munday, Jeremy. *Translation: An advanced resource book.*, New York: Taylor&Francis e-Library, 2004, fq. 150

⁵⁸ Vinay, J. P, and J. Dalbernet. *Comparative Stylistics of French and English: A methodology for Translation*, translated by J.C Sager and M.J Hamel, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 1995, fq. 52

⁵⁹ Ristani, Viktor. *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Tiranë: Mirgeeralb, 2010, fq. 229

duhet të jetë në thelb e njëjtë me atë që ekzistonte midis receptorëve origjinal (marrësve të mesazhit në gjuhën origjinale) dhe mesazhit". Mesazhi duhet të përshtatet për nevojat gjuhësore dhe pritjen kulturore të receptorit dhe synon "natyralitetin e shprehjes" të plotë. Kjo qasje e orientuar nga receptorët konsideron përshtatjet e gramatikës, të leksikut dhe të referencave kulturore si thelbësore për të arritur natyralitetin.⁶⁰

Për Nida, suksesi i përkthimit varet mbi të gjitha nga arritja e përgjigjes ekuivalente. Është një nga "katër kërkesat themelore të një përkthimi", të cilat janë :

- (1) të ketë kuptim;
- (2) të përçojë frymën dhe mënyrën e origjinalit;
- (3) të ketë një formë të shprehur natyrore dhe të lehtë;
- (4) të prodhojë një reagim të ngjashme me origjinalin⁶¹

I. 1. 4 Qëndrimi i përkthyesit ndaj tekstit origjinal

Bazuar në pikëpamjet dhe rezultatet e shumë studimeve mbi teorinë e procesit të përkthimit është gjithnjë e më shumë e rëndësishme që përkthyesi ta kuptojë shumë mirë tekstin origjinal në mënyrë që teksti në gjuhën e përkthimit të transmetohet në një mënyrë sa më natyrale. Megjithatë, për ta kuptuar tekstin origjinal kërkohet që përkthyesi të njohë shumë mirë edhe kulturën e vendit në të cilën flitet ajo gjuhë e caktuar. Përkthyesi rekomandohet të vendosë lidhur me rëndësinë që kanë elementët kulturorë dhe deri në çfarë pike është e nevojshme të përkthehen apo dhe shpjegohen në gjuhën e përkthimit. Ai merr gjithashtu në konsideratë qëllimet e tekstit origjinal si dhe gjithashtu lexuesit e këtij të fundit në gjuhën e përkthimit.

Përpara se të fillojë përkthimin e tekstit, përkthyesi sugjerohet që të analizojë problemet, aspektet kulturore mes dy gjuhëve që të zgjedhë metodën më të mirë për ta sjellë tekstin origjinal në gjuhën e përkthimit. Për sa i përket problemeve të përkthimit, Nida thekson rëndësinë e njëjtë të ndryshimeve kulturore dhe gjuhësore të gjuhës origjinale dhe gjuhës së përkthimit. Ai përmbledh në këtë mënyrë: “ndryshimet midis kulturave mund të shkaktojnë probleme më të rënda për përkthyesin sesa ndryshimet në strukturën gjuhësore”.⁶²

Përveç tekstit në përgjithësi, përkthyesi është i kushtëzuar t’i kushtojë një vëmendje të veçantë edhe titullit. Ai duhet të analizohet më vete në mënyrë që të ruajë origjinalitetin dhe të transmetojë mesazhin e tekstit origjinal. Titulli mendohet se duhet të analizohet pasi janë trajtuar të gjithave aspektet kulturore dhe më pas të arrihet tek konkluzionet për

⁶⁰ Munday, Jeremy., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 42

⁶¹ Po aty

⁶² Nida, E., *Towards a Science of Translating*. Leiden: Brill, 1964, fq.130

të vendosur mbi të.⁶³

Teoria e Lotman shprehet se "asnjë gjuhë nuk mund të ekzistojë nëse nuk është kapur në kontekstin e kulturës; dhe asnjë kulturë nuk mund të ekzistojë nëse nuk ka në qendër të saj strukturën e gjuhës natyrore".⁶⁴ Rrjedhimisht, sipas këtij citimi gjuha dhe kultura janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën dhe në mënyrë që të transmetojmë siç duhet mesazhin duhet që fillimisht të hyjmë në thellësi të kulturës.

Basnet thekson gjithashtu rëndësinë e këtij binomi në procesin e përkthimit duke shprehur që “gjuha është zemra brenda trupit të kulturës.”⁶⁵ Kur përkthyesi merr përsipër të përkthejë tekstin ai/ajo mban një lloj qëndrimi ndaj tekstit, krijon opinionet, idetë dhe këndvështrimet mbi atë që lexon. Si rezultat, kur përkthehet është e rëndësishme të konsiderohet jo vetëm aspekti leksikor por edhe mënyra sesi aspektet kulturore mund të perceptohen nga lexuesi.

Sigurisht që përkthyesi mban një lloj qëndrimi ndaj burimit të tekstit dhe ai mund të niset nga disa aspekte. Coulthard thekson rëndësinë e përkufizimit të lexuesit ideal si për autorin ashtu dhe për përkthyesin. Këtu mund të citojmë fjalët e tij: "përkthyesi transmeton njohuri për fakte të caktuara, kujtime të përvojave të caktuara ... plus mendime, preferenca dhe paragjykime të caktuara dhe një nivel të caktuar të kompetencës gjuhësore."⁶⁶

Nuk mund të harrohet fakti që lidhet me nivelin deri ku influencohet autori dhe nga cilat shkaqe niset ai si për shembull dhe grupi socio-kulturor të cilit do t'i adresohet teksti pasi këtu niset krijimi i idesë së përkthyesit rreth kuptimit të botës së autorit. Më pas, sigurisht që pika në të cilën përqëndrohet përkthyesi është lexuesi në gjuhën e përkthimit. Në momentin që arrihet të kuptohen pak a shumë karakteristikat e lexuesit në gjuhën e përkthimit mund të fillojë procesi i vërtetë i përkthimit.

Më poshtë japim pikat kryesore që njihen si problemet më të shpeshta me të cilat mund të përballet një përkthyes:

-problemet e dykuptimësisë: këto probleme vijnë nga ndryshimet strukturore dhe leksikore ndërmjet gjuhëve

-problemet e gramatikës: ka lloje të ndryshme të strukturave gramatikore me rregulla të cilat mund të jenë të vështira për t'u kuptuar apo dhe shpjeguar në gjuhën e përkthimit

-problemet e gjuhës: mund të hasin probleme në përkthimin e idiomave, neologjizmave, ose zhargonit

⁶³ Eco, Umberto, *Të thuash gati të njejtën gjë*, Përkth. Mariana Ymeri & Alketa Ylli, Tiranë, 2006, fq.121

⁶⁴ Lotman, J., Uspensky, B. "On the Semiotic Mechanism of Culture," *New Literary History*, 1978, fq 211

⁶⁵ Bassnett, Susan and Andre Lefevere, *Translation, History and Culture*, London and New York Routledge, 1992, fq 13-14

⁶⁶ Coulthard, M., *Linguistic Constraints on Translation. In Studies in Translation*. Universidada Federal de Santa Catarina, 1992, fq. 12-13

-problemet kulturore: ka terma të cilat përkthehen më vështirësi për shkak se janë tërësisht kulturore dhe mund të mos kuptohen nga lexuesi në gjuhën e përkthimit

Ka disa lloje përkthimi të cilat vijnë në përshtatje me tipologjinë e tekstit, qëllimin e tij, lexuesin e tekstit në gjuhën e përkthimit, vështirësia e tekstit, etj.

Coulthard gjithashtu thekson se vështirësia kryesore dhe më e madhja e përkthyesit është ndërtimi i figurës së lexuesit ideal të tekstit në gjuhën e përkthimit i cili edhe pse mund të ketë të njëjtin nivel intelektual, arsimor, dhe profesional me lexuesin e tekstit origjinal ekzistojnë ndryshime për sa u përket pritshmërive lidhur me tekstin dhe elementët kulturorë.⁶⁷

Rrjedhimisht, kjo është vështirësia më e madhe e përkthyesit pasi teksti dhe mesazhi që ai duhet të përcjellë nuk mendohet të ndryshojë nga origjinali pavarësisht ndryshimeve apo të përbashkëtave që ekzistojnë mes lexuesve të dy gjuhëve të ndryshme.

Edhe pse preferencat apo paragjykimet mund të jenë të njëjta përkthyesi sugjerohet të ketë parasysh se ndoshta janë eksperiencat dhe situatat e ndryshme sociale që nuk mund të përputhen. Si përfundim mund të themi se aspektet kulturore dhe shoqërore janë problematike kur bëhet fjalë për të përkthyer nga një gjuhë në tjetrën dhe këtu qëndron sfida më e madhe që përkthyesi has dhe vlerësohet mjeshtria e tij për ta menagjuar këtë pengesë.

Etienne Dolet, fati i trishtuar i të cilit u vu në dukje më lart, në dorëshkrimin e tij të vitit 1540 "Mënyra e përkthimit të mirë nga një gjuhë në tjetrën" përcakton parimet në rend të rëndësisë së tyre si më poshtë:

- (1) Përkthyesi këshillohet të kuptojë në mënyrë të përsosur kuptimin dhe materialin e autorit origjinal, megjithëse ai (ajo) sugjerohet të ndjehet i lirë të sqarojë “errësirat”.
- (2) Përkthyesi këshillohet të ketë njohuri të përsosur si për gjuhën e origjinalit ashtu edhe për gjuhën e përkthimit, në mënyrë që të mos zvogëlohet madhështia e gjuhës.
- (3) Përkthyesi këshillohet të shmangë paraqitjet fjalë për fjalë.
- (4) Përkthyesi këshillohet të shmang format latine dhe të pazakonta.
- (5) Përkthyesi këshillohet të mbledhë dhe të lidhë fjalët me elokuencë për të shmangur ngathtësinë e shprehisë.⁶⁸

⁶⁷ Po aty

⁶⁸ Munday, Jeremy., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq.27

I. 2 Zhvillimet kryesore në fushën e përkthimit para viteve ‘90

Ashtu siç shpjeguam në hyrje të këtij punimi, për shekuj me radhë njerëzit kanë besuar në lidhjen mes përkthimit dhe historisë së Kullës së Babelit. Me lindjen e studimeve mbi përkthimin dhe me rritjen e numrit të kërkimeve në këtë fushë njerëzit filluan të largoheshin nga historia e Babelit dhe filluan të kërkonin për data dhe të dhëna të cilat përkonin me periudhat e historisë së përkthimit.

Përkthimi u studiuua fillimisht si një fenomen lingistik, si një proces i transmetimit të fjalëve, mesazhe nga një gjuhë në tjetrën. Ai u konsiderua si një disiplinë gjuhësore. Janë bërë përpjekje për të zhvilluar “një shkencë të përkthimit” apo një teori gjuhësore të përkthimit qëllimi i të cilit ishte të jepte një përcaktim të saktë lidhur me transferimet e mesazheve nga një gjuhë në tjetrën.

Mes viteve 1950-1960, sipas Steiner ekzistonte një debat lidhur me përkthimin fjalë për fjalë, të lirë dhe përkthimit besnik.⁶⁹ Pas disa vitesh, Ulrych dhe Bolleteiri Bosinelli theksuan se lidhjet mes përkthimit dhe gjuhësisë u forcuan, sidomos si rezultat i zhvillimeve në fushën e gjuhësisë. Përkthimi u përkufizua si “gjuha e cila është një fenomen shoqëror që zhvillohet brenda një konteksti specifik kulturor”.⁷⁰

Në vitin 1988 mediat e huaja shkruanin kështu lidhur me përkthimin në Shqipëri: “Studimi i gjuhëve të huaja aktualisht po promovohet gjerësisht në radhët e opinionit public shqiptar, ku në të shkuarën vetëm një sasi e pakët të përzgjedhurish janë lejuar të mësojnë.”⁷¹ Në të njëjtën kohë, përkthimi i letërsisë së huaj po inkurajohej pasi ishte në linjë me rritjen e kontakteve që vendi komunist po synonte me botën e jashtme.

Në fakt, shqiptarët edhe në një pikëpamje historike kanë shfaqur e vijojnë të shfaqin interes të veçantë për mësimin e gjuhëve të huaja. Që në kohët e hershme, nën sundimin romak, bizantin, venedikas ose osman, shqiptarët kanë shfaqur aftësi të veçanta duke u rekrutuar shpesh jo vetëm si luftëtarë e nënpunës të zotë por dhe si mendimtarë, e në këtë kontekst dhe si përkthyes.⁷² Mund të përmendim këtu angazhimin zyrtar në shërbim të Perandorisë Osmane, të Ismail Qemalit i cili shërbeu si përkthyes i disa gjuhëve të huaja në Ministrinë e Jashtme Osmane. Gjatë viteve të komunizmit kishte një trend më tepër të përcjelljes së veprave të letërsisë shqipe e atyre me përmbajtje ideologjike drejt gjuhëve të huaja.⁷³

⁶⁹ Steiner, George, *After Babel: aspects of Language and Translation*, Oxford, England: Oxford University Press, 1975, fq. 319

⁷⁰ Ulrych, M., Bolletteiri Bosinelli, R.M. *The State of the Art in Translation Studies: An Overview*. Textus XII, 1999, fq. 229

⁷¹ Newmark, Loenard, Hubbard, Philip, Prifti, Peter, *Standard Albanian*, Stanford, California, Stanford University Press, 1982, 73

⁷² Po aty

⁷³ Po aty, 74

Sigurisht që pas viteve '90 u rrit interesi për mësimin e gjuhëve të huaja, kryesisht atyre të mëdha perëndimore, dhe ky interes u shoqërua vullshëm me rritjen e numrit të përkthimeve nga letërsia e huaj.⁷⁴

I. 2. 1 Llojet dhe metodat kryesore të përkthimit para viteve '90

Në shekullin e XVII filluan të zhvilloheshin teori lidhur me përkthimin. Ndërsa në shekullin e XVIII përkthyesi krahasohej me një artist i cili kishte një detyrë të dyfishtë morale, të studionte punën e autorit në tekstin origjinal dhe më pas të “mendonte për lexuesin e tekstit në gjuhën e përkthimit. Në këtë periudhë, studimi i përkthimit dhe teorinë lidhur me të u bënë më të zhvilluara.

Pikërisht gjatë këtij shekulli, Dolet në dorëshkrimin e tij “Mënyra e përkthimit mirë nga njëra gjuhë në tjetrën” vendosi 5 parime bazë lidhur me përkthyesit dhe punën e tyre:

- a. Përkthyesi duhet të kuptojë në mënyrë perfekte kuptimin e tekstit origjinal edhe pse ai më pas duhet të ndihet i lirë të sqarojë elementët që mund të mos jenë të qartë.
- b. Përkthyesi duhet të ketë njohuri perfekte mbi të dyja gjuhët.
- c. Ai/ajo duhet të shmangë përkthimin fjalë për fjalë
- d. Përkthyesi duhet të shmangë format e pazakonta të fjalëve që mund të ngatërrojnë lexuesin
- e. Përkthyesi duhet të sjellë një përkthim sa më natyral për lexuesin në gjuhën e përkthimit.⁷⁵

Kështu, këto ishin përpjekjet e para lidhur me përkthimin dhe mënjanimin e përkthimit fjalë për fjalë duke u përqëndruar më shumë në mesazhin e tekstit sesa në fjalët në veçanti.

Shekulli i XIX-të u karakterizua nga dy tendenca kontradiktore:

E para lidhej me përkthimin që konsiderohej një lloj mendimi dhe që e shihte përkthyesin si një gjeni krijues i cili pasuronte letërsinë dhe gjuhën në të cilën ai përkthente. Ndërsa tendenca e dytë e shihte përkthyesin si një makineri e cila kishte si funksion të bënte një tekst, ta sillte atë në një gjuhë tjetër.⁷⁶ Shekulli i XIX –të lidhet gjithashtu me lindjen e shumë teorive dhe përkthimeve në fushën e letërsisë, sidomos tek poezia. Një shembull i këtyre përkthimeve është dhe Fitzgerald për Rubalyat Omar Al- Khayyam. Që në vitin 1960 janë bërë ndryshime të mëdha në fushën e studimeve mbi përkthimin duke sjellë një rritje në studimin e gjuhësisë në përgjithësi. Dijetarët në Hollandë, Cekoslovakia, Bashkimin Sovietik, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës ngritën zërin lidhur me nevojën për krijimin e shkollave të përkthimit. Përkthyesit profesionistë kanë bërë një punë shumë të madhe në këtë drejtim. “Puna e cila i pati fillimet në vitet ‘70, u zhvillua

⁷⁴ Po aty, 75

⁷⁵ Munday, Jeremy, *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 23

⁷⁶ McGuire, S. *Translation Studies*, London: Methuen, 1980, fq. 26

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

më shumë në vitet '80 dhe preku majat në vitet '90” shkruan Bassnet.⁷⁷

Në SHBA-në e viteve 60 ishte tepër present përkthimi letrar dhe në të njëjtën kohë u zhvillua dhe krahasimi letrar mes veprave të ndryshme. Në gjysmën e dytë të shekullit të XX, studimet mbi përkthimin u bënë shumë të rëndësishme edhe për mësimin dhe mësimindhënien e gjuhës në shkolla. Kjo periudhë karakterizohet nga përkthimi pragmatik dhe teoritë që lidheshin me të.⁷⁸

Në SHBA, përkthimi, konkretisht përkthimi letrar, u promovua në universitete në vitet 1960 nga koncepti i seminarit të përkthimit. Bazuar në seminarin e leximit të I. A. Richards dhe qasjes praktike të kritikës që filloi në vitet 1920 dhe në seminarin e tjera të mëvonshme të shkrimit krijues, këto seminare të përkthimit u krijuan për herë të parë në universitetet e Iowa dhe Princeton. Ato ishin menduar si një platformë për futjen e përkthimeve të reja në kulturën e përkthimit dhe për diskutimin e parimeve më të përsosura të procesit të përkthimit dhe të kuptimit të një teksti.⁷⁹

Drejtimi paralel me këtë qasje ishte ai i letërsisë krahasuese, ku letërsia studiohet dhe krahasohet në mënyrë transnacionale dhe transkulturore, duke kërkuar leximin e disa letërsive në përkthim. Kjo më vonë do të lidhej me rritjen e kurseve të llojit të studimeve kulturore. Një fushë tjetër në të cilën përkthimi u bë objekt studimi ishte analiza kontrastive. Ky është studimi i dy gjuhëve në kontrast, në një përpjekje për të identifikuar dallimet e përgjithshme dhe specifike midis tyre. Ajo u zhvillua në një zonë sistematike të kërkimit në SH.B.A. nga vitet 1930 e tutje dhe doli në sipërfaqe në vitet 1960 dhe 1970.⁸⁰

Munday shkruan me tej se përkthimet dhe shembujt e përkthyer siguruan shumë nga të dhënat në këto studime (këtu mund të përmendim Di Pietro 1971 dhe James 1980). Qasja kontrastive ndikoi shumë studime të tjera, të tilla si Vinay dhe Darbelnet (1958) dhe Catford (1965), të cilët shprehën qartë qëllimin e tyre për të ndihmuar në kërkimin e përkthimit. Edhe pse analiza e dobishme kontrastuese nuk përfshin, faktorët sociokulturorë dhe praktikë, as rolin e përkthimit si një veprim komunikues, sidoqoftë, aplikimi i vazhdueshëm i një qasjeje gjuhësore në përgjithësi, dhe modeleve specifike gjuhësore si gramatika funksionale ka demonstruar një lidhje të qenësishme me përkthimin.⁸¹

Në veprën e tij “Contemporary Translation Theories” Gentzler pershkruan punimin e James Holmes mbi fushën e përkthimit *The Name and Nature of Translation* (Emri dhe natyra e përkthimit) që bëri të mundur që përkthimi të konsiderohej disiplinë me vete si “deklarata themeluese për studimin e fushës së përkthimit”.⁸² Holmes bën një ndarje të studimeve përkthimologjike në dy ndarje kryesore: 1. të mirëfillta dhe 2. të aplikuara.

⁷⁷ Bassnet, Susan and Andre Lefevere, *Translation, History and Culture*, London and New York Routledge, 1992, fq. 214

⁷⁸ Po aty

⁷⁹ Gentzler, Edwin, *Contemporary Translation Theories*. London & New York: Routledge, 1993, fq. 18

⁸⁰ Munday, Jeremy, *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 9

⁸¹ Po aty, fq. 9-10

⁸² Gentzler, Edwin, *Contemporary Translation Theories*. London & New York: Routledge, 1993, fq. 92

Sipas tij, objektivat e fushave 'të mirëfillta' të hulumtimit janë:

- (a) përshkrimi i fenomeneve të përkthimit (përshkruese);
- (b) vendosja e parimeve të përgjithshme për të shpjeguar dhe parashikuar fenomene të tilla (teorike).

Objektiva 'teorike' është e ndarë në teori të përgjithshme dhe të pjesshme. Me 'teori të përgjithshme', Holmes u referohet atyre shkrimeve që kërkojnë të përshkruajnë ose japin llogari për çdo lloj përkthimi dhe të bëjnë përgjithësime që do të jenë të rëndësishme për përkthimin në tërësi. Studimet teorike 'të pjesshme' janë të kufizuara sipas parametrave të diskutuar më poshtë.⁸³

- Teoritë e kufizuara nga mjetet: ndahen sipas përkthimit nga makineritë dhe njerëzit, me nëndarje të mëtejshme, nëse makina / kompjuteri po punon vetëm ose si ndihmë për përkthyesin, nëse përkthimi është shkruar ose folur dhe nëse përkthimi i folur (interpretimi) është i njëpasnjëshëm apo i njëkohshëm.
- Teoritë e kufizuara nga zona: janë të kufizuara në gjuhë specifike ose grupe gjuhësh dhe/ose kulturash. Holmes vëren se teoritë e kufizuara gjuhësore janë të lidhura ngushtë me punën në gjuhësi dhe stilistikë.
- Teoritë e kufizuara nga niveli i tekstit: janë teori gjuhësore që janë kufizuar në një nivel specifik të fjalës ose fjalisë. Në kohën kur Holmes po shkruante, kishte një prirje drejt gjuhësisë së tekstit, do të thotë analiza e tekstit, e cila që nga ajo kohë është bërë shumë më e popullarizuar.
- Teoritë e kufizuara të llojit të tekstit: shikojnë llojet ose zhanret specifikë të ligjëritimit; si për shembull përkthim letrar, i biznesit apo teknik.
- Termi “teori e kufizuar në kohë” është vetë-shpjegues: duke iu referuar teorive dhe përkthimeve të kufizuara sipas kornizave kohore dhe periudhave specifike. Historia e përkthimit bën pjesë në këtë kategori.
- Teoritë e kufizuara nga problemet: mund t'i referohen problemeve specifike siç janë ekuivalentimi, një çështje kryesore e viteve 1960 dhe 1970.

Objektiva tjetër e 'të mirëfilltave' në hartën e Holmes është përshkruese. Studimet përshkruese të përkthimit kanë tre fokuse: ekzaminimin e (1) produktit, (2) funksionit dhe (3) procesit.⁸⁴

- E orientuar drejt produktit: shqyrton përkthimet ekzistuese. Kjo mund të përfshijë përshkrimin ose analizën e një çifti të vetëm tekst origjinal-tekst i përkthyer ose një analizë krahasuese të disa tekste të përkthyer të të njëjtit tekst origjinal. Këto studime në shkallë më të vogël mund të grupohen në një njësi më të madhe të

⁸³ Munday, Jeremy, *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 10-11

⁸⁴ Munday, Jeremy, *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 11

analizave të përkthimit, duke parë një periudhë specifike, gjuhë ose tekst/lloj ligjerimi. Studimet në shkallë më të madhe mund të jenë diakronike (duke ndjekur zhvillimin me kalimin e kohës) ose sinkronike (në një pikë të vetme ose në një periudhë në kohë) dhe, siç e parashikon Holmes “një nga qëllimet përfundimtare të teorive pershkruese të përkthimit të orientuara nga produkti ndoshta mund të jetë një histori e përgjithshme e përkthimeve”⁸⁵

- E orientuar nga funksioni: Holmes nënkupton përshkrimin e 'funksionit të përkthimeve në situatën sociokulturore të marrësit: është një studim i konteksteve dhe jo i teksteve. Çështjet që mund të hulumtohen përfshijnë cilat libra janë përkthyer kur, ku dhe çfarë ndikimesh kanë ushtruar ato. Kjo fushë, e cila Holmes e quan 'studime socio-përkthimi', por që sot ndoshta do të quhej përkthim i orientuar nga studimet kulturore, ishte më pak i hulumtuar në kohën e punimit të Holmes, por është më e studiuar në punimet e tanishme në studimet e përkthimit.
- E orientuar drejt procesit: në punën e Holmes ka të bëjë me psikologjinë e përkthimit, domethënë merret me përpjekjen për të zbuluar se çfarë ndodh në mendjen e një përkthyesi. Kjo është një fushë e studimit e cila ende nuk është analizuar sistematikisht.⁸⁶

Dega e studimeve përkthimologjike 'të aplikuara' të Holmes ka të bëjë me:

- trajnimin e përkthyesit: metodat e mësimdhënies, teknikat e testimit, hartimin e kurrikulës;
- mjete ndihmëse për përkthim: siç janë fjalorët, gramatikat dhe teknologjia e informacionit;
- kritika e përkthimit: vlerësimi i përkthimeve, përfshirë shënimin e përkthimeve të studentëve rishikimet e përkthimeve të botuara⁸⁷

Një fushë tjetër që përmend Holmes është politika e përkthimit, ku ai shikon studiuesin e përkthimit që këshillon për vendin e përkthimit në shoqëri, përfshirë çfarë vendi ai duhet të zërë në kurrikulën mësimore dhe veçanërisht mësimin e gjuhës.

I. 3 Procesi i përkthimit pas viteve '90

Vitet 1990 shënojnë përfshirjen e shkollave dhe koncepteve të reja, me përkthim dhe hulumtim gjinor me bazë kanadeze të udhëhequr nga Sherry Simon, shkolla kanibaliste braziliane e promovuar nga Else Vieira, teoria e përkthimit postkolonial, me figurat e shquara të studiuesve nga Bengali Tejaswini Niranjana dhe Gayatri Spivak dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, analiza e orientuar nga studimet kulturore të Lawrence Venuti.⁸⁸

⁸⁵ Po aty

⁸⁶ Munday, Jeremy, *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 11-12

⁸⁷ Po aty

⁸⁸ Po aty, fq. 15

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Për vite me radhë, praktika e përkthimit konsiderohej si derivative dhe sekondare, një qëndrim që zhvlerësoi në mënyrë të pashmangshme çdo studim akademik të kësaj veprimtarie. Tani, pas shumë neglizhencave dhe shtypjeve, studimet e përkthimit i kanë themelet më të forta pasi po bëjnë përparime të shpejta në të gjithë botën.

Megjithatë, studimet e përkthimit dhe përkthimi shpesh vazhdojnë të bëhen në kontekstin e departamenteve të gjuhëve moderne, dhe praktikës së përkthimit ende shpesh i mohohet barazia me fushat e tjera akademike. Për shembull, praktika e vlerësimit të fushës së kërkimit në Mbretërinë e Bashkuar (një kontroll zyrtar i jashtëm dhe vlerësimi i rezultatit të fushës të individëve dhe departamenteve) akoma vlerëson më shumë artikuj akademikë se përkthime, madje edhe përkthime të librave të tërë, pavarësisht faktit që praktika e përkthimit duhet të jetë një përvojë thelbësore për teoricien dhe trajnues.

George Steiner në klasifikimin e tij të hollësishëm idiosinkratik të historisë së hershme të teorisë së përkthimit rendit një numër të vogël prej katërmbëdhjetë shkrimtarësh që përfaqësojnë “shumën e përgjithshme të atyre që kanë thënë ndonjë gjë themelore ose të re në lidhje me përkthimin”⁸⁹. Kjo listë përfshin Shën Jeronimin (St Jerome), Luther, Dryden dhe Schleiermacher dhe gjithashtu na merr në shekullin e njëzetë me Ezra Pound dhe Walter Benjamin, ndër të tjerë. Shtajner (Steiner) në të vërtetë përshkruan si 'shumë të vogël' gamën e ideve teorike të mbuluara në këtë periudhë:

“Ne kemi parë se sa prej teorive të përkthimit, nëse ka një të tillë si të dallueshme nga recetat e idealizuara, sillet monotonisht rreth alternativave të papërcaktuara: 'shkronja' apo 'simbolika', 'fjala' apo 'mesazhi'. Dikotomia supozohet të ketë kuptim të analizuar. Kjo është dobësia dhe mprehtësia qendrore epistemologjike e dorës së përkthyesit.”⁹⁰

Teoricienët e tjerë modernë pranojnë se problemi kryesor me shkrimet e përkthimit në këtë periudhë ishte se kriteret për gjykime ishin të paqarta dhe subjektive dhe vetë gjykimet ishin jashtëzakonisht normative.⁹¹

Ndërsa pas viteve 90, në Shqipëri u vu re një rritje e madhe e numrit të përkthimeve nga letërsia e huaj. Kjo gjë erdhi si rezultat i ndryshimeve të mëdha që ndodhën në vend pas rënies së komunizmit, ndryshime këto që prekën edhe fushën e përkthimit. Deri në atë moment, letërsia e huaj ishte e censuruar dhe e mirëmonitoruar pasi përkthimet nuk duhet të zgjonin tek populli ndjenja që binin në kundërshtim me atë që propagandohej nga regjimi në fjalë. Për këtë arsye, shqiptarët ishin të etur për letërsi “ndryshe” më të hapur dhe të zhvilluar.

Në ditët e sotme, përkthimi ka marrë një rrugë tjetër duke qenë se gjithçka po shkon drejt automatizimit. Shpikja e internetit bashkë me zhvillimet e reja teknologjike në të gjitha fushat e jetës ka rritur bashkëndarjen mes kombeve. Kjo gjë ka bërë që përkthyesit të gjejnë forma të ndryshme sesi të përshtaten më këto ndryshime të mëdha dhe të gjejnë e

⁸⁹ Steiner, George, *After Babel: Aspects of Language and Translation*, Oxford, England: Oxford University Press, 1975, fq. 283

⁹⁰ Po aty, fq. 290

⁹¹ Munday, Jeremy, *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 29

përdorin teknika që nuk mund t’i zëvendësojë as teknologjia më e zhvilluar.

Me lindjen e përkthimit audiovisual, ata e ndejnë gjithashtu nevojën për të hyrë edhe në botën e përkthimit kinematografik. Një ndër teknikat më të fundit e quajtur “screen translation” ka të bëjë me përkthimet që lidhen me programet televizive, duke përfshirë filmat, serialet apo dokumentarët. Ajo bazohet tek programet kompjuterike të përkthimit dhe ndahet në dy metoda kryesore: dublimi dhe titrimi. Në fakt këto zhvillime të fundit kanë sjellë një epokë të re në fushën e përkthimit.

I. 3. 1 Llojet dhe metodat kryesore të përkthimit pas viteve’90

Sigurisht që vitet 90 sollën mënyra të reja të përkthimit dhe studimit të teksteve. Snell-Hornby, në librin e saj *Translation Studies: An Integrated Approach* illustroi sesi globalizimi dhe zhvillimet teknologjike kanë ndikuar së tepërmi në përkthimin dhe komunikimin ndërkombëtar dhe ajo diskuton gjithashtu dhe pasojat tek puna e përkthyesve. Ajo argumenton se globalizimi është shoqëruar me ndryshimin e perceptimit të njerëzve mbi gjuhën dhe përkthimin.⁹²

Fakti që informacioni është i pafund dhe ai duhet të përpunohet me një shpejtësi tepër të madhe sjell pasoja për gjuhën. Ka një trend tjetër që lidhet me numrin: numri i madh dhe gjithnjë në rritje i përdoruesve të internetit sjell dhe rritjen e numrit të gjuhëve që njerëzit mesojnë. Megjithatë, gjuha angleze mbetet gjuha më e përdorur në të gjithë botën.⁹³

Uiserma (Wiersema) në esenë e tij, “Globalizimi dhe Përkthimi” thekson faktin se globalizimi ka bërë që gjuha angleze të jetë “lingua franca”, pra gjuha që përdoret në konferenca ndërkombëtare, gjuha e përdorur në mjetet teknologjike dhe manualët e tyre.⁹⁴

Përdorimi i anglishtes si një gjuhë ndërkombëtare është një trend i rëndësishëm në botën e komunikimit. Globalizimi lidhet gjithashtu me fushën e studimeve përkthimore. Ai dhe teknologjia janë shumë të dobishëm për përkthyesit duke qenë se këta të fundit kanë më tepër mundësi për të marrë informacione, të studiojnë kulturat e ndryshme apo dhe të gjejnë fjalorë të gjuhëve që nuk janë shumë të njohura. Në rastet kur elementët kulturorë në një tekst janë pak ose aspak të njohura, interneti mund ta ndihmojë përkthyesin të kuptojë këto elementë dhe në këtë mënyrë përkthimi mund të vijë më natyral dhe i kuptueshëm për lexuesin. Si rrjedhim, interneti ka sjellë dhe një reduktim të kufinjve mes kulturave të ndryshme duke e bërë më të lehtë përkthimin. Uiserma (Wiersema) thekson se globalizimi po ecën me hapa shumë të shpejtë dhe nuk e “ka ndër mend” të

⁹² Snell-Hornby, Mary, *Translation Studies: An Integrated Approach*, Philadelphia: John Benjamin's Publishing Company, 1988, fq. 214

⁹³ Bielsa, E, *Globalization as Translation: An Approximation to the Key but Invisible Role of Translation in Globalization*. CSGR Working Paper, 2005, fq. 163

⁹⁴ Wiersema, N, *Globalisation and translation*, *Translation Journal*, 2004, fq. 53

ngadalësojë.⁹⁵

Këto ndryshime dhe zhvillime kanë bërë që cilësia e përkthimeve të rritet duke qenë se tashmë fokusi nuk është në përkthimi e fjalëve të veçanta por të tekstit në tërësi. “Përkthyesi përqëndrohet tek konteksti duke u munduar të bëjë sa më shumë kërkime lidhur me kontekstin kulturor e historik në të cilin është zhvilluar vepra” shkruan profesor Tupja ne librin e tij *Këshilla një përkthyesi të ri*.⁹⁶

Lidhur me llojet dhe metodat e përkthimit mund të themi se ato vazhdojnë të jenë prezente po njësoj pavarësisht ndryshimeve të lartpërmendura. Përdorimi i tyre përcaktohet thjesht nga lloji i tekstit, pra kur duhet një përkthim i lirë si në rastin e disa poezive apo kur duhet një përkthim besnik si në rastin e teksteve teknike e shkencore ku përkthyesi nuk duhet të bëjë ndryshime, të heqë apo të shtojë element nga vetja. Kemi dhe rastin e përkthimit komunikues që përdoret në ligjërata dhe fjalime. Ai ka mbetur në thelb i njëjtë dhe ndryshimet e vetme mund të vijnë nga fjalët e reja por qartësia dhe karakteristikat e tjera mbeten po ashtu në thelb. Ndërsa, përkthimi fjalë për fjalë është një përkthim që përdoret në përkthimet e automatizuara, ai që quhet “machine translation”. Ky i fundit bën një përkthim të fjalëve të veçanta dhe nuk mund të përcjellë kuptimin e saktë kontekstual.⁹⁷

I. 4 Ndryshimet në metodikën e procesit të përkthimit në periudhën para dhe pas viteve ‘90

Duke u nisur tek përkufizimet e shumata që i janë bërë përkthimit në periudha të ndryshme kohore mund të vërejmë dhe ndryshimin që ka pësuar ky process gjatë viteve. Ketford (Catford) jep këtë përkufizim: “përkthimi është zëvendësimi i materialit tekstual në një gjuhë (gjuha origjinale) nga materiali ekuivalent tekstual në një gjuhë tjetër (gjuha e përkthimit). Fakti se shqetësimi i tij ishte mbajtja e një lloj ‘ekuivalence’ midis gjuhës së origjinalit dhe gjuhës së përkthimit është e dukshme.”⁹⁸

Nga ana tjetër, Bell jep një përkufizim pak më informal: “shndërrimi i një teksti fillimisht në një gjuhë në një tekst ekuivalent me një gjuhë tjetër, duke ruajtur, aq sa është e mundur, përmbajtjen e mesazhit dhe tiparet zyrtare dhe rolet funksionale të tekstit origjinal.”⁹⁹

Një përkufizim tjetër vjen nga Koller “Rezultati i një aktiviteti të përpunimit të tekstit, me anë të të cilit një tekst i gjuhës së origjinalit zhvendoset në një tekst në gjuhën e përkthimit. Midis tekstit që rezulton në gjuhën e përkthyer dhe tekstit në gjuhën origjinale

⁹⁵ Po aty

⁹⁶ Tupja, Edmond. *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri 2000, fq. 31

⁹⁷ Bielsa, E, *Globalization as Translation: An Approximation to the Key but Invisible Role of Translation in Globalization*. CSGR Working Paper, 2005, fq. 54

⁹⁸ Catford J.C., *A Linguistic Theory of Translation*, London: Oxford University Press, 1965, fq 20

⁹⁹ Bell, R.T., *Translation and Translating: Theory and Practice*, 1991, London: Longman, fq. 403

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

ekziston një marrëdhënie, e cila mund të përcaktohet si një lidhje përkthimi, ose ekuivalentimi”.¹⁰⁰

Në Shqipëri përkthimi ka pësuar shumë ndryshime në këto dy periudha, para dhe pas viteve 90. Në periudhën e komunizmit ka ndarje të përkthimit në disa degë. Në atë kohë kur diktatura shqiptare kishte vendosur që të mbyllte brenda kufinjve popullin e vet ishte pikërisht leximi dhe përkthimi që mundësonte njohjet me kulturat e tjera. Prandaj në këtë periudhë përkthimi mori një lloj zhvillimi. Përkthyesit e asaj kohe vunë në themelet e letërsisë së përkthyer përpjekje shumë serioze në përkthime të letërsive të mëdha. Në periudhën kur shteti shqiptar kishte marrëdhënie me shtetin sovjetik pati një shpërthim të autorëve sovjetikë të të gjitha zhanreve të letërsisë.

Në përgjithësi, në të gjithë botën përkthimi ka ndryshuar shumë si rezultat i zhvillimeve. Sot ai është bërë më i specializuar, i ndarë në fusha të ndryshme. Pavarësisht ndryshimeve, rolet bazë të përkthyesit mbesin ato që kanë qenë përherë, pra plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe pritshmërive të lexuesve. Metodat mbeten pothuajse të njëjta pavarësisht përsojes që u është bërë me kalimin e kohës.¹⁰¹

Në këtë pjesë të parë të kapitulli kemi diskutuar lidhur me përkthimin dhe ecurinë e ij ndër vite, sa ka ndryshuar dhe faktorët që kanë sjellë këtë ndryshim. Kemi përmendur gjithashtu llojet kryesore dhe metodat e përkthimit të cilat do t'i zgjerojmë në kapitujt në vijim.

¹⁰⁰ Koller, W. , *The concept of equivalence and the object of translation studies*, Target, 1995, fq. 196

¹⁰¹ Newmark, Loenard, Hubbard, Philip, Prifti, Peter, *Standard Albanian*, Stanford, California, Stanford University Press, 1982, fq. 23

Kreu II


Plaku dhe Deti i Ernest Heminguei nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona

Në këtë kre do të diskutojmë lidhur me veprën “Plaku dhe deti” të Ernest Heminguei të përkthyer nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona. Në pjesën e parë do të flasim pak mbi jetën dhe veprat e Hemingway në mënyrë që të njihemi pak me karakteristikat e autorit, pra kushtet në të cilat ka jetuar të cilat mund të kenë patur ndikim në veprat e tij. Më pas do të diskutojmë për “Plaku dhe deti” të sjellë në shqip nga Ismail Kadare dhe do të bëjmë gjithashtu një përmbledhje të shkurtër të veprës. Si çdo vepër tjetër, edhe “Plaku dhe deti” ka personazhe kryesorë rreth të cilëve sillet e gjithë vepra. Ne do të merremi me analizën e këtyre personazheve si dhe do të diskutojmë lidhur me tematikat dhe simbolet e trajtura në këtë vepër. Rrjedhimisht, në pjesën e parë do të marrim më tepër në konsideratë aspektin letrar.

Në pjesën e dytë të kapitullit do të flasim shkurtimisht mbi jetën dhe veprat e Ismail Kadesë, veprimtarinë e tij si përkthyes si dhe për veprën sipas versionit të Ismail Kadesë. Më pas ndjek një përshkrim i shkurtër për Vedat Kokonën, veprimtarinë e tij si përkthyes si dhe veprën “Plaku dhe deti” sipas Vedat Kokonës.

II.1 Pak mbi jetën dhe veprat e Ernest Heminguei

Ernest Heminguei lindi në korrik të vitit 1899 dhe vdiq në korrik të vitit 1961 në Oak Park, Illinois. Ai ishte një nga shkrimtarët më të rëndësishëm dhe më me ndikim të shekullit XX-të dhe shumë nga detajet e jetës së tij janë bërë po aq të njohura sa dhe veprat. Ai përshkruhet si një person stoik dhe në të njëjtën kohë dhe aventurier si dhe mendohej se ai i shkruante veprat duke u bazuar në përvojat e tij personale.



Ai ishte një figurë shumë e njohur madje dhe lider i të ashtuquajturit “Brezi i Humbur.” Imagjinata e tij, sidomos në veprat e tij të para dominohej nga dy tipe personazhesh: i pari ishte personazhi të cilin përvoja në Luftën e Parë Botërore e kishte ndryshuar dhe tipi i dytë ishte, ndoshta dhe një lloj përgjigjeje për tipin e parë, i thjeshtë, i vendosur i cili gjentë kënaqësi në aktivitetet e ndryshme fizike.¹⁰²

Për sa i përket jetës së tij, ajo ishte e qetë. Ai ishte djali i një mjeku fizikant. Heminguei e kaloi fëmijërinë dhe rininë pas peshkimit dhe gjuetisë. Pas

¹⁰²Baker, Carlos, Ernest Hemingway: A life story, New York, Charles Scribner’s Sons, 1969, fq. 12

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

mbarimit të shkollës së mesme, ai punoi si reporter për Kansas City Star. Vetëm dy muaj më pas ai e lë punën me dëshirën për t’iu bashkuar ushtrisë së Shteteve të Bashkuara por ai nuk e kaloi ekzaminimin mjekësor që duhej bërë për të qenë pjesë e forcave të armatosura. Më pas ai u nis drejt Italisë dhe pak kohë më vonë ai u përball me brutalitetet e luftës. Ai u kthye në shtëpi në vitin 1920 dhe u punësua në një redaksi, në gazetën “Toronto Star” si korrespondent, shkrimtar dhe profesionist i lirë. Në vitin 1921 u martua me Hadley Richardson dhe u zhvendos në Paris për të bërë rolin e korrespondentit të Toronto Star për Luftën Greko-Turke.¹⁰³

Në vitin 1923 ai botoi librin e parë, vit në të cilin lindi dhe djali i tij i parë, John. I dhënë pas jetës familjare, ai dha dorëheqjen në vitin 1924. Më pas ai vendosi të jetonte në Paris. Botimi i librit “Dhe lind dielli” (The Sun Also Rises) u prit me dashamirësi dhe pati sukses. Stili i tij pati ndikim në letërsinë e asaj kohe, periudhë në të cilën dominonte shkrimi Viktorian.

“Dhe lind dielli” është romani i parë i Ernest Hemingueit, njërit prej mjeshtërve më të mëdhenj të prozës bashkëkohore.¹⁰⁴ Vendosur në sfondin romantik të Spanjës së korridave, subjekti tërheqës i romanit shpalos karakteret tipike të prozës së Hemingueit, karaktere të mundura, por jo të mposhtura, burrërore në dhimbjen e tyre. Një protagonist i traumatizuar fizikisht dhe shpirtërisht në Luftën Botërore, një shpirt i pashpresë e i trishtuar dashurie, një atmosferë dhimbjeje dinjitoze. Të gjitha këto elemente të indit artistik të kësaj kryevepre të letërsisë së shekullit të kaluar, mishërojnë tiparet më thelbësore të asaj që u quajt “letërsi e brezit të humbur”.

Ndërsa në vitin 1927 u botua “Burrat pa gratë” (Men without Women) i cili përmbante disa histori të shkurtra, ndër të cilat ishte dhe historia e mirënjohur “Vrasësit” (The Killers). Në veprën e tij të dytë “Lamtumirë armë” (Farewell to arms),¹⁰⁵ e botuar në vitin 1929 siç përmend dhe Kobler në librin e tij *Ernest Hemingway, Journalist and Artist*: “ai u bazua së tepërmi tek përvojat e tij gjatë Luftës së Parë Botërore.” Ky roman përshruan historinë e dashurisë mes një ushtari amerikan dhe një infermiereje britanike dhe përfundon me vdekjen e saj.¹⁰⁶

Në vitin 1932 u botua vepra tjetër e tij “Vedkja pasdite” (Death in the Afternoon) e cila kishte si tematikë “bullfight” (lufta me demin), një sport spanjoll. Në vjeshtën e po këtij viti, ai shkoi për gjueti në Nairobi dhe Machakos dhe rezultati i këtij udhëtimi ishte “Jeta e shkurtër e lumtur e Francis Macomber” (The Short Happy Life of Francis Macomber). Në vitin 1935 u botua “Kodrat e gjelbërta të Afrikës” (Green Hills of Africa) bazuar në eksperiencën e tij të gjuetisë, safari në Afrikë.¹⁰⁷

¹⁰³ Hotchner, A. E, *Papa Hemingway: A Personal Memoir*, New York, Random House, 1966, fq. 31

¹⁰⁴ Meyers, Jeffrey, *Hemingway: A Biography*, New York, Harper and Row, 1985, fq. 71

¹⁰⁵ Reynolds, Michael S, *Hemingway's First War: The Making of a Farewell to Arms*, Princeton: Princeton University Press, 1981, fq.47

¹⁰⁶ Kobler, J. F, *Ernest Hemingway, Journalist and Artist*, Ann Arbor, Mich: UMI Research Press, 1985, fq.

23

¹⁰⁷ Lynn, Kenneth, *Hemingway*, New York, Simon and Schuster, 1987, fq. 37

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Në vitin 1940 u botua “For Whom the Bell Tolls” (Për kë bie këmbana), një roman i cili lidhej me Luftën Civile të Spanjës, tematika kryesore e të cilit ishte liria dhe sipas këtij romani, humbja e lirisë në mbarë botën përkthehej në humbjen e të gjitha lirive. Janë shkruar shumë e shumë vepra letrare për Luftën e Spanjës: romane, poema, drama, tregime, por një vepër e cila e paraqet më së miri këtë luftë është "Për kë bie kambana" e Ernest Hemingueit. Baker në librin e tij *Ernest Hemingway: A Life Story* shkruan:

“Autori ka ditur që përmes këtij romani t’i japë lexuesit thelbin e Luftës së Spanjës. Duke qenë njohës i thellë i folklorit spanjoll e hispanist, i dashuruar pas fiestave, toreadorëve, kurbatkave, pas gjuetisë në tokë e në det, i kacafytur disa herë me vdekjen, Ernest Heminguei krijoi një roman, ku jepet ajo periudhë në të cilën jetoi me të gjitha detajet e saj. Ide thellësisht humane e përparimtare, realizëm i ashpër, karaktere të forta, stil krej origjinal, të gjitha bashkë, të shkruara në një, ato të bëjnë për vete e të vënë në mendime... ato të trondisin.”¹⁰⁸

Në 8 dhjetor të vitit 1941 Shtetet e Bashkuara të Amerikës hynë në Luftën e Dytë Botërore dhe kjo datë shënoi dhe pjesëmarrjen e parë aktive të Heminguei në një luftë. Pas luftës, filloi por më pas hoqi dorë nga shkrimi i një romani mbi tokën, detin dhe ajrin. Më pas ai shkoi në Itali ku dhe mblodhi material për veprën “Përtej lumit dhe në pemë: Një homazh për Venecian” (Across the River and Into the Trees: A Homage to Venice). Ky roman nuk u vlerësua shumë nga kritikët, shumë nga të cilët e akuzonin Heminguein për shije jo të mirë, mungesë stili dhe sentimentalizmi shkruan Fenton në librin e tij *The Apprenticeship of Ernest Hemingway: The Early Years*.¹⁰⁹

Një tjetër vepër është dhe “Kopshti i Edenit” (The Garden of Eden) i cili ishte dhe projekti i parë më i madh i Hemingueit pas një periudhe pauze në fillim të viteve 40. Mendohej se jeta e tij personale kishte ndikim tek kjo vepër pasi ai në këtë periudhë kishte një bashkëshorte të re dhe ishte përballur me sfida shëndetësore.¹¹⁰

“Në kohën tonë” (In Our Time) është një tjetër e vepër e Hemingueit e shkruar në vitin 1925 dhe kritikata mbi këtë libër i dhanë atij një shtysë. Ndërsa në vitin 1964 u botua nga gruaja e tij, pas vdekjes së Hemingueit “Një festë e lëvizshme” (A Moveable Feast). Ky libër është një lloj përkujtimoreje për jetën e tij në Paris dhe vende të tjera si dhe marrëdhëniet me njerëz të ndryshëm.¹¹¹

¹⁰⁸ Baker, Carlos, *Ernest Hemingway: A Life Story*, New York, Charles Scribner’s Sons, 1969, fq. 231

¹⁰⁹ Fenton, Charles A, *The Apprenticeship of Ernest Hemingway: The Early Years*, New York, Farrar, Straus and Young, 1954, fq. 68-71

¹¹⁰ Meyers, Jeffrey, *Hemingway: A Biography*, New York, Haper and Row, 1985, fq. 95

¹¹¹ Ross, Lilian, *Portrait of Hemingway. Reporting*, New York, Simon and Schuster, 1964, fq. 159

II.1.1 Plaku dhe Deti nga Heminguei

Plaku dhe Deti u botua në vitin 1952. Suksesi i madh i kësaj vepre e motivoi së tepërmi shkrimtarin. Romani fitoi Cmimin Pulitzer në vitin 1953 dhe Cmimin Nobel në letërsi në vitin 1954.

Plaku dhe deti është një tregim për forcën dhe dinjitetin e shpirtit të njeriut. Me simbolikën e tij ai trajton pyetjen e madhe se deri ku duhet të shkojë njeriu, deri ku duhet të guxojë. Për Heminguein ,shkruan Fenton ne librin e tij mbi fillesat e krijimtarise se Heminguei *The Apprenticeship of Ernest Hemingway: The Early Years*, njeriu nuk ka përse të tërhiqet pa e provuar edhe nëqoftëse do të dështojë pasi ndryshe nuk mund të arrihet sukseesi.¹¹²

“Plaku dhe deti” është një nga romanët më të shitura, të cilin shpeshherë e quajnë novelë, shpeshherë roman. Kjo vepër njihet si një nga veprat më të thjeshta, por më të fuqishme e më të çmuara të Hemingueit. Themi të thjeshta, sepse kemi pothuajse vetëm një personazh, një subjekt tepër të zakonshëm, por nëpërmjet të cilave autori arrin të japë një filozofi të tërë jetësore.

Një njeri i vetëm, në muzgun e jetës së tij, me forcat e shpenzuara, përballë një fuqie të pamatshme dhe me plot të papritura, siç është deti, ku ai e ka kaluar jetën si peshkatar. Plakun Santiago, peshktarin e vetmuar,jo vetëm profesioni që ushtron, jo vetëm nevoja për të jetuar, por ndoshta vetë fati e vë ballë për ballë me një peshkaqen, në një luftë për jetë a vdekje në mes të oqeanit, pa pasur kush t’i ofrojë ndihmë.

Pangopësia e peshkaqenit dhe përpjekja mbinjerëzore e plakut për ta mbrojtur preinë e tij të kapur me grep. Lufta zhvillohet pa praninë e askujt. Plaku lufton e mediton njëkohësisht, fjalët e tij s’kanë kujt t’i drejtohen përveç peshkaqenit, me të cilin jeta e detyron të luftojë. Herë-herë edhe i vjen keq edhe për peshkun e kapur, edhe për peshkaqenin, por jeta është e tillë: luftë për ekzistencë. Në fund plaku kthehet në breg vetëm me skeletin e një peshku të madh, sepse mishin ia kanë ngrënë peshkaqenët. Ky është triumf dhe humbje njëkohësisht, është fati i tij jetësor, fati i njeriut në përgjithësi.

Vepra të bën për vete me shkathtësitë e të rrefyerit, me koncizitetin e shprehjes, me dialogun dhe me monologun dinamik. Në këtë vepër ka gjetur zbatim në menyrën më të spikatur parimi i ashtuquajtur i ajsbergut, domethënë të thuhet vetëm gjerat më të domosdoshme, kurse shumë të tjera të lihen për t’u nënkuptuar në mbarë letërsisë amerikane. Në kritikët letrarë ekziston mëdyshja nëse libri është roman apo novelë si dhe fati që në fillim, nga vetë titulli, kemi të bëjmë me dy kundërvënie të ndryshme: plakun në perëndim të jetës së tij dhe detin e paskaj, kjo fuqi e pambarueshme.¹¹³

“Plaku dhe deti” është një nga novelat më mbresëlënëse të nobelistit amerikan Ernest Heminguei. Kjo vepër erdhi për të mbetur në historinë e letërsisë si një narrativ që kumton për forcën dhe dinjitetin e shpirtit njerëzor. Me simbolikën e tij autori trajton

¹¹² Fenton, Charles A, *The Apprenticeship of Ernest Hemingway: The Early Years*, New York, Farrar, Straus and Young, 1954, fq. 46

¹¹³ www.shtëpiaelibr.it/store/sp/nobelistët740-plaku-dhe-deti-ernest-hemingway.html

pyetjen e madhe, se deri ku duhet të guxojë njeriu për të matur forcat për t’u përballur me fatin dhe natyrën. Për Heminguein siç e përmendëm edhe me lart, njeriu edhe kur e di se do ta kapërcejë të zakonshmen, se po shkel përtej saj në trevën e dyluftimit të pabarabartë, madje të vetë vdekjes, nuk ka përse të tërhiqet pa e provuar. Më mirë të kthehesh i mundur pasi e ke provuar ndeshjen, pasi e ke treguar se e ke guximin ta bësh, sesa të dështosh pa provuar. Plaku i detit na tregon se e arriti atë që nuk e kishte bërë tjetër kush dhe nuk ka rëndësi se nuk e solli edhe mishin e peshkut për ta ngrënë.¹¹⁴

II.1.1.1 Një përmbledhje e shkurtër e veprës

Plaku dhe deti (titulli origjinal: *The Old Man and the Sea*) është një novelë e shkruar nga shkrimtari amerikan Ernest Hemingway në vitin 1951 në Kubë, dhe botuar në vitin 1952. Ishte vepra e fundit madhore e prodhuar nga Heminguei dhe botuar gjatë kohës kur ai ishte gjallë.

Vepra rrotullohet rreth Santiagos, një peshkatar i moshuar që përpiket të kapi një peshk marlin në largësi të Rrymës së Golfit. Plaku dhe Deti ka fituar çmimin Pulitzer (Pulitzer Prize for Fiction) në vitin 1953 dhe është cituar nga komiteti i Nobelit si një nga veprat që kontribuan në dhënien e Nobelit në Letërsi për Heminguei në vitin 1954.

Kemi të bëjmë me dy kundërvënie të ndryshme: Plakun në vitet e fundit të jetës se tij dhe detin e paskajë, atë fuqi të pafundme. Personazhi kryesor Santiago është përzierje e vetë ekzistencës njerëzore kundrejt dallgëve të shumëzuar të jetës me përplot zhgënjim e pabesi. Santiago lufton me tërë fuqinë e tij të mplakur dhe për çudi të fatit ai del fitimtar.¹¹⁵

Kjo vepër është paraqitja për rrugën e qartë të racës njerëzore: trazimi i përpjekjes për përvijimin e jetës në kushte sado të rënda. Është një luftë e pabarabartë ndërmjet njeriut dhe natyrës por që gjithsesi i lejon njeriut të masë forcat e veta. Njeriu plaket ndërsa natyra mbetet po e njëjtë, deti mbetet po i pamasë dhe i pabesë.

Ka edhe disa personazhe të tjerë por ato vetëm sa skicohen në vepër sa për sfond. Dy miq-armiq të vjetër luftojnë përballë njëri tjetrit, luftë që jep edhe mesazhin e lartë filozofik se njeriu nuk është krijuar për të pësuar humbje, të asgjësosh njeriun nuk do të thotë që e ke mposhtur atë. Duke krijuar personazhe të tillë si plaku Santiago, Heminguej lartëson figurën e njeriut që tregohet dinjitoz përballë dështimeve dhe sfidave në jetë.¹¹⁶

Heminguei shkruan pak por nënkupton shumë. Personazhet parapëlqejnë më shumë heshtjen, mbylljen në vetvete çka e bën edhe me interesante e tronditëse leximin e veprës. Në pamje të parë ata duken të ftohtë, indiferente por në fakt cilësitë e tyre qëndrojnë në nëntekstet e frazës.

¹¹⁴ www.botimeshqip.com/roman/7748-plaku-dhe-deti.html

¹¹⁵ Brenner, Gerry, *The Old Man and the Sea: Story of a Common Man*, Boston, Twayne, 1991, fq. 16

¹¹⁶ Po aty, 23-24

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Vihet re edhe dialogimi me vetveten që përbën një veçori tjetër të personazheve të këtij romani. Edhe nqs. personazhet ndiejnë frikë, gëzim apo cdo ndjenjë ato nuk jepen por nënkuptohen nga situatat e krijuara. Kjo mban gjallë emocionin gjatë leximit të novelës.

Plaku dhe Deti është historia e një beteje epike mes një peshkatari të vjetër, me përvojë dhe një Marline të madhe. Romani hapet me arsyetim se peshkatari, i cili është quajtur Santiago, ka kaluar 84 ditë pa kapjen e një peshku. Ai është aq i pafat sa që nxënësi i tij i ri, Manolin, ka qenë i ndaluar nga prindërit e tij të lundrojë me plakun e vjetër dhe është urdhëruar të shkojë me peshkatarët më të suksesshëm. Sidoqoftë, djali vazhdon të kujdeset për plakun pas kthimit të tij çdo natë. Ai e ndihmon plakun që të vendos pajisjet në kasollen e tij, siguron ushqim për të dhe diskuton mbi zhvillimet e fundit në bejbsollin amerikan, veçanërisht gjykimet e heroit të plakut, Joe DiMaggio.¹¹⁷

Santiago i tregon Manolinit se në ditën e ardhshme, ai do të udhëtojë larg Gulf Strimit (Gulf Stream) për peshkim, për t’u bindur se sezoni i tij i pafat është pranë fundit. Kështu në ditën e 85, Santiago i jep kurajo vetes, duke marrë varkën e lehtë të tij deri në Gulf Stream.

Në ditën e tetëdhjetë e pestë të tij të pafat, Santiago bën siç premtoj, duke lundruar varken e tij përtej ujërave të cekëta të ishullit dhe duke u futur në rrjedhën e Gulf Strimit (Gulf Stream). Ai përgatit grepat e tij dhe i hedh ato. Në mesditë, një peshk i madh, që ai e di se është marlin, kap karremin që Santiago ka hedhur thellë në ujëra. Plaku e lidh me mjeshtëri peshkun, por ai nuk mund ta tërheqë. Në vend të kësaj, peshku fillon të tërheq varkën.

Në pamundësi të lidhjes së grepit për varkë nga frika se peshku i fuqishëm do ta këpuste, plaku mbart te gjithë peshën me shpatullat, shpinën dhe duart. Peshku vazhdon ta tërheq varkën gjatë gjithë ditës e natës. Ai noton në mënyrë të qëndrueshme në veriperëndim derisa më në fund lodhet dhe noton drejt lindjes i shtyre nga rryma e ujit. Gjatë gjithë kohës, Santiago duron dhimbje të vazhdueshme nga filli i peshkimit. Kurdoherë që peshku kërcen, filli pret duart e Santiagos. Edhe pse i plagosur dhe i lodhur, plaku ndjen një dhimbje dhe në të njëjtën kohë admirim të thellë për marlinin, vëllain e tij në vuajtje, forcë dhe vendosmëri.

Në ditën e tretë, peshku lodhet. Po ashtu edhe Santiago, i privuar nga gjumi, në dhimbje arrin të tërheqë marlinin mjaft afër për ta vlarë atë me një goditje me fuzhnjën e tij. I lidhur për varkë, marlini është peshku më i madhë që Santiago ka parë ndonjëherë. Ai e godet me barkën e tij, ngre anijen e vogël dhe vë vela për në shtëpi. Ndërsa Santiago është i entuziazmuar nga çmimi që marlini do të sjellë në treg, ai është më i shqetësuar se njerëzit që do të hanë peshk nuk janë të denjë për madhështinë e tij.

Ndërsa Santiago lundron me peshqit, gjaku i marlinit lë gjurmë në ujë dhe tërheq peshkaqenë. I pari që sulmon është një peshkaqen të cilin Santiago arrin ta mbysë me fuzhnjën e tij. Në luftim e sipër, plaku humbet fuzhnjën dhe gjatësinë e litarit të vlefshëm, gjë që e lë të prekshëm nga sulmet e tjera të peshkaqenëve. Plaku lufton grabitqarët e

¹¹⁷ Donaldson, Scott, *By Force of Will: The Life and Art of Ernest Hemingway*, New York, Viking, 1977, fq. 43-46

njëpasnjëshëm me gjithë forcen e shpirtit që ka, duke i goditur me thikë me një shtizë të pamprehur, të cilën e sajoi me thikën e tij dhe leukoplast dhe me fund të rremë për të ndihmuar shmangien e një linje tjetër peshkaqenësh. Në total, janë vrarë pesë peshkaqenë dhe shumë të tjerë janë shtyrë larg. Megjithatë ai vret disa peshkaqenë, gjithnjë e më shumë shfaqen, dhe me kohën që bie nata, lufta e vazhdueshme e Santiago kundër tyre është e padobishme. Ata gllabërojnë mishin e çmuar të marlinit, duke lënë vetëm skelet, kokë dhe bisht. Santiago dënon veten për daljen shumë larg dhe për sakrificimin e kundërshtarit të tij të madh dhe të denjë. Në fund duke arritur në breg para agimit në ditën e ardhshme, Santiago lufton gjatë rrugës për në kasollen e tij, duke mbajtur një shtyllë të rëndë mbi shpatullat e tij. Pastaj, në shtëpi, ai shtrihet mbi shtratin e tij dhe bie në një gjumë të thellë.

Të nesërmen në mëngjes, një turmë peshkatarësh të mahnitur mblidhen rreth mbetjeve skeletore të peshkut, i cili është akoma i lidhur për varkë. Duke mos ditur asgjë nga lufta e një plaku, turistët në një kafene aty pranë vëzhgojnë mbetjet e marlinit gjigand dhe e ngatërrojnë atë për një peshkaqen. Manolin, i cili është shqetësuar shumë për mungesën e plakut, mallëngjehet kur gjen Santiagon të sigurt në shtratin e tij. Djali i sjell plakut ca kafe dhe gazeta ditore me rezultatet e bejsbollit dhe e shikon duke fjetur. Kur plaku zgjohet, të dy bien dakord të peshkojnë si partnerë edhe një herë. Plaku kthehet në dark për të fjetur dhe ëndërron ëndrrën e tij të zakonshme të luanëve duke luajtur në plazhet e Afrikës.¹¹⁸

II.1.2 Analizë e personazheve kryesorë të veprës

Santiago është personazhi kryesor i romanit. Ai është një peshkatar i vjetër nga Kuba i cili, siç edhe përmendet në fillim të veprës, nuk kishte kapur asnjë peshk që prej tetëdhjetë e katër ditësh. E gjitha vepra silltet rreth përpjekjes së këtij personazhi për të fituar “dinjitetin e humbur” prej kaq shumë ditësh. Ai përballet me një sfidë të madhe duke dashur ta sjellë peshkun e madh drejt bregut por janë peshkaqenët ata të cilët bëhen pengesë në rrugën e tij. Por pavarësisht rezultatit, që ishte vetëm skeleti i peshkut, Santiago ndihet fitimtar dhe i qetë në shpirt. Personazhi i tij sjell një mesazh të madh për njerëzit që pavarësisht moshës, mundësive apo ndonjëherë dhe fatit nuk duhet të dorëzohen kurrë.¹¹⁹

Manolin është një djalë në fillim të adoleshencës i cili është “nxënës” i Santiagos. Plaku e merrte me vete në varkë që kur ishte vetëm pesë vjeç. Duke qenë se plakut nuk po i ecte më si dikur, prindërit e kishin detyruar Manolinin të lundronte me peshkatarë të tjerë. Megjithatë, Manolini përsëri kujdesej shumë për plakun të cilin ai akoma e shihte si mësuesin e tij. Dashuria e tij për Santiagon ishte aq e madhe sa që ai u kërkonte ndihmë fshatërëve të tjerë për të përmirësuar sadopak kushtet e mjerueshme në të cilat jetonte plaku. Manolini është shoku i vetëm i peshkatarit. Ai nuk e humbiste kurrë besimin tek

¹¹⁸ wordpress.com/2017/01/02/plaku-dhe-deti-ernest-ernest-heminguei

¹¹⁹ Hurley, C. Harold, *Hemingway's Debt to Baseball in The Old Man and the Sea: A Collection of Critical Readings*, Lewiston, New York: Mellen, 1992, fq. 19

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

plaku edhe pse ky i fundit nuk kishte shumë fat. Ai e shihte Santiagon si një model shumë të mirë dhe e adhuronte atë për forcën që përcillte.¹²⁰

Marlin është shumë i rëndësishëm edhe pse nuk është një personazh “njeri” siç ndodh zakonisht. Është pikërisht ai që sfidon Santiagon në të gjithë momentet e veprës. Plaku e kap atë që në ditën e parë të peshkimit, pas “dështimit” të tetëdhjetë e katër ditëve. Madhësia e këtij peshku është deri diku e papërbalueshme nga plaku dhe pikërisht këtu fillon dhe “dyluftimi” mes tyre. Në fakt ka moment kur ky dyluftim duket me tepër si aleancë pasi ka një lidhje magjike mes tyre. Kjo gjë vihet re në momentin kur Marlin sulmohet nga peshkaqenët dhe mbetet thjesht një skelet. Këtu Santiago ndihet tepër i trishtuar. Edhe pse Marlin nuk flet dhe lexuesi nuk mund të depërtojë tek mendimet e tij ai është një personazh tepër i rëndësishëm i veprës. Rosenfield shkruan se “Santiago e sheh Marilini si “shprësen” e tij, atë që do t’i kthejë dinjitetin dhe për këtë arsye lufton aq fort për ta kapur”.¹²¹

DiMaggio apo Dimaxhio i Madh ka një rol domethënës edhe pse nuk shfaqet në roman. Ai ka një rëndësi të madhe për Santiagon që e sheh si model të fuqisë dhe vendosshmërisë. Rosenfield gjithashtu thekson faktin se “plaku mendon për Dimaxhion sidomos në momentet kur dëshiron t’i tregojë vetvetës se është akoma i fortë dhe i guximshëm”.¹²²

Perico është një personazh që nuk shfaqet në roman në mënyrë direkte por ka rolin e ndihmësit në jetën e Santiagos duke i dhënë këtij të fundit gazeta në të cilat shihte rezultatet e ndeshjeve të beizbollit. Ky gjest tregon se ai ishte një person zemërmirë i cili ndihmonte plakun.¹²³

Martin, ashtu siç *Perico*, nuk shfaqet në roman. Ai është pronar i një kafeneje në fshatin e Santiagos. Lexuesi mëson për ekzistencën e tij përmes Manolinit i cili shkon tek ai për të marrë drekën apo darkën e Santiagos. Rrjedhimisht, edhe *Martin* shfaqet si një personazh që mundohet t’i vijë në ndihmë plakut.¹²⁴

Deti është një “personazh” kryesor i kësaj vepre pasi përfshihet në çdo moment dhe jo vetëm pasi ai përmendet dhe në titull. E gjithë ngjarja zhvillohet në det dhe Santiagoja identifikohet gjatë gjithë kohës me të. Ngjyra e tij e syve reflekton si qetësinë ashtu dhe fuqinë e detit. E gjithë jeta e plakut është deti edhe pse në momente të caktuara ai e sfidon, e sfilat por megjithatë mbetet i rëndësishëm.¹²⁵

¹²⁰ Rosenfield, Claire, “New World, Old Myths”, *Twentieth Century Interpretations of The Old Man and the Sea: A Collection of Critical Essays*, Ed. Katherine, T. Jobs, Englewood Cliffs, N. J: Prentice-Hall, 1964, fq. 34

¹²¹ Po aty, fq. 35-36

¹²² Smith, Paul, *A Reader’s Guide to the Short Stories of Ernest Hemingway*, Boston, G. K. Hall, 1989, fq. 23

¹²³ Po aty, fq. 24

¹²⁴ Po aty, fq. 26

¹²⁵ Po aty, fq. 27

II.1.3 Tematika dhe simbolet e trajtuara në vepër

Dhuna dhe vdekja janë tema pothuajse të përhershme në jetën dhe veprat e Hemingueit pasi ai u përball me to në dy luftërat botërore si dhe në Luftën Civile të Spanjës.

Në veprën *Plaku dhe Deti* janë prekur disa tematike dhe ndër to mund të përmendim *Sfidën* dhe *Dështimin*. Që në paragrafin e parë Santiago shfaqet si personi që lufton për të mos dështuar. Dështimi shfaqet në të gjithë ditët që ai nuk kishte kapur as edhe një peshk të vetëm. Megjithatë, ai e refuzon me çdo kusht dështimin: vendosë të peshkojë aq larg sa të tjerët nuk kishin shkuar kurrë pasi vetëm atje mund të gjente peshqit më të mëdhenj. Dyluftimi me peshkun e madh, edhe pse e dinte se beteja ishte pothuajse e humbur është tregues i dëshirës së tij për t’ia dalë mbanë.¹²⁶

Krenaria është një tjetër tematike e prekur në këtë vepër. Si Santiago ashtu dhe Marlini tregojnë cilësi të krenarisë, nderit dhe guximit. Ata ndjekin të dy një rregull: të vrasin ose të vriten. Kështu, krenaria nuk i lejon ata të “lëshojnë pe”. Edhe pse peshkaqenët shkatërruan gjithçka Santiago përsëri ndihet krenar: të paktën ai ka peshkuar atje ku asnjë tjetër nuk ka mundur. Ky personazh shërben si model për të treguar se krenaria e motivon njeriun për të ecur përpara drejt rrugës së suksesit. Pikërisht fakti që Santiago nuk hoqi dorë në asnjë moment nga Marlini tregon që krenaria ishte një karakteristikë e tij. Pa këtë krenari ai do të kishte hequr dorë që në momentet e para pasi ai e dinte që mbërritja në breg do të ishte shumë e vështirë.¹²⁷

Kur peshkaqeni i parë afrohet drejt Marlinit autori shprehet kështu për gjendjen e plakut: “ishte plot vendosshmëri por ai kishte pak shpresë.”¹²⁸ Ndërsa në momentin kur fillojnë dhe afrohen të tjerët autori e përshkruan kështu: “Ai goditi peshkaqenin pa shpresë por me vendosshmëri.”¹²⁹ Me këto dy fjali kuptojmë se plaku në çdo moment gjente diçka që e bënte të vazhdonte përpara. Ai i përballon të gjitha sfidat me të njëjtën vendosshmëri. Ai është gati të japë edhe jetën, të përballlet me peshkaqenët vetëm që të sjellë peshkun në breg.

Shprehja e famshme e shkëputur nga libri “një njeri mund të shkatërrohet, por jo të mposhtet”¹³⁰ është një lloj treguesi i krenarisë. Kështu, edhe nëqoftëse mundesh një herë kjo nuk do të thotë se duhet të heqësh dorë dhe të mos realizosh dëshirat dhe ëndrrat. Shpeshherë është pikërisht krenaria që nuk na lejon të dorëzohemi dhe kjo tematikë është ndër më kryesoret në veprën “Plaku dhe Deti”.

Vendosmëria është ajo që vërejmë në çdo rresht të kësaj vepre. Heminguei na përcjell mesazhin që në fakt fitorja e vërtetë nuk është rezultati përfundimtar por të gjitha përpjekjet dhe sfidat që duhen kaluar për të arritur aty thekson Brenner në librin e tij *The*

¹²⁶ Stephens, Robert O, *Hemingway’s Nonfiction: The Public Voice*, Chapel Hill: University of North Carolina Press, 1968, fq. 67

¹²⁷ Baker, Carlos, *Ernest Hemingway: A Life Story*, New York, Charles Scribner’s Sons, 1969, fq. 56-57

¹²⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 34

¹²⁹ Po aty, fq. 38

¹³⁰ Po aty, fq. 22

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

*Old Man and the Sea: Story of a Comman Man.*¹³¹ Edhe pse plaku kthehet në breg pa “trofeun” e tij, ai gjithsesi ndihet deri diku fitimtar.

Bashkimi është një tjetër tematikë e kësaj vepre. Atë e gjejmë në përpjekjet e Hemingueit për të lidhur Santiagon me ambjentin që e rrethon: me peshqit, zogjtë, breshkat, ai ha vezë breshke për të qenë i fortë, pi vaj peshku, etj. Pra, ekziston një lidhje e fortë mes tij dhe natyrës. Ka gjithashtu bashkim mes të kundërtave: deti është njëkohësisht i butë por dhe i ashpër me plakun, Marlini është njëkohëshit miku dhe armiku i tij. Suksesi dhe dështimi bashkohen kur Santiago zë peshkun por arrin ta sjellë atë në breg vetëm si një skelet.

Heroizmi është një tematikë prezente në veprën “Plaku dhe Deti”. Santiago mund të konsiderohet si heroi që luftoi deri në fund, pa u dorëzuar në asnjë moment. Ai fillon pikërisht me vendimin që plaku merr për të peshkuar në ujëra të panjohura deri në atë moment. Më pas përlëshja e ashpër dhe e vazhdueshme me peshkun derisa arrin ta kapi atë. Në fund përshkruhet përlëshja edhe më e fortë me peshkaqenët me qëllim ruajtjen e “trofeut”: Marlinit.

Burrëria është një tematikë pothuajse e përafërt me heroizmin që përmendëm më sipër. Sipas Hemingueit, duke u bazuar në vepër, të kesh burrëri do të thotë të jesh i ndershëm, i papërkulshëm para vështirësive, të vuash pa u ankuar për këtë si dhe të mos heqësh dorë në anjë moment. Këto cilësi i gjejmë të gjitha tek Santiago. Burrëria shprehet gjithashtu përmes Marlinit të cilin Heminguei e përshkruan si “fantastik”, “fisnik”, “i qetë,” e shumë mbiemra të tjerë.¹³²

Deti është një symbol i pranishëm në këtë vepër. Ai simbolizon atë që ishte gjithçka për Santiagon, të gjithë universin e tij. Është pikërisht deti vendi në të cilin Santiago përballet me një sfidë shumë të madhe të jetës së tij. Deti përfaqëson pak dhe femrën: kapriçoz, emotiv dhe këtë e gjejmë në frazën: " nëse ajo bënte gjëra të egra apo të liga ishte sepse nuk mund të ndalonte natyrën e saj".¹³³

Marlin-i simbolizon sfidën dhe vështirësitë e jetës. Ai është kundërshtari i plakut dhe në të njëjtën kohë nxjerr anën më të fortë të këtij të fundit.

Peshkaqenët simbolizojnë pengesat që has njeriu në jetë, ato pengesa që të bëjnë shpeshherë të ndalosh apo të kesh vështirësi të mëdha për t’ia arritur qëllimit.

Dimaxho i Madh është symbol i fuqisë dhe vendosmërisë. Santiago e konsideron atë të paprekshëm dhe të suksesshëm. Ai simbolizon vullnetin e madh të njeriut dhe për këtë arsye plaku mendon për të sidomos në momente shumë të vështira pasi përmes imazhit të tij ai merr forcë.

¹³¹ Brenner, Gerry, *The Old Man and the Sea: Story of a Comman Man*, Boston, Twayne, 1991, fq. 82-83

¹³² Po aty, fq. 84

¹³³ Po aty, fq. 85

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Luanët simbolizojnë rininë dhe burrërinë. Santiago sheh në ëndërr luanë dhe në fund të veprës ato simbolizojnë besimin tek jeta e përtejme.¹³⁴

Direku i anijes simbolizon kryqin pasi pikërisht në anije, aty ku është dhe direku Santiago kalon vuajtjet më të mëdha. Ai vuan në mes të detit për tre ditë me radhë me dhimbje të mëdha në pëllëmbët e duarve dhe në shpinë, ashtu si Jezu Krishti.¹³⁵

Manolini, shoku i Santiagos është symbol i shpresës dhe miqësisë. Edhe pse prindërit nuk e lejojnë më atë të peshkojë me plakun që tashmë nuk kishte më “suksesin” e dikurshëm, ai përsëri besonte tek mentori i tij. Ai nuk e braktis asnjëherë Santiagon, sidomos emocionalisht. Ai mundohet të kujdeset për të dhe beson se do vi dita kur plaku të zerë përsëri peshk si dikur.¹³⁶

Fuzhinja që Santiago humb gjatë përleshjes me peshkaqenët është simbol i atyre që e humbasin besimin në vetvete në momentet kur jeta tregohet e ashpër. Ashtu si plaku është i pambrojtur kur e humb fuzhinjën ashtu janë dhe njerëzit kur e humbasin besimin.¹³⁷

II.2 Jeta dhe veprat e Ismail Kadaresë



Ismail Kadare është një shkrimtar i famshëm i letrave shqipe. Ai lindi në Gjirokastrë, qyteti i cili është bërë shpesh subjekt i veprave të ndryshme letrare të tij, por edhe qyteti që mbajti peshën kryesore për krijimet e mëtejshme letrare. Atje ai përfundoi edhe arsimin e mesëm ndërsa në vitin 1958 mbaroi degën e Gjuhës e të Letërsisë në Universitetin e Tiranës. Më pas ai vazhdoi me studime dy vite në Moskë në Institutin e Letërsisë Botërore "Maksim Gorki" (1958-1960). Ismail Kadare është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqipe por gjithashtu dhe një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë botërore bashkëkohore. Me veprën e tij, që ka shënuar një numër rekord të përkthimeve (në mbi 45 gjuhë të huaja) ai e ka bërë të njohur Shqipërinë në botë, me historinë dhe me kulturën e saj shekullore.¹³⁸

Në vjeshtën e vitit 1990 Ismail Kadare vendosi të largohet nga Shqipëria dhe të qëndrojë në Paris. Shkrimtari në atë kohë e përligji këtë largim me “mungesën e ndryshimeve demokratike”. Autoritetet e kohës e dënuan largimin e Ismail Kadaresë, por krijimtaria e

¹³⁴ Po aty

¹³⁵ Po aty

¹³⁶ Po aty, fq. 86

¹³⁷ Po aty, fq. 87

¹³⁸ Wood, James, *Chronicles and Fragments: The novels of Ismail Kadare*, The New Yorker. Condé Nast, 2010, fq. 139

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

tij nuk u ndalua. Në vitin 1990 e më pas vepra e tij bëhet shprehja më e fuqishme e vlerave gjuhësore dhe artistike të shqipes letrare. Letërsia e Ismail Kadaresë pas vitit 1990 bart të njëjtat tipare thelbësore të asaj të mëparshme: frymën etnografike dhe shpërfaqjen e identitetit shqiptar.¹³⁹

Rrugën e krijimtarisë letrare e nisi si poet që në vitet e gjimnazit me “Frymëzimet Djaloshare” në 1954, “Ëndërrimet” në 1957, por ai u bë i njohur sidomos me vëllimin “Shekulli im” në vitin 1961, që u pasua nga vëllimet e tjera poetike, si: “Përse mendohen këto male” (1964), “Motive me diell” (1968) dhe Koha (1976).¹⁴⁰

Poezitë e Kadaresë shquhen për gjuhën e pasur me figuracione dhe për idetë tepër të thella. Ndërsa në fushën e prozës, Ismail Kadare ka shkruar tregime, novela dhe romane. Vepra e parë e rëndësishme e Ismail Kadaresë në prozë është romani “Qyteti pa reklama”, vepër e cila nuk u lejua të botohej e plotë deri në vitin 2003. Një karakteristikë e prozave të tij është përgjithësimi si dhe mendimi i thellë i cili shprehet përmes parabolës.¹⁴¹

Kadare ka prekur mjaft tema historike dhe patriotike. Romani “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur” (1964) shpreh gjithë shpirtin liridashës të popullit shqiptar. Kjo temë trajtohet gjithashtu edhe te romani “Kështjella” (1975). Në përmbledhjen me tregime e novela “Emblema e Dikurshme” (1977), “Ura me Tri Harqe” (1978) dhe “Gjakftohtësia” (1980) janë trajtuar problem të rëndësishme historike.¹⁴²

Morgan në librin e tij shprehet që “temat historike dhe patriotike nuk janë temat e vetme të trajtuara në veprat e Ismail Kadaresë. Romani “Kronikë në Gur” (1970) është një lloj kritike e autorit ndaj provincialitetit dhe prapambetjes në mendime dhe mentalitet”.¹⁴³

Një nga krijimet më të arritura të Ismail Kadaresë dhe të të gjithë letërsisë shqiptare është romani “Pallati i Endrrave” (1981). Shumica e veprave të Ismail Kadaresë janë pritur shumë mirë nga publiku lexues. Ai është shkrimtari shqiptar më i njohur në botë.

Ismail Kadare është nderuar me shumë çmime letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 1996, ai u zgjodh anëtar për jetë i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike në Francë, duke zëvendësuar filozofin anglez me prejardhje austriake, Karl Popper. Ndërsa nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë është dekoruar me Urdhrin “Nderi i Kombit” dhe nga shteti francez me urdhrat “Kryqi i Legjionit të Nderit” e “Oficeri i Legjionit të Nderit”.¹⁴⁴

¹³⁹ Po aty, fq. 140

¹⁴⁰ Po aty

¹⁴¹ Morgan, Peter, *Ismail Kadare: Creativity under Communism*, The Australian Newspaper, 2005, fq. 3

¹⁴² Morgan, Peter, *Ismail Kadare: The Writer and the Dictatorship 1957–1990*, Oxford: Legenda, 2010, fq.

10

¹⁴³ Po aty

¹⁴⁴ Po aty, fq. 11

Në vitin 2012 u nderua me Çmimin e madh spanjoll, "Princi i Asturias per Letërsi", që një nga çmimet më prestigjoze letrare në botë.¹⁴⁵

Ismail Kadare nuk është vetëm shkrimtari më i madh i letërsisë shqiptare, por edhe një nga shkrimtarët më të njohur të letërsisë botërore. Me njohjen dhe rrëfimin e tij, Kadare e ka afirmuar kulturën shqiptare në botë. Vitet e fundit, me një seri shkrimesh eseistike, Ismail Kadare u bë protagonist dhe objekt debatesh të mëdha intelektuale lidhur me çështje të identitetit të shqiptarëve dhe kulturës së tyre. Për krijimtarinë e gjerë të Ismail Kadaresë është shkruar dhe do të shkruhet po ashtu gjerësisht, sepse me përmasat dhe vlerat e saj tashmë ka bërë që pa të nuk mund të përfytyrohet jo vetëm letërsia shqipe, por as edhe kultura shqiptare në tërësi.¹⁴⁶

II.2.1 Kadareja si përkthyes

Përveç kontributit të tij të madh si shkrimtar Kadareja është dhe përkthyes. Në vitin 1986 ai përgatiti për përkthim veprën e plotë të tragjedianit të lashtësisë, Eskili. Në parathënien e këtij vëllimi, ai trajton natyrën e përkthimit në përgjithësi duke theksuar më pas disa nga mekanizmat e gjuhës shqipe. Ai bën një analizë të thellë përkthimore duke nxjerrë në pah mjeshtërinë e tij edhe si përkthyes.¹⁴⁷

Një grup poezish të përkthyer nga Kadare e gjejmë tek vëllimi “Ftesë në Studio” (1990). Aty janë renditur krijime nga kultura të ndryshme duke filluar nga autorët grekë si Eskili, Kavafis, Seferis, Elitis, etj. Më pas vijohet me poezi kineze, fraceze të Vinjon, Bodler e në fund janë Eminesku dhe Majakovski.¹⁴⁸

Duke qenë autori shqiptar, veprat e të cilit janë përkthyer më shumë se të të gjithë tjerëve, ai është përballur dhe me përkthimin e veprave të tij. Tek “Te Dialog me Alain Bosquet” (1996), Kadare e përshkruan procesin e përkthimit si nga më të vështirët dhe të mundimshmit me të cilët mund të ndeshet njeriu. Ai shton dhe diçka tjetër lidhur me përkthimin e veprave në vendet diktatoriale. Ai shprehet se të përkthesh në këto vende nuk është thjesht një proces i lodhshëm por edhe sfidues e padyshim edhe i rrezikshëm. Në veprën e tij ai e përqëndron vëmendjen sidomos tek figura e përkthyesit. Wood shkruan: “Sipas tij midis shkrimtarit dhe përkthyesit ekziston një fill i padukshëm”.¹⁴⁹

Në veprën e tij “Dimri i vetmisë së madhe” (1973) ai ka zgjedhur si personazh kryesor një përkthyes. Ai shkon në Moskë dhe përpiqet që të dalë në qendër të vëmendjes duke dashur të tregojë diçka nga vetja. Në fillim vihet në dyshim aftësia e tij si përkthyes dhe pastaj ai haset me një vështirësi për sa i përket përkthimit të idiomave të cilat ishte e vështirë t’i kalojë nga një gjuhë në tjetrën. Kështu ai trajton edhe probleme specifike të

¹⁴⁵ <https://www.fpa.es>

¹⁴⁶ <http://www.panorama.com.al/bibliografia-e-vepres-se-kadarese/>

¹⁴⁷ Wood, James, *Chronicles and Fragments: The novels of Ismail Kadare*, The New Yorker. Condé Nast, 2010, fq. 140

¹⁴⁸ Po aty

¹⁴⁹ Po aty

përkthimit. Edhe në një vepër të viteve të fundit “Kalorësi me Skifter” (2001), personazhi kryesor është një përkthyes i cili e ka këtë rol në një periudhë delikate: në kohën e prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe ish Jugosllavisë.¹⁵⁰

II.2.1.1 Plaku dhe Deti sipas Ismail Kadaresë

Plaku dhe Deti u përkthye nga Ismail Kadare në vitin 1963. Deri më 1960 E. Heminguei nuk ishte i pranishëm në botën letrare shqiptare. Sipas vlerësimeve të kritikës sovjetike në vitet 1950, siç e thotë një enciklopedi sovjetike e asaj kohe, vepra e Hemingueit paraqiste fatet e “brezit të humbur”, të gjymtuar nga Lufta e Parë Botërore, dhe përshkohej nga pesimizmi i thellë, nga parandjenja e mortjes së shoqërisë borgjeze. Vetë vepra “Plaku dhe Deti” përshkruan në njëfarë mënyre luftën e njeriut me natyrën.¹⁵¹

Në hapësirën lindore, që ishte bërë “revizioniste” shkruan Morgan ne librin e tij *Ismail Kadare: Creativity under Communism* “Ky autor amerikan ishte bërë i pranueshëm, domethënë mund të hynte edhe në Shqipëri.” Por Kadareja na e ka kujtuar, se në vitet 1961-1965, edhe te ne pati një “periudhë liberale në kulturë”, madje në një nga librat e tjerë (Kohë barbare, 2000) ka përmendur se “deri më 1962-64 hera herës dilte në pah pak liri, e më pas puhiza regëtitëse e ajrit të freskët u shua...”. Rrethanat për ta pasur autorin amerikan shqip ishin bërë të pëlqyeshme, ose, siç e thonë sot, ky ishte konteksti i kohës.¹⁵²

Megjithatë, Kadareja pati një arsye mjaft vetjake, por dhe tepër interesante për ne sot që të merrej me këtë tregim. Tek “Ftesë në Studio” ai shprehet kështu: “Më 1961, fill pas kthimit nga Moska, kisha nisur të mësoja frëngjisht dhe anglisht, në mënyrën më të çrregullt dhe më antipedagogjike që mund të mendohej. Një javë merresha me njërën gjuhë e një javë me tjetrën. Për anglishten përdorja “Plakun dhe detin” të Hemingueit, kurse për frëngjishten një antologji poetike.” Këtu ne kuptojmë se përkthyesi e ka përkthyer këtë vepër me mundimin e fillestarit që do të thotë se ka qenë një përkthim besnik i origjinalit.

Në atë periudhë Kadareja po merrej me romanin e tij të parë të suksesshëm, me “Gjeneralin e Ushtrisë së Vdekur” (1962), pasi kishte botuar tre vëllime me poezi (Lirika 1953, Ëndërrime 1957, Shekulli im 1961) dhe një pjesë të atij romani, që do të dilte shumë më vonë me titullin “Qyteti pa Reklama.”

Përkthimi i “Plaku dhe Deti” u ribotua dhe pas dyzet vitesh, në vitin 2002 dhe ai mund të quhet një rikthim te Heminguei. Shkrimtari është kujtuar se ka bërë edhe një përkthim prej tij dhe e rishikoi për ta botuar. E rishikoi, duke u bindur se nuk kishte bërë një përkthim të keq as dyzet vjet më parë. Redaktimi ka prekur pothuaj vetëm fjalët e huazuara, kryesisht huazime orientale, të cilat kanë përgjegjëse shqip. Nuk do të ishte një kureshti e tepërt përmendja e tyre. Fjalët: akoma, bile, bojë (njeriu), budallallëk, delikat,

¹⁵⁰ www.gazetadita.al/kadare-shkrimtari-perkthyes

¹⁵¹ Morgan, Peter, *Ismail Kadare: Creativity under Communism*, The Australian Newspaper, 2005, fq. 5

¹⁵² Po aty, fq. 6

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

dysHEME, fiksoj, formë, indiferent, jastëk, kalem, kanxhë, kapelë, kontrolloj, krevat, kurort, origjinal, pozë (pozicion), qejf, qoshe, reflekse, reflektim, rehat, respektoj, sakatoj, sfond, shyqyr, tamam, tavolinë, tension, ters, uniform, xhelatinoz, i zorshëm – janë zëvendësuar me: ende (prapë, sërish), madje, ngjyrë, shtat, marrëzi, i hajthëm (i brishtë, i lehtë), fundashtrajtë, ngulit (ngul), trajtë, shpërfillës, nënkresë, laps, grremç, kësulë, përmbaj, shtrat, hotel, parak, skajim, ëndë, kënd, pikëzime, pasqyrim, mirë, nderoj, gjymtoj, fundajë, lavdi, pikërisht (mu, enkas, si), tryezë, trysni, mbrapsht, i njëtrajtshëm, veshtullor, i vështirë. Kështu Kadareja plotësohet si përkthyes poezie, drame dhe proze.

“Plaku dhe deti” sic e përmendëm edhe më lartë është një tregim për forcën dhe dinjitetin e shpirtit të njeriut. Me simbolikën e tij ai trajton pyetjen e madhe, se deri ku duhet të shkojë njeriu, deri ku duhet të guxojë. Për Heminguein më mirë të kthehesh i mundur pasi e ke provuar ndeshjen, pasi e ke treguar se e ke guximin ta bësh, sesa të dështosh pa e bërë provën. Plaku i detit na tregon se e arriti atë që nuk e kishte bërë tjetërkush dhe nuk ka rëndësi që nuk e solli edhe mishin e peshkut për ta ngrënë. Kjo nuk ishte një sprovë për të sjellë diçka për të ngrënë, por për të sjellë një provë të guximit dhe të krenarisë. Është një ngjarje në kufirin e së pamundurës, nga e cila peshkatari është kthyer fitimtar.

Në këtë kuptim, rrëfimi kishte forcë tërheqëse për një shkrimtar si Ismail Kadareja, i cili jo një herë në veprën e vet shkon te kufiri i së pamundurës, madje te vetë kufiri midis jetës e vdekjes. Ashtu sic Konstandini i Kadarese u ngrit nga varri për ta kapërcyer kufirin, se atij i pëlqenin idetë e reja, kapej me pasion, duke i çuar nganjëherë deri në skaj, ashtu edhe plaku i Hemingueit shkon tepër larg, që të tregojë se çfarë është i zoti të bëjë njeriu dhe çfarë mund të durojë.

Përveç përkthimit të jashtëm nga një gjuhë në një tjetër, ka edhe një përkthim të brendshëm, përbrenda po asaj gjuhe. Sic shkruan Morgan në librin e tij *Ismail Kadare: The Writer and the Dictatorship 1957–1990*: “Ismail Kadareja është mjeshtër i këtij përkthimi të brendshëm në veprën e vet. Jo vetëm në rastet kur drejtpërdrejt shënon po në atë vendese dhe trajtesë, proces dhe zhdrivillim, por edhe duke e shndërruar këtë në përftesë letrare”.¹⁵³

Te “Ura me Tri Harqe” janë vënë pranë fjalët e katër gjuhëve: “Sonte është tamam aksham. Nuk është as mbrëmje, as soir, e aq më pak vjeçer, por është aksham.”¹⁵⁴ Po në këtë vepër, nëpërmjet një stilizimi arkaizues, është ndërtuar togu autonomi me cak, që është në të vërtetë një “përkthim” i togut real, të përdorur nga udhëheqësit sovjetikë pas pushtimit të Çekosllovakisë: sovranitet i kufizuar; e po kështu e ka bërë me togun kompromisi historik (nga leksiku i jetës politike italiane), duke e kthyer në: lëshim i dyanshëm historik. Madje edhe sajemat e veta Kadareja i përkthen, siç e gjejmë një rast te po ajo vepër: “Nulbytnin, që mund të përkthehej njëfarësoj me fjalën zerokrejtj.”¹⁵⁵

¹⁵³ Morgan, Peter, *Ismail Kadare: The Writer and the Dictatorship 1957–1990*, Oxford: Legenda, 2010, fq. 24

¹⁵⁴ Kadare, Ismail, *Ura me tri harqe*, Naim Frasheri, Tirane, 1978, fq. 48

¹⁵⁵ Po aty, fq. 52

Duke e ndjekur këtë vijë të menduari, bindemi se lidhjet e shkrimtarit me përkthimin janë më të thella sesa duken. Ai bën rregullisht përkthim, shpjegim, interpretim, apo ndërshtëmbim. Krijimtaria nuk është pasqyrim i realitetit, por një rishpjegim i tij pasi ajo nuk mund të gjykohej sesa besnike i qëndron historisë, por sesa na zbulon një mesazh artistik aty ku ne shohim e dëgjojmë, por kuptojmë pak. Ne kemi nevojë për përkthyesin që të bëjë të mundur realizimin e një përkthimi përmes të cilit ne të “prekim” mesazhin e autorit. Në këtë kuptim, shkrimtari është kurdoherë për ne edhe një përkthyes, nga ligjëratat e zakonshme në gjuhën artistike dhe anasjelltas.

II.3 Kush është Vedat Kokona

Vedat Kokona (8 gusht 1913 - 14 tetor 1998) ishte një shkrimtar, përkthyes dhe leksikolog shqiptar, i shekullit të 20-të, i njohur edhe për fjalorët e tij të dyfishtë anglisht-shqip dhe frëngjisht-shqip dhe për kontributin e tij në leksikologjinë dhe leksikografinë shqiptare.



Vedat Kokona lindi më 8 gusht 1913, në Izmir, të Turqisë, nga një familje intelektuale shqiptare. I ati, Elmazi, ishte avokat. Më 1920 kthehet në Tiranë, ku kreu shkollën fillore. Më 1935 përfundoi Liceun e Korçës, pastaj ndoqi studimet e larta në Paris, Francë për drejtësi. Që kur ishte nxënës, ra në sy prirja e tij për mësimin e gjuhëve të huaja. Gjuhën frënge e përvetësoi mjaft mirë. Pas përfundimit të shkollës, u emërua në gjykatën e Krujës, ku nuk shkoi të merrte detyrën. Më vonë, u emërua mësues i Gjuhës Shqipe në Liceun e Korçës. Aty, Kokona, u dallua si një mësues i zoti dhe intelektual neutral.¹⁵⁶

Në fillim të viteve '40 e emëruan në gjimnazin e Tiranës. Me pushtimin fashist, kur Kokona punonte si mësues, do t'i kërkohej që të spiunonte nxënësit dhe të merrej me punë që nuk mund t'i pranonte karakteri i tij. Kështu, kjo ishte dhe arsyeja që dha dorëheqjen nga profesioni i mësuesit. Pas luftës shërbeu si mësues në gjimnazin “Qemal Stafa”. Më 1949 u emërua redaktor dhe përkthyes në Shtëpinë Botuese “Naim Frasheri”. Për një kohë të gjatë punoi si pedagog në Universitetin e Tiranës. Ai shërbeu si mësues në katedrën e gjuhës frënge, deri në kohën kur doli në pension. Vedat Kokona mban tituj, urdhra dhe dekorata të shumta. Ai është doktor "Honoris Causa" i Universitetit të Tiranës, “Kalorës i Urdhrit të Arteve dhe të Letërsisë”, “Oficeri i Palmave Akadematike Franceze”.¹⁵⁷

¹⁵⁶ Gazetavatra.com/vedat-kokona-shkrimtar-perkthyes-dhe-leksikolog

¹⁵⁷ Po aty

II.3.1 Kokona si përkthyes

Vedat Kokona ja kushtoi pjesën më të madhe të jetës dhe të punës rrezatimit të gjuhës frënge. Ai ishte një nga leksikologët më të mirë të kësaj gjuhe. Nga mendja dhe dora e tij dolën mjaft fjalorë shqip-frëngjisht dhe anasjelltas. Fjalorin e parë e botoi në vitin 1932. Fjalori i fundit është me 40-mijë fjalë. Ai është autori më i rëndësishëm në fushën e leksikologjisë dhe leksikografisë.

Kokona është një nga përkthyesit më të njohur të vendit tonë. Që në moshë të re dha kontribut të ndjeshëm në lëmin e përkthimeve në poezi dhe në prozë. Nga ai janë përkthyer në shqip vepra të tilla si “Ana Karenina” e Leon Tolstoj, “Fundërrinat” e Maksim Gorkit, “Saga e Forsajtëve” e Xhon Gollsuarthit, “David Koperfeld” të Dikensit, “Udha e Volokolamskut” e Aleksandër Bekut, “Stuhi në Gang” e Rabindranat Tagores etj. Kokona ka sjellë në shqip rreth 15 mijë vargje nga poezia botërore. Ai ishte një nga përkthyesit kryesorë nga frëngjishtja, italishtja, anglishtja dhe rusishtja. Me urdhër të nomenklaturave partiake përktheu shumë raporte të kongreseve të partisë, rinisë, të Bashkimeve Profesionale e të gruas që nga Kongresi i Parë e deri tek i shtati. Gjithashtu, ka botuar 30-40 vëllime të përkthyer me urdhër nga lart, nga nomenklatura komuniste.¹⁵⁸

II.3.2 Plaku dhe Deti sipas Vedat Kokonës

“Plaku dhe Deti” u përkthye nga origjinali edhe nga Vedat Kokona. Në një vështrim të përgjithshëm mund të themi se ai i ka qëndruar besnik origjinalit duke përcjellë mesazhin e fortë që kjo vepër mbart dhe të gjitha tematikat e simbolet e përfshira aty.

Në kapitujt e mëtejshëm kemi bërë një krahasim përkthimi dhe shohim se ndërmjet versionit të Kadaresë dhe atij të Kokonës ekzistojnë ndryshime si mes tyre ashtu edhe me origjinalin. Ndryshimet janë të dukshme në strukturë dhe në përzgjedhjen e fjalëve por sigurisht që mesazhi përcillet po njësoj në të dyja veprat.

Në shumë shembuj Kokona i afrohet origjinalit si në formë ashtu dhe në përmbajtje. Kemi për shembull këtë fjali: “Bad luck to your mother” e cila vjen në shqip nga Kokona në këtë formë: “Ters i shkoi tët ëme”.¹⁵⁹ Me këtë përkthim ai përpiqet të transmetojë tek lexuesi të gjithë zemërimin që e ka kapluar plakun i cili gjendet mes detit, i vetëm dhe në vështirësi.

Në shumë momente vërejmë se Kokona përdor fjalë të cilat duket sikur e transmetojnë tërësisht atë që personazhi ndjen. Në faqet e para të romanit hasim këtë fjali: “It made the boy sad to see the old man...”¹⁶⁰ po të shohim versionin e Kadaresë ai e përkthen kështu: “Djalit i vinte keq, kur shihte plakun...”¹⁶¹ Kjo fjali na transmeton pak keqardhjen e djalit

¹⁵⁸ Po aty

¹⁵⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Cabej, Shtator 1997, fq. 89

¹⁶⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 5

¹⁶¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 7

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

për plakun. Ndërsa Kokona e përkthen kështu: “Djali pikëlluhej kur shihte plakun...”¹⁶² Vërejmë se Kokona përdor një folje më të “fuqishme” që tregon se në fakt ajo që ndjente djali nuk kishte një keqardhje që mund ta ndjesh për këdo por një pikëllim i thellë që e përjeton vetëm për njerëzit e dashur, ashtu siç ishte plaku për Manolinin. Në kapitujt e mëposhtëm do të shohim disa ndryshime strukturore, stilistikore dhe leksikore ndër keto dy versioneve.

Në këtë kapitull folëm shkurtimisht mbi jetën dhe veprat e Ernest Heminguei, si dhe të dy përkthyesve të kësaj vepre, Ismail Kadare dhe Vedat Kokona. Një pjesë e këtij kapitulli përqëndrohet tek përmbajtja e veprës, versioni origjinal dhe si ka ardhur ajo në gjuhën shqipe. Elementë të tjerë trajtuar në këtë kapitull lidhen me aspektin letrar. Kemi përmendur dhe analizuar personazhet kryesore të kësaj vepre si dhe tematikat e simbolet. Këto të fundit janë tepër të fuqishme dhe edhe pse kanë kaluar shumë vite që nga botimi i “Plaku dhe Deti” ato akoma kanë të njëjtin ndikim tek lexuesi.

¹⁶² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 17

KREU III

Vleresimi dhe krahasimi i përkthimit në rrafshet e ndryshme

A. III. Krahasim përkthimi i *Plaku dhe Deti* nga Ismail Kadare dhe *Plaku dhe Deti* nga Vedat Kokona në rrafshin gramatikor

A. III.1 Analizë krahasuese e strukturës së fjalisë

Kreu III do të trajtoj në mënyrë të detajuar strukturën e fjalisë, më saktë do të jetë një analizë në lidhje me rendin e fjalëve në fjali, mënyrën sesi fjalët janë lidhur mes tyre si dhe ndryshimet që ka pësuar versioni origjinal në këtë aspekt. Me anë të kësaj analize synohet të vërehet sesi ka ardhur në shqip “The Old Man and the Sea” i Heminguei si dhe ndryshimet e bëra nga secili prej përkthyesve.

Kjo analizë do të shërbejë gjithashtu edhe për të parë ndikimin që struktura e fjalisë në gjuhën shqipe ka tek tekstet e përkthyer. Duke qenë se kjo strukturë ndryshon nga ajo e gjuhës angleze që ka një strukturë pothuajse të ngurtë, do të shohim a ka një ndikim apo ndryshim në mesazhin që përcillet, rendi pothuajse i lirë i fjalëve apo ky mesazh përcillet gjithsesi, pavarësisht lëvizjeve strukturore. Në shembujt ilustrues të përzgjedhur nga versioni origjinal si dhe dy versionet e përkthyer mund të vihet re se në shumë raste dy përkthyesit e kanë sjelle veprën në mënyra të ndryshme.

Ka raste kur Kadare i ka qëndruar relativisht besnik burimit nga ana strukturore, ndërsa Kokona ka sjellë një strukturë të ndryshme ose rend të përmbysur të fjalëve ose anasjelltas. Në shembujt e përmendur më poshtë gjejmë dhe raste kur një fjali me disa pjesë të bashkërenditura përkthehet si fjali me disa pjesë të nënrenditura dhe ka arsye të ndryshme përse kanë ndodhur ato ndryshime ku ndër to mund të jenë strukturore, kuptimore apo stilistikore.

Si rezultat, kjo pjesë e parë e këtij kapitulli do të ketë në fokus strukturën e fjalisë dhe mënyrën sesi është përkthyer në gjuhën shqipe në dy versione, ndryshimet apo dhe të përbashkëtat që vërejmë tek këto dy përkthime.

A. III.1.1 Rendi i fjalëve në fjali

Fjalitë është një grup fjalësh të lidhura mes tyre sipas kuptimeve dhe rregullave gramatikore të gjuhës. Në gjuhën shqipe, rendi i fjalëve në fjali është një rend relativisht i lirë. Ai mund të varet nga faktorë gramatikorë apo stilistikorë. Rendi i fjalëve përcaktohet nga arsyet strukturore në rastet kur fjalitë kryesore i mungon kryefjala. Ndërsa në rastet

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

kur ky rend përcaktohet nga arsye stilistikore është në rastin kur duam të theksojmë fjalinë kryesore.¹⁶³

Për sa i përket rendit të gjymtyrëve në fjali në gjuhën angleze, në shumicën e rasteve ai është i tillë: S-V-O (Kryefjalë-Kallëzues-Kundrinor). Ky rend relativisht i ngurtë ndodh sepse gjuha angleze është një gjuhë analitike dhe si e tillë, funksionet dhe lidhjet sintaksore të gjymtyrëve të fjalisë shprehen me anë të renditjes së tyre në fjali.¹⁶⁴

Për ta ilustruar këtë do të sjellim disa shembuj nga librat *The Old Man and the Sea* nga Heminguei, *Plaku dhe Deti* i përkthyer nga Ismail Kadare si dhe *Plaku dhe Deti* i përkthyer nga Vedat Kokona. Me anë të këtyre shembujve do të shohim sesi ndryshon rendi i fjalëve në fjali nga një version në tjetrin.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He was an old man who fished alone in a skiff in the Gulf Stream and he had gone eighty-four days now without taking a fish. ¹⁶⁵	Ai ishte një plak që peshkonte i vetëm me barkë mbi Gulf Stream dhe që kish tetëdhjetë e katër ditë pa kapur asnjë peshk. ¹⁶⁶	Ishte një plak që gjuante peshk fill i vetëm në varkën e tij në Golfstrim. Kishte shkuar tetëdhjetë e katër ditë pa kapur asnjë peshk. ¹⁶⁷

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He was holding his glass and thinking of many years ago. ¹⁶⁸	Ai mbante në dorë gotën dhe mendonte për vitet e shkuara. ¹⁶⁹	Mbante në dorë gotën e birrës dhe sillte ndër mend kohën e shkuar. ¹⁷⁰

¹⁶³ Newmark, Loenard, Hubbard, Philip, Prifti, Peter, *Standard Albanian*, Stanford, California, Stanford University Press, 1982, fq. 52

¹⁶⁴ Radford, Andrew, *English Syntax, An Inroduction*, Cambridge University Press, Cambridge, 2004, fq.7

¹⁶⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.5

¹⁶⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.17

¹⁶⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq7.

¹⁶⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.7

¹⁶⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.19

¹⁷⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 8

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
The old man was thin and gaunt with deep wrinkles in the back of his neck. The brown blotches of the benevolent skin cancer the sun brings from its reflection of the tropic sea were on his cheeks. ¹⁷¹	Plaku ishte thatanik dhe i rraskapitur, me rrudha të thella në qafë. Në faqe kishte njolla ngjyrë kafe kanceri të parrezikshme të lëkurës, shkaktuar nga pasqyrimi i diellit mbi detin tropikal. ¹⁷²	Plaku ishte thatanik dhe i drobitur, me qafën plot me rrudha të thella dhe faqet plot me njolla të murme, që i qenë shkaktuar nga rrezet e diellit që pasqyrohen nga faqja e detit të tropikut. ¹⁷³

Në shembullin e parë vërejmë se Kadare ka ruajtur pothuajse një rend të njëjtë me versionin original përveç faktit që nuk e ka përsëritur kryefjalën në pjesën e bashkërenditur të fjalisë të cilën e ka shprehur fillimisht me përemrin vector *ai*, ndërsa në pjesën e dytë e ka hequr terësisht.

Nëse shohim versionin e Kokonës fillimisht vërejmë se ai e ka ndarë frazën në dy fjali të ndryshme dhe në fjalinë e parë ai ka përmbysur rendin kryefjalë-kallëzues siç është në versionin anglisht duke vendosur foljen në fillim të fjalisë. Në fjalinë e dytë, ai nuk e përkthen fare kryefjalën duke qenë se në gjuhën shqipe është folja ajo që shërben edhe si një lloj treguesi i vetës, pra *kishte shkuar* është veta e trete njëjës. Në gjuhën angleze, kjo gjë është e pamundur pasi në të gjitha vetat nuk vërehet asnjë ndryshim kur kemi përdorim të Past Perfect Tense.

Në shembullin e dytë si Kadare ashtu dhe Kokona ruajnë një rend të njëjtë me versionin original. I vetmi ndryshim është fakti se Kokona e anashkalon përdorimin e kryefjalës dhe e le atë të nënkuptuar, ashtu siç e shpjeguem më sipër faktin në gjuhën shqipe folja është tregues i vetës, ndërsa në gjuhën angleze kjo gjë nuk është gjithmonë e mundur, me përjashtim të disa rasteve.

Në shembullin e tretë, përkthimet ndryshojnë shumë pasi Heminguei shkruan dy fjali, Kadareja ruan pothuajse të njëjtën strukturë ndërsa Kokona i shkrin të dy fjalitë në një fjali të vetme.

Një shembull tjetër i rastit kur kryefjala mungon plotësisht është ky:

¹⁷¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.5

¹⁷² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 17

¹⁷³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.7

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Five and you nearly were killed when I bought the fish in too green and he nearly tore the boat into pieces. ¹⁷⁴	Pesë, dhe gati sa s’vdiqe kur unë hodha në barkë një peshk pothuaj të gjallë, që desh copëtoi çdo gjë. ¹⁷⁵	Pesë, dhe mend vdiqe kur nxora nga deti dhe hodha në varkë një peshk të gjallë që edhe për pak do t’i bënte copë-copë të gjitha. ¹⁷⁶

Në versionin e Kadaresë, kryefjala është përdorur vetëm në një rast, veta e parë njëjës, ndërsa kryefjala në vetën e dytë njëjës, pra *you*, në pjesën e bashkërenditur të fjalisë mungon. Përemri vector *he* nuk është përkthyer dhe ai nënkuptohet me anë të foljes në vetën e tretë njëjës. Në të dyja rastet është folja ajo që shërben si tregues për të kuptuar se cilës vetë i përket kryefjala. Për sa i përket rendit të fjalëve në fjali, ai është ruajtur si në versionin original, pa asnjë lloj ndryshimi.

Në versionin e dytë të përkthyer, kryefjala mungon në çdo pjesë të bashkërenditur apo të nënrenditur dhe ajo nënkuptohet nga folja. Struktura e fjalisë në gjuhën shqipe le hapësirë për mungesa të tilla, gjë e cila në gjuhën angleze është pothuajse e pamundur pasi në këtë rast një fjalie nuk mund t’i mungojë kryefjala. Përemrat *I, you, he* nuk janë përkthyer nga Kokona.

Për sa i përket rendit të fjalëve në fjali, edhe në këtë version ai mbetet i pandryshuar. Edhe pse struktura e fjalisë në gjuhën shqipe mund ta lejojë një ndryshim të rendit, në këto shembuj ilustrues, përkthyesit kanë zgjedhur t’i qëndrojnë besnikë strukturës së tekstit origjinal.

A. III.1.2 Fjali me bashkërenditje apo me nënrenditje?

Fjali të përbëra me bashkërenditje janë fjalitë e përbëra nga të paktën nga dy pjesë të pavarura. Të dyja pjesët mund të përdoren më vete si fjali të thjeshta. Këto dy pjesë lidhen mes tyre me anë të lidhëzave bashkërenditëse.¹⁷⁷

Llojet e fjalive të përbëra me bashkërenditje janë:

- *Shtuese: fjali që lidhen me lidhëzat e, dhe edhe, as, si, jo vetëm*
- *Veçuese: fjali që lidhen me lidhëzat ose, apo, a, etj.*

¹⁷⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.8

¹⁷⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.19-20

¹⁷⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.9

¹⁷⁷ Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Eneida Pema, *Gjuha Shqipe*, Botime Pegi, Tirane, 2017, fq.217

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

- *Kundërshtuese: fjali që lidhen me lidhëzat po, por, kurse, mirëpo, megjithatë, ndërsa, teksa, porsa, veç, veçse, etj.*
- *Përmbyllëse: fjali që lidhen nga lidhëzat andaj, ndaj, prandaj, pa, etj.*

Fjalitë e përbëra me nënrenditje janë fjalitë e përbëra të paktën nga dy pjesë, njëra kryesore dhe tjetra e varur prej saj. Këto fjali nuk mund të qëndrojnë më vete si fjali të thjeshta.

Llojet e fjalive të nënrenditura janë:

- *Përcaktore: fjali që lidhen me lidhëzën që*
- *Ftilluese: fjali që shprehen me lidhëzat se, që*
- *Kohore: fjali që shprehen me lidhëzat sapo, kur*
- *Qëllimore: fjali që shprehen me lidhëzat me qëllim që*
- *Vendore: fjali që shprehen me lidhëzën ku*
- *Shkakore: fjali që shprehen me lidhëzën meqë*
- *Rrjedhimore: fjali që shprehen me lidhëzën kështu që*
- *Lejore: fjali që shprehen me lidhëzat megjithëse, ndonëse, sido që, edhe pse,*
- *Kushtore: fjali që shprehen me lidhëzat nëse, me kusht që, në rast se, po qe se,*
- *Krahasore: fjali që shprehen me lidhëzat as sa, po aq¹⁷⁸*

Këto fjali do t’i ilustruj me shembuj nga libri *Plaku dhe Deti* i Heminguei si dhe nga dy versionet e përkthyer nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He had been there before <u>and</u> one of the fishermen was looking after the skiff for him. ¹⁷⁹	Ai kishte qenë në breg me përpara <u>dhe</u> njëri nga peshkatarët i kish thënë <u>se</u> do të kujdesej për barkën në vend të tij. ¹⁸⁰	Ai kishte qenë poshtë më parë <u>dhe</u> një nga peshkatarët i kish thënë <u>se</u> do të kujdesej për varkën. ¹⁸¹

¹⁷⁸ Po aty, fq.222

¹⁷⁹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.106

¹⁸⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.107

¹⁸¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.78

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
<p>That afternoon there was a party of tourists at the Terrace <u>and</u> looking down in the water among the empty beer cans <u>and</u> dead barracudas a woman saw a great long white spine with a huge tail at the end <u>that</u> lifted <u>and</u> swung with the tide <u>while</u> the east wind blew a heavy steady sea outside the entrance to the harbor.¹⁸²</p>	<p>Atë mbasdite në Terracë erdhi një grup turistësh <u>dhe</u> duke vështruar poshtë ujët, midis gotave bosh të birrave <u>dhe</u> meduzave të ngordhura, një grua pa një kurriz të gjatë të bardhë me një bisht të madh në fund, <u>që</u> lëkundej e ngrihej nga batica, <u>ndërsa</u> era e lindjes ngrinte pa pushim dallgë të mëdha në të hyrë të gjirit¹⁸³</p>	<p>Atë ditë një grup turistësh erdhi në Taracë; një nga turistët, duke vështruar tallazet e mëdha <u>që</u> ngrinte era e lindjes në të hyrë të gjrit, në mes të kanoçeve të zbrazëta të birrës <u>dhe</u> kandilave të ngordhur të detit, vuri re një unazë të gjatë të peshkut të kurrizit me një bisht të madh në fund, <u>që</u> ngrihej dhe lëkundej në dallgët <u>që</u> përplaseshin pas shkëmbinjve¹⁸⁴</p>

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
<p><u>When</u> the wind was in the east a smell came across the harbour from the shark factory; <u>but</u> today there was only the faint edge of the odour because the wind had backed into the north <u>and</u> then dropped off <u>and</u> it was pleasant and sunny on the terrace.¹⁸⁵</p>	<p>Kur era frynte nga lindja, sillte kundërmimin e fabrikës së peshkaqenëve; por sot, kundërmimi ndihej fare pak, sepse era ishte nga veriu dhe pastaj kish pushuar fare, dhe në Terracë kish diell dhe ta kishte ënda të rrije.¹⁸⁶</p>	<p>Kur frynte erë nga ana e lindjes, ndihej në gjithë portin kundërmimi i qelbur që vinte nga fabrika e peshkaqenit: por sot ky kundërmim thuhet nuk ndihej, sepse era kishte zënë të fryjë nga veriu dhe pataj kishte pushuar, kurse në Taracë kishte diell e ta</p>

¹⁸² Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.109

¹⁸³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.110

¹⁸⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.80

¹⁸⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.7

¹⁸⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.19

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

		kishte ënda që të rrije. ¹⁸⁷
--	--	---

Fjalja e parë është një shembull i fjalisë me bashkërenditje sepse kemi dy pjesë të pavarura që lidhen mes tyre me anë të lidhëzës bashkërenditëse *and-dhe*. Në versionin e përkthyer nga Kokona vërejmë se kemi dy pjesë të bashkërenditura që lidhen me lidhëzën *dhe* si edhe një pjesë të nënrenditur ftilluese e cila lidhet me pjesën e bashkërenditur me anë të lidhëzës ftilluese *se*. Përkthyesi ka vendosur të shtojë dhe këtë pjesë në mënyrë që të japë një farë shpjegimi apo sqarimi për lexuesin.

Edhe në versionin e përkthyer nga Kokona vërejmë të njëjtën gjë, shtimin e një pjese të nënrenditur ftilluese të shprehur me lidhëzën *se*.

Në shembullin e dytë, në versionin e përkthyer nga Ismail Kadare, kemi katër pjesë të bashkërenditura shtuese që shprehen me lidhëzën *and-dhe*, një pjesë të bashkërenditur kundërshtuese që shprehet me anë të lidhëzës kundërshtuese *while-ndërsa* dhe një pjesë të nënrenditur përcaktore që shprehet me anë të përemrit lidhor *that-që*.

Në versionin e përkthyer nga Vedat Kokona vërejmë disa ndryshime në raport me atë çfarë thamë më sipër. Gjëja e parë që vihet re është fakti se pjesët e bashkërenditura jo gjithmonë janë shprehur me lidhëzën shtuese *dhe* apo atë kundërshtuese *ndërsa* si në rastin e Kadaresë, por ato janë zëvendësuar me presje apo pikëpresje. Për sa u përket pjesëve të nënrenditura ato janë tre dhe janë përcaktore. Ata lidhen me anë të përemrit lidhor *që*.

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
<p><u>But</u> they were up to the bow <u>and</u> driving in one after the other and together, tearing of the pieces of meat <u>that</u> showed glowing below the sea <u>as</u> they turned to come once more.¹⁸⁸</p>	<p><u>Po</u> ata ishin tani te bashi dhe vërsuleshin njëri pas tjetrit <u>dhe</u> në tufë, duke zhvatur copa mishi <u>që</u> shndrisnin poshtë në det, <u>ndërsa</u> ktheheshin që të turreshin përsëri.¹⁸⁹</p>	<p><u>Por</u> peshkaqenët tani ishin te maja e varkës <u>dhe</u> i vërsuleshin peshkut njëri pas tjetrit <u>dhe</u> përnjëherë të gjithë sëbashku, duke zhvatur copa mishi, <u>të cilat</u> shkëlqenin në det, <u>kur</u> peshkaqenët ktheheshin përsëri për t’iu vërsulur prapë gjahut.¹⁹⁰</p>

¹⁸⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.8

¹⁸⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.102

¹⁸⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.104

¹⁹⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.75-76

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 5

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
There were other boats from the other beaches going out to sea <u>and</u> the old man heard the dip <u>and</u> push of their oars <u>even though</u> he could not see them now the moon was below the hills. ¹⁹¹	Nga cektinat e tjera zunë të dalin në det barka të tjera <u>dhe</u> plaku dëgjonte zhurmën e zhytjes së lopatave të tyre <u>ndonëse</u> me sy nuk i shihte, tani që hëna kishte rënë prapa kodrave. ¹⁹²	Nga cektinat e tjera zunë të shkisinin në det edhe varkat e tjera <u>dhe</u> plaku, <u>megjithëse</u> nuk i shikonte tani që hëna kishte qëndruar prapa kodrës, dëgjonte sesi binin lopatat dhe çanin ujin. ¹⁹³

Shembull 6

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
It made the boy sad to see the old man come in each day with his skiff empty <u>and</u> he always went down to help him carry either the coiled lines <u>or</u> the gaff <u>and</u> harpoon <u>and</u> the sailed <u>that</u> was furled around the mast. ¹⁹⁴	Djali pikëllohej <u>kur</u> shihte plakun <u>që</u> kthehej çdo ditë me barkën bosh <u>dhe</u> zbriste gjithmonë në breg për ta ndihmuar të çonte në shtëpi veglat e peshkimit <u>ose</u> fuzhnjën dhe litarët <u>dhe</u> pëlhurën e mbështjellë pas direktut. ¹⁹⁵	Djalit i vinte keq, <u>kur</u> shihte çdo ditë plakun, <u>që</u> kthehej me varkën bosh; ai dilte gjithmonë breg të detit që ta ndihmonte të shpintë në shtëpi lëmshet e tojës, <u>ose</u> shkopin me grep në majë, kamaqen <u>dhe</u> pëlhurën e mbështjellë rreth direktut. ¹⁹⁶

Në shembullin e katërt të këtyra tabelave mund të vërejmë se fjalia ka filluar me një lidhëz bashkërenditëse kundërshtuese *but* dhe në të dy versionet e përkthyer fjalia ka ardhur në po këtë formë; Kadare e ka filluar me *po*, ndërsa Kokona me *por*. Kjo fjali përbëhet nga tre pjesë të bashkërenditura dhe këto pjesë janë shprehur me anë të lidhëzës shtuese *dhe* si dhe me lidhëzën kundërshtuese *ndërsa* në rastin e Kadaresë. Në versionin e Kokonës, të tre pjesët e bashkërenditura janë shprehur me lidhëzën *dhe*. Për sa u përket

¹⁹¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.21

¹⁹² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.31-32

¹⁹³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.18

¹⁹⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 5

¹⁹⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 17

¹⁹⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.7

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

pjesëve të nënrenditura, ato janë shprehur me lidhëzën përcaktore që në versionin e Kadaresë dhe me lidhëzën kohore në versionin e Kokonës.

Në shembullin e pestë kemi një fjali të përbërë nga dy pjesë me bashkërenditje të shprehura me lidhëzën shtuese dhe si edhe një pjesë të nënrenditur të shprehur me lidhëzat lejore ndonëse/megjithëse të përdorura nga përkthyesit. Një ndryshim që mund të vihet re është fakti se Kokona “luan” me rendin e fjalëve, ndërsa Kadare ruan pothuajse të njëjtin rend me origjinalin.

Në shembullin e fundit kemi një fjali të përbërë nga pjesë me bashkërenditje të cilat në të dyja versionet janë shprehur me lidhëzën shtuese *dhe* si edhe me lidhëzën kundërshtuese *ose*. Për sa u përket pjesëve të nënrenditura mund të vërejmë se të dy përkthyesit kanë përdorur lidhëzën kohore *kur* për të shprehur pjesën e parë të nënrenditur. Lidhëza përcaktore *që* është gjithashtu e njëjtë në të dy versionet.

Në fjalinë e përkthyer nga Kokona mund të vërejmë se ai përdor shenjën e pikëpresjes në vend të lidhëzës *dhe*. Këtë e kemi hasur edhe në një fjali tjetër të versionit të tij.

A. III.1.3 Përkthimi i formës së ngurtësuar (ing-form)

Forma- ing mund të jetë e përbërë ose nga një përemer pronor dhe folje e ndjekur nga forma + ing ose nga vet folja + ing.¹⁹⁷ Ajo përdoret në këto raste: si kryefjalë, kundrinor apo përcaktor. Pas disa parafjalëve, apo dhe pas disa fjalëve që shprehin pëlqim ose mospëlqim të diçkaje si p.sh: dua, pëlqej, adhuroj, urrej, nuk e kam problem, etj. Ka dhe raste kur përdoret pas këtyre foljeve si psh: pranoj(admit), shmang(avoid), mohoj(deny), fal (forgive), heq dorë (give up), imagjinoj (imagine), përfshij (involve), etj.¹⁹⁸. Forma - ing shërben edhe për të formuar kohët e përbëra të vazhduara si. p.sh. Present Continuous (to be+verb+ing), Past Continuous (was/were+verb+ing), etj.

Shembujt e mëposhtëm do të shërbejnë si ilustrim i mënyrës sesi ka ardhur në shqip forma *-ing*:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
The blotches ran well down the sides of his face and his hands had the deep-creased	Njollat zbrisnin nga faqet deri në qafë dhe në duar kishte shenja të thella	Këto njolla zgjateshin deri te qafa, dhe në duar kishte njolla plage të thella, që ia

¹⁹⁷ Baker, C. L, *English Syntax, Second Edition*, Cambridge, Massachusetts, London England, The MIT Press, 1995, fq. 186

¹⁹⁸ Norris, Roy, *Ready for FCE*, Macmillan Publishing House, New York, 2012, fq.206

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

scars from <u>handling</u> heavy fish on the cords. ¹⁹⁹	plagësh, të bëra nga litari kur <u>kishte tërhequr</u> ndonjë peshk të madh. ²⁰⁰	kish bërë litari kur <u>kish tërhequr</u> një peshk të madh. ²⁰¹
--	---	---

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“I can remember the tail <u>slapping</u> and <u>banging</u> and the thwart <u>breaking</u> and the noise of the <u>clubbing</u> .” ²⁰²	Më kujtohet bishti që <u>përplasej</u> dhe <u>godiste</u> , dhe që <u>theu</u> fronin, dhe zhurma e shkopit tënd, kur ti <u>i bije</u> peshkut. ²⁰³	Më kujtohet si <u>rrihte</u> e <u>përplaste</u> bishtin, si <u>theu</u> fronin dhe si zhurmonte kur e <u>kopanisë</u> . ²⁰⁴

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“What’s that?” she asked a waiter and pointed to the long backbone of the great fish that was now just garbage <u>waiting</u> to go outwith the tide.” ²⁰⁵	Ç’është kjo? –pyeti ajo një kamarier dhe tregoi skeleton e gjatë të peshkut të madh që tani s’ishte veç një plaçkë që <u>priste</u> ta merrte zbatica. ²⁰⁶	Ç’është kjo? –pyeti ajo kamarierin, duke I treguar unazën e gjatë të peshkut të madh, që tani s’ishte veçse një plaçkë që <u>do ta merrte</u> zbatica. ²⁰⁷

¹⁹⁹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 5

²⁰⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 17-18

²⁰¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 7

²⁰² Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.8

²⁰³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.20

²⁰⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.9

²⁰⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.109

²⁰⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.110

²⁰⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 80

Shembull 4

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He noticed how pleasant it was to have someone to talk instead of <u>speaking</u> only to himself and to the sea. ²⁰⁸	Ai vuri re se sa kënaqësi ishte kur mund të bisedoje me njënjeri në vend që të <u>flisje</u> vetëm me veten dhe me detin. ²⁰⁹	E ndjeu sa gjë e mirë ishte kur kishe me kë të <u>kuvendoje</u> , përveç vetes dhe detit. ²¹⁰

Në shembullin e parë, *handling* vjen në gjuhën shqipe me një folje të kohës më se të kryer e cila tregon një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Ky veprim i plakut kishte lënë pasoja. Kështu nga roli i një kundrinori në gjuhën angleze, në gjuhën shqipe përkthehet me një folje nga të dy përkthyesit.

Në shembullin e dytë, *slapping* dhe *banging* janë përkthyer, në të dy versionet, me folje të kohës së pakryer e cila tregon një veprim në zhvillim e sipër në një cast të së shkuarës. *Breaking* është përkthyer si nga Kadare ashtu dhe nga Kokona me një folje në kohën e kryer të thjeshtë, kohë e cila tregon një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës. Në këtë rast folja *theu* tregon një veprim i cili ka përfunduar si dhe ka edhe një rezultat të caktuar.

Clubbing është përkthyer në dy mënyra të ndryshme nga përkthyesit. Kadare ka zgjedhur ta përkthejë si *i bije peshkut*. Ai ka përdorur foljen *i bije*, e cila është në kohën e pakryer.

Kokona e ka përkthyer *clubbing* si *e kopanise*. Edhe ai, njësoj si Kadare, ka përdorur një folje të kohës së pakryer.

Në shembullin e tretë kemi një ndryshim në mënyrën sesi *waiting* ka ardhur në versionin shqip nga dy përkthyesit. Mund të vërejmë se ata kanë zgjedhur kohë dhe fjalë të ndryshme për ta sjellë atë në gjuhën shqipe. Kadare ka përdorur foljen *pres* në kohën e pakryer, ndërsa Kokona ka përdorur foljen *marr* në kohën e ardhme. Edhe pse ka këto ndryshime, mesazhi është i njëjtë në të dy versionet.

Në shembullin e fundit, *of speaking*, në të dy versionet, vjen e përkthyer me një folje të kohës së pakryer të mënyrës lidhore. Ndryshimi i vetëm qëndron në zgjedhjen e fjalës. Kadare ka zgjedhur *flas*, ndërsa Kokona ka përdorur foljen *kuvendoj*. Në këto shembuj mund të vërejmë se përkthyesit nuk kanë përdorur asnjë nga format e pashtjelluara të

²⁰⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.107

²⁰⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.108

²¹⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.79

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

foljes, siç zakonisht përdoren për të sjellë në gjuhën shqipe formën –ing. Në vend të këtyre formave, ata kanë përdorur kohën e pakryer apo të kryerën e thjeshtë.

A. III.2. Analizë krahasuese e përdorimit të kohëve të foljeve

Folja është një pjesë e ndryshueshme e ligjëratës që emërton një veprim ose gjendje të kryefjalës. Ajo tregon një veprim të cilin e kryen kryefjala e fjalisë apo gjëndjen në të ilen ajo ndodhet. Folja apo kallëzuesi është gjymtyra kryesore dhe më e rëndësishmja e fjalisë. Ajo përshtatet në numër dhe në vetë.²¹¹

Folja në gjuhën shqipe ka tre shtylla ndarjeje kohore: *e shkuar*, *e tashme*, *e ardhme*. Koha e shkuar ndahet në: *e pakryer*, *e kryer e thjeshtë*, *e kryer, më se kryer*, *e kryer e tejshkuar*.²¹²

Koha e tashme tregon kryerjen e një veprimi në një kohë me çastin e ligjërimin. *Koha e pakryer* tregon një veprim në zhvillim e sipër në një cast të së shkuarës. *E kryera e thjeshtë* tregon një veprim të përfunduar në një cast të caktuar të së shkuarës. *E kryera* tregon një veprim të përfunduar që ka akoma lidhje me çastin e ligjërimin dhe mund të ketë pasoja në të tashmen. *Koha më se e kryer* tregon një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. *Koha e kryer e tejshkuar* është një kohë sinonimike me kohën më se të kryer, pra tregon një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës.

Koha e ardhme tregon një veprim që do të kryhet pas çastit të ligjërimin, ndërsa *koha e ardhme e përparme* tregon një veprim që pritet të kryhet në të ardhmen para një veprimi tjetër.²¹³

Me anë të këtyre shembujve ilustrues do të vërejmë sesi kanë ardhur në shqip foljet e kohëve të ndryshme.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
No one <u>would steal</u> from the old man but it <u>was</u> better to <u>take</u> the sail and the heavy lines home as the dew <u>was</u> bad for them and, though he <u>was</u> quite sure no local people <u>would steal</u> from him, the old man	Asnjëri <u>s'mund t'i vidhte</u> gjërat e plakut, por <u>ishte</u> më mirë që pëlhurën dhe litarët e rëndë t'i <u>conte</u> në shtëpi sepse i <u>dëmtonte</u> vesa. Megjithëse <u>ishte</u> i sigurt, se asnjë nga njerëzit e këtushëm nuk <u>do ta vidhte</u> ,	Askujt nuk <u>do t'i shkonte</u> ndër mend që të vidhte placket e plakut, por e mira <u>ish</u> që pëlhurën dhe takëmet e rënda t'i <u>shpinin</u> në shtëpi, që të mos <u>lageshin</u> nga vesa. Megjithëse plaku <u>ish</u> i bindur se askush nga

²¹¹ Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Eneida Pema, *Gjuha Shqipe*, Botime Pegi, Tirane, 2017, fq.196

²¹² Po aty, fq. 199-200

²¹³ Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Eneida Pema, *Gjuha Shqipe*, Botime Pegi, Tirane, 2017, fq. 199-201

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

<p><u>thought</u> that a gaff and a harpoon <u>were</u> needless temptations to <u>leave</u> in a boat.²¹⁴</p>	<p>plaku <u>mendoj</u>, se fuzhinja dhe gremçi <u>mund të ishin</u> një tundim i keq për mëkat, po t'i <u>linte</u> në barkë²¹⁵</p>	<p>banorët e vendit nuk <u>do të lakmonte</u> plaçkën e tij, prapëseprapë e <u>pa</u> të udhës që ta <u>mernte</u> kallamin me grep dhe kamaqen, që të mos e <u>shtynte</u> tjetrin të <u>bënte</u> një mëkat.²¹⁶</p>
---	--	--

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
<p>“I do not care. I <u>caught</u> two yesterday. But we <u>will fish</u> together now for and still <u>have much to learn</u>.”²¹⁷</p>	<p>Aq më bën. Dje <u>kapa</u> dy peshq. Po ne <u>do të peshkojmë</u> bashkë tani, që unë të <u>mësoj</u> akoma më shumë gjëra.²¹⁸</p>	<p>Le të <u>thonë</u> ç'të duan! Dje <u>kapa</u> dy peshq. Tani <u>duhet të peshkojmë</u>, se unë <u>kam</u> shumë për të mësuar.²¹⁹</p>

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
<p>The old man <u>had taught</u> the boy <u>to fish</u> and the boy <u>loved</u> him.²²⁰</p>	<p>Plaku e <u>kish mësuar</u> djalin <u>të zinte</u> peshq dhe djali e <u>donte</u>.²²¹</p>	<p>Plaku e <u>kish mësuar</u> djalin e vogël të <u>gjuante</u> peshk, andaj djali e <u>donte</u> kaq shumë.²²²</p>

Në shembullin e parë kemi këto folje të cilat janë përkthyer në këtë mënyrë nga Kadare dhe Kokona:

²¹⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.10

²¹⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.22

²¹⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.10

²¹⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.108

²¹⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.109

²¹⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.79

²²⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.6

²²¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.18

²²² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.7

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Would steal-s'mund t'i vidhte-do t'i shkonte ndër mend- Përkthyesit kanë përdorur dy folje të ndryshme dhe i kanë shprehur ato në mënyra të ndryshme. Kadare ka përdorur foljen modale *mund+vjedh* në kohën e pakryer, ndërsa Kokona ka zgjedhur të përdorë foljen *shkoj në kohën e ardhme+ ndër mend*. Ata kanë përdorur kohë dhe mënyra të veçanta për të shprehur të njëjtën gjë.

was-ishte-ish- Në këtë rast ata kanë përdorur të njëjtën folje në të njëjtën kohë që është koha e pakryer. I vetmi ndryshim qëndron në faktin se Kokona e ka sjellë në një formë të shkurtuar.

*Take-çonte-shpinin-*Përkthyesit kanë përdorur një kohë ndryshe nga ajo e versionit original, që është në kohën e tashme. Kadare dhe Kokona përdorin dy folje sinonimike në kohë të njëjtë që është koha e pakryer.

*Was(bad)-dëmtonte-të lageshin-*Përkthyesit kanë përdorur dy folje me kuptime të ndryshme nga njëra-tjetra, por duke u bazuar në kontekst ata japin të njëjtin mesazh. Koha e këtyre foljeve është e pakryera.

*Would steal-do ta vidhte-do të lakmonte-*Kadare dhe Kokona kanë përdorur të njëjtën kohë foljeje që është koha e ardhme. Këto janë dy folje me kuptime të ndryshme të përshtatura sipas kontekstit.

*Thought-mendoj-pa (të udhës)-*Përkthyesit kanë zgjedhur dy folje të ndryshme dhe i kanë sjellë në shqip në të njëjtën kohë. Ata e ka përkthyer foljen nga past tense në kohën e kryer të thjeshtë.

Were-mund të ishin- Këtu folja *to be* e *past tense* është përkthyer me një folje modale+foljen *jam* në kohën e pakryer.

*Leave-linte-shtynte, bënte-*Në këtë rast folja është përkthyer në dy versione të ndryshme. Koha që kanë përdorur përkthyesit është e njëjtë, koha e pakryer, por ndryshon me atë të versionit origjinal.

Shembulli i dytë:

Caught-kapa-kapa- Si Kadare ashtu dhe Kokona kanë përdorur të njëjtën folje në të njëjtën kohë. Folja në past tense ka ardhur në gjuhën shqipe në kohën e kryer të thjeshtë.

Will fish-do të peshkojmë-duhet të peshkojmë- Në këtë shembull, përkthyesit kanë përdorur të njëjtën folje por e kanë sjellë në mënyra të ndryshme. Kadare i ka qëndruar besnik kohës së origjinalit, future tense-kohës së ardhme, ndërsa Kokona ka përdorur foljen modale *duhet+foljen kryesore* në kohën e tashmë të lidhore.

Have to learn-të mësoj-kam për të mësuar- Folja *mësoj* ka ardhur në gjuhën shqipe në dy mënyra të ndryshme. Kadare ka përdorur kohën e tashme të lidhore, ndërsa Kokona ka përdorur foljen ndihmëse *kam+formën e pashtjelluar paskajore* të foljes *mësoj*.

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Shembulli i tretë:

Had taught-kish mësuar-kish mësuar- Në këtë rast folja në past perfect është sjellë në shqip në kohën e më se të kryer nga të dy përkthyesit.

To fish- të zinte-të gjuante- Folja në infinitive është përkthyer nga Kadare dhe Kokona në të njëjtën kohë, në kohën e tashmë të mënyrës lidhore. Ndryshimi i vetëm qëndron në faktin se foljet nuk janë të njëjta, por sinonimike.

Loved-donte-donte- Në këtë shembull, folja në past tense është sjellë në kohën e pakryer në të dy versionet.

A. III.3 Analizë krahasuese e përkthimit apo jo të vetës së parë njëjës dhe shumës

Përemrat vetorë janë ato gjymtyrë të fjalisë që tregojnë vetat. Kuptimi i vetës tek këta përemra përkon me kuptimin e tyre leksikor. Përemri vetor i vetës së parë njëjës dhe shumës tregon përkatësisht vetën që flet ose një grup personash (vetash) ku hyn dhe veta folësi.²²³

Shembull 1

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“How old was I when you first took me in a boat?” ²²⁴	-Sa vjeç isha, kur më more për herë të parë në barkë?” ²²⁵	-Sa vjeç isha kur më more për herë të parë në varkë?” ²²⁶

²²³ Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Eneida Pema, *Gjuha Shqipe*, Botime Pegi, Tirane, 2017, fq. 10

²²⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.8

²²⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.19

²²⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.9

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“I remember everything from when we first went together.” ²²⁷	Mua më kujtohet çdo gjë, që nga dita që kemi dalë për herë të parë bashkë në det. ²²⁸	Të gjitha më kujtohen, që ditën e parë që më more me vete në det. ²²⁹

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“I would like to go. If I cannot fish with you, I would like to serve in some way.” ²³⁰	Dua ta hedh unë. Në qoftë se s’mund të vij të peshkoj me ty, unë dua të të shërbej në ndonjë mënyrë. ²³¹	Kam qejf të vij. Në mos mundsha të gjuaj peshk me ty, atëherë lemë të të ndihmoj ndryshe. ²³²

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“We can do that,” the boy said. ²³³	-Mund ta blejmë, tha djali. ²³⁴	-Pse të mos e blejmë? –tha djali. ²³⁵

²²⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.8

²²⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.20

²²⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.9

²³⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.7

²³¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.19

²³² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.9

²³³ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.12

²³⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.24

²³⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.12

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Në shembullin e parë mund të vërejmë se në të dyja versionet veta e parë njëjës nuk është përkthyer, por është folja ajo që na bën të kuptojmë se në cilën vetë është kryefjala. Gjuha shqipe na e lejon këtë për shkak se nëqoftëse zgjedhjmë një folje në çfarëdo lloj kohe ajo do të ndryshojë formën në secilën vetë. Ndërsa në gjuhën angleze kjo gjë nuk ndodh në të gjitha vetat apo kohët. Trajtat e shkurtra apo ato të shkurtra të bashkuara shërbejnë gjithashtu si një tregues i vetës. Për shembull: më more, kë? mua më. Kështu edhe në këtë mënyrë e kuptojmë se bëhet fjalë për vetën e parë njëjës.

Në shembullin e dytë vërejmë se veta e parë shumë nuk është përkthyer. Në versionin e Kadaresë e kuptojmë nga folja *kemi dalë* se kemi të bëjmë me vetën e parë shumë. Në versionin e Kokonës, nuk kemi fare përdorim të vetës së parë shumë, ajo është zëvendësuar nga trajta e shkurtër më që në këtë rast, shërben si tregues i vetës së parë njëjës. Për sa i përket vetës së parë njëjës në pjesën e bashkërenditur të fjalisë, vëmë re se Kadare ka përdorur përemrin mua si dhe trajtën e shkurtër më. Kokona gjithashtu ka përdorur trajtën e shkurtër më.

Në shembullin e tretë, Kadare e ka përkthyer vetën e parë njëjës, ndërsa Kokona e lë të nënkuptuar me anë të foljes.

Në shembullin e fundit vëmë re se veta e parë njëjës nuk është përkthyer nga asnjëri nga përkthyesit. Ajo lihet e nënkuptuar nga folja *blejmë*.

A. III.4 Analizë krahasuese mbi përdorimin e shenjave të pikësimit

Sistemi i pikësimit në gjuhën shqipe ka ngjashmëri me sistemet e gjuhëve të tjera. Parimi kryesor mbi të cilin mbështeten rregullat e pikësimit është parimi sintaksor. Pikësimi e bën më të qartë strukturën sintaksore për të ndarë fjalitë e periudhat nga njëra-tjetra dhe për të ndarë e veçuar fjalitë në periudhë dhe gjymtyrët e fjalive.

Parimi sintaksor gërshetohet edhe me parimin intonativ. Struktura sintaksore dhe intonacioni bashkekzistojnë si dy mjete me anën e të cilëve organizohet materiali leksikor për të shprehur marrëdhënie të ndryshme kuptimore dhe nuanca të ndryshme.

Më poshtë gjejmë një list të rregullave të pikëzimit në gjuhën shqipe sipas Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:²³⁶

Pika shënon mbarimin e një fjalie të mëvetësishme ose të një periudhe që nuk shqiptohet as me intonacion pyetës apo thirrës. Vihet pikë:

-në fund të një fjalie dëftore

-në fund të një fjalie të varur prej fjalish të varura kryesore dëftore

-në fund të një fjalie të mëvetësishme nxitëse jothirrmore

²³⁶ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Mahir Domi, Menella Totoni, Nikoleta Cikuli, Spiro Floqi, *Rregullat e Pikësimit në Gjuhën Letrare Shqipe*, 1981, fq. 19-22

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

-në fund të një fjalie të mevetësishme dëshirore jothirrmore

-para një lidhëze bashkërenditese ose/dhe para një lidhëze nënrenditëse, duke ndarë kështu në dy pjesë një periudhë për arsye kryesisht stilistikore.

Pikëpyetja shënon përfundimin e një fjalie a të një periudhe që shqiptohet me intonacion pyetës. Përdoret pikëpyetja:

-në fund të një fjalie pyetëse të drejtë

-kur vijnë njëra pas tjetrës disa fjali të mëvetësishme pyetëse

-në fund të një periudhe që mbaron me një fjali pyetëse

-pas fjalive të quajtura “retorike”

Pikëçuditja shënon përfundimin e një fjalie të mëvetësishme apo të një periudhe që shqiptohet me intonacion thirrmore. Pikëçuditja vihet:

-në fund të një fjalie dëftore-thirrmore

-në fund të një periudhe me nënrenditje që ka si fjali kryesore një fjali me karakter thirrmore

-në fund të një periudhe që mbaron me karakter thirrmore

-pas një onomatopeje

-në vend të fjalëve të një bashkëbiseduesi për të shprehur çudinë apo një ndjenjë të shprehur me anë të mimikës.

Presja ndan ose veçon gjymtyrë të një fjalie. Presja përdoret:

-për të ndarë gjymtyrë homogjene si p.sh. kryefjalë, kundrina, përcaktorë, etj. që bashkohen pa lidhëza.

Pikëpresja ndan në mënyrë më të prerë se presja. Ajo përdoret:

-për të ndarë fjali të gjata ose gjymtyrë të zgjeruara, sidomos kur brenda tyre është përdorur presja

-për të ndarë fjali të bashkuara pa lidhëza që zbërthejnë përmbajtje e një fjalie.

Shumëpikëshi tregon që thënia, për arsye të ndryshme, ndërpritet e nuk jepet e plotë. Ai përdoret:

-për të shprehur ndërprerjen e një thënieje kur i lihet lexuesit ta marrë me mend ç’ka dashur të thotë tjetri, kur ndërhyjnë diçka, kur folësi ngurron të thotë diçka, etj.

-në vend të një fjalie apo të një thënieje që nuk duam ta përmendim

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

-në shkurtimet e fjalëve ose të datave të paplota

-në një ligjërim pa vijimësi logjike.

Thonjëzat tregojnë se fjalët e përfshira në të nuk janë të një natyre me pjesën tjetër të tekstit ose përdoren më një kuptim jo të zakonshëm. Thonjëzat përdoren:

-në ligjëratën e drejtë dhe në citime për të veçuar e për të dalluar fjalët që riprodhohen, nga fjalët e autorit

-kur fjalët riprodhohen, formojnë një fjali apo një periudhë dëftore dhe ndodhen pas fjalëve të autorit

-pas shumëpikëshit, kur fjalët që riprodhohen mbarojnë me të

-kur fjalët e autorit ndodhen në mes të fjalëve që riprodhohen, thonjëzat vihen në fillim dhe në fund, në qoftë se pas fjalëve të autorit nuk vihet pikë

-mbyllen në thonjëza fjale me ngarkesë emocionale.

Kllapat shënojnë një pushim të shkurtër si presja dhe shërbejnë për të dalluar, shquar e dalluar një grup fjalësh që shprehin një sqarim.

Dy pikat shënojnë një pushim që zgjat pothuajse sa pikëpresja, por ndryshe prej saj ato kanë një vlerë që japin një shpjegim, një shembull, etj.

Në gjuhën angleze ka disa ndryshime në shenjat e pikësimit. Me poshte theksojmë disa nga keto rregulla të përcaktuara nga Greenbaum dhe Nelson në librin e tyre *An Introducion to English Grammar*:²³⁷

- Në gjuhën angleze përdoret pika jo vetëm në fund të fjalisë por edhe pas shkurtimeve si Mrs., Mr.
- Pikëçuditësja në gjuhën angleze tregon se një fjalë, fraze apo fjali përdoret për të shprehur një emocion.
- Presja vendoset në rastet kur sendet janë të listuara.
- Një vize ndarëse ndihmon për të siguruar një informacion shtesë.
- Shumëpikëshi ose ellipsis na tregon për një hezitim apo mos përfundim të një mendimi.
- Në kllapa vendoset informacioni shtesë apo shpjegimet.
- Apostrofi përdoret në krijimin e emrave që tregojnë pronësi, si dhe për foljet në formë të shkurtuar.

²³⁷ Greenbaum, Sidney & Nelson, Gerald, *An Introducion to English Grammar*, London, Longman Pearson Education, 2002, fq. 34-38

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembujt e mëposhtëm do të shërbejnë si ilustrim i asaj çfarë parathrum më sipër si dhe për të bërë një analizë krahasuese mes versioneve të *The Old Man and the Sea* në gjuhën shqipe duke synuar krahsimin në përdorimin e shenjave të pikësimit:

Shembull 1

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He could only use it effectively with one hand because of the grip of the handle and he took good hold of it with his right hand, lexing his hand on it, as he watched the sharks come. ²³⁸	Plaku mund ta përdorte mirë vetëm me një dorë, nga shkaku i dorezës, dhe tani e kapi fort me dorën e djathtë, duke tundur grushtin, ndërsa vështronte peshkaqenët që po vinin. ²³⁹	Ai mund ta kapte ashtu siç duhet, vetëm me një dorë, atje ku ishte doreza, e mbërthen fort me dorën e djathtë duke vështruar peshkaqenët që po afroreshin. ²⁴⁰

Shembull 2

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
But, thank God, they are not as intelligent as who will kill them; although they are more noble and more able. ²⁴¹	Por lavdi Zotit që peshqit nuk janë aq të mençur sa ne që i vrasim, megjithëse ata janë më fisnikë dhe më të shkathët. ²⁴²	Po shyqyr Zotit, që peshqit nuk janë kaq të mençur sa ne që i vrasim, ndonëse ata janë më fisnikë dhe më të shkathët. ²⁴³

²³⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.97

²³⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.100

²⁴⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.72

²⁴¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.53

²⁴² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.60

²⁴³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.72

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“How old are you? the old man asked the bird. “Is this your first trip?” ²⁴⁴	Sa vjeç je? E pyeti plaku, zogun. Ky është udhëtimi yt i parë? ²⁴⁵	-Sa vjeç je? e pyeti zogun, plaku.–Si duket ky është udhëtimi yt i parë? ²⁴⁶

Në shembullin e parë nuk ka një dallim mes tre varianteve për sa i përket vendosjes së pikës. Ajo që vihet re është përdorimi i presjes që ndryshon nga një version në tjetrin. Në versionin original nuk ka një presje pas pjesës së bashkërenditur të fjalisë, ndërsa në të dy versionet shqip, presja është vendosur sapo ajo mbaron. Në versionin e Kadaresë është vënë presje para fillimit të pjesës së bashkërenditur kundërshtuese, ashtu siç edhe në versionin original. Në rastin e Kokonës, presja nuk vendoset pasi ai ka përdorur një formë të pashtjelluar përcjellore: *duke vështruar*.

Në shembullin e dytë, Kadare nuk ka përdorur presjen në pjesën e parë të fjalisë ashtu siç është në versionin origjinal, ndërsa Kokona e ka përdorur atë pas përfundimit të pjesës së bashkërenditur. Për sa i përket pjesës tjetër të bashkërenditur kundërshtuese, në të dy variantet shqip është përdor presja, ndërsa në atë anglisht pikëpresja duke qenë se në këtë variant presja është përdorur disa herë brenda fjalisë.

Në shembullin e fundit vërejmë se thonjëzat nuk janë përdorur në asnjërin prej versioneve shqip, në ndryshim nga origjinali. Tek version i Kokonës vihet re përdorimi i vijës ndarëse.

B. III. Krahasim përkthimi i *Plaku dhe Deti* nga Ismail Kadare dhe *Plaku dhe Deti* nga Vedat Kokona në rrafshin leksikilogjik

Jani Thomai shkruan: “Leksikologjia është shkencë gjuhësore, që studion fjalët si njësi leksikore si dhe leksikun, pra tërësinë e fjalëve nga ndërtimi, nga kuptimi apo dhe nga shtresëzimi i mundshëm.”²⁴⁷ Në këtë pjesë do të bëhet një analizë, një krahasim përkthimi mbi përzgjedhjen e fjalëve, përkthimin e emrave të përveçëm si dhe mbi anglicizmat. Në pjesën e parë, fokusi do të jetë mbi përzgjedhjen e fjalëve që secili nga përkthyesit ka bërë. Pyetja që ngrihet është a është i njëjtë mesazhi që përcillet në të dy versionet pavarësisht nga përzgjedhja e ndryshme e fjalëve?

²⁴⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.45

²⁴⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.53

²⁴⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq.35

²⁴⁷ Thomai, Jani. *Leksikologjia e Gjuhës Shqipe*. Tiranë, Botimet Toena, 2006

Në pjesën e dytë, fokusi do të jetë mbi përkthimin e emrave të përveçëm. Do të vërejmë mënyrën sesi secili nga përkthyesit ka zgjedhur ta sjellë në shqip, a ka ndryshime të dukshme apo ato janë të papërfillshme. Në pjesën e tretë trajtohen anglicizmat, të cilat janë prezente në të dy versionet, nga ku do të shohim nese autorët janë përpjekur t'i sjellin fjalët “e papërkthyeshme” përmes një shpjegimi apo kanë zgjedhur t'i sjellin pa asnjë ndryshim.

B. III.1 Analizë mbi përzgjedhjen e fjalëve

Në librin e shkruar nga Umberto Eco dhe të sjellë në shqip nga Mariana Ymeri dhe Alketa Ylli mund të veçojmë një nga shprehjet: “Edhe pse e dimë që s’thuhet kurrë e njëjta gjë, mund të thuhet të paktën pothuajse e njëjta gjë.”²⁴⁸ Thënë kjo, është e vështirë që përkthimi të vijë plotësisht siç është në origjinal pasi përkthyesi, i kushtëzuar edhe nga ndryshimet mes gjuhëve dhe kulturave, detyrohet të bëjë ndryshime gramatikore, leksikore dhe stilistike, por sigurisht që qëllimi është përcjellja e mesazhit ashtu siç përcillet në origjinal, pavarësisht këtyre ndryshimeve.

Ka raste kur një fjalë e caktuar nuk mund të arrihet të përkthehet dhe Eco e quan këtë si humbje e cila mund të quhet absolute. Sipas tij këto janë rastet kur përkthyesi përdor mundësin e fundit, pra vendos një shënim në fund të faqes dhe ky shënim në fund të faqes vulos një herë e mirë humbjen e tij. Një shembull i humbjes absolute na vjen nga lojërat e shumta të fjalëve të cilat ndonjëherë, për shkak të ndryshimeve kulturore janë të papërkthyeshme.²⁴⁹

Ndonjëherë, humbjet edhe mund të kompensohen.²⁵⁰ Me këtë frazë të Ekos (Eco) mund të kuptojmë se është e vërtetë që mund të humbasim pjesë gjatë përkthimit, por ama ka raste kur përkthyesi, përmes zgjedhjes së fjalëve bën të mundur që të kompensojë humbjen e tij.

“Ka përkthime që e pasurojnë në mënyrë të mrekullueshme gjuhën në të cilën përkthehet dhe se në disa raste, arrijnë të thonë më shumë se origjinali”, shprehet Eko në librin e tij. Por zakonisht kjo gjë ka të bëjë pikërisht me veprën që realizohet në gjuhën e përkthimit. “Një përkthim që arrin “të thotë më shumë”, mund të jetë një vepër e shkëlqyer në vetvete, por nuk është një përkthim i mirë, pasi të përkthesh veprën e dikujt tjetër dhe të krijosh versionin tënd janë dy gjëra të ndryshme.” shkruan Eko.²⁵¹

Ndërkohe Nida përshekruan “qasje të ndryshme shkencore për kuptimin” të lidhura me punën që ishin realizuar nga teoricienët në semantikë dhe pragmatikë. Qendrore për veprën e Nidas është largimi nga ideja e vjetër që një fjalë ortografike ka një kuptim të caktuar dhe afrimi drejt një përkufizimi funksional të kuptimit në të cilin një fjalë

²⁴⁸ Eco, Umberto, *Të thuash gati të njejtën gjë*, Përkth. Mariana Ymeri & Alketa Ylli, Tiranë, 2006, fq.10

²⁴⁹ Po aty, fq.100

²⁵⁰ Po aty, fq.113

²⁵¹ Po aty, fq. 117

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

"përvetëson" kuptimin përmes kontekstit të saj dhe mund të prodhojë përgjigje të ndryshme sipas kulturës.²⁵²

Jeremy Munday në veprën e tij *Introducing Translation Studies* thekson “Kuptimi është zbërthyer në kuptimin gjuhësor (elementët huazues të modelit Chomsky), kuptimi referencial (kuptimi 'fjalor' kuptimplotë) dhe kuptimi emocional (ose konotativ).”²⁵³

Një seri teknikash, të adaptuara nga puna në gjuhësi, paraqiten si një ndihmë për përkthyesin në përcaktimin e kuptimit të objekteve apo dukurive të ndryshme gjuhësore. Teknika për të përcaktuar kuptimin referues dhe emocional përqendrohet në analizimin e strukturës së fjalëve dhe diferencimin e fjalëve të ngjashme në fushat leksikore të ndërlidhura. Këto përfshijnë strukturimin hierarkik, i cili diferencon seritë e fjalëve sipas nivelit të tyre dhe teknikave të analizës komponentiale.

Në përgjithësi, Munday thekson se teknikat e analizës komponentiale janë propozuar si një mënyrë për të sqaruar paqartësitë, sqarimin e pasazheve të paqarta dhe identifikimin e dallimeve kulturore. Ato mund të shërbejnë si një pikë krahasimi midis gjuhëve dhe kulturave të ndryshme.²⁵⁴

Më poshtë janë marrë disa shembuj nga libri original si dhe dy versionet e përkthyer të tij:

Shembull 1

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“Thank you. You make me happy. I hope no fish will come along so great that he will prove us wrong.” ²⁵⁵	-Të faleminderit. Më gëzon me këtë që thua. Shpresoj se nuk do të zë ndonjë peshk aq të madh, sepse kjo do të provonte të kundërtën. ²⁵⁶	-Të faleminderit. Gëzohem që ke një mendim të tillë për mua. Besoj se ska peshk aq të madh sa të provojë se ne e kemi gabim. ²⁵⁷

²⁵² Nida, E., *Towards a Science of Translating*. Leiden: Brill, 1964, fq. 33

²⁵³ Munday, Jeremy, *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq.38

²⁵⁴ Munday, Jeremy, *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq.39

²⁵⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.17

²⁵⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.28

²⁵⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 15

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He had no longer dreamed of storms, nor of women, nor of great occurrences, nor of great fish, nor fights, nor contests of strength, nor of his wife. ²⁵⁸	Ai nuk shihte më në ëndërr, as furtuna, as gra, as ngjarje të mëdha, as peshq të mëdhenj, as përlëshje, as gara mundjesh, as gruan e tij. ²⁵⁹	Në ëndërr ai tani nuk shihte as stuhi, as gra, as ngjarje të mëdha, as peshk të madh, as përlëshje, as mundje, as edhe të shoqen. ²⁶⁰

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
When they reached the old man's shack the boy took the rolls of line in the basket and the harpoon and gaff and the old man carried the most with the furled sail on his shoulder. ²⁶¹	Kur arritën kasollen e plakut, djali mori lëmshet me fill, futur në një shportë, dhe kanxhën me fuzhinjën. ²⁶²	Kur erdhën në kasollen e plakut djali mori shportën me lëmshet e tojës, kamaqen dhe kallamin me grep në majë, kurse plaku vuri në sup direkun me pëlhurën e mbështjellë rreth tij. ²⁶³

Në shembullin e parë vërejmë se nuk ka ndryshime të mëdha për sa i përket zgjedhjes së fjalëve. Pjesa më e madhe e fjalëve janë të njëjta dhe ndryshojnë vetëm në formë si p.sh përdorimi i shumësit nga Kadare *peshq të mëdhenj* dhe njëjësit nga Kokona *peshk të madh* i cili, në këtë aspekt, i qëndron besnik origjinalit, Kemi gjithashtu përdorim të sinonimeve kur Kadare e përkthen duke mos dalë jashtë kornizave të origjinalit kur *hope* e përkthen si shpresoj, ndërsa Kokona e sjell si *besoj*. “...will prove us wrong” përkthehet pa pësuar asnjë ndryshim nga Kokona, ndërsa Kadare zgjedh fjalë të tjera për ta përkthyer.

²⁵⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, pg. 19

²⁵⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq.29

²⁶⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 17

²⁶¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, pg. 20

²⁶² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 30

²⁶³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 17

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Në shembullin e dytë shohim gjithashtu disa ndryshime në formë, tek numri i emrave. Diçka tjetër që vërejmë është se Kadare zgjedh ta përkthejë *contests of strength* pa bërë asnjë ndryshim, ndërsa Kokona e thjeshtëzon duke e përkthyer si *mundje* pa shtuar fjalën *garë*. Ndërsa emrin *wife* Kokona zgjedh ta përkthejë si *të shoqen* dhe jo *gruan* siç ka bërë Kadare.

Në shembullin e tretë vërejmë se përkthyesit kanë përdorur fjalë të ndryshme për të sjellë të njëjtën gjë në gjuhën shqipe. Në pjesën e nënrenditur kohore vërejmë se ata kanë përdorur dy sinonime për të përkthyer *reached*. Fjala *line* është përkthyer si *tojë* nga Kokona dhe *fill* nga Kadare. Kokona ka zgjedhur të përdorë një fjalë më specifike që lidhet me peshkimin, ndërsa Kadare e ka përkthyer me një fjalë më të përgjithshme. Fjala *tojë*, sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, është një fill i gjatë, me një grep në fund, i lidhur në kallam që përdoret për të zënë peshk.²⁶⁴

Në këtë shembull shohim se Kadare ka zgjedhur ta shkurtojë fjalinë dhe të përdorë fjalë më specifike që lidhen me peshkimin, ndërsa Kokona e ka sjellë atë në një version shumë të përafërt me origjinalin duke përdorur fjalë më të përgjithshme, në ndryshim nga sa kanë vepruar me pjesët që përmendëm më lart. Fjala *harpoon*, në fjalorin e Pavli Qesku-t, është përkthyer si *fuzhinjë*²⁶⁵. Kjo fjalë shpjegohet në këtë formë në Fjalorin e Gjuhës së sotme shqipe: “mjet peshkimi në trajtën e një sferkës me bisht të gjatë e me gremç në majë.” Pikërisht në këtë mënyrë e ka përkthyer Kokona si *kallam me grep në majë*.

Më poshtë do të trajtojmë disa shembuj të tjerë duke i analizuar nisur nga zgjedhja e fjalëve:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He fitted the rope lashings of the oars onto the thole pins, and, leaning forward against the thrust of the blades in the water, he began to row out of the harbor in the dark. ²⁶⁶	Ai vendosi litarët, duke lidhur lopatat në kunjat, dhe, pasi i dha trupit përpara, filloi të voziste, duke e nxjerrë barkën nga limani në errësi. ²⁶⁷	Vari lavarin e lopatës në kunjën e guzhmes dhe, duke i dhënë trupit përpara, zuri ta nxjerrë varkën nga limani në errësi. ²⁶⁸

²⁶⁴ M.fjalori.shkenca.org

²⁶⁵ Qesku, Pavli, *Fjalor Anglisht-Shqip*, Tiranë, Botime Edfa, 2005, fq.171

²⁶⁶ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq.21

²⁶⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 31

²⁶⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, pg. 18

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Here there were concentrations of shrimp, and bait fish and sometimes schools of squid in the deepest holes and these rose close to the surface at night where all the wandering fish fed on them. ²⁶⁹	Këtu mblidhen karavidhet dhe peshqit e vegjël dhe disa herë molusqet, në thellësitë më të mëdha, dhe natën ngjiten në sipërfaqe ku i hanë peshqit endacakë. ²⁷⁰	Këtu grumbullohen tufat e mëdha të karavidheve të vogla dhe të peshqve të vegjël, kurse në thellësitë më të mëdha, grumbullohen herë-herë një mori butakësh; natën ata ngjiten në faqen e detit dhe shërbejnë si ushqim për të gjithë peshqit endacakë. ²⁷¹

Në shembullin e parë shohim disa ndryshime në zgjedhjen e fjalëve që ka bërë secili nga përkthyesit. Kadare, në këtë shembull, ka vendosur të përktheje me fjalë më të përgjithshme mjetet e peshkimit, kurse Kokona përkthen me fjalë më specifike. Vërejmë një ndryshim në mënyrën sesi është përkthyer *row out*. Kadare ka përdorur foljen *nxjerr*, ndërsa Kokona e përkthen si *vozis*, një fjalë kjo më specifike për lundrimin. Për sa i përket ndryshimeve të tjera në këtë fjali, ato nuk janë shumë të mëdha pasi janë sinonime që nuk përbëjnë ndonjë ndryshim nga ana kuptimore.

Në shembullin e dytë, vërejmë se *concentrations* përkthehet si *mblidhen/grumbullohen*, fjalë të cilat mund të konsiderohen sinonimike. *Squid* është përkthyer thjesht si *molusqet* nga Kadare dhe *një mori butakësh* nga Kokona. Këto dy fjalë janë sinonime të njëra tjetrës. Sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, fjala *molusk* përdoret për t’iu referuar “një lloj gjallese me trup të butë, pa skelet dhe të mbuluar me një cipë të qullët që jeton në ujëra të kripura dhe të ëmbla.”²⁷² Si sinomin jepet fjala butak. Kështu, përkthyesit i kanë qëndruar besnik origjinalit në përkthim e kësaj fjale.

Ndërsa po ta marrim të gjithë shprehjen idiomatike *schools of squid* vërejmë se Kadare nuk e ka përkthyer pjesën e parë dhe ka sjellë në shqip vetëm fjalën *molusk*, ndërsa Kokona e ka përkthyer si *mori butakësh*. Ai ka përdorur fjalën *mori* dhe nuk e ka përkthyer shprehen fjalë për fjalë duke qenë se kemi të bëjmë me një shprehje idiomatike.

²⁶⁹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 22

²⁷⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 32

²⁷¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 19

²⁷² www.fjalorishqip.com

B. III.2 Përkthimi i emrave të përveçëm

Emrat e përveçëm, të cilët përcaktohen nga Richards si "emrat e një personi të caktuar, vendi ose sendi" dhe janë shkruar "me shkronjë të madhe", luajnë një rol thelbësor në një vepër letrare. Ata mund t'i referohen pozicionit, statusit shoqëror dhe kombësisë së personazheve dhe vërtet kërkojnë vëmendje kur përkthehen në një gjuhë të huaj.²⁷³

Sipas fjalorit të gjuhës shqipe, emri është një fjalë e ndryshueshme që tregon frymorë, objekte, pjesë përbërëse të tyre, dukuri të natyrës, koncepte abstrakte etj dhe sipas kuptimit leksikor dy ndarjet e emrave janë: a) emra të përgjithshëm dhe të përveçëm b) emra konkretë dhe abstraktë. Emrat e përveçëm tregojnë një njeri, një kafshë apo një gjë të veçantë, të dalluar nga gjërat e tjera të të njëjtit lloj.²⁷⁴

Kur bëhet fjalë për përkthimin e emrave të përveçëm, përkthyesi mund të zgjedhë t'i ruajë ato siç janë apo t'i përkthejë. Kjo zgjedhje përcaktohet nga fakti se çfarë do të përcjellë përkthyesi në gjuhën e përkthimit dhe çfarë sugjeron teksti i origjinalit. Duke konsideruar disa nga shembujt që kemi zgjedhur të paraqesim më poshtë vërejmë se përkthyesi ka vendosur t'i përkthejë dhe arsyeja është se ata nuk mbartin ndonjë kuptim të veçantë përveç emërimit. Këto emra nuk përmbajnë ndonjë kuptim të fshehur në vetvete.

Duke i përkthyer ata, përkthyesi ia ka dalë të përkthejë me lehtësi nga anglishtja në shqip duke bërë të mundur që lexuesi shqiptar të marrë idenë e njëjtë të shqiptimit të emrave, ashtu siç e merr dhe lexuesi në gjuhën angleze.

Ka raste kur përkthimi është si në origjinal, por kemi dhe raste kur emri lakohet sipas rasave të gjuhës shqipe. Ka edhe raste të shkrimit apo formës fonetike, pra emri vjen në gjuhën e përkthimit duke iu përshtatur formës fonetike të gjuhës shqipe si p.sh: Gulf Stream²⁷⁵-Gul strim²⁷⁶-Golfstrim²⁷⁷

Emrat e përveçëm përbëjnë një nga pjesët më të debatueshme në teorinë dhe praktikën e përkthimit. Ata shërbejnë për të identifikuar një element konkret. Për të dalluar këta emra përdoret kriteri referencial dhe ai semantik. Emrat e përveçëm mund të konsiderohen si “etiketa” identifikuese, por që janë semantikisht boshe.²⁷⁸

Nga ana tjetër, siç vë në dukje dhe Njumarku (Newmark), ky grup fjalësh mund të kërkojë një njohje kulturore apo enciklopedike, pavarësisht se nuk kanë një kuptim gjuhësor, prandaj edhe nuk përfshihen në fjalor, por në një enciklopedi.²⁷⁹

Sipas Newmark: “... qoftë emrat e përveçëm, qoftë edhe termat kulturorë u referohen personave, objekteve apo proceseve të një komuniteti të vetëm etnik, por ndërsa të parët

²⁷³ Richards, et al, Longman dictionary of applied linguistics. UK: Longman, 1985, fq. 68

²⁷⁴ Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Eneida Pema, *Gjuha Shqipe*, Botime Pegi, Tirane, 2017, fq. 182

²⁷⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 5

²⁷⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 17

²⁷⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 7

²⁷⁸ Revistë shkencore e Institutit Alb-Shkenca, *Aktet*, Vol. v, nr. 4, 2012 fq. 699

²⁷⁹ Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 201

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

kanë referent individualë, të dytët u referohen klasave. Teorikisht, emrat e personave apo objekteve të veçanta janë “të jashtme” në lidhje me gjuhën, u përkasin enciklopedive dhe jo fjalorëve, prandaj janë të papërkthyeshëm dhe nuk duhen përkthyer.”²⁸⁰

Si rezultat, kur flasim për emra të përveçëm me ngarkesë semantike, në rastet kur konotacionet dhe kombësia e emrave janë të rëndësishme, atëherë Njumarku propozon si strategji që të përkthehet fillimisht përmbajtja e emrit dhe më pas të natyralizohet përkthimi.

Për më tepër, sipas tij për sa u përket toponimeve, mund të themi se strategjia kryesore është ajo e përshtatjes ortografike për toponimet konvencionale dhe përdorimi i emrit zyrtar për toponimet që tashmë ekzistojnë në gjuhën e përkthimit.²⁸¹

Më poshtë do të japim disa shembuj ilustrues mbi mënyrën sesi janë përkthyer në gjuhën shqipe emrat e përveçëm në *Plaku dhe Deti* i Kadaresë dhe i Kokonës:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He was an old man who fished alone in a skiff in the <u>Gulf Stream</u> ... ²⁸²	Ai ishte një plak që peshkonte i vetëm mbi <u>Gulf Strim</u> ... ²⁸³	Ishte një plak që gjuante peshk fill i vetëm në varkën e tij në <u>Golfstrim</u> ... ²⁸⁴

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
...to the fish house where they waited for the ice truck to carry them to the market in <u>Havana</u> ²⁸⁵	...në depon e peshkut, ku ata prisnin autofrigoriferë që do t'i çonin në breg të <u>Havanës</u> ²⁸⁶	...në depon e peshkut, ku prisnin kamionin e frigoriferit për t'i shpënë në pazarin e <u>Havanës</u> ²⁸⁷

²⁸⁰ Po aty, fq. 203-204

²⁸¹ Po aty, fq. 205-206

²⁸² Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 5

²⁸³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 17

²⁸⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 7

²⁸⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 7

²⁸⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 19

²⁸⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 8

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“ <u>Santiago</u> ,” the boy said. ²⁸⁸	- <u>Santjago</u> , tha djali. ²⁸⁹	- <u>Santiago</u> , -tha djali. ²⁹⁰

Në shembullin e parë vërejmë se Kadare e përkthen pjesën e parë të emrit pa bërë asnjë ndryshim, kurse në pjesën e dytë i përmbahet formës fonetike të gjuhës shqipe. Kokona zgjedh ta bashkojë të gjithë emrin duke e sjellë atë në një të vetëm. Ai e sjell atë në një formë të përshtatshme fonetike për gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë, ai i largohet versionit original më shumë sesa Kadare.

Në shembullin e dytë, emri vjen në shqip i lakuar në rasën gjinore në të dy rastet. Përkthyesit u janë përshtatur rregullave gramatikore të gjuhës shqipe, të cilat janë të ndryshëm nga ato të gjuhës angleze.

Në shembullin e tretë vërejmë një ndryshim tepër të vogël. Kadare e zëvendëson zanoren *i* me një bashkëtingëllore, ndërsa Kokona ka vendosur mos t’a ndryshojë atë dhe si rezultat emri nuk ka pësuar asnjë ndryshim: *Santiago-Santjago-Santiago*.

Ka dhe disa raste të përkthimit të emrave të besimit dhe te skuadrave të cilat do t’i shohim më poshtë dhe do të vërejmë se cilat janë ndryshimet që kanë pësuar:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
On the brown walls of the flattened, overlapping leaves of the sturdy-fibred guano there was a picture in the colour of the <u>Sacred Heart of Jesus</u> and another of the <u>Virgin of Cobre</u> ²⁹¹	Në muret ngjyrë kafe, të thurura me gjethe të dendura dhe me fibra guanos, ishin vënë piktura me ngjyra, njëra <u>zemra e shenjtë e Jezuit</u> dhe tjetra <u>Shën Mëria e Virgjër e Kobres</u> . ²⁹²	Muret e murrmë, që ishin ndërtuar me gjethe të shtypura fije-fije, ishin zbukuruar me oleografi me ngjyra të <u>Zemrës së Krishtit</u> dhe të <u>Zonjës së Kobrenit</u> . ²⁹³

²⁸⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 7

²⁸⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 19

²⁹⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 8

²⁹¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 10-11

²⁹² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 22

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
<p><u>Hail Marys</u> are easier to say than <u>Our Fathers</u>, he thought. “<u>Hail Mary full of Grace the Lord</u> is with thee.”²⁹⁴</p>	<p><u>Lutjen e Shën Mërisë</u> është me e lehtë ta thuash se <u>Ati Ynë</u>, mendoi.</p> <p>- <u>O Shën Mëri e bekuar, Zoti</u> qoftë me ty.²⁹⁵</p>	<p>Është më lehtë të thuash lutjen e <u>Shënmërisë</u> se sa lutjen “<u>Ati Ynë</u>”, mendonte ai.</p> <p>- <u>O hirplota Zonja Shënmëri, Zoti</u> është me ty.²⁹⁶</p>

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
<p>“<u>The Yankees</u> cannot loose. But I fear the <u>Indians of Cleveland</u>. Think of the <u>Great Di Maggio</u>. I fear both the <u>Tigers of Detroit</u> and the <u>Indians of Cleveland</u>. Be careful or you will fear the <u>Reds of Cincinnati</u> and the <u>White Sox of Chicago</u>.”²⁹⁷</p>	<p><u>Jankit</u> s’mund të humbasin. Ua ka frikën <u>Indianëve të Kllivlendit</u>. Kujto të <u>madhin Di Maxhio</u>. Ua kam frikën “<u>Tigrave</u>” të <u>Detroitit</u> dhe “<u>Indianëve</u>” të <u>Kllivlendit</u>. Mos trembesh së shpejti edhe nga <u>Lëkurëkuqtë e Xinxitatit</u> dhe <u>Corapet e Bardha të Cikagos</u>.”²⁹⁸</p>	<p>“<u>Jankit</u> s’munden. Kam frikë nga “<u>Indianët</u>” e <u>Kllivlendit</u>. Sill ndërmend <u>Di Maxhion e madh</u>. Frikën ua kam <u>Tigrave të Detroitit</u> dhe <u>Indianëve të Kllivlendit</u>. Shiko mirë se mos kesh frikë edhe nga “<u>Të Kuqtë</u>” e <u>Cincinnati</u> dhe nga “<u>të Bardhët</u>” e <u>Cikagos</u>.”²⁹⁹</p>

²⁹³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 11

²⁹⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 54-55

²⁹⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 61

²⁹⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 42

²⁹⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 12

²⁹⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 24

²⁹⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 12

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 4

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
In the other league, between <u>Brooklyn</u> and <u>Philadelphia</u> I must take <u>Brooklyn</u> . But then I think of <u>Dick Sisler</u> and those great drives in the old park. ³⁰⁰	Në skuadrat e tjera, midis <u>Bruklini</u> t dhe <u>Filadelfisë</u> , duhet të fitojë <u>Bruklini</u> . Mu kujtua <u>Dik Sajzllëri</u> kur shutonte në parkun e vjetër. ³⁰¹	Në lidhjen tjetër, midis <u>“Bruklinit”</u> dhe <u>“Filadelfias”</u> , unë zgjedh <u>“Bruklinin”</u> . A të kujtohet sesi godiste <u>Dik Sajzleri</u> ? ³⁰²

Në shembullin e parë, Kadare i ka përkthyer në gjuhën shqipe emrat e përveçëm dhe në ndryshim nga origjinali ai nuk e ka shkruar me shkronjë të madhe *Sacred Heart* por thjesht si *zemra e shenjtë*. Kokona po ashtu i ka përkthyer, por i ka qëndruar besnik vendosjes së shkronjës së madhe. Ai ka bërë një ndryshim të vogël duke mos e përkthyer fare mbiemrin *sacred*. Një ndryshim që mund të vërehet në të dy versionet është dhe përkthimi i *Virgin of Cobre* ku secili ka sjellë një version të ndryshëm. Kadare e ka përkthyer si *Shën Mëria e Virgjër*, ndërsa Kokona si *Zonja*. Emri i përveçëm *Cobre* është sjellë i lakuar në rasën gjinore në të dy versionet. Ajo çfarë ndryshon është vetëm forma fonetike e secilit rast.

Në shembullin e tretë kemi të bëjmë me përkthim të emrave të skuadrave. *Yankees* është përkthyer në të dy versionet duke iu përshatur formës fonetike shqipe dhe duke e lakuar emrin në rasën emërore: *Jankit*. *Indians of Cleveland dhe Tigers of Detroit* janë përkthyer në të njëjtën mënyrë. Kadare e ka përkthyer si *Indianëve të Klivlendit* ndërsa Kokona si *“Indianët” e Klivlendit*, kurse shembulli i dytë nuk ka pësuar asnjë ndryshim. Pra ndryshimi i vetëm është rasi në të cilën janë lakuar si dhe fakti që Kadare ka përdorur shkonjën “ll”, ndërsa Kokona “l”. *The Great Di Maggio* vjen në shqip si *Di Maxhio i madh* pa asnjë lloj ndryshimi nga njëri-tjetri.

Në këtë shembull mund të vërejmë se ka dhe disa ndryshime tek mënyra sesi secili nga përkthyesit e ka sjellë në shqip. Kadare e ka përkthyer si *Lëkurëkuqtë e Xinxitatit*, duke dhënë një farë informacioni mbi skuadrën, ndërsa Kokona zgjedh t’ a përkthejë thjeshtë si *“Të Kuqtë”*. Të njëjtën gjë shohim edhe tek *White Sox of Chicago* i cili përkthehet nga Kadare si dhe *Corapet e Bardha të Cikagos* duke bërë këtu një përkthim fjalë për fjalë, ndërsa Kokona vepron si në shembullin e mësipërm duke e përkthyer thjesht si *“të Bardhët” e Cikagos*. Shteti është përkthyer duke iu përshtatur formës fonetike të gjuhës shqipe: *Brooklyn-Bruklinin-Bruklinin*.

³⁰⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 14

³⁰¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 27

³⁰² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 14

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Në shembullin e fundit kemi të bëjmë me përkthim të emrave të vendeve dhe njerëzve. Po të bëjmë një krahasim të përkthimeve vërejmë se ato janë përkthyer në të njëjtën mënyrë në të dy versionet. Si Kadare, ashtu dhe Kokona i sjellin këto duke iu përshtatur formës fonetike të shqipes. I vetmi ndryshim qëndron tek lakimi i këtyre emrave duke qenë se secili e ka sjellë fjalinë në një formë paksa të ndryshme nga njëri-tjetri.

B.III .3 Anglicizmat

Fjalët e huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe në rrjedhë të kohërave deri në ditët e sotme me veçoritë e tyre specifike në dy pjesë kryesore të leksikut: në leksikun e përgjithshëm dhe në atë terminologjik.

Në fjalorin Macmillan anglicizmat përkufizohen kështu: “Është një fjalë nga një gjuhë që përdoret në një gjuhë tjetër pa u ndryshuar.”³⁰³

Ka raste kur në një gjuhë të caktuar mungon një term dhe ai huazohet nga një gjuhë tjetër pa pësuar asnjë lloj ndryshimi. Ata quhen “loan words”. Këto fjalë përkufizohen si “fjalë të cilat përdoren në rastet kur termi mungon në gjuhën e përkthimit, p.sh .: kompjuteri, mausi, futboll etj, dhe këto fjalë përdoren gjithashtu për të prezantuar një ngjyrë lokale.”³⁰⁴

Me poshtë do të trajtohen disa shembuj të marrë nga libri “The Old Man and the Sea” si dhe të dy versioneve të tij të përkthyer:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Go and play <u>baseball</u> . ³⁰⁵	Shko të luash <u>bejsboll</u> . ³⁰⁶	Shko dhe luaj <u>bejzboll</u> . ³⁰⁷

³⁰³ William, D. Halsey, Macmillan Dictionary, Macmillan Publishing Company, New York, 1986, pg. 885

³⁰⁴ Po aty

³⁰⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, pg. 7

³⁰⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 19

³⁰⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 9

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
At least he carried <u>lists</u> of horses at all times in his pocket and frequently spoke the names of horses on the telephone. ³⁰⁸	Gjithmonë xhepat i kishte të mbushur me <u>programet</u> e kuajve dhe shpeshherë i thoshte emrat e kuajve në telefon. ³⁰⁹	I mbante gjithmonë në xhep <u>programet</u> e vrapimeve me kuaj dhe i thërriste emrate kuajve me telefon. ³¹⁰

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He was a great <u>manager</u> . ³¹¹	Ai ishte një <u>trajner</u> i madh. ³¹²	Ish <u>trajner</u> i madh. ³¹³

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
An <u>aeroplane</u> passed overhead on its course to Miami and he watched its shadow scaring up the schools of flying fish. ³¹⁴	Një <u>aeroplan</u> kaloi mbi kokën e tij drejt Majamit, dhe plaku vuri re sesi hija e tij trembi një tufë me peshq fluturues. ³¹⁵	Atje lart në qiell, mbi kokën e tij, fluturoi <u>aeroplani</u> që shkonte për Majami dhe plaku pa se hija e <u>aeroplanit</u> trembi dhe ngriti lart në erë një tufë peshqish fluturues. ³¹⁶

³⁰⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 16-17

³⁰⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 28

³¹⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 15

³¹¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 17

³¹² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 28

³¹³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 15

³¹⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 60

³¹⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 66

³¹⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 46

Në shembullin e parë kemi të bëjmë me një fjalë e cila nuk ekziston në gjuhën shqipe pasi *bejsbolli* është një lloj sporti që nuk praktikohet në shqipëri. Kjo fjalë është dhe një lloj treguesi kulturor pasi nuk i përket të gjitha vendeve dhe është e veçantë. Vërejmë se të dy përkthyesit e kanë përkthyer në të njëjtën mënyrë, pra duke e lënë ashtu siç është me një ndryshim të vogël në strukturën fonetike. Fjalë të tilla janë të papërkthyeshme dhe përkthyesi është në njëfarë mënyre “i detyruar” të veprojë kështu.

Në shembullin e dytë vërejmë se fjala *list* është përkthyer në të dy rastet si *program* një fjalë kjo e cila përdoret në këtë formë edhe në gjuhën angleze, pra nga forma fonetike nuk kanë asnjë ndryshim, Kjo fjalë, sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe përkufizohet si “tërësia e detyrave dhe e punëve të parashikuara për t’u plotësuar; një plan që parashikon punë apo veprimtari; përmbledhje e shkurtër etj. Pra në një farë mënyrë përkthyesit kanë dal pak jashtë nga kuptimi i drejtëpërdrejtë i fjalës *list*.

Në shembullin e tretë kemi po ashtu të njëjtën situatë si më sipër kur përdoret një tjetër fjalë e huazuar. Në fjalor, fjalën *trajner* e gjejmë të përkufizuar kështu: “Sportist i përgatitur dhe me përvojë, që ka për detyrë të stërvitë një skuadër futbollit, basketbollit, etj dhe ta përgatisë atë për ndeshje. Kadare dhe Kokona kanë zgjedhur një fjalë që është specifike për të folur mbi një drejtues sporti, jo thjesht si manaxher, që është një person që mund të drejtojë dhe një biznes.

Në shembullin tjetër kemi nënvizuar fjalën *aeroplan*. Kjo fjalë, në versionet shqip, ka pësuar vetëm një ndryshim të vogël të formës fonetike pasi përkthyesit kanë vendosur ta lënë ashtu siç është duke qenë se në gjuhën shqipe nuk ka një tjetër term që mund ta zëvendësojë. Nëqoftëse do t’i referohemi fjalorit, përkufizimi që i bëhet kësaj fjale është ky: “Mjet fluturues më i rëndë se ajri, zakonisht me krahë, që punon me motor dhe që përdoret për udhëtime, për qëllime ushtarake, etj.” Pra, përkthyesit nuk e shpjegojnë me fjalë se çfarë është një aeroplan, por thjesht vendosin ta përkthejnë atë pa ndryshime pasi kështu është mësuar edhe lexuesi duke qenë se nuk ka një tjetër mundësi zgjedhjeje.

Shembujt e mëposhtëm do të jenë gjithashtu shembuj ilustrues sesi ka fjalë të cilat nuk mund të përkthehen apo që përkthyesit, për motive të ndryshme kanë zgjedhur të mos i përkthejnë ato:

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
...when he had played the hand game with the great <u>negro</u> from Casablanca. ³¹⁷	...sesi njëherë në një tavernë të Kasablankës kishte bërë mundje me një <u>negër</u> të madh... ³¹⁸	...kur ishte mundur një herë me një zezak të fortë nga Senfuegosii.. ³¹⁹

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
...and the bird now dropping and dipping into the bait fish that were forced to the surface in their <u>panic</u> . ³²⁰	...dhe zogu zhytej tani dhe binte mbi peshqit e vegjël që dilnin në sipërfaqe në <u>panik</u> e sipër. ³²¹	...kurse fregati kridhej në det, kapte peshkun e vogël që dilte në sipërfaqe nga <u>frika</u> që kishte nga tonot. ³²²

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He commenced to say his prayers <u>mechanically</u> . ³²³	Plaku filloi të thoshte lutjen në mënyrë <u>mekanike</u> . ³²⁴	Plaku zuri të thotë lutjen <u>mekanikisht</u> . ³²⁵

³¹⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 58

³¹⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 64

³¹⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 44

³²⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 30

³²¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 40

³²² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 25

³²³ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 54

³²⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 61

³²⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 41

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Sometimes he would be so tired that he could not remember the prayer and then he could say them fast so they could come automatically. ³²⁶	Nganjëherë ndihej kaq i rraskapitur, saqë harronte fjalët, dhe ahëre ai I thoshte ato shumë shpejt, në mënyrë që t'i kujtoheshin automatikisht. ³²⁷	Herë-herë e ndiente veten kaq të lodhur, sa s'i kujtoheshin fjalët dhe, atëherë, mundahej t'i thoshte sa më shpejt që t'ish e mundur, kështu që fjalët t'i vinin <u>vetvetiu</u> . ³²⁸

Në shembullin e parë shohim që fjala *negro* nuk është përkthyer në versionin e Kadaresë, por thjesht ka përshtatje të formës fonetike. Negër është një formë paksa e zbutur të thëni të fjalës *zezak*. Pra mund të vijmë në një përfundim se Kadare ka dashur të ruajë njëfarë etike duke mos përdorur një fjalë e cila mund të konsiderohet si “përcmuese”.

Ndërsa kur shohim shembullin e Kokonës vërejmë se ai ka bërë të kundërtën duke e përkthyer fjalën nga anglishtja dhe e ka sjellë atë si *zezak*. Pra, mund të themi se nuk ka marrë parasysh faktin sesi mund të interpretohet kjo fjalë, por thjesht ka zgjedhur ta përkthejë duke i qëndruar besnik origjinalit.

Edhe në shembullin e dytë kemi të njëjtën situatë, Kadare e sjell termin si në versionin original duke mos e përkthyer fjalën *panic*, por thjesht duke e përshtatur atë me formën fonetike të gjuhës shqipe. Kokona bën përsëri të kundërtën duke zgjedhur ta përkthejë fjalën dhe të përdorë një fjalë shqipe, *frikë*.

Në shembullin e tretë, shohim se nuk ka ndryshim në përkthim. Kokona dhe Kadare kanë zgjedhur ta lënë termin ashtu siç është pa pësuar ndonjë ndryshim shumë të dukshëm. Në fjalorin e gjuhës shqipe, fjala mekanike përkufizohet kështu: “fig. diçka që bëhet në mënyrë të pavullnetshme, në mënyrë të pavetëdijshme.” Pra, në shqip ka mënyra sesi mund të përkthet kjo fjalë, ama të dy përkthyesit e kanë menduar si më të arsyeshme mos ta përkthejnë atë.

Në shembullin e fundit kemi përseëri një tendencë të Kadares për të mos zëvendësuar fjalën e gjuhës angleze me një fjalë shqip. Ai, ashtu siç ka bërë dhe në shembujt e sipërpërmendur, thjesht ka bërë një përshtatje fonetike duke e përkthyer fjalën *automatically* si *automatikisht*. Ndërsa Kokona e ka përkthyer këtë fjalë si *vetvetiu*, e cila

³²⁶ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 54

³²⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 61

³²⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 41-42

është një fjalë e gjuhës shqipe. Në fjalor kjo fjalë përkufizohet si “pa u menduar, pa vetëdije”, pra kuptimi është ai që ka zgjedhur Kokona.

Pasi kemi marrë në konsideratë disa shembuj ilustrues nga libri original dhe dy versionet e përkthyer do të vijmë në disa përfundime gjithmonë duke u bazuar në shembujt e analizuar më sipër. Nëqoftëse do të bëjmë një krahasim të përgjithshëm, në lidhje me mënyrën sesi secili nga përkthyesit ka zgjedhur të sjellë fjalët nga gjuha origjinale në gjuhën e përkthimit mund të vijmë në përfundimin se në rastet kur termi mungon në gjuhën shqipe, të dy përkthyesit zgjedhin alternativën e vetme. Kjo alternativë është mospërkthimi i fjalëve si pasojë e asaj që në anglisht quhet “linguistic gap”, pra mungesë e termit në gjuhën e përkthimit.

Po të marrim pastaj rastet kur fjala është e përkthyeshme vërejmë se Kadarare zgjedh të mos e përkthejë fjalën dhe të ruaj origjinalin, ndërsa Kokona e përkthen atë duke përdorur fjalën në gjuhën shqipe që është e barazvlefshme me atë të gjuhës angleze.

C. III Krahasim përkthimi i *Plaku dhe Deti* nga Ismail Kadare dhe *Plaku dhe Deti* nga Vedat Kokona në rrafshin stilistikor

Në këtë pjesë do të fokusohemi më tepër mbi aspektin stilistikor të veprës duke bërë dhe një krahasim mbi mënyrën sesi secili nga përkthyesit e ka sjellë veprën duke e parë nga këndvështrimi stilistik. Në shembujt ilustrues që do të trajtohen më poshtë do të vërejmë se cili nga përkthyesit i ka qëndruar më besnik stilit të autorit të veprës origjinale apo dhe rastet kur mes tyre nuk asnjë dallim pasi, të kushtëzuar nga konteksti, u duhet të veprojnë ashtu.

Si fillim e ndjejmë të udhës të vëmë në dukje se termi “stil” është një term i gjerë që strehon një numër të madh të teorive dhe pikëpamjeve. Vetëm fushat e psikologjisë, filozofisë dhe estetikës, gjuhësisë dhe kritikës letrare kanë ofruar përkufizime e perspektivave nga më të larmishmet. Disa nga idetë dhe përkufizimet më të hershme për stilin janë renditur më poshtë duke synuar të tregojnë larminë e gjerë të spekulimeve në trajtimin e termit:

- Stili është një cilësi e gjuhës e cila komunikon saktësisht emocionet ose mendimet, ose një sistem emocionesh ose mendimesh, të veçantë për autorin.³²⁹
- Funkcioni poetik projekton parimin e ekuivalencës nga boshti i përzgjedhjes në boshtin e kombinimit.³³⁰
- Teksti do të tregojë zgjedhjen dhe rregullimin e sendeve që kontribuojnë në efektin total.³³¹

³²⁹ Murry, John Middleton, *The problem about Style*, Praeger, Oxford, 1980, fq. 65

³³⁰ Jakobson, Roman, *Linguistics and poetic in Style in Language*, Harvard University press, 1995, pg. 358

- "Devijimet" nga norma ose normat e pranuar jo vetëm që tolerohen, por edhe priten brenda traditave, periudhave dhe zhanreve të ndryshme poetike. "Devijime" të tilla nuk duhet të shihen si licensë poetike dhe krijime individuale; ato, përkundrazi, janë rezultat i manipulimeve të materialit gjuhësor të disponueshëm dhe përdorimi i shkathët i mundësive të qenësishme të gjuhës së folur.³³²
- Është shkelje ose neglizhencë e rregullave që rregullojnë strukturën e klauzolave, fjalive dhe paragrafëve gjë që përbën sekretin e vërtetë të stilit.³³³
- Stili është “Shkelja e normës së standardit, shkelja e saj sistematike, është ajo që bën të mundur përdorimin poetik të gjuhës; pa këtë mundësi nuk do të kishte poezi.³³⁴
- Stili mund të hetohet, si devijim nga një normë ashtu edhe si një sistem i mënyrave koherente ose modeleve të të bërit të gjërave.³³⁵
- Stili është një produkt i zgjedhjeve individuale dhe modeleve të zgjedhjeve midis mundësive gjuhësore.³³⁶
- Stili përcaktohet si devijime të një individi nga normat për situatat në të cilat ai po kodon, këto devijime janë në vetitë statistikore të atyre tipareve strukturore për të cilat ekziston një farë zgjedhje në kodin e tij.³³⁷
- Stili - një pronë e të gjitha teksteve, jo vetëm letrare - mund të thuhet se banon në manipulimin e variablave në strukturën e një gjuhe, ose në zgjedhjen e veçorive opsionale.³³⁸
- Stili i një teksti (...) identifikohet në vetvete si shuma e një numri pikësh në disa shkallë gjuhësore; të përcaktuara nga vendi i saj në disa kontekste. Çdo shprehje, sado e shkurtër, është e ndjeshme ndaj përshkrimeve në lidhje me një gamë të tërë karakteristikash.³³⁹
- Stili (është) një variacion sistematik i gjuhës.³⁴⁰

³³¹ Chapman, Siobhan, *Philosophy for Linguists: An Introduction*, London and New York, Routledge, 2000, fq. 13-14

³³² Stankiewicz, Edward, *Style and Language*, Edizioni dell' Ateneo, Roma, 1986, fq. 70

³³³ Galperin, I. R, *An Essay in Stylistic Analysis*, Higher School Publishing house, Moscow, 1978, fq. 15

³³⁴ Po aty, fq. 23

³³⁵ Hymes, Dell, *Foundations in Sociolinguistics*, Routledge and Kegan paul, 1960, fq. 109

³³⁶ Chatman, Seymour, *Literary Style: A Symposium*, Oxford University Press, 1971, fq. 111

³³⁷ Galperin, I. R, *An Essay in Stylistic Analysis*, Higher School Publishing house, Moscow, 1978, fq. 22

³³⁸ Chapman, Siobhan, *Philosophy for Linguists: An Introduction*, London and New York, Routledge, 2000, fq. 17

³³⁹ Enkvist, Nils Erik, *Linguistics and Style; On defining Style*, Oxford University Press, 1960, fq. 32

³⁴⁰ Po aty, fq. 47

Siç kemi vërejtur më lart, këto ide, mendime dhe teori ndryshojnë në lidhje me kuptimin e asaj që përbën thelbin e stilit. Prandaj, asnjë përcaktim i vetëm nuk duhet të jetë i privilegjuar ndaj të tjerëve, pasi stili është përshkrues i këtyre pikëpamjeve të ndryshme. Secila teori i afrohet pyetjes së stilit me një vizion të ndryshëm. Do të ketë aq shumë përkufizime sa ka teori të ndryshme. Për më tepër, besohet se stili është një term i paqartë, ‘i pakapshëm’. Prandaj, është e pamundur të arrihet në një përkufizim përfundimtar i termit "stil", ku të gjitha tiparet duhet të shtrydhen në një përkufizim të vetëm. Përkufizimet kanë tendencë të jenë ose shumë të gjera ose shumë të ngushta.

Wimsatt në veprën e tij *Ikona Fjalë; Studime në kuptimin e poezisë* shprehet se "cdo ligjërim në lidhje me përkufizimin e "stilit" është i pafrytshëm nëse thjesht shpreh: "stili është kështu apo stili është ashtu." Sidoqoftë, për të shmangur heterogjenitetin e termit "stil", është mjaft analitike për të dalë me një listë të pikave kryesore që përcaktojnë natyrën e stilit në teorinë e përgjithshme të stilistikës gjuhësore.³⁴¹ Pothuajse të gjitha reflektimet për stilin, të theksuara drejtpërdrejt ose indirekt më sipër, sugjerojnë një seri konceptesh: devijim, zgjedhje, variant, karakteristikat dhe përsëritje.

Dy përkufizime konsiderohen se janë të rëndësishme për sa i përket këtij studimi:

1. stili si devijimi
2. stili si zgjedhja.

Devijimi është një koncept që i referohet shkeljes së përdorimit normal të gjuhës. Efekti kryesor i këtij lloji të stilit arrihet nga shkeljet, qoftë semantike, sintaksore, leksikore, etj. Zgjedhja varet veçanërisht nga frekuencat e veçorive të caktuara. Ajo ka të bëjë me shumën e atyre tipareve të qenësishme në tekst të cilat konsiderohen si rregulla stilistike që përcaktojnë preferencën stilistike.

Enkvist në monografinë e tij, *Gjuhësia dhe stili; Mbi përcaktimin e stilit*, diskuton gjashtë qasje për përcaktimin e stilit:³⁴²

- 1- Stili si guaskë që rrethon një thelb paramenduese të mendimit si ato të devotshëmve antikë të retorikës.
- 2- Stili si zgjedhja midis shprehjeve alternative.
- 3- Stili si devijime nga një normë
- 4- Stili si ‘një tërësi karakteristikash individuale.
- 5- Seti i karakteristikave kolektive.

³⁴¹ Wimsatt, W. K, *The Verbal Icon; Studies in the Meaning of Poetry*, University Press of Kentucky, 1960, fq. 201

³⁴² Enkvist, Nils Erik, *Linguistics and Style; On Defining Style*, Oxford University Press, 1960, fq. 34

6- Stili si ato marrëdhëniet midis subjekteve gjuhësore që janë të pasakta për sa i përket hapësirave më të gjera të tekstit sesa fjalia dhe kjo ide është mbështetur nga veprat e kontekstualistëve: Austin (1962), Searle (1979), Grice (1991), dhe Pratt (1977).

Para se të përmbylim këtë pjesë të diskutimit mbi termin "stil", le të diskutojmë dy emra eminentë që kanë kontribuar shumë në nocionet e stilit dhe stilistikës: Geoffrey Leech dhe Mick Short. Leech and Short paralajmërojnë se përkufizimet e stilit mund të 'zgjerohen ose ngushtohen', të ndriçojnë ose të pengojnë të kuptuarit e artit verbal.³⁴³ Kështu ata sugjerojnë që të jemi të vëmendshëm kur kemi të bëjmë me diskutime të tilla për stilin ose përndryshe zhytemi në konfuzionin e përkufizimeve gojore.

Duke marrë nocionin e *parole* si pikë themelore për fillimin e përcaktimit të stilit, Leech and Short vërejnë se është përzgjedhja nga një repertor gjuhësor i përgjithshëm që përbëjnë një stil. Stilistika, nga ana tjetër, 'ka, në mënyrë të nënkuptuar ose në mënyrë të qartë, qëllimin e shpjegimit të lidhjes midis gjuhës dhe funksionit artistik.' Kjo detyrë e stilistikës na ka ndihmuar për të bërë hapa përpara për të shqyrtuar në një kuptim më studimor termin 'stil' ku pyetja 'çfarë' është që të shfuqizohet nga pyetja më praktike dhe analitike 'pse dhe si'.³⁴⁴

Ndërkohë në vijim të këtij kapitulli do të bëjmë një krahasim të përgjithshëm mbi stilet e secilit prej përkthyesve, më pas do të përmendim dhe do mundohemi të japim përkufizimet e disa stileve. Pjesa tjetër e kapitullit do të fokusohet më tepër tek mjetet stilistikore të përdorura nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona duke sjellë shembuj për secilin nga këto mjete. Shembujt do të analizohen në mënyrë të detajuar duke bërë dhe një krahasim mes dy versioneve.

Gjatë procesit të përkthimit në përgjithësi, si dhe gjatë përkthimit të veprave që i përkasin letërsisë artistike, përkthyesi vëren stilet e ndryshme funksionale. Këto stile, pavarësisht nga ndryshimet që mund të vërehen nga pikëpamja funksionale, për përkthyesin nuk paraqesin vështirësi për faktin se kanë më shumë elementë të përbashkët se sa dallues. Përkthyesi mendohet t'i kushtojë vëmendje tipareve dalluese që ekzistojnë ndërmjet stileve funksionale dhe siç citon dhe Prof. Dr. Ristani "Detyrë e përhershme e përkthyesit mbetet ndërgjegjësimi në lidhje me tiparet dalluese të stileve funksionale, në kuadrin e skemave të stileve funksionale përkatësisht në gjuhën e burimit dhe në atë mbërritëse, përcaktimi i tipareve dalluese të përhershme të tyre."³⁴⁵

Për sa i përket veprave në gjuhën angleze që i përkasin fushës së letërsisë R. Quirk nuk pranon veçimin e letërsisë si stil funksional të shkëputur, duke gjykuar se "në letërsi ndodhen po aq variante, përkatësisht stile sa edhe jashtë saj, në atë masë që letërsia imiton jetën."³⁴⁶

³⁴³ Short, Michael.H, Leech, Geoffrey.N, *Style in Fiction; A linguistic Introduction to English Fictional Prose*, Routledge, 1981, fq. 109

³⁴⁴ Po aty, fq. 109-110

³⁴⁵ Ristani, Viktor. *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Tiranë: Mirgeeralb, 2010, fq. 17-18

³⁴⁶ Po aty, fq. 20

Për më tepër, stili ndryshon në varësi të dëgjuesve, lexuesve, marrëdhënieve mes folësve apo shkrimtarëve me ta. Ai mund të jetë formal, libror, bisedor, intim dhe ai përcaktohet gjithmonë nga konteksti dhe shkalla e njohjes mes atyre që japin informacionin dhe atyre që e marrin atë.³⁴⁷ Ai ndahet në dy grupime të mëdha duke u bazuar tek “shkalla e ngulitjes, përpunimit historik të një grupi të përcaktuar përfytesash, stilemash, tiparesh, ngjyrimesh, ndërthurjesh, si shfaqje konkrete e funksionit stilistik për t’iu përgjigjur kërkesave dhe praktikës shoqërore sipas kushteve të komunikimit dhe sferave e qëllimeve të caktuar, nga njëra anë, dhe ndërthurjes së re si shprehje e kërkimeve krijuese, e nevojës për origjinalitet, në kërkim të individualiteti, si organizim për synime të veçanta të folësit, të autorit e të një grupi autorësh.”³⁴⁸

Grupimi i parë trajton stilin e një gjuhe duke analizuar tipare të cilat nuk kanë një ndikim të drejtëpërdrejtë në kuptimin apo aspektet komunikative dhe referenciale të gjuhës duke qenë se këto tipare janë thjesht informacione plotësuese. Pra, ky grupim merret më tepër me mjetet stilistike të gjuhëve të veçanta.

Ndërsa grupimi i dytë trajton më tepër mënyrën sesi burimet apo mjetet e ndryshme stilistikore përdoren nga autorë të veçantë për të krijuar stilin e tyre individual i cili është unik dhe i papërsëritshëm. Në ky grupim dallojmë dy nëngrupime kryesore:

1. *Stilet standarte*, përkatësisht mënyra tradicionale, të përgjithësuara modelime të ngulitura historikisht të tipit funksional, që përfshijnë:
 - A. Ligjërimet
 - B. Stilet funksionale
2. *Stilet individuale*, mënyra vetjake, unike ose për një grup që kërkon të veçohet, një zgjidhje krijuese e lidhjes së formave të shprehjes gjuhësore me realitetin jashtëgjuhësor, që klasifikohen më tej përkatësisht në:
 - A. Stilin e drejtimit, që shfaqet në mënyrat e organizimit të përbashkët për një grup autorësh, të cilët i përkasin një epoke, një vendi apo një rryme.
 - B. Stilin e autorit, i cili shfaqet në mënyrat e organizimit që përshkojnë veprat e një autori, por që në shumë raste nuk është i barabartë me stilin e një vepre të tij, për shkak të pranisë së tipareve të qëndrueshme nga njëra anë dhe tipareve të veçanta, të papërsëritshme nga ana tjetër.
 - C. Stilin e një teksti, përkatësisht organizimin tërësor të një vepre të veçantë.³⁴⁹

Më poshtë do të fokusohemi tek një analizë e detajuar e mjeteve stilistike të përdorura nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona në përkthimin e *Plaku dhe Deti*.

³⁴⁷ Po aty, fq. 19

³⁴⁸ Po aty, fq. 43

³⁴⁹ Ristani, Viktor. *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Tiranë: Mirgeeralb, 2010, fq. 44-45

C. III.1. Krahasim i stilit përkthimor të Kadaresë me atë të Kokonës

Për të bërë një krahasim të stileve të dy përkthyesve duhet fillimisht të përmendim disa nga karakteristikat e stilit të Ernest Heminguei. Vërehet se stili i tij është pothuajse i njëjtë në të gjitha veprat e shkruara nga ai. Ky stil karakterizohet nga fjali të shkurtra, të thjeshta, por me një kuptim të thellë. *Plaku dhe Deti* mund të konsiderohet një vepër e thjeshtë, por tepër e fuqishme. Mund të duket e thjeshtë pasi ka vetëm një personazh kryesor që lufton pafund për të dalë “fitimtar”, por në fakt kemi një simbolikë të madhe të një njeriu i cili lufton në çdo ditë të jetës së tij për t’ia dalë mbanë. Një tjetër karakteristikë që mund të përmendet në lidhje me stilin e Heminguei është dhe përdorimi i fjaleve me kuptime të shumëfishta si dhe përsëritja e fjalëve. Pra, për të bërë një përgjithësim mund të themi se ai shkruan thjesht, shkurt dhe në të njëjtën kohë përcjell mesazhe shumë të forta.

Nëse do të bënim një krahasim të përgjithshëm mbi stilet përkthimore të Kadaresë dhe Kokonës mund të themi se Kokona është më tepër i orientuar tek ligjërimi bisedor, pra fjalët që ai zgjedh janë të thjeshta dhe shumë afër gjuhës së përditshme, sidomos në këtë vepër e cila në përgjithësi ka një gjuhë të tillë. Po të flasim për stilin e Kadaresë mund të themi se stili i tij është paksa më i ndryshëm nga ai i Kokonës, në aspektin e të qënurit më formal, megjithatë *Plaku dhe Deti* “e detyron” atë që të përdorë herë pas here dhe një stil paksa të shkujdesur bisedor në mënyrë që efekti të përcillet tek lexuesit në mënyrë sa më të arrirë.

C. III. 2 Analizë krahasuese e mjeteve stilistike

Mjetet stilistike që do të shqyrtojmë në këtë pjesë të kapitullit janë: përshtatja, ekuivalenca dhe transpozimi. Do të vërejmë se si dy përkthyesit e kanë sjellë veprën në shqip përmes këtyre mjeteve si dhe nëse mjetet e përdorura prej tyre janë tërësisht të ndryshme në fjali apo periudha të njëjta apo ata kanë zgjedhur pothuajse të njëjtat mjete stilistikore. A ndikon zgjedhja e ndryshme tek kuptimi duke e ndryshuar atë nënjë njëfarë mënyre apo mesazhi mbetet po ai pavarësisht mjeteve të përdorura? Kësaj pyetjeje do t’i përgjigjemi pasi të analizojmë shembujt konkretë të marrë nga libri edhe pse nga një vështrim i përgjithshëm mund të themi se ka raste kur dy përkthyesit zgjedhin mjete tërësisht të ndryshme nga njëri-tjetri dhe mesazhi vjen po aq i fortë sa është dhe në origjinal.

Kështu, para se të fillojmë analizën e tre mjeteve stilistikore që kemi zgjedhur (përshtatja, ekuivalenca dhe transpozimi) të ilustrojmë me shembuj dhe të japim përdorimin e tyre në gjuhën e origjinalit si dhe si janë përkthyer nga dy përkthyesit tonë, e gjejmë të udhës të bëjmë një panoramë të përgjithshme të mjeteve dhe metodave stilistikore në periudha të ndryshme dhe nga studiues dhe linguist që kanë dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm në këtë fushë.

Si fillim, Vinay dhe Darbelnet realizuan një analizë stilistikore krahasuese të frëngjishtes me anglishten. Ata studiuuan tekstet në të dy gjuhët, duke vërejtur dallime midis këtyre gjuhëve dhe duke identifikuar strategji, metoda dhe procedura të ndryshme të përkthimit.

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Edhe pse vepra e tyre *Stylistique comparée du français et de l'anglais* (1958) bazohet vetëm në frëngjisht dhe anglisht, ndikimi i saj ka qenë shumë më i gjerë, pasi është përdorur si baza e shumë anilzave të ngjashme të tjera stilistikore me gjuhë të tjera.

Dy strategjitë e përgjithshme të përkthimit të identifikuar nga Vinay dhe Darbelnet janë përkthimi i drejtpërdrejtë dhe përkthimi i zhdrejtë. Të dy strategjitë përfshijnë shtatë procedura, nga të cilat përkthimi i drejtpërdrejtë përfshin tre:³⁵⁰

1. Huazimet: Fjala nga gjuha e origjinalit transferohet drejtpërdrejt në gjuhën e përkthimit për të mbushur një boshllëk semantik në gjuhën e përkthimit.
2. Kalket: Ky është një lloj i veçantë huazimi ku shprehja ose struktura nga gjuha e origjinalit transferohet në një përkthim të mirëfilltë. Vinay dhe Darbelnet vërejnë se si huazimet ashtu dhe kalket shpesh integrohen plotësisht në gjuhën e përkthimit, megjithëse ndonjëherë me disa ndryshime semantike, të cilat mund t'i kthejnë ato në miq të rremë.
3. Përkthimi i drejtpërdrejtë: Ky është përkthimi 'fjalë për fjalë', të cilin Vinay dhe Darbelnet e përshkruajnë si më të zakonshmet midis gjuhëve të së njëjtës familje dhe kulturë.

Përkthimi fjalë për fjalë është receta e autorëve për një përkthim të mirë. Letërsia duhet të sakrifkohet vetëm për shkak të kërkesave strukturore dhe metalinguistike dhe vetëm pasi të kontrollohet se kuptimi është ruajtur plotësisht.³⁵¹ Sipas Vinay dhe Darbelnet përkthyesi mund të gjykojë se përkthimi i mirëfilltë është 'i papranueshëm' sepse ai:³⁵²

- (a) jep një kuptim tjetër;
- (b) nuk ka kuptim;
- (c) është e pamundur për arsye strukturore;
- (d) nuk ka një shprehje përkatëse në gjuhën e përkthimit;
- (e) korrespondon me diçka në një nivel tjetër të gjuhës.

Në ato raste kur përkthimi i mirëfilltë, fjalë për fjalë, nuk është i mundur, Vinay dhe Darbelnet thonë se strategjia e përkthimit të zhdrejtë hyn në përdorim. Kjo përfshin katër procedurat e tjera.³⁵³

³⁵⁰ Vinay, J. P, and J. Dalbarnet. *Comparative Stylistcs of French and English: A methodology for Translation*, translated by J.C Sager and M.J Hamel, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 1995, fq.84-93

³⁵¹ Po aty, fq. 288

³⁵² Po aty, fq. 34-35

³⁵³ Vinay, J. P, and J. Dalbarnet. *Comparative Stylistcs of French and English: A methodology for Translation*, translated by J.C Sager and M.J Hamel, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 1995, fq. 90-99

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

1. Transpozimi: Ky është një ndryshim i një pjese të fjalës me një tjetër por pa ndryshuar kuptimin.
2. Modulimi: Kjo ndryshon semantikën dhe këndvështrimin e gjuhës së burimit.
3. Ekuivalentimi: Vinay dhe Darbelnet e përdorin këtë term për t'iu referuar rasteve kur gjuhët përshkruajnë të njëjtën situatë me mënyra të ndryshme stilistikore ose/dhe strukturore. Ekuivalenca është veçanërisht e dobishme për përkthimin e idiomave dhe të fjalëve të urta.
4. Përshtatja: përfshin ndryshimin e referencës kulturore kur një situatë në kulturën e gjuhës së origjinalit nuk ekziston në kulturën e gjuhës së përkthimit.

Vinay dhe Darbelnet i japin më shumë rëndësi modulimit duke iu referuar si "çelësi i një përkthyesi të mirë", ndërsa zhvendosja "thjesht tregon një komadë të mirë të gjuhës së përkthimit".³⁵⁴

Është e rëndësishme të theksohet fakti se këto shtatë kategoritë kryesore të përkthimit të përshkruara më lart nga Vinay dhe Darbelnet funksionojnë në tre nivele të cilat pasqyrojnë elementet kryesore strukturore të librit. Ata janë:

1. leksiku
2. struktura sintaksore
3. mesazhi³⁵⁵

Pika e fundit që duam të sjellim nga studimi i Vinay dhe Darbelnet është rëndësia që ato i kushtojnë stilistikës duke pohuar që është pikërisht kjo fushë që duhet të jetë shqetësimi kryesorë i përkthyesit. Kështu roli i përkthyesit është të zgjedhë midis opsioneve në dispozicion për të shprehur nuancat e mesazhit. Në fund ato japin një listë prej pesë hapash që përkthyesi sugjerohet të ndjekë në kalimin nga teksti origjinalë në tekstin e përkthimit të cilat janë:

- Identifikoni njësitë e përkthimit
- Shqyrtoni tekstin e gjuhës origjinale, duke vlerësuar përmbajtjen përshkruese, ndikuese dhe intelektuale të njëjësive
- Rindërtoni kontekstin metalinguistik të mesazhit
- Vlerësoni efektet stilistike
- Prodhoni dhe rishikoni tekstin e përthyer.³⁵⁶

³⁵⁴Po aty, fq. 92

³⁵⁵ Po aty, 27-30

Katër hapat e parë ndiqen gjithashtu nga Vinay dhe Darbelnet në analizën e tyre të përkthimeve të botuara. Ndërsa për sa i përke pyetjes kryesore "po njësia e përkthimit?", autorët kundërshtojnë fjalën individuale. Ata e konsiderojnë njësinë e përkthimit si një kombinim të 'njësisë leksikologjike' dhe 'njësisë së mendimit' dhe e përkufizojnë si “segmentin më të vogël të pohimit, shenjat e të cilit janë të lidhura në atë mënyrë që të mos përkthehen individualisht”.³⁵⁷

Edhe pse Vinay dhe Darbelnet nuk përdorin fjalën 'zhvendosje' (shift), për të diskutuar ndryshimin e përkthimit, kjo është në fakt ajo që ata po përshkruajnë. Vetë termi duket se ka origjinën në një teori gjuhësore të përkthimit të Catford (1965), ku ai i kushton një kapitull të tërë temës. Catford ndjek modelin gjuhësor Firthian dhe Hallidayan, i cili analizon gjuhën si komunikim, duke funksionuar në mënyrë funksionale në kontekst dhe në një gamë të niveleve të ndryshme (p.sh. fonologji, gramatikë, leksik).³⁵⁸

Për sa i përket përkthimit, Catford bën një dallim të rëndësishëm midis korrespondentit zyrtar dhe ekuivalencës tekstuale si më poshtë:

- Një korrespondent zyrtar është: “çdo kategori e tekstit të origjinalit (njësi, klasë, element i strukturës, etj.) për të cilën mund të thuhet se zë, sa më shumë të jetë e mundur, vendin e "njëjtë" në “botën” e tekstit të përkthyer, si kategoria e dhënë në gjuhën e origjinalit zë në gjuhën e përkthimit”³⁵⁹
- Një ekuivalent teksti është: “çdo tekst ose pjesë e tekstit të gjuhës së përkthyer e cila vërehet në një rast të veçantë. . . të jetë ekuivalent i një teksti të caktuar ose një pjesë e tekstit të gjuhës origjinale”.³⁶⁰

Ekuivalenca tekstuale është e lidhur kështu me një tekst të veçantë origjinal dhe tekstin e përkthyer, ndërsa ekuivalentimi zyrtar është një koncept më i përgjithshëm i bazuar në sistem midis disa gjuhësh. Kur dy konceptet ndryshojnë, një zhvendosje përkthimi konsiderohet të ketë ndodhur. Sipas Catford, zhvendosjet e përkthimit janë kështu "largime nga korrespondenca zyrtare në procesin e kalimit nga teksti origjinal në tekstin e përkthyer”.³⁶¹

Catford konsideron dy lloje të zhvendosjes:

1. zhvendosja e nivelit dhe
2. zhvendosja e kategorisë

³⁵⁶ Vinay, J. P, and J. Dalbernet. *Comparative Stylistics of French and English: A methodology for Translation*, translated by J.C Sager and M.J Hamel, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 1995, fq. 30-31

³⁵⁷ Po aty, fq. 21

³⁵⁸ Munday, Jeremy., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 60

³⁵⁹ Catford J.C , *A Linguistic Theory of Translation*, London: Oxford University Press , 1965, fq. 27

³⁶⁰ Po aty

³⁶¹ Catford J.C , *A Linguistic Theory of Translation*, London: Oxford University Press , 1965, fq. 41

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Sipas tij zhvendosja e nivelit do të ishte diçka që shprehet me gramatikë në një gjuhë dhe leksik në një tjetër, ndërsa zhvendosjen e kategorisë ai e ndan në katër nënkategori të cilat janë:³⁶²

1. Zhvendosjet strukturore: Këto konsiderohen nga Catford si forma më e zakonshme e zhvendosjes dhe përfshijnë kryesisht një zhvendosje në strukturën gramatikore.
2. Zhvendosjet klasore: Këto përmbajnë zhvendosje nga një pjesë e ligjeratës në tjetrën.
3. Zhvendosjet e njësisive ose zhvendosjet në gradë: Këto janë zhvendosje ku ekuivalenti i përkthimit në gjuhën e përkthyer është në një gradë të ndryshme me gjuhën origjinale. “Gradë” këtu i referohet njësisive gjuhësore hierarkike të fjalisë, grupit, fjalës dhe morfemës.
4. Zhvendosjet brenda sistemit: Këto janë zhvendosje që ndodhin kur gjuha e origjinalit dhe gjuha e përkthimit posedojnë sisteme për afërsisht të ngjashme, por ku “përkthimi përfshin zgjedhjen e një termi jo korrespondues në sistemin e gjuhës së përkthimit”

Një periudhë tjetër të rëndësishme përbëjnë edhe shkrime të tjera mbi zhvendosjet në përkthim në vitet 1960 dhe 1970 nga Çekosllovakia e atëhershme, ku prezantohet një aspekt letrar, ai i 'funksionit shprehës' ose stilit të një teksti. Kjo risi erdhi nga puna e Jiří Levý mbi përkthimin letrar. Në veprën e tij *Arti i përkthimit* Levý shikon nga afër përkthimin e strukturës sipërfaqësore të tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer me vëmendje të veçantë për përkthimin e poezisë dhe e sheh përkthimin letrar si një punë riprodhuese dhe krijuese me qëllimin e një efekti ekuivalent estetik³⁶³

Ai gjithashtu jep një kategorizim të veçorive të teksteve ku mund të ketë nevojë për ekuivalencë. Këto janë:

- kuptimi denotativ
- konotacioni
- organizimi stilistik
- sintaksa
- përsëritja e tingullit (ritmit, etj.),
- gjatësia zanore
- artikulimi.

³⁶² Po aty, 141-143

³⁶³ Levý, Jiří, *The Art of Translation*, John Benjamins Publishing Co, Amsterdam, Netherlands, 2011, fq. 63

Rëndësia e tyre në një përkthim varet nga lloji i tekstit. Kështu që, gjatësia e zanores dhe artikulimi nuk duhet të ndryshojnë në dublim, ndërsa në një tekst teknik, kuptimi denotativ është me rëndësi kryesore dhe nuk duhet të ndryshojë.³⁶⁴

Një tjetër nga punimet e tij *Përkthimi si proces vendimtar* (1967/2000), gjithashtu ka pasur një ndikim të rëndësishëm, në lidhje me “zhvendosjen graduale semantike” të zgjedhjeve gjuhësore të përkthyesve. Prandaj, Levý e sheh punën e përkthimit në botën reale si pragmatike.

“Përkthyesi zgjedh një nga zgjidhjet e mundshme e cila premtun një efekt maksimal me një minimum përpjekjet. Kjo do të thotë, ai zgjidh intuitivisht për të ashtuquajturën ‘strategjia minimax’.”³⁶⁵

Munday shkruan se përpjekja më e detajuar për të prodhuar dhe aplikuar një model të analizës së zhvendosjes është realizuar nga Kitty van Leuven-Zwart nga Amsterdam. Modeli i Van Leuven-Zwart merr si pikënisje disa nga kategoritë e propozuara nga Vinay dhe Darbelnet dhe Levý dhe i zbaton ato në analizën përshkruese të një përkthimi, duke u përpjekur që të sistemoj krahasimin ashtu si dhe të ndërtoj një kornizë ligjërimi mbi nivelin e fjalive.³⁶⁶

Në artikullin e tij *Target* Leuven-Zwart ka për qëllim përshkrimin e dy qasjeve:

- modeli krahasues i përkthimit
- modeli përshkrues i përkthimit

Leuven-Zwart shkruan se tendencat e identifikuar nga këto modele plotësuese japin indikacione për normat e përkthimit të miratuara nga përkthyesi. Karakteristikat e secilit model janë si më poshtë:³⁶⁷

1. Modeli krahasues: përfshin një krahasim të hollësishëm të tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer dhe një klasifikim të të gjitha zhvendosjeve mikrostrukture (brenda fjalive, klauzolave dhe frazave).
 - Mungesa e një marrëdhënie sinonimike tregon një zhvendosje në përkthim, dhe zhvendosjet ndahen në tre kategori kryesore me nënkategori të shumta. Tre kategoritë kryesore janë:
 - modulimi
 - modifikimi
 - mutacioni³⁶⁸

³⁶⁴ Po aty, fq. 69

³⁶⁵ Po aty, 156

³⁶⁶ Munday, Jeremy., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 64

³⁶⁷ Po aty, fq. 65

³⁶⁸ Munday, Jeremy., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 65

2. Modeli përshkrues: është një model makrostrukturor, i hartuar për analizën e literaturës së përkthyer. Ajo bazohet në koncepte të huazuara nga narratologjia dhe stilistika. Përpiqet të gërshetojë konceptet e nivelit të ligjërit (shprehja gjuhësore e botës së trilluar) dhe niveli i tregimit (narracioni i tekstit, përfshirë këndvështrimin narrativ) me tre metafunksionet gjuhësore (ndërpersonale, ideologjike dhe tekstuale).³⁶⁹

Thënë këto, tani vazhdojmë me analizën e tre mjeteve stilistikore të zgjedhura për diskutim dhe ilustrim në dy përkthimet e veprës tonë qendrore *The Old Man and the Sea*.

C. III. 2.1 Përshtatja

Në librin “*Translation: An advanced resource book*” përshtatja përkufizohet kështu: “Përshtatja është kufiri i skajshëm i përkthimit: përdoret në ato raste kur lloji i situatës për të cilin referohet mesazhi nga gjuha e origjinalit nuk është i njohur në kulturën e gjuhës së përkthimit. Në raste të tilla, përkthyesit duhet të krijojnë një situatë të re që mund të konsiderohet si ekuivalente. Përshtatja, pra, mund të përshkruhet si një lloj i veçantë ekuivalentimi, një ekuivalent i situatës.”³⁷⁰

Sipas këtij përkufizimi, përshtatja është një lloj i veçantë i ekuivalencës, një lloj ekuivalence që varet tek konteksti dhe situata. Ky mjet stilistik përdoret në rastet kur mesazhi nuk mund të përcillet në gjuhën e përkthimit pa bërë një lloj përshatjeje që e bën më të kuptueshëm këtë mesazh në gjuhën tjetër.

Newmark e përshkruan përshtatjen si “një teknikë ku një element kulturor zëvendësohet me një tjetër element që është tipar i kulturës së gjuhës së përkthimit”,³⁷¹ kështu lexuesi e kupton atë pasi ai vjen përmes një elementi që ai e njeh dhe si rezultat arrin dhe ta kuptojë. Kjo është një teknikë shumë e mirë kur kemi të bëjmë me përkthimin e sloganeve të ndryshme, reklamave, etj. Në këto raste i jepet rëndësi mesazhit më tepër sesa fjalëve të përdorura dhe kjo ndodh për shkak se ajo që përcillet është më e rëndësishme se sa si përcillet.

Qëllimi kryesor përse përkthyesi zgjedh të përdorë këtë mjet stilistik është përcjellja e efektit të njëjtë tek lexuesit e tekstit në gjuhën e përkthimit duke përshtatur termat kulturorë në një farë mënyre. Në mënyrë që të arrihet një përkthim sa më i mirë duhet të shkohet përtej kuptimit sipërfaqësor të fjalëve. Është shumë e rëndësishme që të përcillet kuptimi i fjalëve në një situatë të caktuar duke u bazuar në konteksti kulturor. Fakti që merret parasysh elementi kulturor bën që të kuptohet se përkthyesi nuk është i vetmi person i përfshirë në përkthim.

³⁶⁹ Po aty

³⁷⁰ Hatim, Basil dhe Munday, Jeremy. *Translation: An advanced resource book*, New York: Taylor&Francis e-Library, 2004, fq. 151

³⁷¹ Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 56

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Eugene Nida ka vërejtur se “gjuha është një pjesë e kulturës, dhe në fakt, është grupi më i ndërlikuar i zakoneve që shfaq çdo kulturë. Gjuha pasqyron kulturën, siguron qasje në kulturë dhe në shumë aspekte përbën një model të kulturës.”³⁷²

Kështu sipas Nidas përshtatja është një teknikë shumë e rëndësishme. Ajo është e nevojshme sidomos në rastet kur diçka që është e veçantë, specifike në një gjuhë është totalisht e ndryshme dhe e panjohur në një tjetër gjuhë. Kur përkthyesi përdor këtë teknikë do të thotë se kemi një ndryshim tek elementi kulturor në mënyrë që t’i përshtatet kulturës së gjuhës se përkthimit.

Koller thekson se “koncepti i “përkthimit” ndonjëherë vendoset kundër konceptit “përshtatje” dhe kjo ndodh sidomos në rastet kur komentohet origjina e tekstit.”³⁷³ Duke përdorur përshtatjen mendohet se humb origjinaliteti i tekstit origjinal me qëllim që të jetë sa më i kuptueshëm nga lexuesit e tekstit në gjuhën e përkthimit. Në fakt është e vështirë që të gjendet një lloj ndryshimi ndër këto dy koncepte pasi vetë përkthimi është një lloj përshtatjeje. Ka raste kur përkthyesi përdor përshtatjen si teknikë edhe nëqoftëse nuk ka ndonjë element kulturor të përfshirë në tekst. Kjo gjë ndodh pasi është teksti ai që e “detyron” përkthyesin të veprojë kështu. Atij i duhet ta përshtasë gjuhën në të gjitha nuancat e saj në mënyrë që përkthimi të jetë sa më i natyrshëm.

Disa nga elementët kulturorë tek *Plaku dhe Deti* të cilët mund t’i përmendim janë:

-Përshkrimi i kasolles së plakut ngjan me kasollet që përdoren nga peshkatarët në Kubën e atyre kohëve. Kështu, nëpërmjet përkthimit sillet një lloj imazhi i atij vendi por me fjalë të cilat duhet t’i përshtaten lexuesit të tekstit në gjuhën e përkthimit dhe në këtë rast përkthyesi duhet të përshtasë në mënyrë që të jetë sa më i kuptueshëm tek lexuesit. Për shembull: *The shack was made of the tough bud-shields of the royal palm which are called guano...-Kasollja ishte ndërtuar me degë palmash që quhen guano...(Kadare)-...kasollja ishte ndërtuar me gjethet e palmës të cilën këtu e quajnë guanjo (Kokona).* Po të shohim dy versionet e përkthyer na bie në sy fakti që Kokona shton “këtu” për të përcaktuar faktin se guanjo është një bimë tipike e asaj zone dhe ai e thekson këtë gjë.

-Në këtë libër përmendet Katolicizmi dhe Virgjëresha Mari dhe në këtë rast përkthimi nuk ka nevojë për përshtatje, edhe pse ka element kulturorë pasi edhe lexuesi i tekstit në gjuhën e përkthimit ka njohuri mbi Katolicizmin pasi një pjesë e popullsisë i përket këtij besimi.

-Santiago mban një foto të Virgin of Cobre në kasollen e tij dhe ku është një element tërësisht kulturor i Kubës

³⁷² Nida, E., *Language Structure and Translation*. Stanford, California: Stanford University Press, 1975, fq. 136

³⁷³ Koller, W., *The concept of equivalence and the object of translation studies*, Target, 1995, fq. 67

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

-Interpretimi romantik i Santiagos mbi stereotipet kulturore gjinore, p.sh simbolizon një grua të cilës i luhatet shpesh humori. Pra, deti është herë i qetë e herë i trazuar ashtu siç janë dhe ndjenjat e një gruaje.³⁷⁴

Për ta ilustruar këtë do të sjellim mëposhtë një shembull si dhe do të shohim se si dhe dy versionet e përkthyer në gjuhën shqipe:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Why did they make birds so delicate and fine as those sea swallows when the ocean can be so cruel? She is kind and beautiful. But she can be so cruel and it comes so suddenly and such birds that fly, dipping and hunting, with their small sad voices are made too delicate for the sea. ³⁷⁵	Pse vallë zogjtë janë krijuar kaq të brishtë, si këto dallëndyshe deti, kuse oqeani nganjëherë bëhet aq i egër? Ai është i mirë dhe shumë i bukur. Por ai mund të bëhet aq i egër dhe kjo vjen kaq papritur , saqë zogj të tillë si këta, që fluturojnë e kërkojnë ushqim duke klithur me zërat e tyre të hollë e të trishtuar duken aq të hajthëm përpara tij. ³⁷⁶	“Vallë përse i kanë krijuar zogjtë kaq delikatë dhe të dobët, siç janë dallëndyshet e detit, kurse oqeani është nganjëherë shumë i rreptë e mizor? Ai është i mirë edhe i bukur por, nganjëherë, pa pritur e papandehur, bëhet kaq irreptë sa zogjtë, që fluturojnë sipër tij duke u zhytur për të kërkuar ushqimin e tyre dhe duke i klithur njëri-tjetrit me zërat e tyre të dobëta dhe të trishtuara, duken shumë të brishtë përpara tij. ³⁷⁷

Ky paragraf e sjell më së miri interpretimin romantik që i bën personazhi kryesor luhatjeve që ka deti duke i krahasuar me karakterin e një gruaje. Po të vëmë re me kujdes, në versionin original Heminguei përdor përemrin vetor “she” dhe jo “he” kur i referohet oqeanit. Ndërsa dy përkthyesit shqiptarë e kanë përshtatur atë duke përdorur përemrin vëtor të gjinisë mashkullore “ai”.

³⁷⁴ Brenner, Gerry, *The Old Man and the Sea: Story of a Comman Man*, Boston, Twayne, 1991, fq. 92

³⁷⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 23

³⁷⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 33

³⁷⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 19

C. III .2.2 Ekuivalenca

Ekuivalenca përdoret në rastet kur kemi të bejmë me dy tekste që kanë dy stile dhe metoda strukturore tërësisht të ndryshme. Produkt i përdorimit të ekuivalencës janë dy tekste ekuivalente. Ekuivalencat, në shumicën e rasteve, janë të “ngurta” dhe përdoren sidomos në rastet e përkthimit të shprehjeve frazeologjike, proverbave, grupeve emërore, etj.³⁷⁸

Në monografinë e prof. dr. Ristanit, ekuivalenca përkufizohet si “përftesë përkthimore e emërtuar ekuivalencë ose ndryshe përkthim i barazvlefshëm, nëpërmejt së cilës vendosen marrëdhënie të barazvlefshmërisë kuptimore” cila përdoret në rastet kur ka mospërputhje sintaksore dhe leksikore ndërmjet njësisive gjuhësore përkatëse në gjuhën e burimit dhe të përkthimit.³⁷⁹

Siç parashtruam edhe më lart, Vinay and Dalbernet e cilësojnë përkthimin e orientuar nga ekuivalenca si “një procedurë e cila përsërit të njëjtën situatë si në original, por duke e formuluar në një mënyrë tjetër.”³⁸⁰ Ata thonë se në rastet kur përdoret kjo procedurë gjatë procesit të përkthimit ajo shkakton të njëjtin efekt stilistik që shkakton dhe teksti original te lexuesit.

Sipas tyre, ekuivalenca, siç u përmend dhe më sipër, është metoda ideale kur kemi të bëjmë me përkthim të proverbave, shprehjeve frazeologjike, tingujt onomatopeikë, etj.³⁸¹

Sipas Nidas ka dy lloje të ndryshme ekuivalencash, të quajtura ekuivalencë formale dhe ekuivalencë dinamike. Ekuivalenca formale fokusohet tek mesazhi që përcillet si te forma ashtu dhe te përmbajtja. Njësitë gjuhësore të gjuhës së origjinalit janë të barazvlefshme me njësitë gjuhësore të gjuhës së përkthimit. Megjithatë, ka raste kur nuk është e mundur të ketë një ekuivalencë formale mes dy gjuhëve.³⁸²

Ndërsa ekuivalenca dinamike bazohet mbi “parimin e efektit të njëjtë”. Ajo përkufizohet si parim i përkthimit sipas të cilit një përkthyes kërkon të përkthejë kuptimin e tekstit original në atë mënyrë që formulimi i tekstit në gjuhën e përkthimit do të shkaktojë të njëjtin efekt tek lexuesi i tekstit të përkthyer ashtu siç shkakton dhe teksti original tek lexuesit e tij.³⁸³

Baker ka një qasje përsa i përket ekuivalencës së përdorur si teknikë përkthimi. Në veprën e saj *Me fjalë të tjera: Libër Kursi mbi Përkthimin* ajo shkruan:

³⁷⁸ Hatim, Basil dhe Munday, Jeremy. *Translation: An advanced resource book*, New York: Taylor&Francis e-Library, 2004, fq. 150

³⁷⁹ Ristani, Viktor. *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Tiranë: Mirgeeralb, 2010, 129

³⁸⁰ Vinay, J.P, and J. Dalbernet. *Comparative Stylistics of French and English: a methodology for Translation*, translated by J.C Sager and M.J Hamel, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 1995, fq. 342

³⁸¹ Po aty, fq. 343

³⁸² Nida, Eugene A. *Towards a Science of Translating*, Leiden: E.J.Brill, 1964, fq. 167

³⁸³ Nida, Eugene A and C.R.Taber. *The Theory and Practice of Translation*, Leiden: E.J. Brill, 1969/1982, fq. 200

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

“Ekuivalenca tekstuale i referohet ekuivalencës mes tekstit të gjuhës origjinale dhe tekstit në gjuhën e përkthimit për sa i përket infomacionit dhe mënyrës se si përcillet. Struktura/ ndërtimi është një element shumë i rëndësishëm në procesin e përkthimit pasi ai shërben si një guidë për të kuptuarit dhe analizën e tekstit origjinal të cilat mund të ndihmojnë përkthyesin në përpjekjen e tij për të prodhuar një tekst që ka një lloj logjike dhe ndërtimi që vjen në mënyrë sa më natyrale që të jetë e mundur. Përkthyesi është ai që vendos nëqoftëse do të bëjë apo jo ndryshime dhe nese po sa të mëdha dhe çfarë lloji do të jenë ato.”³⁸⁴

Koller përshkruan pesë lloje të ndryshme të ekuivalencës:³⁸⁵

1 Ekuivalentimi denotativ ka të bëjë me ekuivalencën e përmbajtjes ekstralinguistike të një teksti. Letërsia tjetër e quan këtë "ndryshim të përmbajtjes".

2 Ekuivalenca konotative është e lidhur me zgjedhjet leksikore, veçanërisht midis sinonimeve të afërta.

3 Barasvlera-normative e tekstit ka të bëjë me llojet e tekstit, me llojet e ndryshme të teksteve që sillen në mënyra të ndryshme.

4 Ekuivalentimi pragmatik, ose 'ekuivalentimi komunikues', është i orientuar drejt marrësit të tekstit ose mesazhit. Kjo është e barazvlefshme me 'ekuivalencën dinamike' të Nidas.

5 Ekuivalenca formale, e cila ka të bëjë me formën dhe estetikën e tekstit, përfshin lojëra fjalësh dhe veçoritë individuale stilistike të tekstit të origjinalit. Ndryshe referohet si 'ekuivalentim shprehës' që të mos ngatërrohet me termin e Nidas.

Më poshtë do të trajtojmë disa shembuj të marrë nga libri original dhe dy versionet e përkthyer dhe do të vërejmë ndryshimet në secilin prej tyre.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
It made the boy <u>sad</u> to see the old man... ³⁸⁶	Djali <u>pikëlluhej</u> kur shihte plakun... ³⁸⁷	Djalit <u>i vinte</u> keq, kur shihte plakun... ³⁸⁸

³⁸⁴ Baker, Mona. *In Other Words: A Coursebook on Translation*. London: Routledge, 1992, fq. 134

³⁸⁵ Koller, W. , *The concept of equivalence and the object of translation studies*, Target, 1995, fq. 186-91

³⁸⁶ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 5

³⁸⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 17

³⁸⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 7

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
They sat on the Terrace and many of the fishermen made fun of the old man and he was not <u>angry</u> . ³⁸⁹	Ata u ulën në Terracë dhe shumë peshkatarë nisën të talleshin me plakun, por ai nuk u <u>zemërua</u> . ³⁹⁰	Ata u ulën në Taracë dhe shumë peshkatarë zunë të talleshin me plakun, por ai s’u <u>zemërua</u> . ³⁹¹

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
The old man looked at him with <u>his sunburned, confident, loving eyes</u> . ³⁹²	Plaku e vështroi <u>me sytë e tij të skuqur nga dielli, plot dashuri dhe besim</u> . ³⁹³	Plaku e vështroi <u>me ata syt’ e tij të ëmbël që ishin skuqur nga dielli, me ata sy ku pasqyrohej një besim i thellë</u> . ³⁹⁴

Në shembullin e parë vërejmë se mbiemri “sad” që përkthehet si “i/e mërzitur” është përkthyer me një folje nga të dy përkthyesit. Ata kanë zgjedhur folje të ndryshme për ta përkthyer atë por gjithsesi mesazhi që përcillet është i njëjtë me origjinalin, pra shprehje e keqardhjes së djalit për gjendjen e plakut.

Në shembullin e dytë kemi të njëjtën situatë, pra një mbiemër i cili është përkthyer me folje, mbiemri “angry” që do të thotë “i/e inatosur”, “i/e zemëruar” është përkthyer nga të dy përkthyesit me të njëjtën folje. Përsëri ndryshimi qendron vetëm tek kategoria gramatikore pasi tek kuptimi ka një ekuivalencë të plotë.

Në shembullin e tretë shohim se kemi të bëjmë me një ekuivalencë dinamike, pra që fokusi është mbi efektin e njëjtë dhe jo aq shumë mbi formën. Kadare i qëndron më tepër besnik origjinalit duke bërë vetëm disa ndryshime të vogla, ndërsa Kokona bën më tepër ndryshime. Ai zgjedh të sjellë një përkthim më të detajuar dhe të japë diçka nga vetja duke shtuar elementë të tjerë përveç atyre të versionit original. P.sh: “confident eyes” ai e

³⁸⁹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 6

³⁹⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 18

³⁹¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 8

³⁹² Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 8

³⁹³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 20

³⁹⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 9

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

sjell të përkthyer si “me ata sy ku pasqyrohej një besim i thellë”. Ai vë theksin së tepërmi tek besimi që plaku kishte për të ardhmen, pra jo thjesht një person me “sy të ëmbël”, por gjithashtu një person që beson.

“Sunburned eyes” përkthehet në të dy versionet duke sjellë ndryshim nga origjinali pasi në gjuhën shqipe nuk ka një term fiks që i përshtatet dhe si rezultat përkthyesi nuk ka zgjedhje tjetër vetëm të përdorë kategori të tjera gramatikore për ta sjellë në shqip.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Then if you hook <u>something</u> truly big we can come to your aid. ³⁹⁵	Pastaj, në qoftë se do të kapësh ndonjë <u>peshk</u> vërtet të madh, ne do të vijmë të të ndihmojmë. ³⁹⁶	Në zënç ndonjë <u>peshk</u> të madh, do të të ndihmojmë. ³⁹⁷

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Come on and eat. You can't fish and not eat. ³⁹⁸	Eja të hamë. S'mund të dalësh për të peshkuar pa ngrënë. ³⁹⁹	Eja të hamë. S'ke si shkon për peshk me bark të zbrazët. ⁴⁰⁰

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona

³⁹⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 9

³⁹⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 21

³⁹⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 10

³⁹⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 14

³⁹⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 25

⁴⁰⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 13

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Most fishermen <u>hated</u> the taste. ⁴⁰¹	Shumicës së peshkatarëve ky vaj <u>u kallte</u> krupën. ⁴⁰²	Shumica e peshkatarëve këtë vaj nuk e vinin në gojë, se <u>u kallte</u> krupën... ⁴⁰³
---	--	--

Në shembullin tjetër, kemi një ekuivalencë pothuajse të plotë në të dy versionet përveç fjalës “*something*” që zëvendësohet me “*peshk*”. Përkthyesit kanë zgjedhur ta përcaktojnë se për çfarë po flet autori edhe pse është pothuajse e qartë. “*Aid*” është përkthyer me një folje, por që pa patur asnjë ndryshim kuptimor, pra ata nuk kanë zgjedhur të thonë ‘*të të vijnë në ndihmë*, por “*të të ndihmojmë*”.

Në shembullin e dytë kemi të bëjmë me një rast ku përkthyesit e kanë sjellë në shqip duke përdorur fjalë të ndryshme. Fjalja e parë e cila është një fjali urdhëro përkthehet njësoj në të dy versionet duke i qëndruar tërësisht besnik origjinalit, shembull ky i ekuivalencës formale ku ruhen si përmbajtja ashtu dhe forma. Ndryshimi në mënyrën e të përkthyerit dallohet tek fjalja që vjen më pas. “*Not eat*” përkthehet nga Kadare si “*pa ngënë*” duke i qëndruar besnik origjinalit, ndërsa Kokoka, ashtu siç kemi vënë re edhe në shembujt e tjerë, zgjedh ta përkthejë një një tjetër mënyrë, si “*me bark të zbrazët*”. Vërejmë se Kokona përqëndrohet më tepër tek përmbajtja e mesazhit se sa tek forma e tij.

Në shembullin e tretë vërejmë që kemi të bëjmë me shprehje të ligjërimit libror të cilat vijnë më së miri dhe në dy versionet në gjuhën shqipe. Folja *hated* përkthehet nga të dy përkthyesit si *u kallte krupën*, një shprehje kjo e cila, në shqip, përdoret kur diçka nuk na pëlqen aspak, biles shkojmë deri në atë pikë sa ndjejmë dhe neveri për të. Kjo është një gjetje shumë e mirë për të transmetuar atë çfarë autori ka dashur të shprehë. Po të ishte përkthyer si “*urrenin*” nuk do të kishte të njëjtin efekt pasi kjo fjalë, në gjuhën tonë, përdoret me tepër për t’iu referuar njerëzve dhe jo gjërave në përgjithësi.

Më poshtë do të analizojmë disa shembuj të tjerë që janë ilustrim i ekuivalencës:

Shembull 1

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
But he makes the difference. ⁴⁰⁴	Por ai është ndryshe. ⁴⁰⁵	...por ai vendos rezultatin e lojës. ⁴⁰⁶

⁴⁰¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 30

⁴⁰² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 39

⁴⁰³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 24

⁴⁰⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 15

⁴⁰⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 27

⁴⁰⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 14

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Sleep well old man. ⁴⁰⁷	Gjumin e ëmbël o plak. ⁴⁰⁸	Gjumë të ëmbël o plak. ⁴⁰⁹

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He was asleep in a short time... ⁴¹⁰	Gjumi e zuri shpejt... ⁴¹¹	E zuri gjumi menjëherë... ⁴¹²

Në shembullin e parë shohim se është Kadare ai i cili përsëri i qëndon pothuajse 100% besnik origjinalit, përveç faktit që emri “*difference*” përkthehet me një ndajfolje, por e cila nuk sjell asnjë ndryshim nga ana kuptimore dhe kjo zgjedhje mund të jetë bërë thjesht me qëllimin që struktura e fjalisë të jetë sa më afër strukturës shqipe që të vijë sa më natyrale tek lexuesi. Po të analizojmë përkthimin e Kokonës shohim ndryshime të dukshme në zgjedhjen e fjalëve që ai bën. Fjalitë, në një vështrim të parë jashtë kontekstit, duket se nuk ka asnjë lidhje me versionin original. Sigurisht që në kontekst kuptohet se përkthyesi ka vendosur ta sjellë në shqip duke bërë disa ndryshime në të gjitha pjesët e fjalisë. Ai ka përdorur fjalë të cilat janë shumë ndryshe nga origjinali, por që efekti është po ai. Në këtë rast kemi të bëjmë me një shembull të ekuivalencës dinamike.

Në shembullin e dytë vërejmë se të dy versionet e përkthyer janë pothuajse të njëjta me njëra-tjetrën me përjashtim të faktit se Kadare emrin *gjumë* e ka përdorur në rasën kallzore të trajtës së shquar ndërsa Kokona në trajtën e pashquar. Po t’i krahasojmë këto dy versione me atë origjinal shohim se ka pak ndryshime në formë, kuptimi mbetet po ai. Kemi një ndajfolje të përkthyer me mbiemër, por pavarësisht kësaj nuk ka ndryshime në përmbajtje.

⁴⁰⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 18

⁴⁰⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 29

⁴⁰⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 16

⁴¹⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 18

⁴¹¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 29

⁴¹² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 16

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Në shembullin e tretë shohim se ka disa ndryshime, si p.sh *he was asleep* është përkthyer në të dy versionet me emrin *gjumi*, *in a short time* është përkthyer nga të dy përkthyesit me një ndajfolje mënyrë, por që secili ka përdorur një të ndryshme. Kadare e sjell në shqip si *shpejt*, ndërsa Kokona e përkthen si *menjëherë*. Në versionin e dytë kemi dhe një inversion, fjalia fillon me një trajtë të shkurtër të rasës kallzore, më pas vjen folja, kryefjala e kështu me radhë. Përsëri, ashtu si dhe në shembujt që analizuam më sipër nuk kemi ndryshim në përmbajtjen e mesazhit që përcillet në gjuhën shqipe.

Në veprat e ndryshme që përkthehen ndeshemi me huazime, kryesisht me ato latine. Këto fjalë lihen shpesh herë ashtu siç janë për të krijuar marrëdhënie të njëjta për sa i përket sociolektit të tyre duke ruajtur në këtë mënyrë efektin e tërësisë ligjërimore dhe për rrjedhojë reagimi të të dyja palëve të lexuesve, si ato që lexojnë veprën origjinale ashtu dhe ata që lexojnë versionin e përkthyer, të jetë i njëjtë.

Më poshtë do të shohim se si disa shprehje, të cilat nuk janë huazime të mirëfillta, por janë lënë ashtu për shkak të kontekstit, do të vijnë në gjuhën shqipe por a do të kenë të njëjtin efekt si në origjinal?

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Que <u>va</u> , the boy said. It is what a man must do. ⁴¹³	Que <u>va</u> , tha djali. Kështu e kanë punët e burrave. ⁴¹⁴	Que <u>va</u> , tha djali. Kështu duhet të bëjë burri. ⁴¹⁵

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He always thought of the sea as <u>la mar</u> which is what people call her in Spanish when they love her. ⁴¹⁶	Gjithmonë në mendimet e tij e quante detin <u>la mar</u> , siç i thonë spanjisht njerëzit që e duan atë. ⁴¹⁷	Në mendjen e tij detin e quante gjithmonë <u>la mar</u> , ashtu siç e quajnë spanjisht ata që e duan atë. ⁴¹⁸

⁴¹³ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 20

⁴¹⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 30

⁴¹⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 17

⁴¹⁶ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 23

⁴¹⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 33

⁴¹⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 19

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
<u>Agua mala</u> , the man said. You whore. ⁴¹⁹	<u>Agua mala</u> , tha plaku. Bushtër e keqe. ⁴²⁰	<u>Agua mala</u> , tha plaku. Ah moj bushtër. ⁴²¹

Në të tre shembujt vihet re përdorimi i fjalëve spanjolle dhe në të tre rastet përkthyesit i kanë këto fjalë ashtu siç kanë qenë në versionin origjinal. Në shembullin e parë kemi përdorimin e një fjale që i përket ligjërimit bisedor dhe që fjalë për fjalë në anglisht përkthehet “*what goes*”. Përkthyesit mund të kenë vendosur ta lënë ashtu siç është për të sjellë atmosferën e plotë në të cilën zhvillohet ngjarja pasi po të përkthehej efekti mund të mos ishte i njëjtë.

Në shembullin e dytë vërejmë se edhe një fjalë e cila është thjeshtë e përkthyeshme si “*sea*” në anglisht dhe “*det*” në shqip është lënë qëllimisht e papapërkthyer. Siç shpjegohet në këtë fjali këtu flitet për një dashuri ndaj detit, për mënyrën se si njërëzitet që e duan atë e quajnë “në përkëdheli”. Pra, ata flasin për diçka që ka shumë rëndësi për ta, për një dashuri të madhe ashtu siç ishte dhe për plakun.

Në shembullin e tretë përdoret një shprehje e ligjërimit bisedor. Nëqoftëse do ta përkthenin *agua mala* i referohet një krijese deti, por me një konotacion negativ. Përkthyesit kanë zgjedhur ta lënë ashtu siç është pasi në këtë mënyrë përcillet plotësisht zemërimi dhe lodhja e madhe e plakut i cili në mes të detit “lufton” papushim për t’ia arritur qëllimit të tij. Fjala që ata përdorin më pas *bushtër* e konfirmon këtë gjë, pra tërbimin që e ka pushtuar këtë njeri.

Si rrjedhim, nëse do të japim një opinion të përgjithshëm në lidhje me faktin se të dy përkthyesit, si Kokona ashtu dhe Kadare, nuk i kanë përkthyer këto fjalë që i përkasin gjuhës spanjolle mund të themi se efekti i tyre është po aq i njëjtë dhe i fuqishëm sa dhe ai që vjen nga leximi i tekstit origjinal. Janë këto fjalë që sjellin tërësisht atmosferën e një momenti të vështirë siç është ai i të qenit i vetëm në mes të detit duke u sflitur dhe përpjekur fort për t’ia arritur qëllimit.

C. III. 2. 3 Transpozimi

Metoda e quajtur transpozim përfshin zëvendësimin e një fjale që i përket një kategorie të caktuar gramatikore më një tjetër pa ndryshuar përmbajtjen e mesazhit. Përveç faktit se kjo është një procedurë e veçantë përkthimore, transpozimi mund të përdoret edhe për

⁴¹⁹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 28

⁴²⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 38

⁴²¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 23

ndryshimet që ndodhin brenda të njëjtës gjuhë. Po ta shohim nga pikpamja stilistike, teksti bazë, original dhe ai i transpozuar nuk kanë të njëjtën vlerë.

Përkthyesit i sugjerohet që kur të përdori këtë metodë të kujdeset edhe për faktin se nuance stilistike nuk duhet të ndryshojë, ajo duhet të jetë e njëjtë pavarësisht ndryshimeve të bëra. Në të vërtetë version i transpozuar ngjan më tepër me një përkthim literal.⁴²²

Kur bëhet një analizë e strukturës gramatikore në konsideratë merren më tepër mënyra se si përkthyesi arrin të realizojë një kalim të strukturave të barazvlefshme nga gjuha origjinale në gjuhën e përkthimit, duke u bazuar tek rregullat e gjuhës së përkthimit. Ai/ajo arrin të përcjellë këto struktura gjuhësore nga njëra gjuhë në tjetrën duke u nisur nga disa faktorë ku më i rëndësishëm është audienca, pra bashkëbiseduesit apo lexuesit, statusi social i tyre, lloji i ligjërimit si dhe situatë ligjërimore. Këto faktorë janë tepër të rëndësishëm në mënyrë që përkthimi të jetë sa më i sukseshëm dhe i kuptueshëm për lexuesit e tekstit në gjuhën e përkthimit.

Në monografinë e tij prof. Ristani thekson: “Transpozimi është përftesë përkthimore që presupozon ndryshime dhe transformime të karakterit gramatikor gjatë kalimit nga gjuha e burimit në gjuhën e përkthimit.”⁴²³ Transpozimet mund të jenë të llojeve të ndryshme duke filluar nga ata më të tjeshtat që janë kalimin e emrave nga trajta e pashqur në atë të shquar apo dhe kalimin nga numri njëjës në shumës.

Sipas profesor Ristanit ka një grup tjetër transpozimesh, i cili lidhet drejtpërdrejtë me zbërthimet sintaksore të strukturave, ka të bëjë me ruajtjen ose shtrembërimin e mesazheve stilistike, ruajtjen ose shmangjen e dallimeve stilistike të ligjërimit, ruajtjen ose ndryshimin e natyrës së kundërvënieve stilistike. Në këtë grup dallojmë transpozimet e mëposhtme:

1. Strukturën mbiemër+emër të origjinalit
2. Në mënyrë që të ruhet natyra librore e ligjërimit propozohet zbërthimi i gerundit në emër+emër,
3. Kalimi nga struktura parafjalë-emër përfoljor, kjo mundëson ruajtjen e natyrës librore të ligjërimit
4. Kalimi nga struktura folje këpujore+parafjalë+mbiemër+emër+parafjalë ruhet natyra librore e ligjërimit, etj.⁴²⁴

Më poshtë do të analizojmë disa shembuj dhe do të vërejmë llojet e ndryshimeve dhe do të gjejmë disa ngjashmëri me llojet e transpozimeve të sipërpërmendura.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The	Përkthim në shqip nga	Përkthim në shqip nga
------------------------------	------------------------------	------------------------------

⁴²² Hatim, Basil dhe Munday, Jeremy. *Translation: An advanced resource book.*, New York: Taylor&Francis e-Library, 2004, fq. 150

⁴²³ Ristani, Viktor. *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Tiranë: Mirgeeralb, 2010, fq. 224

⁴²⁴ Po aty, fq. 225-227

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Old Man and the Sea	Ismail Kadare	Vedat Kokona
And there are many <u>tricks</u> . ⁴²⁵	Këtu ka të bëjë edhe <u>shkathtësia</u> . ⁴²⁶	Gjithë puna është që të jesh edhe i <u>shkathët</u> . ⁴²⁷

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Anyone can be a fisherman in May. ⁴²⁸	Në maj mund të peshkojë cilido. ⁴²⁹	Peshkatar në maj bëhet kushdo. ⁴³⁰

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Most people are <u>heartless</u> about turtles because a turtle’s heart will beat for hours after he has been cut up and butchered. ⁴³¹	Shumica e njerëzve janë <u>zemërgur</u> ndaj breshkave, sepse zemra e breshkës rreh edhe shumë kohë më vonë pasi ta kenë vrarë dhe ta kenë bërë copa. ⁴³²	Shumica e njerëzve sillen pa <u>mëshirë</u> me breshkat, sepse zemra e breshkës rreh edhe shumë kohë pasi ta kenë vrarë kafshën dhe ta kenë bërë copa. ⁴³³

Në shembullin e parë vërejmë se kemi të bëjmë me disa ndryshime të dukshme. Po të krahasojmë dy versionet në gjuhën shqipe vërejmë se ata e kanë përkthyer pothuajse në të njëjtën mënyrë, sidomos fjala “*tricks*” është përkthyer njësoj nga të dy si *shkathtësi*, pavarësisht se Kadare e përkthen me një emër, ndërsa Kokona e përkthen me një

⁴²⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 10

⁴²⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 21

⁴²⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 10

⁴²⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 13

⁴²⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 24

⁴³⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 12

⁴³¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 30

⁴³² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 39

⁴³³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 24

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

mbiemër: *i shkathët*. Kadare përdor një emër në numrin njëjës në ndryshim nga version original që është në numrin shumës. *There are* është përkthyer si *këtu ka të bëjë* nga Kadare dhe *gjithë puna është* nga Kokona. Pra, siç mund ta vërejmë ata e përkthyen këtë pjesë të parë të fjalisë në mënyra të ndryshme, por kuptimi mbetet po ai.

Në shembullin e dytë, vërejmë fillimisht një ndryshim në strukturë. Muaji *maj* është kaluar në fillim të fjalisë në versionin e Kadaresë, ndërsa Kokona e vendos atë në mes të fjalisë. Emri *fisherman* është përkthyer me një folje nga Kadare, pra kemi foljen modale *mund* + foljen *të peshkojë* në mënyrën lidhore. *Anyone* përkthehet në të dy versionet me një përemër të pacaktuar, pavarësisht faktit se zgjedhjet e bëra janë të ndryshme.

Në shembullin e tretë vërejmë se *heartless* është përkthyer po me një mbiemër të panyjshëm nga Kadare, duke i qëndruar besnik origjinalit, ndërsa në versionin e Kokonës kemi një ndryshim pasi ky mbiemër është përkthyer me një emër *mëshirë* duke i shtuar përpara një pjesëz mohore për të sjellë kuptimin e njëjtë me tekstin origjinal.

Më poshtë kemi tre shembuj të tjerë të cilët do t’i analizojmë për të parë ndryshimet që ka sjellë transpozimi i përdorur nga përkthyesit për të sjellë në shqip këto pjesë nga *Plaku dhe Deti*:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“I would like to take the Great Di Maggio fishing”, the old man said. ⁴³⁴	Kisha qejf të merrja në barkë për të peshkuar Di Maxhion e madh, tha plaku. ⁴³⁵	Sa mirë do t’ish sikur të merrnim në varkë Di Maxhion e Madh, tha plaku. ⁴³⁶

Shembull 2

⁴³⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 16

⁴³⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 27

⁴³⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 15

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Very well, Manolin, the old man said. I feel confident today. ⁴³⁷	Shumë mirë, Manolin, tha plaku. Sot kam shumë besim. ⁴³⁸	Shumë mirë, Manolin, tha plaku. Sot besoj se puna do të më shkojë mbarë. ⁴³⁹

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
For a long time now eating had bored him and he never carried a lunch. ⁴⁴⁰	Kish kohë që të ngrënë i qe mërziur dhe tani asnjëherë nuk merrte asgjë për të ngrënë në barkë. ⁴⁴¹	Buka i qe mërziur me kohë dhe s’merrte asgjë për të ngrënë në mëngjes në det. ⁴⁴²

Në shembullin e parë vërejmë se përkthyesit e kanë sjellë në dy mënyra të ndryshme këtë frazë të Heminguei. *I would like* përkthehet nga Kadare si *kisha qejf*, pra me një folje, ndërsa Kokona e përkthen në një mënyrë shumë të ndryshme *sa mirë*. Gerundi *fishing* është përkthyer me një formë të pashtjelluar të foljes nga Kadare, me atë paskajore *për të peshkuar*. Po të shohim versionin e Kokonës do të vërejmë se ai e ka shmangur atë, ka zgjedhur të mos e përkthejë këtë gerund po ta lejë të nënkuptuar.

Në shembullin e dytë shohim se fjalia e parë është përkthyer duke i qëndruar tërësisht besnik origjinalit si nga Kadare ashtu dhe nga Kokona. Po të kalojmë në analizën e fjalisë së dytë vërejmë se fraza është përkthyer me disa ndryshime nga të dy përkthyesit. *I feel confident* është përkthyer *kam shumë besim* nga Kadare, ndërsa Kokona e përkthen si *besoj se puna do të më shkojë mbarë*. Kështu, shihet qartë se ky i fundit ka zgjedhur të bëjë një lloj përfrazimi duke u bazuar dhe mbi kontekstin dhe të japë pak më tepër informacion për lexuesit e tekstit në gjuhën e përkthimit. *I feel confident* e përkthen me një folje të vetme, me foljen *besoj* duke e kompensuar më pas me “s qarimin” që jep.

⁴³⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 20

⁴³⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 31

⁴³⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 18

⁴⁴⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 21

⁴⁴¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 31

⁴⁴² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 18

Në shembullin tjetër shohim se Kadare ndjek të njëjtën strukturë si origjinali, pra e fillon në të njëjtën mënyrë, ndërsa Kokona e fillon fjalinë me kryefjalë. Kjo kryefjalë është e shprehur me një emër, pra gjerundi (gerund) i origjinalit *eating* është përkthyer me një emër të rasës emërore në trajtën e shquar: *buka*. Kadare e përkthen këtë gjerund me një emër të gjinisë asnjansë: *të ngrënë*. Pjesa tjetër e fjalisë përkthehet pothuase në të njëjtën mënyrë nga të dy përkthyesit. Në përgjithësi mund të themi se dy variantet shqip i kanë qëndruar besnik origjinalit duke bërë ndryshime të vogla në formë, por duke e ruajtur tërësisht përmbajtjen.

Pasi kemi analizuar dhe krahasuar dy versionet e përkthyer duke u nisur nga rrafshi stilistikor mund të arrijmë në përfundimin se pavarësisht mjeteve stilistikore të përdorura apo ndryshimeve në formë, përmbajtja dhe kuptimi ka mbetur po ai. Efekti që përcillet te lexuesit është i njëjtë edhe pse ka raste kur ndryshimet e bëra mund të jenë të mëdha.

D. III. Krahasim përkthimi i *Plaku dhe Deti* nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona në rrafshin pragmatik

“Pragmatika është studimi i gjuhës në përdorim. Është studimi i kuptimit, jo siç gjenerohet nga sistemi gjuhësor, por siç përcillet dhe manipulohet nga pjesëmarrësit në një situatë komunikuese”⁴⁴³

Baker merr në konsideratë aspekte të ndryshme të ekuivalencës pragmatike në përkthim, duke aplikuar koncepte gjuhësore përkatëse për transferimin ndërgjuhësorë. E gjejmë të nevojshme ndaljen shkurtimisht në tre aspektet kryesore të pragmatikës që janë:⁴⁴⁴

- koherenca
- presupozimi
- implikimi

Koherenca e një teksti, në lidhje me kohezionin, “varet nga pritjet dhe përvoja e dëgjuesit ose marrësit”.⁴⁴⁵ Është e qartë se kjo mund të mos jetë e njëjtë për lexuesit e tekstit të origjinalit dhe tekstit të përkthyer, vecanërisht nëse ka ndryshim të madhë mes kulturave.

Fusha e presupozimit është e lidhur ngushtë me koherencën. Përcaktohet nga Baker si “përfundim pragmatik”, megjithëse, mbase për çudi, ajo vetëm e diskuton atë shkurtimisht. Presupozimi ka të bëjë me njohuritë gjuhësore dhe ekstra-gjuhësore që dërguesi supozon se marrësi i ka ose që janë të nevojshme për të marrë mesazhin e dërguesit.⁴⁴⁶

⁴⁴³ Baker, Mona, *In Other Words: A Coursebook on Translation*, London: Sage Publication, 1992, fq. 217

⁴⁴⁴ Po aty, 219

⁴⁴⁵ Baker, Mona, *In Other Words: A Coursebook on Translation*, London: Sage Publication, 1992, fq. 219

⁴⁴⁶ Po aty, fq. 259

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Baker i kushton më shumë vëmendje implikimit, një formë tjetër e konkluzionit pragmatik, të cilën ajo e përkufizon si “çfarë do te thotë apo nënkupton folësi, në vend të asaj që thotë”. Koncepti i implikimit u zhvillua nga Paul Grice (1975), i cili përshkroi një seri rregullash të njohura si “maksima” që funksionojnë në bisedë normale bashkëpunimi. Këto janë:⁴⁴⁷

1. Sasia: Jepni sasinë e informacionit që është e nevojshme; mos jepni as me shumë as me pak.
2. Cilësia: Thuaj vetëm atë që e di se është e vërtetë ose atë që mund t’ a mbështesësh.
3. Përshtatshmëria: Ajo që ju thoni duhet të jetë e përshtatshme për bisedën.
4. Mënyra: Thuaj çfarë të duhet të thuash në një mënyrë që është e përshtatshme me mesazhin që dëshiron të japësh dhe që normalisht do të kuptohet nga marrësi.

Për më tepër, disa teoricienë shtojnë maksimen e mirësjelljes: Jini të sjellshëm në komentet tuaja.

Pjesëmarrësit në biseda hamendësojnë se personi me të cilin po flasin është duke ndjekur këto maksima dhe ata vetë bashkëpunojnë duke u përpjekur të kuptojnë atë që thuhet. Nga ana tjetër, ata gjithashtu kanë tendencë të jenë bashkëpunëtorë në ato që thonë dhe mënyrën se si e thonë atë. Është e qartë se kontekstet gjuhësore dhe kulturore janë thelbësore në kufizimin e gamës së implikimeve.

Veshtirësia më e madhe vjen në rastin kur kemi të bëjmë me përkthimin e tekstit të origjinalit në tekstin e përkthimit. Përkthyesi, përveç se ka njohurinë gjuhësore, është e rëndësishme të shqyrtojë kontekstin pragmatik të bisede apo ligjërimeve, në mënyrë që përkthimi të rezultojë i suksesshëm, që do të thotë të ruaje nuancën dhe mesazhin e origjinalit.

Në këtë kapitull do të përqëndrohemi më tepër në rrafshin pragmatik të veprës duke bërë një krahasim përkthimi për sa u përket dy versioneve shqip të këtij romani. Në çështjen e parë do të trajtohet konteksti historik dhe kulturor i veprës në mënyrë që të shohim se cilat janë kushtet historike në të cilat është shkruar kjo vepër dhe ndikimin që ato kanë pasur për sa u përket personazheve të krijuara nga Heminguei apo dhe situatave të ndryshme si dhe mënyrën e jetesës në ato vende si pasojë e këtyre kushteve historike.

Ana kulturore ka gjithashtu peshën e saj të madhe pasi në shumë pjesë të “Plaku dhe Deti” reflektohet kultura e vendeve në të cilat autori ka jetuar apo thjesht i ka vizituar. Ai ka sjellë copëza kulturash spanjolle apo kubane për t’i bërë pjesë të kësaj veprë e cila ka lënë gjurmë të mëdha në letërsinë amerikane. Në pjesën e parë do të ndalemi edhe tek versionet shqip të veprës, për të parë nëse janë transmetuar apo jo të gjithë elementët kulturorë dhe historikë dhe si kanë ndikuar ata në përkthimin e saj si dhe sa kanë arritur

⁴⁴⁷ Munday, Jeremy., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001, fq. 98-99

përkthyesit të sjellin për lexuesin shqiptar një panoramë të asaj shoqërie të varfër dhe jo të zhvilluar të atyre vendeve.

Në pjesën e dytë të do të përqëndrohemi tek idiomat dhe shprehet frazeologjike të veprës dhe do të krahasojmë mënyrën sesi ato kanë ardhur në gjuhën shqipe. Ky krahasim do të nxjerrë në pah ndryshimet apo të përbashkëtat e dy versioneve. Këtë gjë do ta arrijmë përmes shembujve ilustrues të përzgjedhur nga teksti origjinal dhe dy tekstet në gjuhën e përkthimit si dhe përmes këtij krahasimi do të shohim nëse është përcjellur mesazhi në të njëjtën mënyrë ashtu siç është në versionin origjinal apo ka pësuar ndryshime jo vetëm në formë por edhe në përmbajtje.

D.III.1 Rëndësia e kontekstit kulturor dhe historik si dhe ndikimi i tij në dy versionet e përkthyer të veprës

Gjatë jetës së tij, Heminguei është marrë me gjueti, peshkim, boks, aktivitete të cilat u mundua ti perfeksiononte, ashtu siç bëri dhe me të shkruarit. Në vitin 1930 ai jetoi në Key West në Florida, dhe më pas në Kubë. Eksperienca e tij si peshkatar në Gulf Stream dhe Karaibe ndikoi shumë që të bënte ato përshkrime aq të gjalla e të vërteta të punës së një peshkatari tek libri “Plaku dhe Deti”.⁴⁴⁸ Ai e njohu nga afër atë realitet dhe në këtë mënyrë ai pasqyroi tek romani i tij dhe ato çka kishte mësuar dhe përjetuar. Kështu, jeta e tij personale si dhe ndikimi historik dhe kulturor janë pasqyruar më së miri në këtë vepër.

Në fillim të vitit 1939, vit në të cilin ai shkoi në Kubë, ku dhe takoi njeriun i cili u bë frymëzim për personazhin e Santiagos tek “Plaku dhe Deti”, Heminguei filloi të planifikonte që historinë personale të këtij njeriu ta shndërronte në një histori të plotë që do të bëhej pjesë e një vepre të tij që është “Plaku dhe Deti”. Baker në librin e tij *Ernest Hemingway: A Life Story* shkruan që “historia personale e Santiago-s është një lloj historie që kulturalisht i përket Spanjës por gjithashtu dhe Europës.”⁴⁴⁹ Në fillim të vitit 1951, ai filloi më në fund ta shkruante këtë vepër.

Qeveria e presidentit kuban Prio Socarras ishte drejt rënies dhe në fakt u rrëzua në vitin 1952 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me mbështetjen e diktatorit Fulgencio Batista, i cili u dëbua më pas nga Fidel Kastro në vitin 1959. Heminguei shkroi “Plaku dhe Deti” duke qenë nën ndikimin e këtyre ngjarjeve historike. Brenner është i mendimit se “Ky roman pasqyron një model botëror të ndryshimeve sociale dhe ekonomike, ndryshime të cilat ekzistojnë dhe sot në vendet në zhvillim.”⁴⁵⁰

Në Kubën rurale të viteve 1930 dhe 1940 kultura e peshkimit ishte tradicionale për vendin, një kulturë e cila në fakt përbezej nga vendet e industrializuara të cilat e shihnin

⁴⁴⁸ Baker, Carlos, *Ernest Hemingway: A Life Story*, New York, Charles Scribner’s Sons, 1969, fq. 26

⁴⁴⁹ Po aty, fq. 30

⁴⁵⁰ Brenner, Gerry, *The Old Man and the Sea: Story of a Common Man*, Boston, Twayne, 1991, fq. 37

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

zhvillimin vetëm tek modernizimi i teknologjisë. Rrjedhimisht, Fuentes thekson faktin se “kjo kulturë pasqyrohet më së miri në të gjithë romanin.”⁴⁵¹

Heminguei e përshkruan Santiagon si një peshkatar të përkushtuar, zanati i të cilit lidhej me identitetin, sjelljen dhe të gjithë qënien e tij. “Peshkimi për të nuk ishte thjesht një mënyrë për të nxjerrë fitime dhe të ardhura, por edhe për të qetësuar shpirtin pasi ishte vetë kultura e vendit dhe mënyra sesi ai ishte rritur që e lidhte atë aq fort me detin dhe peshkimin” shkruan Smith.⁴⁵²

Për sa i përket lexuesit shqiptar besojmë së ai e ka gjetur dhe veten në disa pjesë ku flitet për peshkimin pasi ky ka qenë dhe në fakt akoma vazhdon të jetë pjesë e kulturës shqiptare pasi pozicioni gjeografik ka bërë të mundur këtë gjë. Përkthyesit kanë përdorur fjalë specifike që i referohen peshkimit, të cilat i kemi përmendur edhe në kapitujt paraardhës, si p.sh fuzhinjë apo kanxhë, etj. Ata e kanë përkthyer veprën për një lexues i cili është goxha i njohur me këtë lloj aktiviteti, edhe pse në veprë flitet për një kulturë dhe vend krejt ndryshe.

E gjithë jeta e Hemingueit u modelua mbi këtë temë, si dhe vetëvrasja që ai bëri pas publikimit të “Plaku dhe Deti” është provë e besimit që kishte ai tek kjo temë. Domethënia historike e këtij romani ishte dhe kulminacioni simbolik i një jete dhe karriere të suksesshme. Heminguei jetoi në Kubë për njëzetë vite. Ai ishte i dhënë pas shkrimeve që i referoheshin vendeve ku ai kishte jetuar apo vizituar. Si rezultat i kësaj, ai shkroi për një nga vendet më të preferuara të tij për të jetuar. Ndërsa Fuentes në librin e tij shkruan: “Fatkeqësisht, revolucioni i Fidel Kastros në Kubë e detyroi atë të largohej.”⁴⁵³

Nga ana tjetër, Heminguei sjell edhe personazhet e peshkatarëve më të rinj të cilët përdorin fitimet e tyre nga industria e naftës për të blerë motobarka të reja, pra për të modernizuar pajisjet që ata përdornin për peshkim. Peshkimi për ta ishte një mënyrë se si të përmirësonin jetën e tyre nga ana financiare.⁴⁵⁴ Ndërsa Santiago ushtronte këtë aktivitet duke përdorur metodat e vjetra, pa mjete të modernizuara, brezi i ri përqafoi ndryshimin, qoftë edhe në këto gjëra kaq të vogla.

Si një njeri që e njohte mirë kulturën spanjolle dhe që bënte udhëtime të shpeshta drejt Afrikës ai solli gjithashtu elementë të asaj kulture. Si një emigrant në Kubë ai është gjysëm amerikan dhe gjysëm kubanez. Elementët e kulturës kubaneze i gjejmë p.sh tek piktura e Vigin of Cobre që Santiago e mbante të varur në mur apo dhe në raste kur ai, në mes të detit dhe vështirësive përpiqet të thotë një lutje, qoftë edhe në mënyrë mekanike. Kjo do të thotë se në këtë roman ka prani të elementëve fetarë të cilët lidhen me kulturën katolike kubaneze. Këtë do ta ilustrojmë me disa shembuj nga version original dhe dy versionet e përkthyer të veprës:

⁴⁵¹ Fuentes, Norberto, *Hemingway in Cuba*, New York: Carol, 1984, fq. 62

⁴⁵² Smith, Paul, *A Reader's Guide to the Short Stories of Ernest Hemingway*, Boston, G. K. Hall, 1989, fq. 51

⁴⁵³ Fuentes, Norberto, *Hemingway in Cuba*, New York: Carol, 1984, fq. 56

⁴⁵⁴ Po aty, fq. 60

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
I am not religious, he said. But I will say ten Our Fathers and ten Hail Marys that I should catch this fish, and I promise to make a pilgrimage to the Virgin de Cobre if I catch him. That is a promise. ⁴⁵⁵	Unë nuk e besoj Zotin, tha. Por do të them dhjetë herë lutjen “Ati ynë” dhe dhjetë herë atë të Shën Mërisë po ta kap këtë peshk, dhe premtoj se do të bëj një pelegrinazh gjer te Virgjëresha e Kobres. Për këtë jap fjalën. ⁴⁵⁶	Unë s’jam fetar, tha. Por do të them dhjetë herë lutjen “Ati ynë” dhe po aq herë lutjen e “Shënmërisë” që të kap këtë peshk. Ja ku zotohem se do të shkoj në peleginazh në Shenmërinë e Kobresit, po ta kap me të vërtetë. Zotohem! ⁴⁵⁷

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Hail Mary full of Grace the Lord is with thee. Blessed art thou among women and blessed is the fruit of your womb, Jesus. Holy Mary, Mother of God, pray for us sinners now and at the hour of our death. Amen. Then, he added, Blessed Virgin, pray for the death of this fish. Wonderful though he is. ⁴⁵⁸	O Shënmëri e bekuar, Zoti qoftë me ty. E bekuar ti ndër gratë dhe i bekuar fruit i gjirit tënd, Jezu. O Zonja Shënmëri, falu për mëkatet tona tani dhe në çastin e vdekjes sonë. Amin. Pastaj shtoi: O Zonjë e Virgjër, lutu që peshku të vdesë. Ndonëse është kaq i bukur. ⁴⁵⁹	O Hirplota Zonja Shënmëri, Zoti është me ty. E bekuar je ti ndër gratë dhe I bekuar fryti I barkut tënd, Jezusi. O Shënmëri, Nënë e Perëndisë, lutu për ne mëkatarët tani dhe në orën e vdekjesonë. Pastaj shtoi: O Zonja Shëmëri, lutu të ngordhë peshku, ndonëse është i mrekullueshëm. ⁴⁶⁰

Në shëmbullin e parë, gjëja e parë që na bie në sy është fraza: “I am not religious”, pra para se të thotë lutjen Santiago e thekson se nuk është fetar apo “nuk e besoj Zotin” siç e përkthen Kadare. Megjithatë, ai përsëri premtim se do t’i thotë lutjet dhe se gjithashtu do të bëjë një pelegrinazh. Kjo gjë është tregues i kulturës së krishterë të atij vendi. Edhe pse ai nuk beson në një forcë të mbinatyrshme përsëri bën një premtim në një çast delikat për të. Kultura dhe edukata që ka marrë në atë vend e ka mësuar se kur je në vështirësi duhet

⁴⁵⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 54

⁴⁵⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 61

⁴⁵⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 41

⁴⁵⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 54-55

⁴⁵⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 61

⁴⁶⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 42

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

të kërkosh ndihmë dhe mbështetje tek Zoti dhe Santiago e bën këtë gjë pavarësisht se mekanikisht. Kështu duket që kultura ka një ndikim tepër të madh tek njeriu. Ky shembull na është transmetuar në gjuhën shqipe nga Kokona dhe Kadare në një formë pothuajse të njëjtë dhe na tregon së tepërmi për katolicizmin që është pjesë e kulturës së vendit ku zhvillohen ngjarjet e këtij romani.

Në shembullin e dytë shohim se kemi të bëjmë me një lutje të krishterë të mirëfilltë. Santiago fillimisht premton se do ta thotë lutjen e më pas, kur gjendet në një situatë edhe më të vështirë sesa e meparshmja, fillon dhe e thotë atë me të vërtetë. Ai ngre sytë drejt qiellit për të kërkuar ndihmë dhe pak fat në “betejën” që po bën me peshkun.

Për sa i përket përkthimit të kësaj lutjeje mund të themi se të dy përkthyesit e sjellin pothuajse në të njëjtën mënyrë, me ndryshime tepër të vogla, duke iu përshtatur mënyrës sesi kjo lutje thuhet në shqip. Në pjesën e fundit të lutjes del në pah fakti se Santiago po lutet sepse ka një arsye të fortë: vdekjen apo ngordhjen e peshkut siç e përkthen Kokona. Pavarësisht qëllimit, mjeti është lutja.

Përveç anës fetare e cila është pjesë e kulturës kubane, vërejmë edhe përshkrime të tjera që tregojnë për mënyrën e jetesës së njerëzve në Kubë. Përshkrimi i kasolles së plakut është tregues i mënyrës së jetesës së kubanëve . Shembulli i mëposhtëm e ilustron këtë:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
On the brown walls of the flattened, overlapping leaves of the sturdy-fibred guano there was a picture in the colour of the Sacred Heart of Jesus and another of the Virgin of Cobre ⁴⁶¹	Në muret ngjyrë kafe, të thurura me gjethe të dendura dhe me fibra guanos, ishin vënë piktura me ngjyra, njëra zemra e shenjtit e Jezuit dhe tjetra Shën Mëria e Virgjër e Kobres. ⁴⁶²	Muret e murrmë, që ishin ndërtuar me gjethe të shtypura fije-fije, ishin zbukuruar me oleografi me ngjyra të Zemrës së Krishtit dhe të Zonjës së Kobrenit. ⁴⁶³

Të gjithë elementët e përshkruar në këtë fragment tregojnë sesi ishin kasollet e peshkatarëve në Kubën e atyre viteve. Muret me gjethe dhe me fibra guanos tregojnë për varfërinë dhe kushtet e vështira në të cilat jetonin ata peshkatarë dhe sfidat me të cilat përballëshin. Ka dhe një fragment ku thuhet se plaku në vend të dyshekut përdorte gazeta apo dhe në vend të jestekut vendoste dorën. Këto element tregojnë për kushtet e mjerueshme në të cilat jetonte peshkatarin i vjetër e megjithatë nuk hiqte dorë nga qëllimet

⁴⁶¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 10-11

⁴⁶² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 22

⁴⁶³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 11

e tija. Piktura në mur është gjithashtu tregues kulturor që ka përdorur Heminguei për të përcjellë sa më mirë kulturën kubane tek lexuesi dhe përkthyesit e sjellin atë në gjuhën shqipe.

D. III.2 Krahasim në përkthimin e idiomave dhe shprehjeve frazeologjike

Idioma është një shprehje me ndërtim të veçantë, tërësisht apo pjesërisht të ngurosur, që përdoret në një gjuhë dhe ka një kuptim të njësishtëm i cili nuk del drejtpërdrejt nga shuma e kuptimeve të fjalëve përbërëse si dhe që nuk mund të përkthehet fjalë për fjalë nga një gjuhë në një tjetër. Neubert shkruan kështu: “Ajo është një fjalë e veçantë që përdoret në kuptim të figurshëm vetëm në një gjuhë e që nuk mund të përkthehet drejtpërsëdrejti në gjuhë të tjera.”⁴⁶⁴

Idiomat mund të shprehin një pjesë të kulturës së një kombi dhe shërbejnë si një tregues i rëndësishëm i saj. Ky kapitull synon të dallojë grupe të caktuara idiomash dhe shprehjesh frazeologjike të cilët ruajnë të njëjtin kuptim gjatë përdorimit paralel në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në shembujt e mëposhtëm do të shohim disa nga shprehjet frazeologjike të përdorur nga autori si dhe versionet e tyre në gjuhën shqipe.

Shembull 1

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
I wonder if he has any plans or if <u>he is just as desperate</u> as I am? ⁴⁶⁵	Dua të di mos vallë ka ndonjë plan dhe ai, apo <u>ikën me kokë në torbë</u> , si unë? ⁴⁶⁶	A e di vallë se ç’po bën apo <u>sulet kuturu</u> si unë? ⁴⁶⁷

Shembull 2

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona

⁴⁶⁴ Neubert, A Shreve, G.M, *Translation as Text*, Kent State University Press, 1992, fq. 190

⁴⁶⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 40

⁴⁶⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 48

⁴⁶⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 31

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

...when the bettors were asking that <u>it be called a draw</u> and the referee was shaking his head... ⁴⁶⁸	...kur ata që kishin vënë bast kërkuan që të <u>dilnin jek e jek</u> dhe arbitri tundi kokën... ⁴⁶⁹	...kur ata që kishin vënë bast kërkuan që arbitri t'i <u>nxirrte fitafit</u> dhe kur ai i mblodhi supet... ⁴⁷⁰
--	--	---

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
That way <u>nothing is accomplished</u> , he thought. ⁴⁷¹	Kështu si e kam zënë <u>s'kam gjë në vijë</u> , mendoi. ⁴⁷²	Kështu si kam zënë <u>s'kam për të nxjerrë gjë në krye</u> . ⁴⁷³

Në shembullin e parë vërejmë se edhe pse në versionin original nuk kemi të bëjmë me një shprehje frazeologjike, por thjesht me një fjali e cila shpreh një gjendje të caktuar të personazhit në fjalë, pra Santiagos, në shqip përkthehet ndryshe. Në versionin e përkthyer nga Kadare vërejmë se ka ardhur në shqip me një shprehje frazeologjike “ikën me kokë në torbë”. Përkthyesi ka zgjedhur këtë shprehje frazeologjike për të transmetuar sa më mirë gjendjen në të cilën ndodhej personazhi kryesor i veprës, duke theksuar kështu faktin se ai ishte tejet i dëshpëruar, pa ndonjë zgjidhje të mundshme për situatën. Fjala *torbë* përkufizohet si trastë dhe “me kokë në torbë” do të thotë në rrezik të madh, pa asnjë shpresë, pa rrugëdalje.⁴⁷⁴

Ndërsa Kokona zgjedh ta përkthejë si “sulet kuturu” për të theksuar gjithashtu se ashtu si plaku nuk kishte ndonjë drejtim apo plan të caktuar, përveç faktit se donte ta kapte peshkun, ashtu dhe peshku nuk “dinte si të shpëtonte”. Ndajfolja *kuturu* përkufizohet si “me hamendje, pa të dhëna të përpikta e të sigurta, pa një drejtim të caktuar, pa e ditur se ku”.⁴⁷⁵ Mund të themi se dy përkthyesit kanë zgjedhur ta sjellin këtë fjali në mënyra të ndryshme, duke ruajtur kuptimin fillestar. Vërejmë se ka ndryshime në formë, si në krahasim me origjinalin, ashtu dhe me njëri-tjetrin por ajo që mbetet e pandryshuar është mesazhi që transmetohet.

⁴⁶⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 59

⁴⁶⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 65

⁴⁷⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 45

⁴⁷¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 79

⁴⁷² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 83

⁴⁷³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 59

⁴⁷⁴ www.fjalorshqip

⁴⁷⁵ www.fjalorshqip

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Në shembullin e dytë kemi një shprehje frazeologjike “call it a draw” që në anglisht mund të shpjegohet në këtë mënyrë: *if a person wants to escape the situation by ending the fight, so proposes that they “call it a draw” since it is an equal outcome for both sides, but in fact it isn’t.*⁴⁷⁶ Kjo shprehje përdoret në rastet kur personi që e ndjen se po humbet dëshiron të shpallë barazimin pasi sipas tij/saj rezultati gjithsesi do të jetë i njëjtë për të dyja palët, por në fakt nuk është kështu pasi e bën këtë gjë vetëm për t’i shpëtuar humbjes.

Kadare e përkthen si “*të dilnin jek e jek*”, një shprehje e cila gjen përdorim të gjërë në gjuhën shqipe në vend të fjalës barazim. Ai e përdor këtë shprehje për të përcjellë tek lexuesi të njëjtën ndjesi që përjeton dhe lexuesi i tekstit original, por nuk kemi të bejmë thjesht me një barazim dosido, por të sajuar. Nga ana tjetër, Kokona e përkthen po ashtu me një shprehje tipike për këtë rast: *fitafit*. Kjo është një tjetër shprehje që përdoret në vend të fjalës “barazim”. Kjo është një shprehje që përdoret në biseda jo formale, ashtu siç ishte dhe ky shembull.

Shembulli i tretë ka pak ngjashmëri me shembullin e parë pasi edhe në këtë rast në versionin në gjuhën angleze nuk ka përdorim të një shprehjeje frazeologjike apo idiome. Ajo mund të përkthehet edhe thjesht si p.sh “në këtë mënyrë nuk mund të arrij apo bëj asgjë”, por përkthyesit kanë zgjedhur ta sjellin në forma të tjera. Kadare e përkthen “*s’kam gjë në vijë*” që në gjuhën shqipe përdoret për të theksuar se dikush nuk i ka punët mirë, nuk po i ecën mbarë apo ashtu siç duhet dhe dëshiron ai/ajo. Mund të themi se përkthyesi zgjedh ta sjellë në këtë formë në gjuhën shqipe për të theksuar sa më shumë që është e mundur mënyrën sesi personazhi kryesor ndihet apo si mendon. Përdorimi i kësaj shprehjeje e përcjell këtë gjë me forcën e duhur dhe nuk e lë të vakët.

Kokona, po ashtu, nuk i qëndron besnik origjinalit duke e përkthyer këtë frazë si “*s’kam për të nxjerrë gjë në krye*” që do të thotë se me këtë mënyrë që po përdor nuk do të arrij të realizoj atë që kam si qëllim. Edhe ai, si Kadareja, përdor një shprehje të tillë si për të theksuar vështirësinë në të cilën plaku ndodhet dhe përpjekjet e tij për të gjetur një rrugëdalje.

Më poshtë do të shohim disa shembuj të tjerë dhe do të analizojmë si kanë ardhur ata në gjuhën shqipe.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
---	-------------------------------------	------------------------------------

⁴⁷⁶ Përkth: nëse një person dëshiron t’i shpëtojë situatës duke i dhënë fund luftës, atëherë propozon që ata “ta quajnë atë një barazim” pasi që është një rezultat i barabartë për të dy palët, por në fakt nuk është.

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

<u>Bad luck to your mother.</u> ⁴⁷⁷	<u>E hëngërt mortja tët ëmë.</u> ⁴⁷⁸	<u>Ters i shkoi tët ëmë.</u> ⁴⁷⁹
--	---	---

Shembull 2

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Don't think old man, he said aloud. Sail on this course and <u>take it when it comes.</u> ⁴⁸⁰	Mos u mendo, plak, tha me zë të lartë. Lundro në drejtimin që ke marrë dhe <u>përballo të keqen kur të të vijë.</u> ⁴⁸¹	Mos u mendo, o plak, - tha me zë të lartë. Lundro në drejtim të erës dhe <u>dili përpara fatkeqësisë kur të të vijë.</u> ⁴⁸²

Shembull 3

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He came <u>like a pig to the trough</u> if a pig had a mouth so wide that you could put your head in it. ⁴⁸³	Ai u afrua <u>si derri të korrita</u> , në qoftë se derri do të kish një gojë aq të gjerë sa të fusje kokën. ⁴⁸⁴	Ai u afrua <u>siç i afrohet derri koritës</u> , vetëm se derri nuk ka një gojë kaq të madhe për ta kollofitur përnjëherë kokën e njeriut. ⁴⁸⁵

Në shembullin e parë vërejmë se përkthyesit kanë zgjedhur ta sjellin në shqip këtë formë mallkimi që Santiago i bën presë së tij. Kadare e ka sjellë në një formë të ndryshme nga origjinali, duke përdorur një mallkim që në gjuhën shqipe përdoret rëndom: “E hëngërt mortja”. Në këtë mënyrë ai e ka përshatur frazën për lexuesin shqiptar duke transmetuar tek ai gjithë mllefën që personazhi kryesor ndjente në ato çaste të vështira për të duke ndryshuar formën por jo përmbajtjen e mesazhit.

⁴⁷⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 87

⁴⁷⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 90

⁴⁷⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 65

⁴⁸⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 89

⁴⁸¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 92

⁴⁸² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 66

⁴⁸³ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 96

⁴⁸⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 99

⁴⁸⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 71

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Nga ana tjetër, Kokona i përafrohet versionit origjinal si në formë dhe në përmbajtje. Ai e përkthen frazën si “Ters i shkoi tët ëme” duke përcjellë tek lexuesi gjithë zemërimin që plaku ndjente në ato moment. Fjal *ters* do të thotë *nuk shkon mbarë*. Sic shihet, në këtë rast Kokona mundohet t’i qëndrojë besnik versionit origjinal.

Në shembullin e dytë kemi të bëjmë me një idiomë e cila mund të shpjegohet: “to deal with difficulties as they happen, without worrying too much”⁴⁸⁶⁴⁸⁷ Kështu kjo shprehje idiomatike tregon se jetën duhet ta jetojmë ashtu siç na vjen, duke u përballur me vështirësitë pa u shqetësuar shumë. Në gjuhën shqipe kemi disa shprehje që janë të ngjashme me kuptimin që përcjell kjo shprehje në gjuhën angleze, si p.sh: “jetoje jetën si të vijë” apo dhe “kur e keqja të vjen thjesht hapi derën.”

Kadare e ka përkthyer këtë idiomë si: “*përballo të keqen kur të të vijë*.” Ky version i përkthyer është një lloj perifrazimi i shprehjes në origjinal pasi i përshtatet situatës në të cilën ndodhet plaku dhe forcën që ai mundohet t’i japë vetes me këtë frazë që e thotë në mes të detit, i vetëm dhe me një “mik-armik” të fuqishëm.

Kokona e ka përkthyer idiomën si “*dili përpara fatkeqësisë kur të të vijë*”. Kjo mënyrë e të përkthyeri është pothuajse e njëjtë me atë të Kadaresë. Ka një lloj përshtatjeje me situatën në të cilën ndodhet personazhi kryesor. Në të dy versionet përmendet fatkeqësia dhe në këtë mënyrë ata pasqyrojnë më me qartësi situatën në të cilën ndodhet plaku, një situatë e vështirë dhe e pashpresë. Në këtë rast mund të themi se të dy versionet shqip nuk kanë shumë ndryshime për sa i përket formës, ndërsa përmbajtja është e njëjtë dhe sjell po atë efekt tek lexuesi.

Në shembullin e tretë, shohim se ka një krahasim të peshkaqenit me nje derr pasi, ashtu siç derri nuk përbuz asnjë lloj ushqimi apo dhe mbeturina, ashtu dhe peshkaqeni, si i babëzitur mundohet t’a hajë peshkun. Në gjuhën shqipe ka një shprehje e cila është ekuivalente e “*like a pig to the trough*” dhe si Kadare ashtu dhe Kokona e kanë sjellë në përkthimin e tyre si “*si derri te korita*”. Korita përkufizohet si *një enë druri ku hidhet ujë ose ushqim për bagëtitë apo shpendët*.⁴⁸⁸

Mund të themi se në të dy versionet e “Plaku dhe Deti” në gjuhën shqipe është ruajtur forma dhe përmbajtja duke sjellë të njëjtin efekt tek lexuesi shqiptar. Teksa lexojmë këto shprehje arrijmë ta ndiejmë atë inatin dhe mlefën që ka plaku ndaj atij peshkaqeni që po i merr atë për të cilën ai kishte luftuar aq fort dhe me shpirt ndër dhëmbë arriti ta mposhte, por që nuk mund t’i gëzohej fitores për shkak të “grykësisë” të peshkaqenit të cilin ai e krahason me një derr që zhytet në ushqim.

Në këtë kapitull kemi analizuar dy versionet e përkthyer të “Plaku dhe Deti” nga një këndvështrim pragmatik duke u ndalur në pjesën e parë në kushtet historike dhe elementët kulturorë të veprës si dhe ndikimin që ato kanë patur. Kemi analizuar gjithashtu dhe ndikimin që këto kushte kanë patur mbi përkthimet që i janë bërë veprës

⁴⁸⁶ *Oxford Idioms Dictionary*, Spain, Oxford University Press, 2005, fq. 390

⁴⁸⁷ Përkth: “të merresh me vështirësi ashtu siç ndodhin, pa u shqetësuar shumë”

⁴⁸⁸ www.fjalorishqip.com

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona dhe kemi vërejtur se këto përkthime kanë sjellë për lexuesin shqiptar panoramën e Kubës nën ato ndikime historike si dhe kulturore.

Në pjesën e dytë kemi trajtuar shprehjet frazeologjike dhe idiomat duke bërë një krahasim përkthimi mes dy varianteve shqip. Këtë krahasim e kemi realizuar me anë të shembujve të marrë nga version origjinal dhe dy versionet në gjuhën e përkthimit. Ajo që kemi vënë re është se në këto shembuj nuk viret re ndryshime në përmbajtje. Ndryshimet e vetme i kemi gjetur në formë e cila është përshtatur në varësi të gjuhës shqipe, por që nuk kanë patur ndikim tek mesazhi i përcjellë tek lexuesi shqiptar. Shprehjet e përdorura nga përkthyesit kanë sjellë emocionet e personazhit kryesor në atë mënyrë që nuk bën dallim me versionin origjinal.

KREU IV

Krahasim analitik mbi llojet e përkthimit të përdorura nga Kadareja dhe Kokona në dy versionet përkatëse të përkthimit të veprës *Plaku dhe Deti*

“Një përkthyes, ndoshta më shumë se çdo praktikues tjetër i një profesioni, është vazhdimisht i ballafaquar me zgjedhje, për shembull kur ai duhet të përkthejë fjalë që tregojnë cilësi, sesa objekte ose ngjarje. Në zgjedhjen e tij, ai po ndjek intuitivisht ose me vetëdije një metodë të përkthimit, ashtu si çdo mësues i gramatikës mëson një metodë të gjuhësisë. Përkthimi thërret një teori që të hyje në veprim; përkthyesi rishikon kriteret për opsionet e ndryshme përpara se të bëjë zgjedhjen e tij si procedurë në veprimtarinë e tij përkthyesë.”⁴⁸⁹

M shprehjen e mësipërme duam të theksojmë se secili përkthyes merr përsipër të zbatojë metodat e tija/saja për realizimin e procesit të përkthimit të veprës dhe kështu në këtë kre do të ndalemi tek metodat e përkthimit që kanë përdorur Ismail Kadare dhe Vedat Kokona për të sjellë në shqip veprën “Plaku dhe Deti” të Ernest Heminguei si dhe do të bëjmë një krahasim analitik mbi këto metoda. Shembujt e marrë nga libri origjinal si dhe dy versionet e përkthyer dhe do të shërbejnë si mjete ilustruese në këtë krahasim përkthimi. Fillimisht do të japim disa përkufizime për secilën prej këtyre metodave dhe më pas do të ndalemi në shembujt që do të tregojnë se si këto metoda përdoren në praktikë dhe sa efikase janë duke marrë parasysh mesazhin që autori ka përcjellë.

Newmark në veprën e tij *A textbook of Translation* përshkruan procesit e përkthimit si një proces i cili fillon me zgjedhjen e një metode. Së dyti, kur jemi duke përkthyer, kemi parasysh katër nivele:

-1 niveli i tekstit të gjuhës së origjinalit, niveli i gjuhës, nga ku fillojmë dhe të cilit i kthehemi vazhdimisht;

-2 niveli i referencës, niveli i objekteve dhe ngjarjeve, reale ose imagjinare, të cilat i vizualizojmë dhe ndërtojmë në mënyrë progresive, dhe që është një pjesë thelbësore, së pari të kuptuarit, pastaj procesi i riprodhimit;

-3 niveli koheziv, i cili është më i përgjithshëm, dhe gramatikor, i cili gjurmon rrjellen e mendimit, tonin e ndjenjës (pozitiv ose negativ) dhe presupozimet e ndryshme të tekstit të origjinalit. Ky nivel përfshin të kuptuarit dhe riprodhimin: ai paraqet një pamje të përgjithshme, për të cilën mund të na duhet të rregullojmë nivelin e gjuhës;

-4 nivelin e natyralitetit të gjuhës së përbashkët të përshtatshme për shkrimtarin, përkthyesin dhe më vonë lexuesin

⁴⁸⁹ Newmark, Peter, *A Textbook of Translation*. New York: Prentice-Hall International, 1988, fq. 8

-Në fund, ekziston procedura e rishikimit. Kjo procedurë përbën të paktën gjysmën e procesit të plotë.⁴⁹⁰

Ai gjithashtu përmend ndryshimin që ekziston mes metodave dhe procedurave të përkthimit. Ai citon se: “metodat e përkthimit përdoren për të trajtuar apo analizuar të gjithë tekstin ndërsa procedurat e përkthimit përdoren për të analizuar apo përkthyer fjali apo njësi më të vogla gjuhësore brenda një teksti.”⁴⁹¹

Sipas Mildred L.Larson “përkthimi klasifikohet në dy lloje kryesore, përkatësisht përkthim të bazuar në formë dhe përkthim të bazuar në kuptime. Përkthimi i bazuar në forma përpiket të ndjekë formën e gjuhës se origjinalit dhe njihet si përkthim i mirëfilltë, ndërsa përkthimi i bazuar në kuptime bën çdo përpjekje për të komunikuar kuptimin e tekstit origjinal në format natyrore të gjuhës së receptorit.”⁴⁹² Ai shton “Një përkthim i tillë quhet përkthim idiomatik. Një përkthim fjale për fjale ka pak vlerë komunikimi”⁴⁹³

Në veprën e tij *Përkthim i bazuar në kuptim*, Larson duket se favorizon përkthimin idiomatik ndaj atij fjalë për fjalë duke shkruar: “përkthimet idiomatike përdorin format natyrore të gjuhës së përkthimit si në ndërtimet gramatikore ashtu edhe në zgjedhjet e mjeteve leksikore. Një përkthim vërtet idiomatik nuk tingëllon si përkthim. Duket sikur është shkruar fillimisht në gjuhën e përkthimit. Prandaj, një përkthyes i mirë do të përpiket të përkthejë idiomatikisht. Ky është qëllimi i tij / saj.”⁴⁹⁴

Në këtë kapitull do të trajtojmë disa nga llojet e përkthimit të klasifikuara nga Newmark që janë:⁴⁹⁵

Përkthimi fjalë për fjalë është përkthimi në të cilin ruhet forma por mund të humbasin elementë nga përmbajtja pasi fjalët përkthehen dhe u marrë si njësi të veçanta dhe jo si pjesë të një fjalie apo teksti. Në këtë mënyrë kontakti nuk merrtë në konsideratë dhe për këtë arsye mesazhi mund të mos përcillet në mënyrën e duhur.

Përkthimi strukturor është përkthimi në të cilin ruhet rendi i fjalëve ashtu siç është në tekstin e gjuhës origjinale për t’u sjellë po në atë formë dhe në tekstin e gjuhës së përkthimit. Në këtë lloj përkthimi vëmendja e përkthyesit përqëndrohet mbi strukturën e fjalisë.

Përkthimi besnik është përkthimi, qëllimi i të cilit, është të riprodhojë kuptimin sa më të saktë kontekstual të tekstit në gjuhën origjinale duke iu përshtatur strukturave gramatikore të gjuhës mbërritëse duke u kujdesur si për formën ashtu dhe për përmbajtjen.

⁴⁹⁰ Newmark, Peter, *A Textbook of Translation*. New York: Prentice-Hall International, 1988, fq. 19

⁴⁹¹ Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 57

⁴⁹² Larson, Mildred L., *Meaning-based Translation*, University Press of America, New York, 1997, fq. 15

⁴⁹³ Po aty

⁴⁹⁴ Po aty, fq. 16

⁴⁹⁵ Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 81-86

Përkthimi semantik është një përkthim i cili ndryshon nga përkthimi besnik duke qenë se ai përqëndrohet më tepër mbi vlerat estetike të tekstit në gjuhën e përkthimit. Përkthyesi e kthen vëmendjen e tij tek stili i autorit dhe mënyra sesi ai e ka përdorur gjuhën.

Përkthimi me përshtatje është dhe forma më e lirë e përkthimit dhe ky lloj përkthimi përdoret kryesisht për veprat dramatike, si p.sh komeditë apo gjithashtu edhe poezia. Përmes këtij lloj përkthimi ruhen temat, personazhet si dhe përmbajtjet si dhe gjithashtu kultura e gjuhës në të cilën është shkruar vepra përshtatet me kulturën në të cilën do të përkthehet. Mund të themi se në këtë mënyrë teksti rishkruhet duke ruajtur elementët më kryesorë edhe pse është bërë një lloj përshtatjeje e cila e bën tekstin më të kuptueshëm për lexuesin e gjuhës së përkthimit.

Përkthimi i lirë: ashtu siç e tregon dhe vetë emërtimi, është një përkthim që realizohet pa marrë shumë parasysh stilin, formën apo dhe përmbajtjen e origjinalit. Mund të themi se duke përdorur këtë formë përkthyesi ruan vetëm esencën e origjinalit por pa u kujdesur për ato elementë që përmendëm më sipër.

Përkthimi idiomatik është ai lloj përkthimi që ka si qëllim të riprodhojë të njëjtin mesazh që përcjell teksti origjinal por duke bërë disa ndryshime në zgjedhjen e fjalëve në mënyrë që të përshatet me gjuhën e përkthimit por duke e sjellë kuptimin si në origjinal. Ka raste kur është e vështirë të gjenden ekuivalentët në gjuhën e përkthimit. Ndryshimet që mendohen të bëhen në këtë lloj përkthimi janë të kushtëzuara nga diferencat e mëdha kulturore që e bëjnë edhe më të ndërlikuar gjetjen e një shprehjeje që i përshatet tërësisht shprehjes idiomatike në gjuhën origjinale.

Përkthimi komunikues është ai lloj përkthimi që synon të përcjellë të njëjtin kuptim siç e përcjell teksti origjinal duke ruajtur formën dhe përmbajtjen në atë masë sa të jetë i kuptueshëm dhe i pranueshëm për lexuesin e tekstit në gjuhën e përkthimit.

Më poshtë do të shpjegojmë në detaje të gjitha këto lloje përkthimi dhe do të trajtojmë disa shembuj që do të na ndihmojmë të bëjmë analizën krahasuese të dy përkthimeve.

IV.1 Përkthim fjalë për fjalë

Në këtë lloj përkthimi kemi ruajtje të rendit të fjalëve të tekstit në gjuhën origjinale dhe këto fjalë përkthehen duke u marrë si njësi të veçanta, pa patur në konsideratë të gjithë fjalinë apo tekstin, si dhe përkthehen në kuptimin e tyre më të përgjithshëm. Kjo do të thotë se përkthimi fjalë për fjalë është versioni më ekstrem dhe forma më “e dobët” e përkthimit pasi ajo përqëndrohet së tepërmi tek fjalori dhe sintaksa e tekstit origjinal. Sipas Newmark, “kjo metodë është baza e përkthimit semantik dhe atij komunikues pasi në fund të fundit përkthimi fillon që këtu.”⁴⁹⁶ Megjithatë, ka raste kur ajo mund të sjellë një përkthim jo natyral madje dhe të çuditshëm të frazave të ndryshme.

⁴⁹⁶ Newmark, Peter, *A Textbook of Translation*. New York: Prentice-Hall International, 1988, fq. 203

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Përkthimi fjalë për fjalë është thjesht një kalim i tekstit nga një gjuhë në tjetrën duke u marrë me fjalët një nga një duke përcjellë ose jo mesazhin e tekstit origjinal. Ndonjëherë, kjo konsiderohet një praktikë jo e mirë kur bëhet fjalë për përkthimin e teksteve jo teknike pasi vërejmë se kemi ruajtje të formës por jo të përmbajtjes. Zakonisht thuhet kështu kur ka një përkthim jo të mirë të idiomave në rastet kur çënohet kuptimi i tekstit, duke e bërë atë të pa deshifrueshëm për lexuesin e tekstit të përkthyer. Për shkak të këtij përkthimi, idiomat mund të vijnë në gjuhën e përkthyer në një mënyrë qesharake dhe aspak profesionale, gjë që sjell dhe pakënaqësinë e lexuesit.⁴⁹⁷

Megjithatë, ka dhe raste kur duke përdorur këtë teknikë, përkthyesi mund të sjellë kuptimin e saktë të tekstit, por nuk sjell stilin dhe bukurinë e atij teksti dhe rezultati nuk është ai i duhuri.

Më poshtë do të shohim disa shembuj të përkthimit fjalë për fjalë dhe do të krahasojmë dy versionet e “Plaku dhe Deti” nga Vedat Kokona dhe Ismail Kadare:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
They played like young cats in the dusk... ⁴⁹⁸	Ata lodronin si mace të vogla në muzg... ⁴⁹⁹	Ata lodronin si mace të vogla në mugëtirën e mëngjesit... ⁵⁰⁰

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
How old was I when you first took me in a boat? ⁵⁰¹	Sa vjeç isha, kur më more për herë të parë në barkë? ⁵⁰²	Sa vjeç isha kur më more për herë të parë në varkë? ⁵⁰³

⁴⁹⁷ Wilss, Wolfram, *The Science of Translation, Problems and Methods*, Tübingen, Gunter Narr Verlag, 1982, fq. 34

⁴⁹⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 19

⁴⁹⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 30

⁵⁰⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 17

⁵⁰¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 8

⁵⁰² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 19

⁵⁰³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 9

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
But are strong enough now for a truly big fish? ⁵⁰⁴	Po ti tani, a je kaq i fortë, sa të zësh një peshk fare të madh? ⁵⁰⁵	A je i fortë sa duhet, në zënc ndonjë peshk të madh? ⁵⁰⁶

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
When the sun had risen further the old man realized that the fish was not tiring. There was only one favourable sign. The slant of the line showed he was swimming at a lesser depth. That did not necessarily mean that he would jump. But he might. ⁵⁰⁷	Kur dielli u ngjit më lart, plaku e kuptoi se peshku nuk ishte lodhur. Kish vetëm një shenjë të mirë. Këndi i litarit mbi ujë tregonte se peshku po notonte në një thellësi më të vogël. Kjo nuk do të thoshte se ai patjetër do të dilte në sipërfaqe. Por mund të dilte. ⁵⁰⁸	Kur dielli u ngjit më lart, plaku e kuptoi se peshku s'qe aspak i lodhur. Vetëm për një gjë u gezua: pjerrja e tojes në ujë tregonte se peshku notonte tani në një thellësi më të vogël. Kjo s'donte të thoshte aspak se ai do të dilte në sipërfaqe. Por edhe mund të dilte. ⁵⁰⁹

Në shembullin e parë shohim se të dy përkthyesit kanë ruajtur pothuajse të njëjtin rend të fjalisë duke e përshtatur paska me strukturën e gjuhës shqipe ku mbiemri qëndron pas emrit dhe jo siç është në gjuhën angleze ku mbiemri vendoset përpara emrit si është e ilustruar dhe në këtë shembull “young cats”. Për sa i përket zgjedhjes së fjalëve, të dy përkthyesit i kanë qëndruar besnikë origjinalit, pasi po të marrim në konsideratë fjalën

⁵⁰⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 9

⁵⁰⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 21

⁵⁰⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 10

⁵⁰⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 44

⁵⁰⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 52

⁵⁰⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 34

“dusk” ajo përkthehet si “mugëtirë, muzg”⁵¹⁰. Kështu, vërejmë se si Kadare, ashtu dhe Kokona, kanë përdorur sinonime duke e sjellë kuptimin në të njëjtën mënyrë siç është sjellë dhe në versionin origjinal.

Në shembullin e dytë shohim se ka gjithashtu një përkthim shumë afer versionit në gjuhën angleze sin ë formë ashtu dhe në përmbajtje. Po te krahasojmë të dy shembujt shohim se ata kanë bërë një përkthim pothuajse identik me njëri-tjetrin. Po t’i krahasojmë me versionin origjinal, i vetmi ndryshim që na bie në sy është heqja e përemrave “I’ dhe “me’ duke qenë se në gjuhën shqip është folja ajo që tregon vetën, ndërsa në gjuhën anglezë kjo gjë ndodh vetëm me vetën e trëtë të numrit njëjës kur folja është në kohën e tashme. Kjo gjë është bërë me qëllim mospërsëritjen e fjalëve. Mund të themi se këtu kemi të bëjmë me një përkthim fjalë për fjalë në të cilin është ruajtur si forma ashtu dhe përmbajtja.

Në shembullin e tretë, shofim se ka pak ndryshime po ta krahasojmë me shembullin e sipërpërmendur në strukturën e fjalisë si dhe tek përzgjedhja e fjalëve ku vërejmë se ata kanë shtuar foljen “zë” edhe pse në mënyra të ndryshme. Në shembullin e katërt Kadareja është më besnik ndaj këtij lloj përkthimi sesa Kokona.

Kështu, duke marrë në konsideratë këto shembuj si dhe shumë të tjerë në këtë vepër mund të themi se edhe në rastet kur kemi hasur përdorim të përkthimit fjalë për fjalë më së bashku ka ardhur i plotë dhe i qartë te lexuesit.

IV. 2 Përkthim strukturor

Çdo gjuhë ka një strukturë dhe rregulla gramatikore të caktuara. Vështirësia e përkthyesve qëndron pikërisht tek përkthimi i strukturave të fjalive, sidomos në raste kur ato janë të ndërlikuara, të përbëra nga shumë pjesë me bashkërenditje dhe nënrenditje.⁵¹¹

Në këtë lloj përkthimi, format gramatikore të gjuhës origjinale përcillen edhe në gjuhën e përkthimit duke u përpjekur për të qenë sa më afër rregullave të kësaj të fundit. Megjithatë, ashtu si edhe në përkthimin fjalë për fjalë, fjalët përkthehen duke u konsideruar si njësi të veçanta pa u marrë shumë parasysh konteksti.

Gjuhët e ndryshme kanë struktura dhe rend fjalësh të ndryshëm. Po të marrim në konsideratë gjuhën shqipe dhe angleze vërejmë se ato ndryshojnë nga njëra-tjetra sidomos për sa i përket rendit të fjalëve në fjali. Një fjali në gjuhën angleze njihet që “ka një rend fjalësh në fjali goxha të ngurtë”⁵¹² dhe priret të fillojë me një kryefjalë dhe më pas vjen folja, kundrinori e kështu me radhë, ndërsa një fjali në gjuhën shqipe mund edhe të fillojë me një gjymtyrë tjetër fjalie dhe megjithatë ka kuptim dhe është e saktë gramatikisht.

⁵¹⁰ Qesku, Pavli, *Fjalor Anglisht-Shqip*, Tiranë, Botime Edfa, 2005, fq. 27

⁵¹¹ Dryer S. Mathew, *Language Typology and Syntactic Description*, Oxford University Press, 1998, fq. 34

⁵¹² Burton-Roberts, N., *Analyzing Sentences: An Introduction to English Syntax*, Harlow Longman, 1986, fq. 23

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Më poshtë do të shohim shembuj fjalish të përbëra dhe do të vërejmë si kanë ardhur ato në gjuhën shqipe nga dy përkthyesit.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
As he watched the bird dipped again slanting his wings for the dive and then swinging them widely and ineffectually as he followed the flying fish. ⁵¹³	Ndërsa plaku e ndiqte me sy, zogu u zhyt përsëri me krahët e mbledhura dhe pastaj, duke përplasur krahët me rrëmbim, zuri të ndiqte i shqetësuar peshkun fluturues. ⁵¹⁴	Zogu i mblodhi krahët, u zhyt përsëri në ujë dhe pastaj I përpoqi me mundim dhe pa rregull, duke ndjekur peshkun fluturues. ⁵¹⁵

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
From where he swung lightly against his oars he looked down into the water and saw the tiny fish that were colored like the trailing filaments and swam between them and under the small shade the bubble made as it drifted. ⁵¹⁶	Ndërsa po u jepte lopatave, ai vështroi poshtë në ujë dhe pa ca peshq të vegjël, të cilët kishin po atë ngjyrë që kishin këmbët e zvarguara në ujë dhe që notonin midis tyre nën hijen e kandilit që e merrte deti. ⁵¹⁷	Duke vozitur ngadalë me lopatat, vështroi thellë në ujë, dhe pa atje ca peshq të vegjël që kishin ngjyrën e këmbëve, që hiqeshin zvarrë në ujë; ata notonin në mes tyre dhe në hijën e kandilit që e merrte deti. ⁵¹⁸

Shembull 3

⁵¹³ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 27

⁵¹⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 36

⁵¹⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 22

⁵¹⁶ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 28

⁵¹⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 38

⁵¹⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 23

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He had sailed for two hours, resting in the stern and sometimes chewing a bit of the meat from the marlin, trying to rest and to be strong, when he saw the first of the two sharks. ⁵¹⁹	Kish dy orë që lundronte shtrirë të kiçi, dhe ndonjëherë përtypte ndonjë copë nga mishi i marlinit, duke u përpjekur të çlodhej e të bëhej i fortë, kur pa njërin nga dy peshkaqenët. ⁵²⁰	Kish dy orë që lundronte, i shtrirë në kiçin e varkës, duke përtypur nganjëherë mishin e peshkut dhe duke u munduar që të çlodhej për të marrë forca të reja, kur pa një nga dy peshkaqenët. ⁵²¹

Në shembullin e parë vërejmë se kemi të bëjmë me një fjali që ka tre pjesë të bashkërenditura. Në versionin e Kadaresë shohim se ai i ka qëndruar besnik strukturës së versionit origjinal në çdo pjesë të fjalisë dhe duke mos bërë asnjë ndryshim. Ndërsa në versionin e Kokonës vërejmë se ka një lloj përmbysjeje të strukturës së fjalisë. Ai e përkthen të parën pjesën që është e dyta në rendin e fjalisë në gjuhën angleze dhe shohim se ka dhe heqje të disa fjalëve duke bërë një perifrazim.

Në shembullin e dytë kemi një fjali pak më të ndërlikuar pasi përbëhet nga tre pjesë të bashkërenditura dhe katër pjesë të nënrenditura. Po të krahasojmë dy përkthimet duke marrë në konsideratë vetëm aspektin strukturor vërejmë se të dy versionet kanë ndjekur të njëjtin rend me origjinalin, edhe pse fjalët që ata zgjedhin janë të ndryshme.

Shembulli i fundit është gjithashtu një fjali e përbërë nga dy pjesë të bashkërenditura dhe dy pjesë të nënrenditura. Vërejmë se Kadare dhe Kokona kanë edhe në këtë rast një përkthim strukturor pasi ata kanë ndjekur të njëjtën renditje të pjesëve të fjalisë. Sigurisht që ka ndryshim në rendin e fjalëve për t’iu përshtatur rregullave të gjuhës shqipe.

IV. 3 Përkthim besnik

Përkthimi besnik synon të prodhojë mesazhin e saktë duke u bazuar tek konteksti si dhe duke iu përmbajtur dhe rregullave gramatikore të gjuhës mbërritëse. Me këtë lloj përkthimi, përkthyesi synon të përcjellë qëllimin e autorit nga gjuha origjinale në atë të përkthimit në mënyrën më të saktë të mundshme. Në përkthimin besnik ruhen si forma ashtu dhe përmbajtja me një fanatizëm tepër të madh. Përkthyesi përpiket që çdo mesazh të përcillet tek lexuesi i gjuhës së përkthimit në mënyrën më të mirë të mundshme.

⁵¹⁹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 92

⁵²⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 95

⁵²¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 68

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Këtu fjalët konsiderohen si pjesë të kontekstit dhe atyre nuk u jepet një përkthim i përgjithshëm por gjithmonë bazuar tek pjesa tjetër e tekstit. Përkthyesit “nuk heqin apo shtojnë fjalë nga vetja pasi duan t’i qëndrojnë sa më besnikë origjinalit duke u përpjekur që ta transmetojnë atë me saktësi sa më të madhe.”⁵²² Më poshtë do të kemi disa shembuj ilustrues të këtij lloj përkthimi dhe do të shohim se si përkthyesit i përkthejnë frazat me një përpikmëri tepër të madhe.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
The sail was patched with flour sacks and, furled, it looked like the flag of permanent defeat. ⁵²³	Pëlhura ishte arnuar me copa thasësh dhe, ashtu e mbështjellë, dukej si një flamur disfatash të përhershme. ⁵²⁴	Pëlhura ishte arna-arna, prej sargie thasësh mielli dhe, ashtu e mbështjellë, dukej si flamur disfatash të përhesrshme. ⁵²⁵

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
They were strange shoulders, still powerful although very old, and the neck was still strong too and the creases did not show so much when the old man was asleep and his head fallen forward. ⁵²⁶	Këto ishin shpatulla të çuditshme, ende të fuqishme, ndonëse të plakura, dhe qafa ishte ende e fortë, dhe rrudhat nuk i dukeshin aq shumë, kur plaku flinted dhe e mbante kokën të lëshuar përpara. ⁵²⁷	Këto ishin shpatulla të çuditshme, ende të forta, me gjithë peshën e rëndë të pleqërisë, po edhe qafën e kish të fortë tani që flinte, me kokë të varur në kraharor, rrudhat s’para i dukeshin. ⁵²⁸

⁵²² Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 83

⁵²³ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 5

⁵²⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 17

⁵²⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 7

⁵²⁶ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 13

⁵²⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 24

⁵²⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 13

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
You did not stay long, the man said. But it is rougher where you are going until you make the shore. How did I let the fish cut me with that one quick pull he made? I must be getting very stupid. ⁵²⁹	Ti nuk qendrove shume kohe me mua, mendoj plaku. Por atje ku shkove ti, era eshte me e rrepte dhe ajo s’do pushoje derisa te arrish bregun. Si e lashe peshkun te me plagoste me nje kercim te shpejte qe beri? Sic duket jam matufepsur. ⁵³⁰	Ti s’qendrove shume me mua, mendoj plaku. Por atje ku fluturove ti, era eshte shume me e forte dhe ajo do te fryje derisa te arrish bregun. Si e lashe peshkun te me plagoste me kete levizje te shpejte qe beri? Me duket se jam budallallosur fare! ⁵³¹

Në shembullin e parë vërejmë se kemi të bëjmë me një përkthim besnik po ta shohim nga të gjitha aspektet. Po të analizojmë strukturën e fjalisë në gjuhën angleze shohim se ajo nuk ka pësuar ndryshime në asnjërin prej versioneve me përjashtim të rendit të disa fjalëve të cilat përkthyesit janë “të detyruar” të bëjnë ndryshim për shkak të sintaksës shqipe. Megjithatë, të gjitha pjesët e fjalisë kanë ardhur në të njëjtin rend. Po të bëjmë një analizë për sa i përket zgjedhjes së fjalëve do të shohim se përsëri përkthyesit i kanë qëndruar besnikë origjinalit dhe në këtë mënyrë duke mos sjellë ndryshime në mesazhin që autori i veprës ka dashur të përcjellë. Ata kanë zgjedhur të njëjtat fjalë duke mos patur asnjë ndryshim nga versioni origjinal. Rrjedhimisht, si Kadare ashtu dhe Kokona kanë ruajtur formën dhe përmbajtjen e tekstit origjinal.

Në shembullin e dytë vërejmë se kemi të bëjmë gjithashtu me një rast ku përkthyesit i kanë qëndruar besnikë versionit origjinal, sidomos Kadare është ai që nuk bën pothuajse asnjë lloj ndryshimi. Po të bëjmë një analizë duke marrë në konsideratë anën strukturore, shohim se të gjitha pjesët e fjalisë janë renditur po njësoj si në origjinal nga të dy përkthyesit. Për sa i përket zgjedhjes së fjalëve, Kadare ka sjellë një version të njëjtë me origjinalin, ndërsa Kokona nuk ka sjellë një version dhe aq besnik.

Po të shkëpusim këtë frazë nga fjalia “although very old” vërejmë së Kadare e ka sjellë në shqip si “ndonëse të plakura” dhe ndryshimi i vetëm është fakti se ai ka hequr ndajfoljen e sasisë “very”, pra “shumë”. Ndërsa Kokona e përkthen si “, me gjithë peshën e rëndë të pleqërisë” duke bërë një përkthim pak a shumë të lirë, duke qëndruar brenda kontekstit por dhe sjellë një version paksa të ndryshëm nga origjinali për sa i përket

⁵²⁹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 47

⁵³⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 54

⁵³¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 36

formës. Megjithatë përmbajtja është e njëjtë dhe transmetohet ashtu siç është transmetuar dhe në versionin origjinal.

IV. 4 Përkthim semantik

Përkthimi semantik ndryshon nga përkthimi besnik pasi ai përqëndrohet me tëpër tek vlerat estetike të tekstit në gjuhën e origjinalit. Prof. Ristani citon se në këtë lloj përkthimi, “Përkthyesi përpiket të transmetojë, në atë shkallë që lejojnë strukturat semantike dhe sintaksore të gjuhës së përkthimit, kuptimin e përpiktë situativo-kontekstual të origjinalit. Kjo metodë respekton nivelin gjuhësor të autorit të origjinalit.”⁵³²

Ky lloj përkthimi është procesi i përdorimit të informacionit semantik në mënyrë që të bëhet i mundur përkthimi i një lloj modeli gjuhësor nga një gjuhë në tjetrën. Përkthimi semantik bazohet mbi kuptimin që kanë fjalët në një gjuhë për të gjetur më pas kuptimin e barazvlefshëm në një gjuhë tjetër. Ai ndryshon nga përkthimi fjalë për fjalë apo ai besnik pasi këtu nuk merrën në konsideratë thjesht fjalët pa u kujdesur shumë për kontekstin por ky i fundit është elementi më i rëndësishëm në bazën e të cilit realizohet përkthimi. Qëllimi i përkthimit semantik është të përcjellë në mënyrën më të mirë të mundshme strukturat sintaksore si dhe kuptimin e origjinalit duke realizuar në këtë mënyrë një përkthim sa më natyral dhe afër tekstit në gjuhën origjinale.

Përkthimi semantik ka disa karakteristika dhe e para që mund të përmendim është përqëndrimi dhe vëmëndja që i kushtohet autorit të tekstit origjinal në mënyrë që përkthyesi të hyjë sa më në brendësi të veprës pasi duke njohur më mirë autorin dhe veçoritë e tij do ta njohë dhe kuptojë më mirë veprën. Me njohje të autorit kemi parasysh marrjen e informacioneve për të si individ, kushtet në të cilat ka jetuar që mund të kenë një ndikim tëpër të madh tek vepra e tij.

Një tjetër karakteristikë është dhe fakti që një përkthim semantik ka tendencën të jetë më i ndërlikuar dhe i detajuar në krahasim me llojet e tjera të përkthimeve. Ka raste kur ka “përkthim më shumë seç duhet” duke dhënë shpjegime dhe duke qenë më specific sesa version origjinal si dhe gjithashtu mund të transmetohen më shumë se një kuptim, duke dhënë disa nuance kuptimore të fjalëve. Mund të themi se përkthimi semantik ndalet më tëpër në tekstin origjinal dhe edhe pse nuk kemi të bëjmë me një përkthim fjalë për fjalë ky lloj përkthimi është shumë më afër tekstit në gjuhën origjinale.

Sipas Newmark, përkthimi semantik ndryshon nga përkthimi fjalë për fjalë pasi ai merr në konsideratë kontekstin, e interpreton atë si dhe jep shpjegime që e bëjnë tekstin më të qartë për lexuesin e gjuhës së përkthimit.⁵³³ Ai gjithashtu ndryshon nga përkthimi besnik, ashtu siç e përmendëm dhe më sipër, pasi përqëndrohet tek bukuria e tekstit, vlerat e tij letrare dhe kujdeset që teksti të tingëllojë sa më natyral dhe në gjuhën e përkthimit dhe të

⁵³² Ristani, Viktor. *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Tiranë: Mirgeeralb, 2010, fq. 217

⁵³³ Newmark, Peter, *A Textbook of Translation*. New York: Prentice-Hall International, 1988, fq. 81

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

mos jetë thjesht një zëvendësim i fjalëve. Në këtë mënyrë version i përkthyer të mos ketë dykuptimësi që do ta hutonin lexuesin apo përsëritje të panëvojshme të fjalëve.

Përkthimi semantik lejon që përkthyesi të japë pak nga vetja e tij duke u futur brenda tekstit origjinal e duke e sjellë atë në një mënyrë sa më të qartë dhe të kuptueshme për lexuesin. Duke marrë parasysh dhe ekonominë e fjalëve mund të themi se mund të konsiderohet si “ekonomik” pasi po ta krahasojmë p.sh me përkthimin komunikues mund të themi se ky i fundit nuk është dhe aq. Përkthimi semantik i referohet nivelit gjuhësor të autorit. Ai mund të konsiderohet pak më inferior po ta krahasojmë me tekstin origjinal për sa u përket humbjeve nga ana pragmatike.

Më poshtë do të analizojmë disa shembuj të marrë nga vepra në gjuhën angleze dhe dy versionet e përkthyer:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
I must give him something more than the belly meat then. ⁵³⁴	Duhet t'i jap diçka më shumë se copën më të mirë. ⁵³⁵	Do t'i jap copën më të mirë të peshkut të madh. ⁵³⁶

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
I worked the deep wells for a week and did nothing. ⁵³⁷	Peshkova një javë mbi pusin e thellë dhe nuk kapa asgjë. ⁵³⁸	Në vendet e thella peshkova një javë të tërë dhe nuk kapa asnjë peshk. ⁵³⁹

⁵³⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 14

⁵³⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 26

⁵³⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 14

⁵³⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 25

⁵³⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 33

⁵³⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 20

Shembull 3

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Then he dove and the old man saw flying fish spurt out of the water and sail desperately over the surface. ⁵⁴⁰	Pataj befaz u zhyt dhe plaku pa nje peshk fluturues qe kerceu nga ujet dhe fluturoi i deshperuar mbi siperfaqen e detit. ⁵⁴¹	Befaz u zhyt dhe plaku pa se nje peshk fluturues kerceu nga uji dhe fluturoi si i kuturisur mbi faqen e lemuar te detit. ⁵⁴²

Në shembullin e parë vërejmë se përkthyesit kanë zgjedhur ta sjellin frazën në mënyra të ndryshme krahasuar me origjinalin por duke iu referuar kontekstit. Fjala “belly: përkthehet si “bark, stomak⁵⁴³ por ata kanë zgjedhur të mos bëjnë një përkthim fjalë për fjalë pasi nuk do të kishtë kuptim në versionin e përkthyer. Vërejmë se Kadare e përkthen si “copën me të mirë” duke marrë në konsideratë kontekstin, pra po flitej për copën më të mirë të peshkut. Kokona e përkthen si “copën më të mirë të peshkut të madh.” Në fakt një ndryshim tjetër që vërejmë është se “something more” Kadare ka zgjedhur ta përkthejë si “diçka më shumë”, ndërsa Kokona ka zgjedhur mos ta përkthejë atë duke e përqëndruar vëmëndjen tek pjesa e dytë e fjalisë por kjo gjë nuk sjell asnjë ndryshim për sa i përket kuptimit të fjalisë.

Në shembullin e dytë vërejmë se të dy përkthyesit e kanë sjellë frazën në shqip duke përdorur fjalë të tjera, të ndryshme nga origjinali. Frazën “I worked the deep wells”, Kadare e përkthen me foljen “peshkova”, ndërsa Kokona e përkthen në një version pak më të gjatë si “Në vendet e thella peshkova”, pra ai e përkthen në mënyrë pak më të detajuar. Edhe pse ekziston ky lloj ndryshimi në përkthim mund të themi se kuptimi i origjinalit përcillet edhe pse ka ndryshim në formë. Ndërsa “did nothing” përkthehet pothuajse në të njëjtën mënyrë nga si nga Kadare ashtu dhe nga Kokona, duke patur ndryshim me origjinalin. Kadare e përkthen si “kapa asgjë” duke nënkuptuar peshq, pasi i gjithë konteksti lidhet me detin, dhe peshkimin pavarësisht se ato shëmbejnë si simbole të jetës dhe vështirësive që kalon njeriu. Nga ana tjetër, Kokona e përkthen si “nuk kapa asnjë peshk” duke dhënë një element më shumë se Kadare. Ashtu siç edhe në shembullin e mësipërm, ai jep detaje në përkthim duke sjellë herë pas here shembuj të përkthimit semantik.

⁵⁴⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 25

⁵⁴¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 26

⁵⁴² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 37

⁵⁴³ Qesku, Pavli, *Fjalor Anglisht-Shqip*, Tiranë Botime Edfa, 2005, fq. 22

IV.5 Përkthim me përshtatje

Përkthimi me përshtatje është forma më e lirë e përkthimit dhe përdoret kryesisht në komeditë apo poezitë. Ai ka të bëjë me përcjelljen e kuptimit përmes përshtatjes në një stil të caktuar dhe përdoret kur diçka specifike në kulturën e një vendi është tërësisht e panjohur apo dhe e papërshtatshme për një kulturë tjetër. Përkthyesi mendohet të bëjë një lloj ndryshimi në formë, ndoshta dhe në përmbajtje për hir të kulturës së gjuhës së përkthimit por duke u munduar të përcillet e njëjta atmosferë si në versionin original.

Qëllimi kryesor përse përkthyesi zgjedh të përdorë këtë mjet stilistik është përcjellja e efektit të njëjtë tek lexuesit e tekstit në gjuhën e përkthimit duke përshtatur termat kulturorë në një farë mënyre.⁵⁴⁴ Përshtatja është një metodë që mund të emërtohet edhe si “ekuivalencë që vjen si rezultat i situatës apo kontekstit”.

Ka situata në të cilat përshtatja është me të vërtetë e nevojshëm si në rastet e përkthimit të reklamave, veprave letrare, emërtimeve gjeografike, përrallave për fëmijë, etj. Përkthyesi zgjedh të përdorë këtë metodë pasi përpiqet të bëjë një përshtatje me kulturën e vendit me qëllim përcjelljen e saktë të mesazhit apo dhe shmangien e keqkuptimeve pasi mund të ndodhë që kultura të ndryshme i interpretojnë gjërat në mënyra tërësisht të ndryshme. Përshtatja përdoret për t’iu përshtatur edhe rregullave gjuhësore apo gramatikore të gjuhës së përkthimit. Qëllimi kryesor që ka një përkthyes kur përdor këtë metodë është që përkthimi të ketë të njëjtin efekt që ka dhe teksti original tek lexuesit duke sjellë për ta një mesazh sa më të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm.⁵⁴⁵

Më poshtë do të shohim shembuj shembuj ilustrues të këtij lloji përkthimi:

Shembull 1

Ernest Hemingway: <i>The Old Man and the Sea</i>	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
It is a big school of dolphin, he thought. ⁵⁴⁶	Do të ketë ndonjë tufë të madhe makrelësh, mendoi plaku. ⁵⁴⁷	Si duket, atje ka një tufë të madhe me delfinë, tha me vete plaku. ⁵⁴⁸

⁵⁴⁴ Koller, W. , *The concept of equivalence and the object of translation studies*, Target, 1995, fq. 21

⁵⁴⁵ Basil Hatim&Jeremy Munday. *Translation, An advanced Resource Book*. New York: Taylor&Francis e- Library, 2004.Print, fq. 151

⁵⁴⁶ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 27

⁵⁴⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 37

⁵⁴⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth.Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 23

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
They were as old as erosions in a fishless desert. ⁵⁴⁹	Ato ishin aq të vjetra sa plasat e një shkretërire pa ujë. ⁵⁵⁰	Ato ishin të vjetra, si plasat që duken në fund të një sterne të tharë. ⁵⁵¹

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“I may not be as strong as I think”, the old man said. “But i know a lot of tricks and i have resolution”. ⁵⁵²	“Mbase nuk jam aq i fortë sa mendoj”, tha plaku. Por kam shkathtësinë dhe jam i qëndrueshëm”. ⁵⁵³	Ndofta s’jam edhe aq i fortë sa ç’mendoj”, tha plaku. Por di shume marifete dhe s’dorëzohem lehtë”. ⁵⁵⁴

Në shembullin e parë shohim se “big school of dolphin” vjen e përkthyer nga Kadare si “ndonjë tufë të madhe makrelësh” ndërsa nga Kadare si “një tufë të madhe me delfinë”. Pra, vërejmë se fjalën “school” të dy përkthyesit e sjellin në shqip si “tufë” duke iu përshtatur gjuhës shqipe duke qënë se në shqip nuk themi “shkollë delfinësh” pasi do të ishte e pakuptimtë dhe e pazakontë dhe madje e çuditshme. Për këtë arsye të dy përkthyesit e sjellin ndryshe në gjuhën e përkthimit dhe ajo çka i “detyron” ta bëjnë këtë është ndryshimi që ekziston midis dy gjuhëve.

Në shembullin e dytë vërejmë sesi të dy përkthyesit e kanë përkthyer “fishless desert” pak më ndryshe nga origjinali. Kadare e përkthen si “shkretërire pa ujë” pasi në këtë mënyrë vjen më natyrale në gjuhën shqipe. Po të kishte bërë një përkthim fjalë për fjalë do të thonte “si shkretëtira pa peshq” dhe në gjuhën shqipe kjo frazë është tërësisht e panjohur, madje mund të tingëllojë dhe e çuditshme.

⁵⁴⁹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 5

⁵⁵⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 18

⁵⁵¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 18

⁵⁵² Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 17

⁵⁵³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 28

⁵⁵⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 16

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
<p>Then came the delicate pulling touch again.</p> <p>-“He’ll take it”, the old mansaid aloud. “God help him take it.”</p> <p>He did not take it though.⁵⁵⁵</p>	<p>Pastaj ndjeu se filli u tërhoq persëri fare lehtë.</p> <p>- “Po e kafshon”, that plaku me zë të lartë. Zoti e ndiftë, po e kafshon”</p> <p>Por peshku nuk kish kafshuar gjë.⁵⁵⁶</p>	<p>Dhe befas ndieu se toja e tërhoqi persëri lehtë.</p> <p>-“ E kafshoi”, that plaku me zë të lartë. E kafshoi, i faltë Zoti shëndet e jetë!”</p> <p>Por peshku s’kish kafshuar.⁵⁵⁷</p>

Nga ana tjetër, Kokona e përkthen si “një sterne të tharë”. Sterna përkufizohet si “depo e gërmuar në tokë për të mbledhur dhe ruajtur ujë e shiut në vendet ku nuk ka burime uji.”⁵⁵⁸ Pra, ai ka zgjedhur këtë fjalë që edhe pse ndryshon në formë nga version origjinal përmbajtja mbetet po ajo dhe efekti përcillet në të njëjtën mënyrë tek lexuesi.

Në këto shembuj kemi parë se përkthyesit kanë si qëllim të sjellin mesazhin e versionit origjinal duke iu përshtatur gjuhës shqipe dhe disa shprehjeve të caktuara që përdoren në këtë gjuhë.

IV. 6 Përkthim i lirë

Përkthimi i lirë, ashtu siç është edhe vet emërtimi i tij, është një lloj përcjelljeje e një mesazhi nga një gjuhë në një tjetër pa marrë në konsideratë disa rregulla të caktuara, kryesisht duke mos marrë parasysh formën pasi përmbajtja, edhe në këtë lloj përkthimi, është e rëndësishme. Ai është prodhimi i një teksti nga gjuha origjinale në gjuhën e përkthimit pa konsideruar stilin apo formën e origjinalit. Përkthyesi jep shumë nga vetja, në një farë mënyre e rishkruan veprën duke u bazuar tek teksti origjinal. Ai përqendrohet më tepër tek përmbajtja duke marrë esencën e saj dhe duke e sjellë në një formë tjetër. Në ndryshimin që i bëhet formës përfshihen fjalët e ndryshme, ndryshimet gramatikore dhe ato strukturore. Ky lloj përkthimi përdoret kryesisht në poezi ku përkthyesi mund edhe të japë diçka nga vetja.

⁵⁵⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 35

⁵⁵⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 43

⁵⁵⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 28

⁵⁵⁸ www.fjalorshqip.com

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Përkthimi i lirë ka dhe disa pika të dobëta dhe këtu mund të përmendim rastet kur përkthyesi mund të japë shumë elementë nga vetja duke zbehur në këtë mënyrë dhe punën e autorit kur përkthimi nuk është i mirë apo dukë dhënë më shumë seç duhet dhe si rezultat duke u larguar nga origjinali. Një pikë tjetër që është pak problematike është fakti se duke qenë një përkthim i lirë dhe për pasojë nuk ka kufinj të mirë përcaktuar nuk dihet se deri ku mund të arrihet me ndryshimet.

Dy pika të tjera të dobëta janë dhe devijimi që mund t’i bëhet përmbajtjes si pasojë e ndryshimeve të mëdha të cilat mund të dalin dhe jashtë kontekstit si dhe pika tjetër është fakti se ky lloj përkthimi mund të përdoret vetëm në tekstet letrare ku ndryshimet janë të pranueshme po jo në tekstet shkencore, teknike apo politike.

Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë mënyrën se si një përkthyes smund të përdorë këtë lloj metode në një tekst letrar, në rastin tonë tek “Plaku dhe Deti”:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Good luck old man. ⁵⁵⁹	Paç fat të mirë, o plak. ⁵⁶⁰	Të vaftë mbarë, o plak. ⁵⁶¹

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
But they did not show it and they spoke politely about the current and the depth they had drifted their lines at and the steady good weather and of what they had seen. ⁵⁶²	Por ata nuk e tregonin pikëllimin dhe flisnin me njerëzi për rrymat dhe sa thellë e kishin hedhur fillin dhe si do të mbajë koha dhe ç’kishin parë në det. ⁵⁶³	...por keqardhjen e tyre se tregonin, flisnin shtruar për rrymën e ujit, sa thellë e kishin hedhur tojën, për motin e mirë që mbante dhe ç’kishin parë. ⁵⁶⁴

⁵⁵⁹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 21

⁵⁶⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 31

⁵⁶¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 18

⁵⁶² Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 6-7

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
If you were my boy I'd take you out and gamble, he said. ⁵⁶⁵	Po të ishe djali im, do vendosja të të merrja me vete. ⁵⁶⁶	Të të kisha djalë, do të të kisha marrë me vete të loznim çift a tek. ⁵⁶⁷

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
“I could go with you again. We've made some money”. ⁵⁶⁸	“Mund te vij perseri me ty ne det. Tani kemi fituar ca para.” ⁵⁶⁹	“Tani mund te shkoj prap me ty ne det. Kemi fituar ca te holla”. ⁵⁷⁰

Në shembullin e parë shohim se Kadare ka bërë një ndryshim duke e përkthyer fjalën “dolphin” si “makrel” duke e përdorur si në gjuhën spanjolle. Në këtë rast, ai është bazuar mbi kontekstin e veprës apo dhe kushtet kulturore në të cilat është shkruar kjo vepër, por në këtë rast përkthimi mund të quhet i lirë. Ai gjithashtu shton një mbiemër tek fjalia pasardhëse kur thotë “makrel i madh i artë” edhe pse në origjinal nuk është përdorur kjo fjalë. Kadare e ka përdorur atë për të përcjellë te lexuesi emocionin dhe ekzaltimin e madh që ka përjetuar plaku në ato momente. Ndërsa Kokona i qëndron besnik origjinalit në përkthimin që ka sjellë.

Në shembullin e dytë kemi të bëjmë me një urim i cili është sjellë në forma të ndryshme nga dy përkthyesit. Në këtë rast Kadare i ka qëndruar më besnik origjinalit duke e përkthyer atë pothuajse fjalë për fjalë. Vërejmë se e ka përkthyer frazën si “Paç fat të mirë, o plak” duke e sjellë pak më ndryshme nga sa jemi mësuar ta dëgjojmë si thjesht “paç fat”. Po të shohim versionin e Kokonës vërejmë se ai ka bërë një përkthim pak më të

⁵⁶³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 19

⁵⁶⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 8

⁵⁶⁵ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 8

⁵⁶⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 20

⁵⁶⁷ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 9

⁵⁶⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 8

⁵⁶⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 20

⁵⁷⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 9

lirë, sigurisht duke qëndruar brenda kornizave të kontekstit por duke e sjellë në një tjetër formë. Ai e përkthen si “Të vaftë mbarë.” Ky është një urim që e dëgjojmë shpesh në gjuhën shqipe dhe Kokona e ka përshtatur më së miri me përmbajtjen duke bërë një përkthim të lirë për sa i përket formës.

Shembulli tjetër është një fjali më e gjatë dhe më e ndërlikuar. Po të analizojmë pjesën e parë të fjalisë vërejmë se të dy përkthyesit përemrin “it” që i referohet mbiemrit “sad” në fjalinë paraardhëse nuk e lënë ashtu siç është në versionin origjinal por kanë zgjedhur ta përkthejnë atë. Kadare e përkthen si “pikëllim” ndërsa Kokona e përkthen si “keqardhje”. Në këtë mënyrë, ata japin më shumë detaje për lexuesin duke bërë një përkthim relativisht të lirë për sa i përket formës. Në pjesën tjetër të fjalisë shohim se “politely” është përkthyer në forma të ndryshme nga të dy përkthyesit. Kadare e sjell në shqip si “me njerëzi”, ndërsa Kokona si “shtruar”. Të dy i kanë qëndruar besnikë kontekstit origjinal por duke e përkthyer atë në një formë të lirë. Ky grup fjalësh “steady good weather” vjen po ashtu ndryshe nga origjinali si nga të dy përkthyesit. Kadare e përkthen si “si do të mbajë koha”, ndërsa Kokona si “për motin e mirë që mbante”.

Po t’i krahasojmë të dy versionet shqip vërejmë se Kadare i është larguar më shumë origjinalit pasi po të kishim p.sh një përkthim fjalë për fjalë duke mos ndryshuar as formën dhe as përmbajtjen ai do të ishte “për motin e mirë dhe të qëndrueshëm”. Ai e sjell me një përkthim të lirë edhe pse nuk ka ndryshim tepër të madh me origjinalin për sa i përket përmbajtjes. Nga ana tjetër, Kokona është më afër versionit origjinal pasi mbiemrin “steady” e ka përkthyer me “që mbante” e cila pak a shumë përcjell idenë e qëndrueshmërisë, pra një mot i mirë që ka disa kohë që është ashtu.

Në shembullin e fundit vërejmë së përkthyesit e kanë sjellë pak më ndryshe nga origjinali, sidomos pjesën e dytë të fjalisë pasi në pjesën e parë nuk vihet re ndonjë ndryshim. “Take you out and gamble” është përkthyer nga Kadare si “do vendosja të të merrja me vete”. Në këtë mënyrë, ai ka hequr “gamble” duke sjellë dhe një ndryshim të vogël në përmbajtje pasi mesazhi nuk përcillet i plotë, nuk përcillet ideja e rrezikut apo provës me fatin. Ndërsa Kokona e sjell pak më ndryshe, ai e përkthen këtë frazë si “do të të kisha marrë me vete të loznim tek a çift”. Ai është më afër origjinalit edhe pse ka një lloj lirshmërie në përzgjedhjen e fjalëve. Mesazhi përcillet tek lexuesi edhe pse me pak ndryshim nga version në gjuhën angleze.

IV. 7 Përkthim idiomatik

Manfred shkruan: “Përkthimi idiomatik është ai lloj përkthimi që përcjell mesazhin e tekstit origjinal por duke përdorur forma të ndryshme për shkak të ndryshimeve mes dy gjuhëve për të sjellë të njëjtën nuancë kuptimore dhe në tekstin e gjuhës së përkthimit.”⁵⁷¹ Rrjedhimisht, në këtë të fundit mesazhi që përcillet është tërësisht i njëjtë me atë në origjinal por që sillet në një tjetër version duke e bërë atë të tingëllojë sa më natyral dhe

⁵⁷¹ Manfredi, M. *Translating Text and Context: Translational Studies and Systematic Functional Linguistics*, vol. 1. Cagliari, CUEC, 2008, fq. 14

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

në gjuhën tjetër. Ai sugjerohet gjithashtu të jetë sa më i qartë dhe i kuptueshëm edhe në rastet kur kemi të bëjmë me një shprehje idiomatike që ka nuanca ironie.

Megjithatë, sic thekson edhe Uolfram Uils (Wolfram Wilss) ne librin e tij *Shkenca e Përkthimit, Problemet dhe Metodat*: “ka raste kur përkthyesi e ka pak të vështirë të gjejë një shprehje të barazvlefshme duke qenë se idiomat janë fikse në çdo gjuhë.”⁵⁷² Siç e kemi përmendur dhe në kapitullin paraardhës, idioma është një shprehje me ndërtim të veçantë, tërësisht apo pjesërisht të ngurosur, që përdoret në një gjuhë dhe ka një kuptim të njësishtëm i cili nuk del drejtpërdrejt nga shuma e kuptimeve të fjalëve përbërëse si dhe që nuk mund të përkthehet fjalë për fjalë nga një gjuhë në një tjetër. Ajo është një fjalë e veçantë që përdoret në kuptim të figurshëm vetëm në një gjuhë dhe që nuk mund të përkthehet drejtpërsëdrejti në gjuhë të tjera.

Përkthimi idiomatik ka disa karakteristika dhe ndër to mund të përmendim faktin që një përkthim i tillë duhet të transmetojë te lexuesi i tekstit në gjuhën e përkthimit të njëjtin efekt që transmeton dhe autori i tekstit origjinal te lexuesi i tij.

Një tjetër karakteristikë është natyrshmëria me të cilën duhet të përkthehet në mënyrë që të mos ngjajë i sforcuar dhe pa kuptim. Ka raste kur është më mirë që të bëhet një lloj perifrazimi i shprehjes nëqoftëse në gjuhën e përkthimit nuk ka një shprehje që është e barazvlefshme me të.

Jo me pak e rëndësishme si karakteristikë është dhe thjeshtësia në të lëxuar. Shprehja duhet të jetë po aq e thjeshtë për t’u kuptuar nga lexuesit e tekstit të gjuhës së përkthyer aq sa është dhe në gjuhën origjinale.⁵⁷³

Më poshtë kemi sjellë shembuj të këtij përkthimi:

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
But you went turtle-ing for years off the Mosquito Coast and your eyes are good. ⁵⁷⁴	Po ti ke shkuar kaq vjet për breshka në Bregun e Mosquitos, dhe sytë s’të janë prishur. ⁵⁷⁵	Po ti ke shkuar kaq vjet për breshka e Moskitos dhe sytë i ke pikë. ⁵⁷⁶

⁵⁷² Wilss, Wolfram, *The Science of Translation, Problems and Methods*, Tübingen, Gunter Narr Verlag, 1982, fq. 19

⁵⁷³ Po aty

⁵⁷⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 9

⁵⁷⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 21

⁵⁷⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997 fq. 10

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
He was shivering with the morning cold. But he knew he would shiver himself warm and that soon e would be rowing. ⁵⁷⁷	U rrëngqeth nga e ftohta e mengjesit. Por e dinte se rrëngqethjen nuk do ta ndjente më, dhe së shpejti do të ngrohej duke vozitur. ⁵⁷⁸	I shkuan mornica nga të ftohtit e mëngjesit, por e dinte se këto rrëngqethje do t'i kalonin dhe së shpejti do të ulej te rremat dhe do të ngrohej mirë. ⁵⁷⁹

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
Only I have no luck any more. But who knows? Maybe today. Every day is a new day. It is better to be lucky. ⁵⁸⁰	Vetëm se une nuk kam më fat. Po ku ta dish? Mbase do kem sot. Cdo ditë është një ditë e re. Është mirë kur të ecen fati. ⁵⁸¹	Po ja që s’kam fat. Po ku ta dish? Ndofta sot fati do më buzëqeshë. Ditë e re, nafakë e re. Si lum ai që ka fat! ⁵⁸²

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona

⁵⁷⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 19

⁵⁷⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 30

⁵⁷⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997 fq. 17

⁵⁸⁰ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 25

⁵⁸¹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 35

⁵⁸² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997 fq. 21

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

But when he was touching the breaking point he held steady and settled back against the strain of the line - “You are feeling it now, fish”, he said. “And so, God knows, am I”. ⁵⁸³	Por pasi e tërhoqi litarin sa mundi, qëndroi përsëri ashtu si më parë, përballe litarit të tendosur. -“ Keq e ndejn veten, peshk? tha. E sheh Zoti që edhe unë se ndjej mirë.” ⁵⁸⁴	Si e tërhoqi litarin sa mundi, qëndroi përsëri si i ngrire ashtu si më parë. -“Pisk e ke, o peshk? pyeti. Besa Zotit që pisk e kam edhe vetë.” ⁵⁸⁵
--	--	--

Ajo që vëmë re është se “your eyes are good” është përkthyer si “sytë s’ të janë prishur” nga Kadare dhe si “sytë i ke pikë” nga Kokona. Me përkthimin e parë kuptojmë se sytë e plakut janë akoma në gjendje të vëzhgojnë mirë dhe nuk i janë dëmtuar pavarësisht moshës dhe punës së rëndë që ka patur. Kokona e përkthen me një shprehje tipike shqiptare që përdoret për të treguar se dikush e ka shikimin shumë të mirë. Ai e përkthen pikërisht me këtë shprehje si për të theksuar se plaku ishte akoma i fuqishëm pavarësisht veshtrësitë e mëdha me të cilat e kishte përballur jeta.

Në shembullin e dytë kemi transformimin e shprehjes “he was shivering with the morning cold” në “i shkuan mornica nga te ftoftit e mëngjesit” nga Kokona.

Shembulli i tretë sjellë shprehjet idiomatike të Kokones sërisht i cili zgjedh të përkthejë shprehjen “every day is a new day” në “ditë e re, nafakë e re”, ndërsa Kadareja i rrin më besnik përkthimit fjalë për fjalë duke zgjedhur ta përkthejë në “ cdo ditë është një ditë e re”. E njëjta gjë vlen për shprehjen “maybe today” të cilën Kokona zgjedh ta përkthejë në “ndofta sot fati do më buzëqeshë” dhe Kadareja “mbase do kem sot”.

IV.8 Përkthim komunikues

Përkthimi komunikues ka si qëllim të përcjellë mesazhin e saktë kontekstual në atë mënyrë që si forma ashtu dhe përmbajtja të përcillen edhe në tekstin e gjuhës se përkthimit në një formë sa më të pranueshme dhe të kuptueshme për lexuesin. Ky lloj përkthimi synon që të arrijë të njëjtin efekt që arrin dhe autori me lexuesin e tekstit origjinal. Ky lloj përshkrimi i përkthimit komunikues ngjan me ekuivalencën dinamike apo të ndryshueshme që përmend Eugene Nida për sa i përket këtij efekti, ndërsa përkthimi semantik që përmendëm më sipër i përafrohet ekuivalencës formale.

Ashtu si dhe llojet e tjera të përkthimit, edhe përkthimi komunikues ka disa karakteristika. Ndër këto karakteristika mund të përmendim faktin se ndryshe nga përkthimi semantik që kishte në qendër autorin dhe tekstin origjinal, në këtë rast

⁵⁸³ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 25

⁵⁸⁴ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 35

⁵⁸⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997 fq. 21

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

vëmëndja e përkthyesit përqëndrohet mbi lexuesin dhe tekstin në gjuhën e përkthimit. Në këtë lloj përkthimi lloji i gjuhës së përdorur është shumë i rëndësishëm pasi përcakton dhe fjalët që do zgjedhë përkthyesi duke i përshtatur ato me përmbajtjen kulturore të tekstit origjinal. Një tjetër karakteristikë është fokusi mbi efektin dhe mesazhin që transmetohet te lexuesi. Përkthimi komunikues është ai përkthim që ka elementë pothuajse të të gjithë llojeve të përkthimeve. Ai është besnik por herë-herë dhe i lirë.

Newmark ka propozuar që përkthimi komunikues duhet të përdoret në tekstet informative dhe në fjalime të ndryshme. Në përgjithësi, ky lloj përkthimi është i thjeshtë, i qartë, i drejtpërdrejtë, konvencional dhe i përshtatet regjistrin të gjuhës mbërritëse. Ka raste kur ai jep më pak detaje sesa versioni origjinal me qëllim që lexuesi ta kuptojë sa më mirë mesazhin pa patur disa shtesa të panevojshme.⁵⁸⁶

Sipas Newmarkut, vetëm përkthimi komunikues dhe ai semantik i përmbushin të gjitha kriteret e atij që quhet “përkthim i mirë” duke plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme që të quhet i tillë si p.sh saktësinë, stilin por gjithashtu duke mos lënë mënjane dhe ekonominë e fjalëve. Ka raste kur një përkthim komunikues është dhe më i qartë se vetë teksti origjinal pasi merr gjithmonë në konsideratë nivelin gjuhësor të lexuesve.⁵⁸⁷

Më poshtë do të sjellim disa shembuj ilustrues të përkthimit komunikues dhe do të krahasojmë dy versionet shqip e do të vërejmë ndryshimet mes tyre.

Shembull 1

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
The shack was made of the tough bud-shields of the royal palm which are called guano... ⁵⁸⁸	Kasollja ishte ndërtuar me degë palmash mbretërore që quhen guano... ⁵⁸⁹	...kasollja që ishte ndërtuar me gjethet e palmës, të cilën këtu e quajnë guanjo. ⁵⁹⁰

Shembull 2

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
--	--	---

⁵⁸⁶ Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford, 1984, fq. 98

⁵⁸⁷ Po aty

⁵⁸⁸ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 10

⁵⁸⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 22

⁵⁹⁰ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 11

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Some of the younger fishermen, those who used buoys as floats for their lines and had motor-boats, bought when the shark livers had brought much money, spoke of her as el mar which is masculine. ⁵⁹¹	Disa nga peshkatarët e rinj, ata që përdorin fuçitë lundronjëse për rrjetat e tyre dhe që kanë barka me motor, të blera ahëre kur mëlçia e peshkaqenit shitej shtrenjtë, e quanin el mar, domethënë në gjininë mashkullore. ⁵⁹²	Peshkatër që janë më të rinj nga mosha, ata që përdorin fuçitë lundruese për të mbajtur rrjetën dhe që shkojnë me motoskafe, që i kanë blerë ato ditë kur mëlçia e peshkaqenit shitej shumë shtrenjtë, e quajnë el mar, domethënë në gjininë mashkullore. ⁵⁹³
---	--	--

Shembull 3

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
But these poisonings from the agua mala came quickly and struck like a whiplash. ⁵⁹⁴	Helmimi i agua malas bëhej shumë shpejt dhe të therte si goditja e kamxhikut. ⁵⁹⁵	Helmimi i agua malas bëhej brenda një kohe shumë të shkurtër dhe të ther në zemër si goditja e kamxhikut. ⁵⁹⁶

Shembull 4

Ernest Hemingway: The Old Man and the Sea	Përkthim në shqip nga Ismail Kadare	Përkthim në shqip nga Vedat Kokona
-But then I think of Dick Sisler and those great drives in the old park. -There was nothing ever like them. ⁵⁹⁷	-Mu kujtua Dik Sajzleri kur shutonte në parkun e vjetër. -Nuk ka si ai. ⁵⁹⁸	-A të kujtohet se si godiste Dik Sajzleri? Ç’të goditur që bënte, kur lozte në parkun e vjetër -S’ka se ku të vejë më mirë! ⁵⁹⁹

⁵⁹¹ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 23

⁵⁹² Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 33

⁵⁹³ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 20

⁵⁹⁴ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 29

⁵⁹⁵ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 38

⁵⁹⁶ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 24

⁵⁹⁷ Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952, fq. 29

⁵⁹⁸ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, Naim Frasheri, Tiranë, 1963, fq. 38

⁵⁹⁹ Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Çabej, Shtator 1997, fq. 24

Në shembullin e parë shohim se të dy përkthyesit e kanë sjellë fjalinë me disa ndryshime të vogla në krahasim me versionin origjinal si nga forma ashtu dhe përmbajtja. Një ndër këto ndryshime është dhe heqja e mbiemrit ‘royal’ nga Kokona pasi ai e përkthen frazën “tough bud-shields of the royal palm” si “me gjethet e palmës”. Megjithatë nuk vihet re asnjë ndryshim për sa i përket anës kuptimore. Kadare, nga ana tjetër, i qëndron më besnik tekstit origjinal. Megjithatë, në vija të përgjithshme mund të themi se ky është shembull i një përkthimi komunikues pasi forma dhe përmbajtja janë të ngjashme me origjinalin duke e përcjellë atë në një mënyrë tepër të qartë për lexuesin.

Në shembullin e dytë, që është një fjali e përbërë nga disa pjesë shohim se dy versionet e përkthyer nuk kanë ndryshime domethënëse nga njëra-tjetra. Ata e komunikojnë në mënyrën më të mirë të mundshme mesazhin e fjalisë, duke bërë ndryshime të vogla ku është e nevojshme në mënyrë që t’i përshtaten rregullave të gjuhës shqipe. Një ndryshim i tillë është dhe përkthimi i frazës “spoke of her as el mar” të cilën Kadare dhe Kokona e përkthejnë po njësoj si “e quanin el mar/ e quajnë el mar” me përjashtim të kohës së foljes që është e ndryshme.

Edhe në shembullin e fundit vërejmë se ndryshimi mes dy versioneve në gjuhën shqipe nuk është i madh dhe po t’i krahasojmë me tekstin origjinal shohim se ata e kanë ruajtur formën dhe përmbajtjen e tij duke e transmetuar mesazhin në një formë të qartë për lexuesin e tekstit në gjuhën e përkthimit. Ashtu si dhe në shembullin e mësipërm vërejmë se Kadare dhe Kokona kanë përdorur një kohë të ndryshme për të përkthyer foljen “struck”. Po të bëjmë një vështrim të përgjithshëm mund të themi se në të gjithë këto shembuj të analizuar Kadare dhe Kokona kanë patur shumë të përbashkëta në mënyrën se si kanë komunikuar mesazhin tek lexuesit pavarësisht ndryshimeve në përzgjedhjen e fjalëve.

Në këtë kapitull kemi bërë një analizë krahasuese mbi metodat e përkthimit të përdorura nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona në përkthimin e veprës “Plaku dhe Deti”. Fillimisht kemi trajtuar tetë llojet kryesore të përkthimeve duke sjellë për secilin prej tyre një përkufizim teorik si dhe duke përshkruar disa nga karakteristikat kryesore që ata kanë. Shembujt ilustrues të marrë nga vepra origjinale dhe dy versionet e përkthyer na kanë ndihmuar të kuptojmë më mirë këto përkthime, të dallojmë ndryshimet që ekzistojnë mes tyre si dhe të shohim dhe pikat e dobëta që mund të kenë ata.

Në të gjithë shembujt e përmendur në këtë kapitull kemi vënë re se të dy përkthyesit i kanë prekur të gjithë këto metoda si dhe ka raste kur një metodë nuk është e vetmja e përdorur brenda një fjali por ka raste të kombinimeve për shkak të përshtatjes që duhet bërë për të sjellë një version sa më natyral, të saktë dhe të kuptueshëm për lexuesin pasi ky i fundit është dhe qëllimi kryesor i përkthyesve.

KREU V

Përfundime

Punimi me temë “**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**” arriti të përmbush qëllimin e realizimit të një analize të detajuar të veprës së mirënjohur “Plaku dhe deti” nga Ernest Heminguei në vitin 1952 me dy versionet e përkthyer në shqip, përkatësisht nga Ismail Kadare në vitin 1963 dhe nga Vedat Kokona në vitin 1997. Përmes qasjes analizuese-krahasuese të dy përkthimeve të dy periudhave të ndryshme, ky studim nxori në dritë transformimet e mundshme që ka pësuar procesi i përkthimit si dhe rrjedhën që ka marrë përkthimi deri para disa vitesh duke na dhënë mundësinë të vërejmë nëse tipare të caktuara vazhdojnë të jenë pjesë e procesit të përkthimit edhe në ditët e sotme.

Pas gjithë këtij hulumtimi mund të arrijmë të themi se studimet e përkthimit janë një zonë kërkimore akademike që është zgjeruar në mënyrë shpërthyese vitet e fundit. Përkthimi është studjuar më parë si një metodologji e mësimit të gjuhës ose si pjesë e literaturës krahasuese, 'workshopeve të përkthimit' dhe kurseve gjuhësore, por disiplina siç e dimë tani i detyrohet shumë punës së James S. Holmes, i cili përmes veprës *Emri dhe natyra e studimeve përkthimologjike* propozoi një emër dhe një strukturë për t'ju referuar studimeve përkthimologjike. Sidoqoftë, me kalimin e kohës ndërdisiplinimi i lëndës është bërë më i dukshëm dhe zhvillimet e fundit kanë parë specializim në rritje dhe importimin e vazhdueshëm të teorive dhe modeleve nga disipinat e tjera.

Kemi filluar me kreun e parë ku kemi prezantuar një qasje sa teorike aq edhe informuese mbi fillesat dhe ecurinë e procesit të përkthimit që nga kulla e Babelit në librin e Gjenezës ku sipas të cilës, pasardhësit e Noas, vendosën pas përmbytjes së madhe të stabilizoheshin në tokën e Shinarit. Atje, ato bënë një mëkat të madhë. Në vend që të krijonin një shoqëri që i përshtatej vullnetit të Zotit, ata vendosën t'a sfidonin Atë dhe të ndërtonin një kullë që të arrinte Parajsen. Megjithatë, ky plan nuk u përmbush pasi Zoti duke e ditur dëshirën e tyre, mori situatën nën kontroll përmes një strategjie linguistike. Ai bëri që ato të flisnin gjuhë të ndryshme në mënyrë që të mos kuptonin njëri-tjetrin. Pastaj, Ai i shpërndau ato në vende të ndryshme të botës. Pas kësaj ngjarjeje, numri i gjuhëve në botë u rrit dhe njerëzit filluan të kërkonin mënyra për të komunikuar dhe si rezultat lindi përkthimi. Me lindjen e shkencave përkthimore dhe rritjen e kërkimit në këtë fushë, njerëzit filluan të largoheshin nga historia e kullës së Babelit dhe filluan të kërkonin të dhëna specifike që shënonin periudhat e historisë së përkthimit. Kërkuesit pohojnë që shkrimet mbi përkthimin datojnë që në kohë të romakeve. Erik Xhakobson (Eric Jakobson) thotë se përkthimi është një shpikje romake. Ai thekson që Ciceroni dhe Horaci (shek I p.e.s) ishin teoricienët e parë të cilët bënë dallimin mes përkthimit fjalë për fjalë dhe përkthimit të mirëfilltë kuptimplotë.

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Në Mesjetë, Shkolla e Përkthyesve Toledo u bë pikë takimi e përkthyesve nga e gjithë Evropa në shekujt XXII dhe XXIII për të përkthyer të gjitha veprat kryesore arabe dhe greke filozofike, fetare, shkencore dhe mjekësore në Latinisht.

Qasja më sistematike, dhe kryesisht e orientuar nga ana gjuhësore për studimin e përkthimit, filloi të shfaqej në vitet '50 dhe '60. Ka një numër shembujsh klasikë si: Zhan-Paul Vinej dhe Zhan Dabernet (Jean-Paul Vinay dhe Jean Darbelnet) prodhuan prodhimet e tyre *Stilistikë krahasues të frëngjishtes dhe anglishtes: Një metodologji për përkthimin (Comparative Stylistics of French and English: A methodology for Translation)*, (1958), një qasje kontrastive që kategorizonte ato që ata shikonin në praktikën e përkthimit midis frëngjisht dhe anglisht; Alfred Malblanc (1963) bëri të njëjtën gjë për përkthimin midis frëngjisht dhe gjermanisht; Georges Mounin *Problemet teorike të përkthimit (Les problèmes théoriques de la traduction)*, (1963) shqyrtuan çështjet specifike të përkthimit; Eugjeni Nida (Eugene Nida) (1964) përfshiu elemente të gramatikës së atëhershme të modelit të Chomskit (Chomsky) si një themel teorik i librave të tij, të cilat fillimisht u hartuan për të qenë manuale praktike për përkthyesit e Biblës.

Në shek. 18-të, përkthyesi krahasohej me një artist me detyrën morale ndaj punës së autorit origjinal dhe lexuesit. Për më tepër, me zhvillimin e teorive të reja dhe volumet e procesit të përkthimit, studimi i fushës së përkthimit filloi të ishte më sistematik. Vëllimi i Aleksander Frejzer Tajtler (Aleksander Fraser Tytler) “Parimet e Përkthimit” 1791 është një nga studimet më me influencë të publikuara në atë kohë.

Shek. 19-të u karakterizua nga dy konflikte. I pari e konsideronte përkthimin si kategori e mendimit dhe e shikonte përkthyesin si një gjeni krijues, i cili pasuronte letërsinë dhe gjuhën në të cilën ai po përkthente. Konflikti i dytë e shikonte përkthyesin përmes funksionit mekanik të të bërit të një teksti apo të bërit të një autori të njohur në gjuhën që po përkthente. Siç pohon dhe Snell-Hornby “kjo periudhë njohu gjithashtu zhvillimin e romanticizmit i cili çoi në krijimin e shumë teorive dhe përkthimeve në fushën e letërsisë, veçanërisht në poezi. Në gjysmën e dytë të shek. 19-të, studimet në fushën e përkthimit u bënë një tematike e rëndësishme në mësimdhënien dhe studimin në shkolla.

Në ditët e sotme kërkimet mbi fushën e përkthimit kanë filluar të marrin një rrugë tjetër e cila është më automatike. Shpikja e internetit së bashku me zhvillimet e reja teknologjike në fushën e komunikimit kanë rritur shkëmbimet kulturore mes kombeve. Kjo i bëri përkthyesit që të kërkonin për mënyra se si të përballeshin me këto ndryshime dhe të perdornin teknika praktike që i mundësonin atyre që të përkthenin më shumë dhe të humbisnin më pak. Ato gjithashtu e kishin të nevojshme të hynin në botën e përkthimeve kinematografike, gjë që solli lindjen e përkthimit audio-viziv. Për t’a mbyllur këtë pjesë hyrëse të këtij kapitulli kemi menduar të sjellim një shtrirje kohore të përkthimeve dhe përkthyesve në vite të hartuar nga Marie Lebert në punimin e saj *Historia e përkthimit dhe e përkthyesave*, e cila fillon me punimet dhe përkthyesit më me zë që nga shekulli i II pes, Terence, e përfundon në 2016 me romanistin italian, kritikun letrar, përkthyesin dhe profesorin Umberto Econ.

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Pjesa e dytë e këtij kreu vazhdon me teorinë mbi përkthimin, llojet dhe metodat e përkthimit. Vlen të përmendet ndarja në tre kategori nga strukturalisti ruso-amerikan Roman Jakobson në veprën e tij *Mbi aspektet gjuhësore të përkthimit*, respektivisht:

(1) përkthim brëndagjuhësore, ose "rishkrim": "interpretim i shenjave gjuhësore të një gjuhë me anë të shenjave gjuhësore të së njëjtës gjuhë";

(2) përkthimi ndër-gjuhësor, ose ‘përkthimi i duhur’: interpretim i shenjave gjuhësore me anë të shenjave gjuhësore të ndonjë gjuhe tjetër’;

(3) përkthim ndër-semiotik, ose ‘shndërrim’: ‘interpretim i shenjave gjuhësore me anë të shenjave të sistemeve të shenjave jogjuhësore’.

Ndërsa Newmark na ndihmon me llojet e përkthimit të cilat ndahen si më poshtë:

Përkthimi fjalë për fjalë është përkthimi në të cilin fjalët përkthehen duke u marrë si njësi të veçanta dhe jo si pjesë të një fjalie apo teksti duke humbur kështu elementët e përmbajtjes; **Përkthimi strukturor**, ashtu siç na e tregon dhe emërtimi, është ai lloj përkthimi që përqëndrohet më tepër në rendin e fjalëve, ruajtjen e tij edhe në gjuhën e përkthimit; **Përkthimi besnik** është lloji i përkthimit i cili “kujdeset” të sjellë në gjuhën e përkthimit si formën ashtu dhe përmbajtjen; **Përkthimi semantik** është një përkthim që ndalet me tepër në vlerat estetike të tekstit në gjuhën e përkthimit ndryshe nga përkthimi besnik; **Përkthimi me përshtatje** është përkthimi përmes të cilit ruhen temat, personazhet si dhe përmbajtjet; **Përkthimi i lirë** është ai lloj përkthimi në të cilin përkthyesi ruan vetëm esencën e origjinalit por pa u kujdesur shumë për formën, strukturën e ndonjëherë edhe përmbajtjen; **Përkthimi idiomatik** ka si qëllim të riprodhojë të njëjtin mesazh që përcjell teksti origjinal edhe pse ka raste që është e vështirë të gjenden ekuivalentët në gjuhën e përkthimit; **Përkthimi komunikues** synon të sjellë në gjuhën e përkthimit tekstin duke ruajtur si formën ashtu dhe përmbajtjen në mënyrë që të komunikojë, të përcjellë një mesazh sa më të kuptueshëm.

Në vijim kemi prezantuar tre metodat kryesore të përkthimit të cilat janë:

përshtatja e cila përkufizohet si kufiri i skajshëm i përkthimit: përdoret në ato raste kur lloji i situatës për të cilin referohet mesazhi i gjuhës origjinale nuk është i njohur në kulturën e gjuhës së përkthimit. Në raste të tilla, përkthyesit duhet të krijojnë një situatë të re që mund të konsiderohet si ekuivalente. Përshtatja mund të përshkruhet si një lloj i veçantë ekuivalentimi, një ekuivalencë situative.

transpozimi përfshin zëvendësimin e një fjale që i përket një kategorie të caktuar gramatikore me një tjetër pa ndryshuar përmbajtjen e mesazhit. Përveç faktit se kjo është një procedurë e veçantë përkthimore, transpozimi mund të përdoret edhe për ndryshimet që ndodhin brenda të njëjtës gjuhë.

ekuivalenca përdoret në rastet kur kemi të bejmë me dy tekste që kanë dy stile dhe metoda strukturore tërësisht të ndryshme. Produkt i përdorimit të ekuivalencës janë dy tekste ekuivalente. Ekuivalencat, në shumicën e rasteve, janë të “ngurta” dhe përdoren sidomos në rastet e përkthimit të shprehjeve frazeologjike, proverbave, grupeve emërore,

etj. Nida është në favor të "dy orientimeve themelore" ose "llojeve të ekuivalencës": (1) ekuivalencës formale dhe (2) ekuivalencës dinamike. Këto përcaktohen nga Nida si më poshtë: **Ekuivalenca formale**: përqendron vëmendjen në vetë mesazhin, si në formë ashtu edhe në përmbajtje ... shqetësohet që mesazhi në gjuhën e receptorit duhet të përputhet sa më shumë që të jetë e mundur me elementët e ndryshëm në gjuhën e përkthimit. **Ekuivalenca dinamike**: bazohet në atë që Nida e quan "parimi i efektit ekuivalent", ku "marrëdhënia midis receptorit dhe mesazhit duhet të jetë në thelb e njëjtë me atë që ekzistonte midis receptorëve origjinal dhe mesazhit". Mesazhi duhet të përshtatet për nevojat gjuhësore dhe pritjen kulturore të receptorit dhe synon "natyralitetin e shprehjes" të plotë. Kjo qasje e orientuar nga receptorët konsideron përshtatjet e gramatikës, të leksikut dhe të referencave kulturore si thelbësore për të arritur natyralitetin.

Pika vijuese e këtij kreu është çështja e qëndrimit të përkthyesit ndaj tekstit të gjuhës së origjinalit dhe bazuar në pikëpamjet dhe rezultatet e shumë studimeve mbi teoritë e procesit të përkthimit është gjithnjë e më shumë e rëndësishme që përkthyesi t'a kuptojë shumë mirë tekstin origjinal në mënyrë që teksti në gjuhën e përkthimit të transmetohet në një mënyrë sa më natyrale. Por, për ta kuptuar tekstin origjinal mendohet që të njohë shumë mirë edhe kulturën e vendit në të cilën flitet ajo gjuhë e caktuar. Përkthyesi rekomandohet të vendosë lidhur me rëndësinë që kanë elementët kulturorë dhe deri në çfarë pike është e nevojshme të përkthehen apo edhe shpjegohen në gjuhën e përkthimit. Ai merr gjithashtu në konsideratë qëllimet e tekstit origjinal si dhe gjithashtu lexuesit e këtij të fundit në gjuhën e përkthimit. Në fund theksohet se vështirësia kryesore dhe më e madhja e përkthyesit është ndërtimi i figurës së lexuesit ideal të tekstit në gjuhën e përkthimit i cili edhe pse mund të ketë të njëjtin nivel intelektual, arsimor, dhe profesional me lexuesin e tekstit origjinal ekzistojnë ndryshime për sa u përket pritshmërive lidhur me tekstin dhe elementët kulturorë.

Vazhdojmë me zhvillimet kryesore në fushën e përkthimit para viteve '90, llojet dhe metodat kryesore të përkthimit në këtë periudhë duke u ndjekur më pas nga parashtrimi i procesit të përkthimit pas viteve '90 si dhe llojet dhe metodat kryesore të përkthimit gjatë asaj periudhë për ta mbyllur këtë kre të parë me ndryshimet në metodikën e procesit të përkthimit në periudhën para dhe pas viteve '90.

Ashtu siç shpjeguam në hyrje të këtij punimi, për shekuj me radhë njerëzit kanë besuar në lidhjen mes përkthimit dhe historisë së Kullës së Babelit. Me lindjen e studimeve mbi përkthimin dhe me rritjen e numrit të kërkimeve në këtë fushë njerëzit filluan të largohen nga historia e Babelit dhe filluan të kërkonin për data dhe figura të cilat përkonin me periudhat e historisë së përkthimit. Përkthimi u studjua fillimisht si një fenomen lingvistik, si një proces i transmetimit të fjalëve, mesazheve nga një gjuhë në tjetrën. Ai u konsiderua si një disiplinë gjuhësore. Ia vlen të përmendet fakti se shekulli i XIX-të u karakterizua nga dy tendenca kontradiktore: e para lidhej me përkthimin që konsiderohej një lloj mendimi dhe që e shihte përkthyesin si një gjeni krijues i cili pasuronte letërsinë dhe gjuhën në të cilën ai përkthente; ndërsa tendenca e dytë e shihte përkthyesin si një makineri e cila kishte si funksion të bënte një tekst, ta sillte atë në një gjuhë tjetër.

Ndërsa pas viteve 90, në Shqipëri u vu re një rritje e madhe e numrit të përkthimeve nga letërsia e huaj. Kjo gjë erdhi si rezultat i ndryshimeve të mëdha që ndodhën në vend pas

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

rënies së komunizmit, ndryshime këto që prekën edhe fushën e përkthimit. Deri në atë moment, letërsia e huaj ishte e censuruar dhe e mirëmonitoruar pasi përkthimet nuk duhet të zgjonin tek populli ndjenja që binin në kundërshtim me atë që propagandohej nga regjimi në fjalë. Për këtë arsye, shqiptarët ishin të etur për letërsi “ndryshe” më të hapur dhe të zhvilluar.

Në ditët e sotme, përkthimi ka marrë një rrugë tjetër duke qenë se gjithçka po shkon drejt automatizimit. Shpikja e internetit bashkë me zhvillimet e reja teknologjike në të gjitha fushat e jetës ka rritur bashkendarjen mes kombeve. Kjo gjë ka bërë që përkthyesit të gjejnë forma të ndryshme sesi të përshtaten më këto ndryshime të mëdha dhe të gjejnë e përdorin teknika që nuk mund t’i zëvendësojë as teknologjia më e zhvilluar.

Lidhur me llojet dhe metodat e përkthimit mund të themi se ato vazhdojnë të jenë prezente po njësoj pavarësisht ndryshimeve të lartpërmendura. Përdorimi i tyre përcaktohet thjesht nga lloji i tekstit, pra kur duhet një përkthim i lirë si në rastin e disa poezive apo kur duhet një përkthim besnik si në rastin e teksteve teknike e shkencore ku përkthyesi nuk duhet të bëjë ndryshime, të heqë apo të shtojë element nga vetja. Kemi dhe rastin e përkthimit komunikues që përdoret në ligjërata dhe fjalime. Ai ka mbetur në thelb i njëjtë dhe ndryshimet e vetme mund të vijnë nga fjalët e reja por qartësia dhe karakteristikat e tjera mbeten po ashtu në thelb. Ndërsa, përkthimi fjalë për fjalë është një përkthimi që përdoret në përkthimin e automatizuar, ai që quhet “machine translation”.

Kreu i dyte ka qasje përshkruese lidhur me veprën plaku dhe deti të Ernest Heminguei të përkthyer nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona. Në pjesën e parë kemi prezantuar jetën dhe veprat e Heminguei në mënyrë që të njihemi me karakteristikat e autorit, kushtet në të cilat ka jetuar të cilat kanë patur ndikim në veprat e tija. Si çdo vepër tjetër, edhe “Plaku dhe Deti” ka personazhe kryesorë rreth të cilëve sillet e gjithë vepra, kështu kemi sjellur dhe analizën e këtyre personazheve së bashku me tematikat dhe simbolet e trajtura në këtë vepër, duke bërë kështu që pjesa e parë të ketë më tepër në konsideratë aspektin letrar.

Pjesa e dytë na prezanton me jetën dhe veprat e Ismail Kadaresë dhe Vedat Kokonës, veprimtaritë e tyre si përkthyes, duke qenë se këto janë dy figurat kryesore në analizën e këtij hulumtimi.

Vlen të përmendet fakti se Ernest Heminguei ka qenë një figurë shumë e njohur madje dhe lider i të ashtuquajturit “Brezi i Humbur.” Për sa i përket jetës së tij, ajo ishte e qetë. Ai ishte djali i një mjeku fizikant. Heminguei e kaloi fëmijërinë dhe rininë pas peshkimit dhe gjuetisë. Pas mbarimit të shkollës së mesme, ai punoi si reporter për Kansas City Star. Vetëm dy muaj më pas ai e lë punën me dëshirën për t’iu bashkuar ushtrisë së Shteteve të Bashkuara por ai nuk e kaloi ekzaminimin mjekësor që duhej bërë për të qenë pjesë e forcave të armatosura. Më pas ai u nis drejt Italisë dhe pak kohë më vonë ai u përball me brutalitetet e luftës. Ai u kthye në shtëpi në vitin 1920 dhe u punësua në një redaksi, në gazetën “Toronto Star” si korrespondent, shkrimtar dhe profesionist i lirë. Në vitin 1921 u martua me Hadley Richardson dhe u zhvendos në Paris për të bërë rolin e korrespondentit të Toronto Star për Luftën Greko-Turke.

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Në vitin 1923 ai botoi librin e parë, vit në të cilin lindi dhe djali i tij i parë, John. I dhënë pas jetës familjare, ai dha dorëheqjen në vitin 1924. Më pas ai vendosi të jetonte në Paris. Botimi i librit “Dhe Lind Dielli” (The Sun Also Rises) u prit me dashamirësi dhe pati sukses. Stili i tij pati ndikim në letërsinë e asaj kohe, periudhë në të cilën dominonte shkrimi Viktorian.

“Dhe Lind Dielli” është romani i parë i Ernest Hemingueit, njërit prej mjeshtërve më të mëdhenj të prozës bashkëkohore. Vendosur në sfondin romantik të Spanjës së korridave, subjekti tërheqës i romanit shpalos karakteret tipike të prozës së Hemingueit, karaktere të mundura, por jo të mposhtura, burrërore në dhimbjen e tyre. Një protagonist i traumatizuar fizikisht dhe shpirtërisht në Luftën Botërore, një shpirt i pashpresë e i trishtuar dashurie, një atmosferë dhimbjeje dinjitoze. Të gjitha këto elemente artistike të kësaj kryevepre të letërsisë së shekullit të kaluar, mishërojnë tiparet më thelbësore të asaj që u quajt “letërsi e brezit të humbur”.

“Plaku dhe Deti” u botua në vitin 1952. Suksesi i madh i kësaj vepre e motivoi së tepërmi shkrimtarin. Romani fitoi Cmimin Pulitzer në vitin 1953 dhe Cmimin Nobel në letërsi në vitin 1954.

“Plaku dhe deti” është një tregim për forcën dhe dinjitetin e shpirtit të njeriut. Me simbolikën e tij ai trajton pyetjen e madhe, se deri ku duhet të shkojë njeriu, deri ku duhet të guxojë. Kjo veper njihet si një nga veprat më të thjeshta, por më të fuqishme e më të çmuara të Hemingueit. Themi të thjeshta, sepse kemi pothuajse vetëm një personazh, një subjekt tepër të zakonshëm, por nëpërmjet të cilave autori arrin të japë një filozofi të tërë jetësore.

Mund të themi se “Plaku dhe deti” është një nga novelat më mbresëlënëse të nobelistit amerikan, Ernest Heminguei. Kjo veper erdhi për të mbetur në historinë e letërsisë si një narrativ që kumton për forcën dhe dinjitetin e shpirtit njerëzor. Me simbolikën e tij autori trajton pyetjen e madhe, se deri ku duhet të shkojë njeriu, deri ku duhet të guxojë ai për të matur forcat për t’u përballur me fatin dhe natyrën. Për Heminguein njeriu, edhe kur e di se do ta kapërcejë të zakonshmen, se po shkel përtej saj, në trevën e dyluftimit të pabarabartë, madje të vetë vdekjes, nuk ka përse të tërhiqet pa e provuar. Më mirë të kthehesh i mundur pasi e ke provuar ndeshjen, pasi e ke treguar se e ke guximin ta bësh, sesa të dështosh pa provuar. Plaku i detit na tregon se e arriti atë që nuk e kishte bërë tjetër kush dhe nuk ka rëndësi se nuk e solli edhe mishin e peshkut për ta ngrënë.

Dy miq-armiq të vjetër luftojnë përballë njëri-tjetrit, luftë që jep edhe mesazhin e lartë filozofik se njeriu nuk është krijuar për të pësuar humbje, të asgjësosh njeriun nuk do të thotë që e ke mposhtur atë. Duke krijuar personazhe të tillë si plaku Santiago, Heminguei lartëson figurën e njeriut që tregohet dinjitoz përballë dështimeve dhe sfidave në jetë.

Heminguei shkruan pak por nënkupton shumë. Personazhet parapëlqejnë më shumë heshtjen, mbylljen në vetvete çka e bën edhe me interesante e tronditëse leximin e veprës. Në pamje të parë ata duken të ftohtë, indiferente por në fakt cilësitë e tyre qëndrojnë në nëntekstet e frazës.

Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit “Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei

Vihet re edhe dialogimi me vetveten që përbën një veçori tjetër të personazheve të këtij romani. Edhe nëqoftëse personazhet ndiejnë frikë, gëzim apo cdo ndjenjë tjetër, ato nuk jepen por nënkuptohen nga situatat e krijuara. Kjo mban gjallë emocionin gjatë leximit të novelës.

Në veprën “Plaku dhe Deti” janë prekur disa tematike ku ndër to mund të përmendim *Sfidën* dhe *Dështimin*. Që në paragrafin e parë Santiago shfaqet si personi që lufton për të mos dështuar. Dështimi shfaqet tek gjithë ditët që ai nuk kishte kapur as edhe një peshk të vetëm. Megjithatë, ai e refuzon me çdo kusht dështimin: vendosë të peshkojë aq larg sa të tjerët nuk kishin shkuar kurrë pasi vetëm atje mund të gjente peshqit më të mëdhenj. Dyluftimi me peshkun e madh, edhe pse e dinte se beteja ishte pothuajse e humbur është tregues i dëshirës së tij për t’ia dalë mbanë.

Kreu i tretë ndahet në katër pjesë analitike: A, B, C, dhe D.

Pjesa A ka për bazë krahasim përkthimi i *Plaku dhe Deti* nga Ismail Kadare dhe *Plaku dhe Deti* nga Vedat Kokona në rrafshin gramatikor. Në analizën e realizur në këtë pjesë jemi ndalur në aspektin e analizës krahasuese të strukturës së fjalisë ku kemi përfshirë këto nëndarje: rendin e fjalëve në fjali; fjali me bashkërenditje apo me nënrenditje?; përkthimi i formës së ngurtësuar (ing-form); analizë krahasuese e përdorimit të kohëve të foljeve; analizë krahasuese e përkthimit apo jo të vetës së parë njëjës dhe shumës; analizë krahasuese mbi përdorimin e shenjave të pikësimit.

Pas studimit të shumë shembujve të cituar dhe shumë më tepër të pacituar për efekt hapësire, arrijmë në përfundimin se Kadareja i qëndron me besnik rendit të fjalëve në fjali të tekstit origjinal, ndërsa Kokona shpesh tregon përmbysje rendi të gjymtyrëve, ndërsa kur flasim për fjali me bashkërenditje apo me nënrenditje në versionet e përkthyer nga Vedat Kokona, gjëja e parë që vihet re është fakti se pjesët e bashkërenditura jo gjithmonë janë shprehur me lidhëzën shtuese *dhe* apo atë kundërshtuese *ndërsa* si në rastin e Kadaresë, por ato janë zëvendësuar me presje apo pikëpresje. Në analizën e formës së ngurtësuar (-ing), pas shqyrtimit të shembujve, arrijmë në përfundimin se në të shumtën e rasteve të dy përkthyesit nuk kanë përdorur asnjë nga format e pashtjelluara të foljes, siç zakonisht përdoren për të sjellë në gjuhën shqipe formën -ing. Në vend të këtyre formave, ata kanë përdorur kohën e pakryer apo të kryerën e thjeshtë. Përkthimi i kohëve të foljeve është mjaftueshmërisht i ngjashëm për të dy përkthyesit, të cilët përgjithësisht i qëndrojnë besnik kohëve të foljeve të dhëna në tekstin e origjinalit, ndërsa mos përkthimi i vetës së parë njëjës apo shumës është më shumë dukuri e përkthimeve të Kokonës sesa Kadaresë. Se fundmi, nga analiza se si kanë kaluar shenjat e pikësimit nga teksti origjinal në tekstet e përkthimit, është vënë re se të dy përkthyesit menjanojnë përdorimin e thonjëzave, ndërsa në përkthimin e Kokonës vihet re përdorimi i vijës ndarëse.

Pjesa B trajton krahasim përkthimi i *Plaku dhe Deti* nga Ismail Kadare dhe *Plaku dhe Deti* nga Vedat Kokona në rrafshin leksikilogjik. Këtu analiza përqëndrohet mbi përzgjedhjen e fjalëve, përkthimin e emrave të përveçëm si dhe mbi anglicizmat.

“Ka përkthime që e pasurojnë në mënyrë të mrekullueshme gjuhën në të cilën përkthehet dhe se në disa raste, arrijnë të thonë më shumë se origjinali”, shprehet Eko në librin e tij. Por zakonisht kjo gjë ka të bëjë pikërisht me veprën që realizohet në gjuhën e përkthimit. “Një përkthim që arrin “të thotë më shumë”, mund të jetë një vepër e shkëlqyer në vetvete, por nuk është një përkthim i mirë, pasi të përkthesh veprën e dikujt tjetër dhe të krijosh versionin tënd janë dy gjëra të ndryshme.” shkruan Eko.

Për sa i përket përzgjedhjes së fjalëve, tipike e kësaj vepre janë termat që kanë lidhje me peshkimin dhe analiza e shumë shembujve gjatë këtij studimi ka nxjerrur në dritë dy metodat kryesore të përdorura nga të dy përkthyesit të cilat janë: ekuivalentimi, me raste përshtatje, i termave të gjuhës e origjinalit, gjuhës angleze, me termat e gjuhës se përkthimit, gjuhën shqipe, si për shembull termi *fishing line*, Kadareja e përkthen *fill*, ndërsa Kokona *toje*, si dhe metoda e tjetër konsiston në përkthimin e drejtëpërdrejtë, fjalëpërfjalë, të termave si për shembull fjala *harpoon* është përkthyer *fuzhnjë* nga Kadareja, përkthim të cilin e gjejmë në fjalorin e Pavli Qeskut, ndërsa Kokona zgjedh ta përkthej si *kallam me grep në maje*, përkthim të cilin e gjejmë në Fjalorin e Gjuhës së Sotme.

Kur bëhet fjalë për përkthimin e emrave të përveçëm, përkthyesi mund të zgjedhë t'i ruajë ato siç janë apo t'i përkthejë. Kjo zgjedhje përcaktohet nga fakti se çfarë do të përcjellë përkthyesi në gjuhën e përkthimit dhe çfarë sugjeron teksti i origjinalit. Duke konsideruar shembujt që kemi prezantuar pjesë të analizës së studimit vërejmë se përkthyesi ka vendosur t'i përkthejë dhe arsyeja është se ata nuk mbartin ndonjë kuptim të veçantë përveç emërtimit. Ka raste kur përkthimi është si në origjinal, por kemi dhe raste kur emri lakohet sipas rasave të gjuhës shqipe apo edhe i përshtatet fonetikes se gjuhës shqipe, si p.sh: Gulf Stream(Heminguei)-Gul strim(Kadareja)-Golfstrim(Kokona).

Përsa i përket anglicizmave, pasi kemi marrur në konsideratë disa shembuj ilustrues nga libri original dhe dy versionet e përkthyerave vijmë në disa përfundime të përgjithshëm në lidhje me mënyrën sesi secili nga përkthyesit ka zgjedhur të sjellë keto terma nga gjuha origjinale në gjuhën e përkthimit dhe kur termi mungon në gjuhën shqipe, të dy përkthyesit zgjedhin alternativën e vetme. Kjo alternativë është mospërkthimi i fjalëve si pasojë e asaj që në anglisht quhet “linguistic gap” (boshllëk gjuhësor), pra mungesë e termit në gjuhën e përkthimit dhe kështu zgjedhin ruajtjen e termit në formën e origjinalit dhe përshtatja e vetme është nga ana fonologjike: p.sh baseball (Heminguei)-bejsboll(Kadareja)-bejzboll(Kokona).

Po të marrim pastaj rastet kur fjala është e përkthyeshme vërejmë se Kadareja zgjedh të huazojë, ndërsa Kokona e përkthen atë duke përdorur fjalën në gjuhën shqipe që është e barazavlefshme me atë të gjuhës angleze: negro (Heminguei)-negër (Kadareja)-zezak (Kokona); automatically (Heminguei)-automatikisht (Kadareja)-vetvetiu (Kokona).

Pjesa C ka trajtuar krahasim përkthimi i *Plaku dhe Deti* nga Ismail Kadare dhe *Plaku dhe Deti* nga Vedat Kokona në rrafshin stilistikor. Si fillim kemi vënë në dukje faktin se termi “stil” është një term i gjerë që strehon një numër të madh të teorive dhe pikëpamjeve. Idetë, mendimet dhe teorit ndryshojnë në lidhje me kuptimin e asaj që përbën thelbin e stilit. Prandaj, asnjë përcaktim i vetëm nuk duhet të jetë i privilegjuar ndaj të tjerëve, pasi

stili është përshkrues i këtyre pikëpamjeve të ndryshme. Secila teori i afrohet pyetjes së stilit me një vizion të ndryshëm. Do të ketë aq shumë përkufizime sa ka teori të ndryshme. Për më tepër, besohet se stili është një term i paqartë, ‘i pakapshëm’. Prandaj, është e pamundur të arrihet në një përkufizim përfundimtar i termit "stil", ku të gjitha tiparet duhet të shtrydhen në një përkufizim të vetëm. Dy përkufizime konsiderohen se janë të rëndësishme për sa i përket këtij studimi: 1. stili si devijimi dhe 2. stili si zgjedhja. Devijimi është një koncept që i referohet shkeljes së përdorimit normal të gjuhës. Efekti kryesor i këtij lloji të stilit arrihet nga shkeljet, qoftë semantike, sintaksore, leksikore, etj. Zgjedhja varet veçanërisht nga frekuencat e veçorive të caktuara. Ajo ka të bëjë me shumën e atyre tipareve të qenësishme në tekst të cilat konsiderohen si rregulla stilistike që përcaktojnë preferencën stilistike.

Gjatë procesit të përkthimit në përgjithësi, si dhe gjatë përkthimit të veprave që i përkasin letërsisë artistike, përkthyesi vëren stilet e ndryshme funksionale. Këto stile, pavarësisht nga ndryshimet që mund të vërehen nga pikëpamja funksionale, për përkthyesin nuk paraqesin vështirësi për faktin se kanë më shumë elementë të përbashkët se sa dallues. Përkthyesi mendohet t’i kushtojë vëmendje tipareve dalluese që ekzistojnë ndërmjet stileve funksionale dhe siç citon dhe Prof. Dr. Ristani “Detyrë e përhershme e përkthyesit mbetet ndërgjegjësimi në lidhje me tiparet dalluese të stileve funksionale, në kuadrin e skemave të stileve funksionale përkatësisht në gjuhën e burimit dhe në atë mbërritëse, përcaktimi i tipareve dalluese të përhershme të tyre.”

Për të bërë një krahasim të stileve të dy përkthyesve duhet fillimisht të përmendim disa nga karakteristikat e stilit të Ernest Heminguei. Vërehet se stili i tij është pothuajse i njëjtë në të gjitha veprat e shkruara nga ai. Ky stil karakterizohet nga fjali të shkurtra, të thjeshta, por me një kuptim të thellë. *Plaku dhe Deti* mund të konsiderohet një vepër e thjeshtë, por tepër e fuqishme. Mund të duket e thjeshtë pasi ka vetëm një personazh kryesor që lufton pafund për të dalë “fitimtar”, por në fakt kemi një simbolikë të madhe të një njeriu i cili lufton në çdo ditë të jetës së tij për t’ia dalë mbanë. Një tjetër karakteristikë që mund të përmendet në lidhje me stilin e Hemingueit është dhe përdorimi i fjalëve me kuptime të shumëfishta si dhe përsëritja e fjalëve. Pra, për të bërë një përgjithësim mund të themi se ai shkruan thjesht, shkurt dhe në të njëjtën kohë përcjell mesazhe shumë të forta.

Bazuar në analizen e realizur në këtë studim arrijmë në përfundimin se kur vlerësojmë stilet përkthimore të Kadaresë dhe Kokonës mund të themi se Kokona është më tepër i orientuar tek ligjërimi bisedor, pra fjalët që ai zgjedh janë të thjeshta dhe shumë afër gjuhës së përditshme, sidomos në këtë vepër e cila në përgjithësi ka një gjuhë të tillë. Po të flasim për stilin e Kadarësë mund të themi se stili i tij është paksa më i ndryshëm se ai i Kokonës. Megjithatë, *Plaku dhe Deti* “e detyron” atë që të përdorë herë pas here dhe një stil paksa të shkujdesur bisedor në mënyrë që efekti të përcillet tek lexuesit në mënyrë sa më të mirë.

Ndërsa mjetet stilistike që do të shqyrtojmë në këtë pjesë të kapitullit janë: përshtatja, ekuivalenca dhe transpozimi. **Përshtatja** përkufizohet kështu: “Përshtatja është kufiri i skajshëm i përkthimit: përdoret në ato raste kur lloji i situatës për të cilin referohet mesazhi nga gjuha e origjinalit nuk është i njohur në kulturën e gjuhës së përkthimit. Në

raste të tilla, përkthyesit duhet të krijojnë një situatë të re që mund të konsiderohet si ekuivalente”. **Ekuivalenca** përdoret në rastet kur kemi të bëjmë me dy tekste që kanë dy stile dhe metoda strukturore tërësisht të ndryshme. Produkt i përdorimit të ekuivalencës janë dy tekste ekuivalente. Ekuivalencat, në shumicën e rasteve, janë të “ngurta” dhe përdoren sidomos në rastet e përkthimit të shprehjeve frazeologjike, proverbave, grupeve emërore, etj. Metoda e quajtur **transpozim** përfshin zëvendësimin e një fjale që i përket një kategorie të caktuar gramatikore me një tjetër pa ndryshuar përmbajtjen e mesazhit.

Duke patur parasysh shembujt e dhënë për të ilustruar punën e përkthyesve në rrafshin stilistikor është e qartë se të dy përkthyesit shfaqin përdorim të bollshëm të të tre këtyre mjeteve stilistike për të menaxhuar procesin e përkthimit nga gjuha origjinale në atë të përkthimit, si ne ato raste kur ishte nevoja e përshtatjes së termit të tekstit origjinal me atë të gjuhës së përkthimit pasi kemi “boshllëkun gjuhësor” që duhet kapërcyer, apo ekuivalencën e termave dhe shprehjeve frazeologjike duke u përpjekur për të ruajtur stilin e origjinalit si dhe transpozimin e shumëpërdoruar kur kemi të bëjmë me tekste që kanë një hendek mes strukturave gramatikore dhe stilistike. Megjithatë, puna e dy përkthyesve është e lavdrueshme pasi pavarësisht mjeteve stilistike të përdorura apo ndryshimeve në formë e strukturë, përmbajtja dhe kuptimi ka mbetur po ai dhe efekti që përcillet tek lexuesit është i njëjtë.

Pjesa e fundit e këtij kreu, pjesa D ka analizuar krahasim përkthimi i *Plaku dhe Deti* nga Ismail Kadare dhe Vedat Kokona në rrafshin pragmatik. Fillimisht u trajtuan kushtet historike në të cilat është shkruar kjo vepër dhe ndikimin që ato kanë pasur për sa u përket personazheve të krijuara nga Heminguei apo dhe situatave të ndryshme si dhe mënyrën e jetesës në ato vende si pasojë e këtyre kushteve historike.

Ana kulturore ka gjithashtu peshën e saj të madhe pasi në shumë pjesë të “*Plaku dhe Deti*” reflektohet kultura e vendeve në të cilat autori ka jetuar apo thjesht i ka vizituar. Ai ka sjellë copëza kulturash spanjolle dhe kubane për t’i bërë pjesë të kësaj vepre e cila ka lënë gjurmë të mëdha në letërsinë amerikane.

Në vijim kemi trajtuar disa shembuj për të ilustruar dhe krahasuar sesi kanë ardhur idiomat dhe shprehjet frazeologjike nga gjuha angleze në gjuhën shqipe nga dy përkthyesit tonë. Bazuar në kete analizë ,mundemi të arrijmë në përfundimin se të dy përkthyesit kanë sjellur mjeshtërisht çdo emocion të synuar nga teksti origjinal në tekstin e gjuhës së përkthyer, ndërsa i vetmi ndryshim që bie në sy është se në përkthimet e Kadaresë , duke u përqëndruar në rrafshin pragmatik, prirjet janë drejt përkthimit sa më të drejtëpërdrejtë, ndërsa Kokona përshtat më shumë me kontekstin dhe kulturën.

Kreu i katërt i cili është gjithashtu dhe pjesa e fundit e analizës krahasimtare të studimit, ka në zemer të saj krahasimin analitik mbi llojet e përkthimit të përdorura nga Kadareja dhe Kokona në dy versionet përkatëse të përkthimit të veprës *Plaku dhe Deti*. Në këtë analizë kemi trajtuar dhe ilustruar me shembuj konkret tetë lloje përkthimi të shfrytëzuara nga të dy përkthyesit tonë, respektivisht:

Përkthimi fjalë për fjalë është përkthimi në të cilin ruhet forma por mund të humbasin elementë nga përmbajtja pasi fjalët përkthehen duke u marrë si njësi të veçanta dhe jo si

pjesë të një fjalie apo teksti. Në këtë mënyrë kontakti nuk merret në konsideratë dhe për këtë arsye mesazhi mund të mos përcillet në mënyrën e duhur.

Përkthimi strukturor është përkthimi në të cilin ruhet rendi i fjalëve ashtu siç është në tekstin origjinal për t’u sjellë po në atë formë dhe në tekstin e gjuhës së përkthimit. Në këtë lloj përkthimi vëmendja e përkthyesit përqëndrohet tek struktura e fjalisë.

Përkthimi besnik është përkthimi, qëllimi i të cilit, është të riprodhojë kuptimin sa më të saktë kontekstual të tekstit në gjuhën origjinale duke iu përshtatur strukturave gramatikore të gjuhës së përkthimit duke u kujdesur si për formën ashtu dhe për përmbajtjen.

Përkthimi semantik është një përkthim i cili ndryshon nga përkthimi besnik duke qenë se ai fokusohet me tepër te vlerat estetike të tekstit në gjuhën e përkthimit. Përkthyesi e kthen vëmendjen e tij mbi stilin e autorit dhe mënyrën sesi ai e ka përdorur gjuhën.

Përkthimi me përshtatje është dhe forma më e lirë e përkthimit dhe ky lloj përkthimi përdoret kryesisht në veprat dramatike, si p.sh në komeditë apo gjithashtu dhe në poezi. Përmes këtij lloj përkthimi ruhen temat, personazhet si dhe përmbajtjet si dhe gjithashtu kultura e gjuhës në të cilën është shkruar vepra përshtatet me kulturën në të cilën do të përkthehet.

Përkthimi i lirë: ashtu siç e tregon dhe vetë emërtimi, ai është një përkthim që realizohet pa marrë shumë parasysh stilin, formën apo dhe përmbajtjen e origjinalit.

Përkthimi idiomatik është ai lloj përkthimi ka si qëllim të riprodhojë të njëjtin mesazh që përcjell tekstin origjinal por duke bërë disa ndryshime në zgjedhjen e fjalëve në mënyrë që të përshtatet me gjuhën e përkthimit por duke e sjellë kuptimin si në origjinal.

Përkthimi komunikues është ai lloj përkthimi që synon të përcjellë të njëjtin kuptim siç e përcjell tekstin origjinal duke ruajtur formën dhe përmbajtjen në atë masë sa të jetë i kuptueshëm dhe i pranueshëm për lexuesin e tekstit në gjuhën e përkthimit.

Në të gjithë shembujt e përmendur në këtë kapitull kemi vënë re se të dy përkthyesit i kanë prekur të gjithë këto metoda si dhe ka raste kur një metodë nuk është e vetmja e përdorur brenda një fjaliqe por ka dhe raste të kombinimeve për shkak të përshtatjes që duhet bërë për të sjellë një version përkthimi sa më natyral, të saktë dhe të kuptueshëm për lexuesin pasi ky i fundit është dhe qëllimi kryesor i përkthyesve.

Ky studim sa teorik e përshkruar në fazat e para, aq edhe analitik e krahasimtare në thelbin e tij, ka arritur të përmbush pikë së pari qëllimin e realizimit të një analize të detajuar të bazuar në dy versionet e përkthyer në shqip të veprës *Plaku dhe deti* të Ernest Heminguei, përkatësisht nga Ismail Kadare në vitin 1963 dhe nga Vedat Kokona në vitin 1997. Ky studim analizoi tiparet dhe vecoritë e aspekteve të veçanta në të

dy versionet e përkthyer të veprës origjinale, duke theksuar ngjashmëritë ashtu si dhe ndryshimet që ka pësuar metodika e përkthimit të dy periudhave të ndryshme kohore.

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Kjo hulumtim ka në zemër një tematike shumë të rëndësishme, përkthimin (që nga origjina e tij, studimet mbi të, klasifikimet e deri tek metodat e llojet e tij) dhe analizën krahasimtare të përkthimeve ndërmjet gjuhëve të ndryshme (anglisht dhe shqip në këtë rast) në të katër rrafshet e saja analitike: gramatikor, leksikologjik, stilistikor dhe pragamatik.

Tashmë dihet se roli i përkthyesve në shoqërinë njerëzore vjen e bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Në gjithë historinë e njerëzimit, përkthimi do të luaj gjithmonë një rol shumë të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm për zhvillimin e tij. Kjo analizë, siç e pohuam që në hyrje, e këtyre përkthimeve të këtyre dy përkthyesve shume të aftë siç janë Kadareja dhe Kokona të veprës së mirënjohur *Plaku dhe deti* e shkruajtur nga një prej shkrimtarëve me famë botërore Ernest Heminguei është sfidë dhe arritje më vete.

Ky hulumtim shpresojmë të merret për bazë për studime të ndryshme akademike, të cilat kanë si qëllim analizën krahasimtare të versioneve përkthimore të vepra të mirënjohura për të dalluar tipare të vecanta, për të përcaktuar ecurinë e procesit të përkthimit, metodikat dhe çdo aspekt të mundshëm gramatikor, leksikologjik, stilistikor apo pragamatik për të pasuar kështu njohurinë tonë mbi këtë fushë gjithnjë e më të rëndësishme për shoqërinë tonë.

“Përkthyesit duhet të dëshmojnë para vetes dhe të tjerëve se ata kanë nën kontroll atë që bëjnë; se ata jo vetëm përkthejnë mirë, sepse ata kanë një "dhunti" për përkthim, por më tepër sepse ashtu si profesionistët e tjerë ata kanë bërë një përpjekje të vetëdijshme për të kuptuar aspekte të ndryshme të punës së tyre. ”

Mona Baker

Bibliografia

- Austin, J. L, *How to do things with words*, London, Oxford University Press, 1962
- Baker, Carlos, *Ernest Hemingway: A Life Story*, New York, Charles Scribner’s Sons, 1969
- Baker, C. L, *English Syntax, Second Edition*, Cambridge, Massachusetts, London England, The MIT Press, 1995
- Baker, Mona , *In Other Words: A Coursebook on Translation*, 1992, London: Sage Publication.
- Baker, Mona , *Translation and Conflict: A Narrative Account* ,London and New York: Routledge, 2006
- Bassnett-McGuire, Susan, *Translation Studies*, London, Methuen, 1980
- Bassnett, Susan and Andre Lefevere, *Translation, History and Culture*, London and New York Routledge, 1992
- Bell, R.T., *Translation and Translating: Theory and Practice*, London: Longman, 1991
- Bell, R.T. *Translation theory; where are we going?*META, London, 1991
- Bielsa, E, *Globalization as Translation: An Approximation to the Key but Invisible Role of Translation in Globalization*. CSGR Working Paper, 2005
- Brenner, Gerry, *The Old Man and the Sea: Story of a Comman Man*, Boston, Twayne, 1991
- Burton-Roberts, N. , *Analyzing Sentences: An Introduction to English Syntax*, Harlow Longman, 1986.
- Catford J.C , *A Linguistic Theory of Translation*, London: Oxford University Press , 1965.

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Chapman, Siobhan, *Philosophy for Linguists: An Introduction*, London and New York, Routledge, 2000

Chatman, Seymour, *Literary Style: A Symposium*, Oxford University Press, 1971

Coulthard, M., *Linguistic Constraints on Translation. In Studies in Translation.* Universidada Fedaral de Santa Catarina, 1992

Doksani, Jorgji & Agim, *Letersia Boterore e Shekullit XX*, Shtëpia botuese UEGEN, 2008

Domi, Mahir, & Toton, Menella & Cikuli, Nikoleta \$ Floqi Spiro, *Rregullat e Pikësimit në Gjuhën Letrare Shqipe*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1981

Donaldson, Scott, *By Force of Will: The Life and Art of Ernest Hemingway*, New York, Viking, 1977

Dryer S. Mathew, *Language Typology and Syntactic Description*, Oxford University Press, 1998

Eco, Umberto, *Të thuash gati të njejtën gjë*, Përkth. Mariana Ymeri & Alketa Ylli, Tiranë, 2006

Eco, Umberto, *Për letërsinë (Sulla Letteratura)*, Përkth. Donika Omari, Bompiani 2002

Elsie, Robert, *Histori e letërsisë shqipëtare*, Përkth. Abdurrahim Myftiu, Peje 2001

Enkvist, Nils Erik, *Linguistics and Style; On defining Style*, Oxford University Press, 1960

Fenton, Charles A, *The Apprenticeship of Ernest Hemingway: The Early Years*, New York, Farrar, Straus and Young, 1954

Franklin, Victoria, *An Introduction to Language*, Wadsworth, 2003.

Fuentes, Norberto, *Hemingway in Cuba*, New York: Carol, 1984

Galperin, I. R, *An Essay in Stylistic Analysis*, Higher School Publishing house, Moscow, 1978

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Gentzler, Edwin, *Contemporary Translation Theories*, London and New York Routledge, 1993

Greenbaum, Sidney & Nelson, Gerald, *An Introduction to English Grammar*, London, Longman Pearson Education, 2002

Grice, H. P, *Logic and Conversation, Reprinted from Syntax and Semantics 3: Speech Acts, London*, University College Press, 1975

Griffin, Peter, *Along with Youth: Hemingway, The Early Years*, New York: Oxford University Press, 1985

Halliday, M.A.K., Hasan, R. *Language, Context and Text: Aspects of Language in a Social-semiotic Perspective*. Deakin University Press/Oxford University Press, Australia/Oxford, 1989

Hatim Basil and Ian Mason, *Discourse and the Translator*, London and New York. Longman, 1990

Hatim, Basil dhe Munday, Jeremy. *Translation: An advanced resource book*. New York: Taylor&Francis e-Library, 2004

House, J., In: Steiner, E., Yallope (Eds.), *How Do we Know when a Translation is Good?* Cambridge: University Press, 2001

Hotchner, A. E, *Papa Hemingway: A Personal Memoir*, New York, Random House, 1966

Hemingway, Ernest, *The Old Man and the Sea*, The Chaucer Press, 1952

Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Ismail Kadare, “Naim Frasheri”, Tiranë, 1963

Heminguei, Ernest, *Plaku dhe deti*, Përkth. Vedat Kokona, Cabej, Shtator 1997

Hurley, C. Harold, *Hemingway's Debt to Baseball in The Old Man and the Sea: A Collection of Critical Readings*, Lewiston, New York: Mellen, 1992

Hymes, Dell, *Foundations in Sociolinguistics*, Routledge and Kegan paul, 1960

Jakobson, R. *On linguistic aspects of translation*, in L. Venuti (ed.) 2004

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Jakobson, Roman, *Linguistics and poetic in Style in Language*, Harvard University press, 1995

Kobler, J. F, *Ernest Hemingway, Journalist and Artist*, Ann Arbor, Mich: UMI Research Press, 1985

Koller, W. , “*The concept of equivalence and the object of translation studies*”, Target, 1995.

Larson, Mildred L., *Meaning-based Translation*, University Press of America, New York, 1997

Lebert, Marie, *History of Translation and Translators*, CC BY-NC-SA, 2019

Lefevere, Andre, *That structure in the dialect of men interpreted*, New York: MLA, 1984

Lefevere, Andre, *Translating Literature: Practice and Theory in a Comparative Literature Framework*. Neë York: MLA, 1992

Lefevere, Andre, *Translatuon, History, Culture*, Routledge, London and New York, 2003

Lefevere, Andre, *Translation, Rewriting, and the Manipulation of Literary Fame*. London/New York:Routledge, 1992

Levý, Jiří, *The Art of Translation*, John Benjamins Publishing Co, Amsterdam, Netherlands, 2011

Lloshi, Xhevat, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987

Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 1999

Lotman, J., Uspensky, B. *On the Semiotic Mechanism of Culture*, New Literary History, 1978

Lynn, Kenneth, *Hemingway*, New York, Simon and Schuster, 1987

Manfredi, M. *Translating Text and Context: Translational Studies and Systematic Functional Linguistics*, vol. 1. Cagliari, CUEC, 2008

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

- McGuire, S. *Translation Studies*, London: Methuen, 1980
- McNally, Luise and Kennedy, Christopher, *Adjectives and Adverbs, Syntax, Semantics and Discourse*, New York, Oxford University Press, 2008
- Meyers, Jeffrey, *Hemingway: A Biography*, New York, Haper and Row, 1985
- Mimoza Gjokutaj, Shezai Rrokaj, Eneida Pema, *Gjuha Shqipe*, Botime Pegi, Tirane, 2017
- Miššiková, Gabriela, *Linguistic Stylistic*, Filozofická Fakulta, Univerzita Konštantína Filozofa, Nitra, 2003
- Mounin, G. *Les problèmes théoriques de la traduction*, Paris: Gallimard, 1963
- Morgan, Peter, *Ismail Kadare: Creativity under Communism*, The Australian Newspaper, 2005
- Morgan, Peter, *Ismail Kadare: The Writer and the Dictatorship 1957–1990*, Oxford: Legenda, 2010
- Munday, J., *Introducing Translation Studies*. London; New York: Routledge, 2001.
- Murry, John Middleton, *The Problem About Style*, Praeger, Oxford, 1980
- Newmark, Loenard, Hubbard, Philip, Prifti, Peter, *Standard Albanian*, Stanford, California, Stanford University Press, 1982
- Newmark, Peter, *About Translation*. Great Britain: Longdunn Press, Ltd, 1991.
- Newmark, Peter, *Approaches to Translation*, Perganon Press, Oxford, 1984
- Newmark, Peter, *A Textbook of Translation*. New York: Prentice-Hall International, 1988
- Neubert, A Shreve, G.M, *Translation as Text*, Kent State University Press, 1992
- Nida, E., *Language Structure and Translation*. Standford, California: Standford University Press, 1975.
- Nida, E., *Towards a Science of Translating*. Leiden: Brill, 1964.

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Nida, E., *Morphology: The Descriptive Analysis of words*, Univ. of Michigan Press, 1949

Nida, Eugene A and C.R. Taber, *The Theory and Practice of Translation*, Leiden: E.J. Brill, 1969/1982

Norris, Roy, *Ready for FCE*, Macmillan Publishing House, New York, 2012

Oxford Idioms Dictionary. Spain: Oxford University Press, 2005

Qesku, Pavli, *Fjalor Anglisht-Shqip*, Tiranë: Botime Edfa, 2005

Raeburn, John, *Fame Became of Him: Hemingway as Public Writer*, Bloomington: Indiana University Press, 1984

Radford, Andrew, *English Syntax, An Introduction*, Cambridge University Press, Cambridge, 2004

Reynolds, Michael S, *Hemingway's First War: The Making of a Farewell to Arms*, Princeton: Princeton University Press, 1981

Reynolds, Michael, *The Young Hemingway*, Oxford: Basil Blackwell, 1986

Revistë shkencore e Institutit Alb-Shkenca, Aktet, Vol. v, nr. 4, 2012

Ristani, Viktor. *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Tiranë: Mirgeeralb, 2010

Robinson, Douglas., *Western Translation Theory*, Manchester St Jerome Publishing, ed. 1997.

Ross, Lilian, *Portrait of Hemingway. Reporting*, New York, Simon and Schuster, 1964

Rosenfield, Claire, “*New World, Old Myths*”, *Twentieth Century Interpretations of The Old Man and the Sea: A Collection of Critical Essays*, Ed. Katherine, T. Jobs, Englewood Cliffs, N. J: Printice-Hall, 1964

Short, Michael.H, Leech, Geoffrey.N, *Style in Fiction; A linguistic Introduction to English Fictional Prose*, Routledge, 1981

Smith, Paul, *A Reader's Guide to the Short Stories of Ernest Hemingway*, Boston, G. K. Hall, 1989

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Snell-Hornby, Mary, *Translation Studies: An Integrated Approach*, Philadelphia: John Benjamin's Publishing Company, 1988.

Snell-Hornby, Mary, *The Turns of Translation Studies: New Paradigms or Shifting Viewpoints?*, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam, Philadelphia, 2006

Shuttleworth, M., Cowie, M., *Dictionary of Translation Studies*, St. Jerome, Manchester, 1997

Stankiewicz, Edward, *Style and Language*, Edizioni Dell'Ateneo, Roma, 1986

Steiner, George, *After Babel: Aspects of Language and Translation*, Oxford, England: Oxford University Press, 1975

Stephens, Robert O, *Hemingway's Nonfiction: The Public Voice*, Chapel Hill: University of North Carolina Press, 1968

Toury, Gideon, *Descriptive Translation Studies and Beyond*. Philadelphia, 1995.

Toury, Gideon, *In Search of a Theory of Translation*, Tel Aviv, 1980

Tupja, Edmond. *Këshilla një përkthyesi të ri*. Onufri 2000.

Thomai, Jani. *Leksikologjia e Gjuhës Shqipe*. Tiranë, Botimet Toena, 2006

Ulrych, M., Bollettieri Bosinelli, R.M. *The State of the Art in Translation Studies: An Overview*. Textus XII, 1999

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, *Mbi letërsinë e huaj bashkëkohore*, Shtëpia Botuese e Librit Universitarë, Tiranë 1989

Vinay, J. P, and J. Dalbernet. *Comparative Stylistics of French and English: A methodology for Translation*, translated by J.C Sager and M.J Hamel, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins, 1995

Wekker, Herman & Haegeman, Liliane, *A Modern Course in English Syntax*, London, New York, Routledge, 1985

Wiersema. N, *Globalisation and translation*, *Translation Journal*, 2004

William, D. Halsey, *Macmillan Dictionary*, Macmillan Publishing Company, New York, 1986

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**

Wilss, Wolfram, *The Science of Translation, Problems and Methods*, Tübingen, Gunter Narr Verlag, 1982

Wimsatt, W. K, *The Verbal Icon; Studies in the Meaning of Poetry*, University Press of Kentucky, 1960,

Wood, James, *Chronicles and Fragments: The novels of Ismail Kadare*, The New Yorker. Condé Nast, 2010

Young, Philip, *Ernest Hemingway: A Reconsideration*, University Park, Pennsylvania State University Press, 1966

Referenca

www.fjalorishqip.com

www.m.fjalori.shkenca.org

<http://www.panorama.com.al/bibliografia-e-vepres-se-kadarese/>

<https://www.fpa.es/en/cargarAplicacionNoticia.do?identificador=163>

www.gazetadita.al/kadare-shkrimtari-perkthyes

**Analizë krahasimtare gjithëpërfshirëse e versioneve të përkthimit në gjuhën shqipe të romanit
“Plaku dhe deti” të shkrimtarit amerikan Ernest Heminguei**
